



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of kosovo
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Raport i punës
Gusht 2008 – Gusht 2009

Përmbajtja

1. PASQYRË E PËRGJITHSHME	3
2. HYRJE	5
2.1 AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT (AKP) – AKTIVITETET E PËRGJITHSHME	6
3. MISIONI	41
3.1 VIZIONI	41
3.2 MISIONI	41
3.3 SYNIMET	41
3.4 ORGANOGAMI I AKP-SË	43
3.5 FINANCAT	44
4. DIVIZIONI I REALIZIMIT TE ASETETEVE	51
4.1 PRIVATIZIMET E PARAARDHËSIT TË AGJENCISË	51
4.2 PRIVATIZIMI NGA AKP	54
4.3 PRIVATIZIMI I TOKËS BUJQËSORE	56
4.4 BREZOVICA	59
4.5 NDËRMARRJET E GJAKOVËS	61
4.6 NSH MINIERA E BOKSITIT	63
4.7 NSH SHARR PRODHIMI	64
5. LIKUIDIMI	66
6. DIVIZIONI I QEVERISJES KORPORATIVE	76
6.1 SPIN OFF-I SPECIAL	76
6.2 NSH-TË E KOMERCIALIZUARA	109
6.3 ADMINISTRIMI I DREJTPËRDREJTË	127
6.4 MINIERAT E TREPÇËS	148
7. STRATEGJITË	156
8. PENGESA DHE RRUGA PËRPARA	160

1. PASQYRË E PËRGJITHSHME

I nderuari Kryetar dhe anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kam kënaqësinë kur shoh se Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) është plotësisht operacionale dhe po shkon përpara drejtë arritjes së caqeve të veta në privatizim dhe likuidim. Gjatë periudhës raportuese ne kemi kompletuar detyrat që rezultojnë prej planit të punës për 2008 dhe një pjesë të madhe të vitit 2009.

Në historikun e shkurtë të AKP-së (të themeluar në fund të gushtit 2008) bota ka parë krijimin e një shteti të ri dhe problemet me transferin e kompetencave nga UNMIK-u tek Institucionet e Republikës së Kosovës ndërsa AKP-ja është shembulli më i mirë i kësaj.

Pengesat e mëdha të dëshmuara gjatë periudhës raportuese dhe viteve të mëparshme ende nuk janë eliminuar. AKP-ja vazhdon të ballafaqohet me dokumente pronësie të pamjaftueshme dhe të dhëna të vjetruara kadastrale. Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës ka shumë ngarkesa me padi dhe ankesa prej kreditorëve dhe punëtorëve.

Për më tepër, Ligji për OVGJS sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Vendosje të Statutit të Kosovës të datës 26 mars 2007, ende nuk është adaptuar dhe si i tillë krijon probleme shtesë në punën e Agjencisë në lidhje me listat e punëtorëve dhe çështjet tjera të lidhura me AKP.

Poashtu, do të kisha dashur të ngritë një çështje shumë të rëndësishme të mos-njohjes së AKP-së nga ana e OVGJS dhe përfshirjen e UNMIK-ut në rastet në gjykata të cilat e përfaqësojnë Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), agjencinë e mëparshme që de facto dhe de jure nuk ekziston më si institucion.

Shkeljet e marrëveshjeve të zotimeve të NSH-ve të privatizuara përmes SOS po merr një pjesë disproporcionale të kohës dhe energjisë së Bordit të AKP-së meqenëse janë zhvilluar dhe adaptuar strategji dhe iniciativa të reja për të adresuar këto probleme. Sa i përket kësaj, AKP-ja ka përfunduar obligimet e veta ligjore dhe po vazhdon të adresojë çështjen duke angazhuar auditorë të specializuar të jashtëm për të vlerësuar performancën e Ndërmarrjeve të reja të privatizuara përmes metodës së Spin off-it Special.

AKP-ja gjithashtu ka trashëguar 9 NSH të komercializuara nga UNMIK-u. Pjesës më të madhe të kontratave të komercializimit do të ju kaloj afati pas 2011 dhe këto do të mbikëqyren nga afër gjatë kësaj periudhe dhe të gjitha veprimet ligjore do të ndërmerren në rast të ndonjë shkeljeje të kontratës së komercializimit.

Ne poashtu kemi arritur të kemi efektivitet në çështjen e 20-% dhe kemi realizuar premtimet e dhëna në fillim të funksionalizimit të AKP-së. Për më tepër, ne kemi trashëguar nga Agjencia e mëparshme një numër prej 166 kontratave të papërfunduara dhe unë kam kënaqësinë të ju njoftoj se një numër i madh i tyre ka përfunduar dhe se jemi duke vazhduar me përgatitje të të gjitha kontratave prej valëve të privatizimit që janë shpallur nga AKP-ja.

Megjithatë misioni dhe strategjia e AKP-së nuk do të ndryshojnë. Ne do të vazhdojmë me detyrën e administrimit të ndërmarrjeve dhe aseteve në mirëbesim për përfitim të pronarëve dhe kreditorëve. Ne do të bëjmë shitjen, transferin ose do të likuidojmë pa ndonjë shtyrje të mëtejme dhe do të punojmë më tepër në shpërndarjen e fondeve të mirëbesimit për kreditorët, punëtorët dhe pronarët sa më parë që është e mundur. Duke pasur këtë parasysh, ne gjithashtu do të punojmë në përfundim të detyrës tonë të parashikuar me ligj, të sigurojmë se të gjitha paditë janë trajtuar si duhet para se të bëjmë shpërndarjen.

AKP-ja ka trashëguar praktikatat dhe procedurat e punës të krijuara nga agjencia e mëparshme. Ne kemi arritur të ndërtojmë punën duke u bazuar në këto mirëpo gjithashtu kemi përmirësuar rrjedhën e punës si dhe e kemi bërë më efektive.

Në fund më lejoni të përsëris se ne jemi të angazhuar të arrijmë caqet që rezultojnë prej strategjisë së përgjithshme dhe planit të punës së AKP-së, megjithatë implikimet më të gjera të krizës ekonomike globale dhe ndryshimet e ligjeve në lidhje me punën e agjencisë mund të shkaktojnë devijime të pashmangshme prej planit.

Veç kësaj AKP-ja është e gatshme të ofroj shpjegime me shkrim në të gjitha kërkesat që Ju mund ti keni lidhur me çështje specifike të referuara në këtë raport
Përfundimisht, do të kisha dashur të shpreh mirënjohjen time për Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë për përkrahjen financiare.

Dino Asanaj,
Kryetar i Bordit të Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

2. HYRJE

Mbi 590 ndërmarrje biznesi në Kosovë janë identifikuar si Ndërmarrje Shoqërore potenciale (NSH).

Sektori i NSH-ve ka punësuar rreth 20,000 njerëz ndërsa numri i njerëzve në lista të punëtorëve shkon deri në 60,000 (p.sh. 40,000 ishin në pushim pa pagesë). NSH-të kanë operuar në një varietet të sektorëve duke përfshirë përpunimin e metaleve, plastikën, letrën, hotelet, minierat, agro-industrinë, bujqësinë, pylltarinë, materialet ndërtimore, ndërtimin, tekstilin, verarinë dhe vreshtat, prodhimin e birrës, duhanin, shitjen me pakicë dhe shumicë.

Është llogaritur që NSH-të kanë paraqitur rreth 90 përqind të bazës industriale dhe të minierave të Kosovës, 50 përqind të hapësirës për shitje komerciale me pakicë dhe më pak se 20 përqind të tokës bujqësore- duke përfshirë tërë tokën komerciale bujqësore dhe pjesën më të madhe të pyjeve të Kosovës.

Pjesa më e madhe e aseteve industriale të Kosovës, toka bujqësore, pyjet, toka komerciale urbane dhe pronat komerciale janë poseduar nga NSH-të. Privatizimi i këtyre aseteve - dhe tërheqja e investitorëve të huaj, atyre nga diaspora, regjioni dhe vendi në programin e privatizimit pritet të ketë ndikim të thellë dhe pozitiv në ekonomi dhe në krijimin e vendeve të punës.

Është e rëndësishme të theksojmë se procesi i privatizimit në Kosovë nuk mund të krahasohet me privatizimet në shtetet tjera, për shkak të specifikave të veta politike dhe ekonomike. NSH-të e Kosovës janë dezintegruar për më tepër se një dekadë nga masat e përkohshme. Kosova është shtet që ka pësuar shumë gjatë luftës dhe NSH-të nuk kanë qenë të përjashtuara nga ky proces. Në duhet të kemi në mendje se udhëheqja e ekonomisë së Kosovës ka qenë e centralizuar nga regjimi i mëparshëm në ish-Jugosllavi dhe një numër i madh i fabrikave është ndërtuar për tregje specifike. Poashtu duhet të theksojmë se tregjet e mëparshme kanë humbur dhe tregu aktual është i dominuar nga produktet e shteteve të huaja. Të gjitha çështjet e përmendura më lartë e bëjnë privatizimin në Kosovë specifik e gjithashtu paraqesin një problem të përgjithshëm për AKP-në.

Një pasqyrë e programit të privatizimit tregon se deri me 30 qershor 2008 agjencia e mëparshme (AKM-ja) ka shpallur 30 valë të privatizimit.

498 Ndërmarrje të reja janë tenderuar për shitje dhe 397 kontrata janë nënshkruar, me të ardhura totale nga privatizimi (të pranuar dhe të depozituara) me shumë prej €392,281,978.

Përfitimet e punëtorëve kanë arritur shumën prej €76,166,646 prej të cilave €15,558,654 janë paguar nga Bashkimi i Pavarur i Sindikatave të Kosovës për shpërndarje tek punëtorët. Poashtu, Bordi i Agjencisë së mëparshme ka aprovuar totalin prej 120 likuidimeve me të ardhura që kanë arritur shumën prej €3,804,992.

Në mbledhjen e Bordit të AKM-së, të mbajturë me 21 maj 2008, Kryetari i Bordit të Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues kanë caktuar një mbledhje tjetër të Bordit për 4 qershor 2008 dhe mbledhjen e fundit lamtumirëse të Bordit, të cilat për arsye të panjohura nuk janë mbajtur kurrë. Unë kam kontaktuar disa herë ish-menaxhmentin e AKM-së dhe anëtarët e Bordit me qëllim të thirrjes së mbledhjes dhe përgjigja e tyre ishte se disa anëtarë ndërkombëtar të Bordit janë jashtë shtetit dhe disa prej tyre kanë probleme shëndetësore. Për këtë shkak procesverbali i mbledhjes së fundit të Bordit të AKM-së nuk është miratuar dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim për tranzicion ose dorëzim korrekt dhe menaxhmenti aktual nuk ka njohuri se çka ka ndodhur në ndërkohë, përkundër faktit që unë personalisht kam kërkuar raport të performancës së anëtarëve vendor të Bordit.

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) ka përfunduar operimet me 30 qershor 2008.

2.1 AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT (AKP) – Aktivitetet e Përgjithshme


Agjencia Kosovare e Privatizimit (më tej referuar si "AKP") është themeluar si agjenci pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 "për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit" me ndryshime, të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të AKP-së. AKP-ja është themeluar me shpalljen e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 03/L-067) që ka hyrë në fuqi me 15 qershor 2008 (më tej i referuar si "Ligji"). Ky ligj implementon dispozitat relevante të Propozimit Gjithëpërfshirës për Vendosjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007 (Shtojca VII, neni 2), që është një pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 145 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës).

AKP-ja është themeluar si organ publik i pavarur që do të ushtrojë funksionet dhe përgjegjësitë me autonomi të plotë. Agjencia do të ketë zotësi të plotë juridike posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padisë dhe të paditet në emër të saj.

Fillimisht, anëtarët e Bordit të Drejtorëve të AKP-së janë emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe anëtarët ndërkombëtarë nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar në pajtim me dispozitat e Ligjit për themelimin e AKP-së dhe ky Bord ka juridiksion të plotë mbi AKP-në.

Hapi i parë ka qenë përshpejtimi i funksionimit të AKP-së dhe me qëllim të arritjes së kësaj ka qenë e domosdoshme të mundësohet qasja në objektin e AKP-së si dhe përgjegjësia ligjore e Bordit të Drejtorëve të AKP-së që të ushtrojë mandatin e përcaktuar me ligj.

Unë kam arritur të hyj në selinë kryesore të ish- Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit me 24 gusht 2008. Ne kemi vërejtur se të gjitha pajisjet në zyre mungonin, në oborr janë gjetur gjurmë të dokumenteve të djegura. Disa prej tyre janë dokumente origjinale dhe disa prej tyre që ishin të hedhura në mbeturina kanë pasur vulën e qartë





që tregonte konfidencialitetin dhe tërë dokumentacioni i Bordit të ish-AKM-së po mungonte. Ne po ashtu kemi gjetur edhe serverin ku mbaheshin kopjet elektronike të dokumenteve të ish AKM-së. Për më tepër, pesë zyre regjionale janë mbyllur dhe tërë pajisjet dhe dokumentet janë larguar dhe zyret në selinë kryesore të AKP-së kanë qenë të zbraztë, si dhe kasafortat ku është ruajtur dokumentacioni konfidencial, siç janë vlerësimet e N.Sh-ve të privatizuara përmes metodës së Spin off-it Special kanë qenë të zbrazëta. Zyrtarët e Policisë së Kosovës kanë qenë dëshmitar të situatës së përshkruar më lartë dhe të gjitha janë regjistruar dhe përfshirë në raport.

Me 26 gusht 2008 është mbajtur mbledhja e parë e Bordit të Drejtorëve të AKP-së dhe përveç emërimit të menaxhmentit të ri të AKP-së me miratimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së, dokumentet zyrtare janë dërguar tek Z. Lamberto Zannier- PSSP i UNMIK-ut dhe Z. Paul Acda ZPSSP i UNMIK-ut ku ndër të tjera ne kemi kërkuar kthimin e menjëhershëm të dokumentacionit që mungonte dhe pajisjeve që janë përdorur paraprakisht nga AKM-ja gjithmonë me qëllimin e fillimit të funksionimit të agjencisë së re sa më shpejtë që është e mundur.



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Për: Z. Lamberto Zannier
PSSP

26 gusht 2008

I nderuari Z. Zannier

Siç jeni të informuar, Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 03/ L-067) ka hyrë në fuqi me 15 qershor 2008 (më tej i referuar si " Ligji". Ky ligj implementon dispozitat relevante të Propozimit Gjithëpërfshirës të Vendosjes së Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007 (Shtojca VII, neni 2) që është pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 145 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës).

Në përputhje me ligjin, Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar si një organ publik i pavarur. Është vendosur si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.2002/12 për Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, me ndryshime dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit janë transferuar tek Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Meqenëse Kuvendi i Kosovës dhe Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar kanë emëruar anëtarët e tyre përkatës të Bordit të Drejtorëve, Agjencia Kosovare e Privatizimit është e gatshme të ushtrojë mandatin sipas ligjit. Ju gjithashtu e dini, Komisioni Evropian është angazhuar të financojë pagat e stafit lokal të cilët më parë kanë qenë të punësuar në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit me qëllim të sigurimit të shkallës më të lartë të mundur të vazhdimësisë operacionale.

Siç keni shpjeguar në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të datës 25 korrik 2008, si rezultat i vendimit të Unionit Evropian për t'i dhënë fund financimit të shtyllës së IV të UNMIK-ut (ristrukturimi ekonomik) UNMIK-u ka mbetur pa kapacitete teknike dhe buxhet për të kryer ndonjë funksion në fushën e zhvillimit ekonomik, duke përfshirë edhe çështjet e lidhura me ndërmarrjet shoqërore. Më tej, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Republika e Kosovës ka deklaruar vullnetin e saj sovran ashtu që çdo funksion politik dhe administrativ për çështjet që më parë ishin nën autoritetin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit tani e tutje do të jenë nën autoritetin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që është një organ publik i pavarur i Republikës së Kosovës.

Në këtë kontekst, unë në këtë mënyrë ju informoj se Agjencia Kosovare e Privatizimit ka marrë nën posedim dhe kontroll objektet që më parë ishin objekte të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Ky veprim ka qenë i domosdoshëm me qëllim që të sigurojë mbrojtjen e duhur ligjore të interesave legjitime të Republikës së Kosovës si dhe të drejtat dhe interesat e pronarëve potencial , kreditorëve dhe punëtorëve të ndërmarrjeve nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit ka pushuar në mënyrë efektive së vepruari dhe në të njëjtën kohë Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka pasur qasje në objektet dhe pronën esenciale / të dhënat e domosdoshme për mirëmbajtje të vazhdimësimit të procesit të privatizimit dhe likuidimit dhe përmbushjes së mandatit të saj ligjor.

Do të kisha dashur të përsëris se të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës kanë treguar angazhim të plotë për të bashkëpunuar me organizatat ndërkombëtare që veprojnë ligjërisht në Kosovë, duke përfshirë UNMIK-un dhe pritjet që UNMIK-u është në mënyrë reciproke i angazhuar për një bashkëpunim të tillë në bazë të vullnetit të mirë. Unë besoj se nuk është në interes të UNMIK-ut dhe të Organizatës së Kombeve të Bashkuara; që të kenë përgjegjësi nëse të drejtat legjitime dhe interesat e kreditorëve, pronarëve dhe punëtorëve do të shkelen në mënyrën që ngarkon UNMIK-un për refuzimin eventual për të dhënë/kthyer qasjen në objekte dhe

pronën/ të dhënat relevante Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Për këtë shkak, me qëllim që të shmangim pasojat e tilla ju ftoj që të transferoni shpejt dhe qetë të gjitha pronat/të dhënat relevante të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit tek Agjencia Kosovare e Privatizimit në mënyrë të përshtatshme ndërmjet UNMIK-ut, Shtyllës BE dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Sinqerisht,

Dino Asanaj
Kryetar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së

Kopje: Dr. Fatmir Sejdiu
President i Republikës së Kosovës

Z. Hashim Thaçi
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Z. Peter Feith
Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Për: Z. Paul Acda
ZPSSP- Shtylla IV e BE-së

26 gusht 2008

I nderuari Z. Acda

Siç jeni njoftuar, Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 03/L-067) ka hyrë në fuqi me 15 qershor 2008 (më tej i referuar si "Ligji"). Ky ligj implementon dispozitat relevante të Propozimit Gjithëpërfshirës për Vendosjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007 (Shtojca VII, neni 2), që është një pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 145 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës).

Në përputhje me ligjin, Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar si një organ publik i pavarur. Është vendosur si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.2002/12 për Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, me ndryshime dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit janë transferuar tek Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Meqenëse Kuvendi i Kosovës dhe Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar kanë emëruar anëtarët e tyre përkatës të Bordit të Drejtorëve, Agjencia Kosovare e Privatizimit është e gatshme të ushtrojë mandatin sipas ligjit. Ju gjithashtu e dini, Komisioni Evropian është angazhuar të financojë pagat e stafit lokal të cilët më parë kanë qenë të punësuar në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit me qëllim të sigurimit të shkallës më të lartë të mundur të vazhdimësisë operacionale

Në këtë kontekst, me këtë ju informoj se Agjencia Kosovare e Privatizimit ka marrë nën posedim dhe kontroll objektet të cilat më parë kanë shërbyer si objekte të selisë kryesore të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Ky veprim ka qenë i domosdoshëm me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së përshtatshme ligjore të interesave ligjore të Republikës së Kosovës si dhe të drejtat dhe interesat e pronarëve potencial, kreditorëve dhe punëtorëve të ndërmarrjeve nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit ka pushuar së vepruari me vendimin e PSSH-së dhe në të njëjtën kohë Agjencisë Kosovare të Privatizimit i është ndaluar qasja në objekte dhe pronën/ të dhënat esenciale të domosdoshme për mirëmbajtjen e vazhdimit të lehtë të procesit të privatizimit dhe likuidimit dhe përmbushjes së mandatit ligjor. Poashtu pajisjet e BKK-së të mbajtura në objekte janë pronë e Republikës së Kosovës dhe si të tilla i janë dorëzuar pronarit të ligjshëm.

Megjithatë, dua të përsëris se Agjencia Kosovare e Privatizimit është plotësisht e angazhuar të bashkëpunojë me të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare që në bazë të ligjit operojnë në Kosovë dhe i njëjti angazhim reciprok pritet për

bashkëpunim. Unë besoj se është në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës, Shtyllës së BE-së në UNMIK, UNMIK-ut dhe Kombeve të Bashkuara që Agjencia Kosovare e Privatizimit të fillojë operimet sa më shpejtë që është e mundur me qëllim që të shmangë ngarkesën e përgjegjësisë potenciale nëse të drejtat dhe interesat e kreditorëve, pronarëve dhe punëtorëve do të shkelen në mënyrë që do të ngarkonte paraardhësin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit nëse vazhdon refuzimi i dhënies / kthimit të qasjes në objektet tjera dhe pronat/ të dhënat tjera relevante. Për këtë shkak me qëllim të shmangies nga pasojat e tilla, ju ftoj të aranzhoni një transfer të shpejtë dhe të qetë të të gjitha pronave/ të dhënave relevante (kopje të shtypura dhe elektronike) të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit në mënyrë të përshtatshme të marrëveshjes ndërmjet Shtyllës së BE-së në UNMIK dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Poashtu, duke qenë në dijeni për angazhimin e juaj në të kaluarën si Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, unë nuk kam ndonjë dyshim se ju doni të na ndihmoni në mënyrë të mundshme për të siguruar se Agjencia Kosovare e Privatizimit si pasardhëse do të zhvillojë përfundimin e suksesshëm të punës së lënë nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit sa i përket procesit të privatizimit dhe likuidimit. Për këtë shkak, me respekt kërkoj dhënien e të gjitha pajisjeve për nevojat e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, gjë që kuptoj se janë pronë e Shtyllës së BE-së të UNMIK-ut që janë përdorur nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në SK të AKM-së dhe në Zyret Regjionale të AKM-së) duke përfshirë por jo kufizuar, të gjitha të dhënat, kompjuterët, printerët, makinat për orto-foto, tavolinat, karriget automjetet, serverët, telefonat, fax makinat etj, të përdorura në të kaluarën nga stafi i AKM-së.

Kisha dashur të shfrytëzoj rastin dhe të shpreh mirënjohjen time për rolin që ka pasur Shtylla BE në UNMIK për përkrahjen e zhvillimit ekonomik në Kosovë.

Nëse keni nevojë për ndonjë informatë shtesë ose asistencë ju lutem mos hezitoni të më kontaktoni.

Sinqerisht;

Dino Asanaj

Kryetar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së

Kopje: Dr. Fatmir Sejdiu

President i Republikës së Kosovës

Z. Hashim Thaçi

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Z. Peter Feith

Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë

Z. Lamberto Zannier

PSPP UNMIK

Dokumentacioni i lartpërmendur është kthyer në posedim të AKP-së dhe serverët janë aktivizuar dhe në ata kanë qenë të ruajtura versionet elektronike të dokumenteve duke përfshirë të gjitha të dhënat prej zyrave regjionale dhe Selisë Kryesore të Agjencisë. Mbetet të shihet nëse mund të gjendet i tërë dokumentacioni dhe ne mbajmë të drejtën për mos-mbajtje të përgjegjësisë në çdo kohë.

Si pasojë, Zyra e Shtypit në UNMIK ka lëshuar komunikatën për media e cila konfirmon faktet e paraqitura më lartë.



UNMIK/PR/1737

E martë, 9 shtator 2008

PSSP viziton Agjencinë Kosovare të Privatizimit

PRISHTINË – Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), Lamberto Zannier, dhe Paul Acda, udhëheqës i Shtyllës IV të UNMIK-ut, sot kanë vizituar objektin e ish-Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), tani Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).

“Deri më tani duket se nuk ka diçka që mungon përveç dokumentacionit të shtypur të Bordit të Drejtorëve të AKM-së që janë nën posedim të UNMIK-ut. Unë jam siguruar prej përfaqësuesve të Shtyllës së BE-së se tërë dokumentet e AKM-së janë të ruajtura në formë elektronike duke përfshirë edhe ankesat. Kur i ka larguar këto dokumente, Z. Acda ka vepruar në emër të UNMIK-ut. Megjithatë nëse ka ndonjë shenjë se diçka tjetër po mungon atëherë do të ketë hetime nga policia”, tha PSSP Zannier.

“Përfaqësuesit e AKP-së posedojnë gjithashtu serverin për të cilin më kanë siguruar përfaqësuesit e Shtyllës IV të BE-së se i përmban gjithë arkivin e AKM-së që përbëhet nga kopjet elektronike të të gjitha dokumenteve zyrtare dhe korrespondencës duke përfshirë të dhënat e Bordit të Drejtorëve”, ka shtuar Zannier.

Me 1 shtator 2008, mbajt mbledhja e dytë e Bordit të Drejtorëve të AKP-së dhe gjatë kësaj mbledhjeje janë miratuar të gjitha aktet nënligjore që krijojnë kornizën e punës së pjesës ekzekutive të AKP-së dhe në mënyrë simultante mundësojnë funksionimin e AKP-së si dhe punën përgatitore për operim me kohë të AKP-së.

Me 10 shtator 2008, AKP-ja është pajtuar me obligimet e veta ligjore që rezultojnë prej Ligjit për Themelimin e AKP-së dhe ka ofruar raportin e vet të parë Kuvendit të Republikës së Kosovës, që është prezantuar më poshtë.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT – KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU –
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

10 shtator 2008

Për: Z. Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Lënda: Njoftim mbi ecurin e punëve në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP)

I nderuar Z.Kryetar,

Sic jeni në dijeni, me rastin e hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, respektivisht në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës të Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-067 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) si organ të pavarur publik me zotësi të plotë juridike dhe si pasardhëse të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM-së) që ka qenë e themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12.

Gjithashtu, në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi themelimin e AKP-së është emëruar Bordi i Drejtorëve të AKP-së nga Kuvendi i Republikës së Kosovës si dhe anëtarët ndërkombëtarë të AKP-së nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, dhe ky bord ka të gjitha kompetencat mbi AKP-në.

Në vazhdim, hapi i radhës ka qenë funksionalizimi sa më i shpejtë i AKP-së, dhe për një gjë të tillë ka qenë e domosdoshme sigurimi i qasjes në objektet e ish – AKM-së si dhe obligimi ligjor për Bordin e Drejtorëve të AKP-së për ushtrimin e mandatit të përcaktuar me ligj në vecanti sigurimi dhe ruajtja e dokumentacionit përkatës. Paraprakisht, në cilësinë e Kryetarit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, gjithmonë në përputhje me dispozitat ligjore është siguruar Pëlqimi nga Kuvendi Komunal i Prishtinës për vazhdimin e shfrytëzimit nga ana e AKP-së të objekteve në shfrytëzim të ish-AKM-së, pasi që objektet në fjalë janë pronë e Kuvendit Komunal të Prishtinës. Gjithashtu, në përputhje me dispozitat ligjore kam kërkuar asistencën e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës në rast të ndonjë pengese në ushtrimin e mandatit të përcaktuar me Ligj dhe vendimit të Parlamentit të Republikës së Kosovës për Emërimin e Drejtorëve të Bordit të AKP-së.

Në cilësinë e Kryetarit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së për herë të parë më është mundësuar qasja në objektet e ish-AKM-së me datë 24 gusht 2008, dhe me këtë rast


Dino Asanaj
Kryetar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së

dëshiroj të ju informoj se i gjithë procesi është i dokumentuar edhe nga vet Pjesëtarët e Policisë së Kosovës. Gjendja në të cilën kemi hasur është se nuk ka pas asnjë pajisje në zyrat e selisë (d.m.th. kompjuterë, printues, telefon etj), kemi hasur në gjurmë të dokumenteve të djegura, kemi hasur në dokumente të ndryshme (disa prej tyre shifet qartë se nuk janë kopje por dokumente origjinale dhe mbajnë qartë shënimin si dokumente konfidenciale) të hudhura në shportë të mbeturinave, dhe më brengosëse ka qenë fakti se ka munguar i gjithë dokumentacioni i Vendimeve të Bordit të Drejtorëve të AKM-së. Me këtë rast dëshiroj të theksoj se kemi hasur në shumë dokumente të paketuara dhe dokumente të ndryshme në disa prej zyreve, dhe në dukje mund të thuhet se janë shumica e dokumenteve nga arkivat e zyreve regjionale të ish-AKM-së, gjithashtu kemi gjetur edhe një pajisje elektronike për ruajtjen e të dhënave ("server") ku mendojmë se janë të ruajtura kopjet elektronike të dokumentacionit të ish-AKM-së.

Duke u ballafaquar me një situatë të tillë jo të rëndomtë, kam qenë i obliguar që në mënyrë urgjente të kërkoj anagazhimin e disa prej nënpunësve të ish-AKM-së për të ndërmarrë veprimet e menjëhershme për prezervimin e dokumentacionit të hudhur si dhe gjurmëve të dokumenteve të djegura si dhe sigurimin fizik të objekteve nga Policia e Kosovës dhe fillimin e punëve përgaditore për takimin konstituiv të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Me datë 26 gusht 2008 është mbajtur takimi konstituiv i Bordit të Drejtorëve të AKP-së dhe përveç emërimit të menaxhmentit të Agjencisë, me miratimin e bordit të drejtorëve të AKP-së i janë drejtuar shkresat Zt. Lamberto Zannier – PSSP i UNMIK-ut dhe zt. Paul Acda ZPSSP i UNMIK-ut ku ndër të tjera është kërkuar kthimi i menjëhershëm i dokumenteve që mungojnë si dhe donacionit të mundshëm të pajisjeve të ndryshme që kanë qenë më herët në shfrytëzim të ish-AKM-së me qëllim të funksionalizimit sa më të shpejtë të Agjencionit pasardhës. Deri më sot nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

Me datë 29 gusht 2008 është mbajtur takimi me zt. Renzo Daviddi Shef i Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë dhe bashkëpunëtorët e tij, me të cilët më herët Unë në cilësinë e Kryetarit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së kam nënshkruar marrëveshjen për financimin e AKP-së në vlerë prej 3 milion euro, që parashikohen të mbulojnë shpenzimet për paga të personelit profesional vendor të AKP-së. Me këtë rast Zt. Daviddi është njoftuar për së afërmi mbi situatën me të cilën ballafaqohemi si dhe ecurinë e deritanishme dhe hapat të cilët do të ndërmerren për sanimin sa më të shpejtë të gjendjes në mënyrë që Agjencia të jetë në gjendje të plotësojë kushtet e diktuar nga marrëveshja e lartpërmendur përkundër të gjitha vështirësive që nuk kemi mundur të parashikojmë të dy palët me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes për financim.

Me datë 1 shtator 2008 është mbajtur takimi i dytë i Bordit të Drejtorëve të AKP-së ku janë miratuar të gjitha aktet nënligjore që formojnë kornizën e punës së pjesës ekzekutive të Agjencisë, dhe mundësojnë krahas punës për funksionalizimin e Agjencisë edhe fillimin e punëve përgaditore të operacionalizimit të Agjencisë me kohë.

~~Dëshiroj të theksoj faktin se për secilin takim të Bordit të Drejtorëve në fund janë lëshuar komunikatat zyrtare nga Agjencia për mediat vendore, për informim të publikut në lidhje~~

me zhvillimet në Agjencinë dhe vendimet e Bordit të Drejtorëve. Sidoqoftë, si pasojë e disa shkrimeve në disa prej gazetave të përditshmeve vendore, dhe më këtë rast dëshiroj të theksoj se pothuajse asnjë prej tyre nuk përkon me komunikatat zyrtare të lëshuara nga Agjencia, me datë 9 shtator 2008 jam informuar për vizitën e Zt. Lamberto Zannier – PSSP i UNMIK-ut dhe zt. Paul Acda ZPSSP i UNMIK-ut në selinë e Agjencisë për të parë për së afërmi gjendjen aktuale. Gjatë kësaj vizite dhe bisedës me përfaqësuesit e lartëpërmendur të UNMIK-ut i kam informuar në lidhje me situatën dhe gjithashtu prej tyre kam marrë konfirmimin se të gjitha dokumentet e Bordit të Drejtorëve të AKM-së janë në posedim të UNMIK-ut, gjithashtu e tërë arkiva elektronike e AKM-së gjindet në njërin prej pajisjeve elektronike për ruajtjen e të dhënave që ndodhet në selinë e AKP-së dhe se të gjithë kopjet e dokumenteve që janë marrë do kthehen në posedim të AKP-së.

Ndër të tjera gjatë vizitës më është ofruar për nënshkrim marrëveshja për donacion të pajisjeve teknike që kanë qenë më herët në shfrytëzim nga personeli i AKM-së, nënshkrimin e të cilës Unë në cilësinë e Kryetarit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së e kam kushtëzuar me kthimin e dokumentacionit të lartëpërmendur, duke pas parasysh faktin se kthimi i dokumentacionit është faktori më relevant për kontinuitetin e AKP-së.

Së fundi më lejoni të ju informoj se takimi i radhës i Bordit të Drejtorëve të AKP-së do të mbahet me datë 11 shtator 2008, ku do të parashtrahet për aprovim Struktura Organizative e AKP-së së bashku me politikat e personelit dhe gjithashtu rikonfirmimi i aprovimit të valës të 31 të procesit të privatizimit në Kosovë, ku data e shpalljes së kësaj vale është në varësi të drejtëpërdrejtë me faktin e kthimit të dokumentacionit të lartëpërmendur.

Vendimet e marra në këtë takim të Bordit të Drejtorëve do të përmbyllin ciklin e vendimeve të domosdoshme për fillimin e funksionalizimit të AKP-së, duke përfshirë strukturën organizative të AKP-së, politikat e punësimit dhe personelit, politikat bankare, statutin, aktin e themelimit si dhe procedurat operacionale.

Duke pas parasysh vështirësitë e lartëpërmendura si dhe përgaditjeve dhe vlerësimit paraprak nga personeli profesional i AKP-së, skenaret e mundshme të funksionalizimit të AKP-së janë në varësi të drejtëpërdrejtë nga reciprociteti i pritshëm nga UNMIK-u dhe Shtylla e IV e UNMIK-ut në kërkesat e ligjshme dhe të arsyeshme të AKP-së për kthimin e dokumentacionit dhe donacionit eventual të pajisjeve të nevojshme. Në rastin më të mirë të mundshëm (pra kthimi i menjëhershëm i dokumenteve si dhe donacioni i pajisjeve) procedurat e përshpejtuara të prokurimit të objekteve për nevoja të zyreve regjionale të AKP-së (5 zyra: Prishtinë, Pejë, Gjiilan, Prizren dhe Mitrovicë), kompletimi i instalimeve të nevojshme të rrjetit informativ, testimi dhe azhurimi i arkivës elektronike, punësimi i personelit të domosdoshëm (përafërsisht 250 punonjës) do të mund të realizohet brenda periudhës prej dy muaj. Cdo skenar tjetër do të shkaktonte vonesa dhe me siguri komplikime të panevojshme dhe normalisht që pasojat do të ishin të rënda.

Sidoqoftë, dëshiroj të ju siguroj se pa marrë parasysh skenarët e pritshëm të zhvillimeve të lartëpërmendura dhe opsioneve tjera alternative që do të mund t'i imponoheshin Agjencisë ju do të jeni të informuar me kohë.

Duke ju falemnderuar për besimin e dhënë mua dhe anëtarëve të tjerë vendor të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, ju lutem nëse kërkohen sqarime shtesë mos hezitoni të më kontaktoni.

Me respekt,

Dino Asanaj,



Kryetar i Bordit të Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Me 11 shtator 2008 është mbajtur mbledhja e tretë e Bordit të Drejtorëve të AKP-së dhe gjatë kësaj mbledhjeje është miratuar struktura organizative e AKP-së së bashku me politikat e stafit dhe rikonfirmimin e miratimit të valës 31 të procesit të privatizimit në Kosovë.

Mbledhja e katërt i Bordit të Drejtorëve është mbajtur me 14 tetor dhe në këtë mbledhje është miratuar plani i punës për periudhën shtator-dhjetor 2008 dhe Bordi gjithashtu ka miratuar ndryshimet në politikat operacionale si dhe ka miratuar valën 32 të privatizimit.

Mbledhja e pestë e Bordit të Drejtorëve është mbajtur me 6 nëntor dhe gjatë kësaj mbledhjeje janë miratuar ndryshimet në urdhëresat e Agjencisë si dhe është miratuar vala 33 e privatizimit.

Gjatë kësaj periudhe të shkurtër kohore AKP-ja ka arritur të publikojë dhe përmbyll me sukses tri valë të privatizimit duke krijuar 21 Ndër. te reja.

Mbledhja e gjashtë e Bordit të Drejtorëve është mbajtur me 11 dhjetor 2008 dhe gjatë kësaj mbledhjeje janë miratuar nga Bordi valët 31 dhe 32 të privatizimit.

Me 23 dhjetor 2008 AKP-ja ka dorëzuar raportin e dytë tremujor në Kuvendin e Republikës së Kosovës në lidhje me aktivitetet e veta dhe operimet.



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

23 dhjetor 2008

Për: Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Lënda: Raporti tremujor mbi aktivitetet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP)

I nderuari Kryetar dhe Anëtarë të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Siç jeni në dijeni me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, respektivisht në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës të Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-067 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) si organ të pavarur publik me zotësi të plotë juridike dhe si pasardhëse të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM-së) që ka qenë e themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12.

Bazuar në paragrafin 20, pika 20.1 të Ligjit mbi themelimin e AKP-së, bordi i dorëzon Kuvendit të Kosovës dhe i bën publike raportet tremujore të cilat përmbledhin aktivitetin e Agjencisë dhe i pasqyrojnë rezultate financiare.

Me këtë rast, ju lus të më lejoni t'ju informoj mbi ecurinë e aktiviteteve të AKP-së deri më sot.

Fillimisht, Bordi i Drejtorëve të AKP-së është themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës si dhe anëtarët ndërkombëtar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi themelimin e AKP-së dhe ky Bord ka juridiksion të plotë mbi AKP-në.

Hapi i parë ka qenë përsheptimi i funksionalizimit të AKP-së dhe për të arritur këtë është dashur të mundësohet qasja në objektet e ish AKM-së si dhe ishte obligim ligjor i Bordit të Drejtorëve të AKP-së për të ushtruar mandatin që iu është caktuar me ligj. Si Kryesues i Bordit të Drejtorëve të AKP-së dhe në përputhje me dispozitat ligjore unë kam kërkuar ndihmë nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës në rast se haset në ndonjë pengesë gjatë ushtrimit të mandatit të caktuar me ligj dhe me vendimin e Parlamentit të Republikës së Kosovës për caktimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Në cilësinë e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së për herë të parë kam pas mundësi të hyj në objektet e ish AKM-së më 24 gusht, 2008 dhe me këtë rast unë dëshiroj t'ju informoj se i tërë procesi është shoqëruar nga Policia e Kosovës. Situata me të cilën jemi ballafaquar ishte se në selinë qendrore nuk kishte asnjë pajisje, kishte dokumente të djegura, dokumente të ndryshme të hedhura në kuti plehrash dhe më brengosëse ka qenë mungesa e tërë dokumentacionit mbi Vendimet e Bordit të Drejtorëve të AKM-së. Është me rëndësi të përmendet fakti se shumë prej dokumenteve janë gjetur të paketuara dhe më vonë kemi arritur në përfundim se ky dokumentacion i ka takuar arkivave të zyrave rajonale të ish AKM-së, të cilat tani me hapjen e zyrave rajonale të AKP-së janë kthyer në zyrat përkatëse.

Pas ballafaqimit me një situatë të pazakontë, unë isha i obliguar të kërkoj angazhim urgjent të disa prej ish punëtorëve të AKM-së për të ndërmarrë disa veprime urgjente në mënyrë që të mbrohet dokumentacioni i hedhur dhe për t'u kujdesur për gjurmët e dokumentacionit të djegur si dhe nga Policia e Kosovës për të ofruar siguri fizik për objektet dhe për të filluar me aktivitetet parapërgatitore në mënyrë që të organizohet edhe takimi i radhës i Bordit të Drejtorëve të AKP-së. Sidoqoftë, ne e kemi të drejtën për të deklaruar në një moment të caktuar kohore se nuk është kthyer i tërë dokumentacioni, pasi që dokumentacioni është larguar një herë dhe nuk ka pas ndonjë dorëzim zyrtar të tij nga Agjencia paraardhëse.

Më 26 shtator, 2008 mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur, dhe përpos caktimit të menaxhmentit të Agjencisë së re, me aprovimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së, dokumentacioni zyrtar i është dërguar Z. Lamberto Zannier – UNMIK PSSP dhe Z. Paul Acda UNMIK ZPSSP, ku ndër tjerash kemi kërkuar kthimin e menjëhershëm të dokumentacionit që mungonte, pajisjeve të ndryshme të cilat ishin përdorur më parë nga AKM-ja, gjithmonë me qëllim të fillimit të funksionalizimit të Agjencisë së re sa më shpejt që të jetë e mundur.

Më 1 shtator 2008 mbledhja e dytë e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur, dhe gjatë kësaj mbledhje janë miratuar të gjitha aktet nën-ligjore të cilët përbëjnë kornizën e pjesës ekzekutive të Agjencisë dhe njëkohësisht mundësojnë funksionimin e Agjencisë si dhe punët parapërgatitore për funksionimin me kohë të Agjencisë.

Më 9 shtator 2008, Z. Lamberto Zannier – UNMIK PPSP dhe Z. Paul Acda UNMIK ZPSSP kanë vizituar objektet e Agjencisë në mënyrë që të shohin situatën aktuale. Gjatë kësaj vizite dhe gjatë diskutimeve me përfaqësuesit e lart-përmendur të UNMIK-ut unë kam ofruar informata lidhur me situatën dhe nga ta kam marrë konfirmimin se i gjithë dokumentacioni i Bordit të Drejtorëve është në posedim të UNMIK dhe e tërë arkiva elektronike e AKM-së gjendet në një bazë të dhënash elektronike në Selinë Kryesore të AKP-së dhe të gjitha kopjet e dokumenteve të marra do t'i kthehen në posedim AKP-së. Dokumentacioni i lart-përmendur i është kthyer AKP-së në posedim dhe serverët ishin aktivizuar në të cilët versioni elektronik i të gjitha dokumenteve ruhet përfshirë edhe të dhënat nga zyrat rajonale dhe nga Selia Kryesore e AKP-së. Mbetet për të parë nëse i gjithë dokumentacioni është këtu. Më 11 shtator 2008, është mbajtur mbledhja e tretë e Bordit të Drejtorëve, dhe në këtë mbledhje është aprovuar struktura organizative e AKP-së si dhe politikat e staft dhe është bërë ri-konfirmimi për Valën 33 të privatizimit.

Mbledhja e katërt e Bordit të Drejtorëve është mbajtur me 14 tetor dhe këtu është aprovuar biznesi plani për periudhën shtator-dhjetor 2008, Bordi gjithashtu ka aprovuar ndryshimet në politikat e staftit si dhe ka aprovuar Valën 32 të privatizimit.

Mbledhja e pestë e Bordit të Drejtorëve është mbajtur më 6 nëntor, gjatë së cilës janë aprovuar ndryshimet e Urdhërësive të Agjencisë si dhe është aprovuar Vala 33 e privatizimit.

Sa i përket procesit të privatizimit unë dëshiroj t'ju informoj se Agjencia gjatë kësaj periudhe të shkurtë kohore ka arritur të publikoj dhe të përfundoj me sukses tri Valë të privatizimit duke krijuar 21 Ndër. të Reja.

Dita e ofertimit për Valën 31 të privatizimit ishte 19 Nëntori duke përfshirë shtatë (7) N. Sh në nëntë (9) Ndër. të Reja. Numri i ofertave të pranuar me spin-off të rregullt ishte 84, me një shumë totale prej €7,840,666.

Dita e ofertimit për Valën 32 të privatizimit ishte 3 dhjetori 2008, përfshirë katër (4) N. SH në gjashtë (6) Ndër. të Reja. Numri i ofertave të pranuar me spin-off të rregullt ishte 18, me një shumë totale prej €1,922,150.

Dita e ofertimit për Valën 33 të privatizimit ishte mbajtur më 17 dhjetor 2008, përfshirë katër (4) N. SH në pesë (5) Ndër. të Reja. Numri total i ofertave të pranuar me spin-off të rregullt ishte 15, me një shumë totale prej €909,072.

Mbledhja e gjashtë e Bordit të Drejtorëve ishte mbajtur më 11 dhjetor 2008 dhe gjatë kësaj mbledhje shitet nga Vala 31 dhe 32 e privatizimit janë aprovuar nga Bordi, ndërsa lidhur me rezultatet e Valës 33 Bordi i Drejtorëve do të vendos në mbledhjen e radhës e cila do të mbahet në janar të vitit 2009.

Një prej aktiviteteve kryesore e caktuar si prioritet nga ana e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është shpërndarja e 20% për listat nga shitja e ndërmarrjeve. Brenda kësaj periudhe të shkurtë AKP përkundër të gjitha vështirësive ka arritur të shpërndaj **7 lista për punëtorët e N. Sh-ve.**

IMN Dukagjini	(€1,099,220.39 –	227 Punëtorë)
Fabrika e Plastikës	(€ 85,335.61 –	142 Punëtorë)
Fan	(€ 450,297.77 –	420 Punëtorë)
Eximkos	(€ 547,685.31 –	110 Punëtorë)
Stacioni i Veterinës	(€ 32,573.39 –	5 Punëtorë)
Kosova Kontroll	(€ 17,476.67 –	6 Punëtorë)
Bujqësia Zahaq	(€ 145,933.61 –	115 Punëtorë)
Total	€2,478,522.75 –	1,025 Punëtorë

Është me rëndësi të theksohet se duke konsideruar rëndësinë dhe implikimet nga vonesa e shpërndarjes së 20% për punëtorët e pranueshëm AKP-ja ka katërfishuar numrin e punëtorëve të cilët merren me përpilimin dhe rishikimin e listave dhe ankesave lidhur me 20%. Numri i punëtorëve që kanë punuar në Agjencinë paraprake ishte në total tre, ndërsa tani ekzistojnë dy njësi (njësia për listat e punëtorëve dhe komisioni për rishikimin e ankesave) që në total përbehen prej 11 punëtorëve të cilët punojnë ekskluzivisht në listat e punëtorëve.

AKP gjithashtu ka arritur të hap të gjitha zyrat rajonale (Prishtina, Peja, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan) duke krijuar kushtet për funksion të plotë të AKP-së. Duke hapur zyrat rajonale dhe duke angazhuar stafin e nevojshëm profesional janë plotësuar të gjitha parakushtet për ri-themelimin e përafërsisht 120 komisioneve të likuidimit të cilat do të aprovohen në mbledhjen e radhës së Bordit të Drejtorëve e cila do të mbahet në Janar 2009.

Aktiviteti tjetër i Agjencisë ishte procedura e përzgjedhjes së Drejtorit Menaxhues për Trepçën jugore, aktivitet ky që ka filluar në tetor të këtij viti përmes konkursit publik. Pas intervistimit të kandidatëve të përzgjedhur nga paneli intervistues i cili ishte i përbërë nga anëtarë të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Ministrisë së Energjisë dhe Minierave dhe përfaqësues së Trepçës, dhe kandidati më i suksesshëm ishte përzgjedhur Z. Ferat Shala i cili do të ushtroj këtë pozitë prej 15 dhjetorit 2008.

Sa i përket të ardhurave nga procesi i privatizimit të cilat mbahen në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) menjëherë pas themelimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së dhe menaxhmentit të AKP-së nënshkrimet e zyrtarëve janë deponuar dhe me këtë rastet fondet janë vendosur nën kontrollin e AKP-së. Dëshirojmë të theksojmë faktin se AKP-ja ka në vazhdimësi ka kërkuar nga BQK-ja të konfirmoj se të ardhurat e Agjencisë janë të garantuara dhe nga e njëjta ka marr informatën se këto të ardhura janë të sigurta dhe se investimet e bëra nga BQK-ja rezultojnë me beneficione (shih letrën e kopjuar të bashkangjitur).

Në fund më lejoni t'ju informoj se pasqyrat përfundimtare financiare të AKP-së do t'u prezantohen pas 31 janarit 2009 në kohën e caktuar me ligj për përfundimin e raporteve financiare të AKP-së.

Me nderime,

Dino Asanaj

Kryetar i Bordit të Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Mbledhja e shtatë e Bordit të Drejtorëve është mbajtur më 21 dhe 22 janar 2009, dhe në këtë mbledhje shitjet nga Vala 33 janë aprovuar.

Bordi i AKP-së ka vendosur për ri-konfirmimin dhe ri-fillimin e likuidimit të 120 ndërmarrjeve për datën 1 shkurt 2009 apo ndonjë datë të mëvonshme ashtu siç dy zëvendës menaxherët në liri të plotë mund të caktojnë duke iu nënshtruar realizimit të shitjeve nga privatizimit, ku është e mundur, dhe dy zëvendës menaxherët janë të autorizuar të caktojnë anëtarët e Komisionit të Likuidimit për çdo likuidim dhe të caktojnë zëvendësime të tilla siç mund të kërkojnë herë pas here.

Bordi i AKP-së ka marrë vendim që të bëhen të gjitha përpjekjet për ushtrimin e tërheqjes së aksioneve dhe të tentohet të caktohen ndëshkime financiare për arsye të shkeljes së qartë dhe të jashtëzakonshme të Marrëveshjes për Zotime në lidhje me Ndërmarrjen e Re Llamkos sh.p.k.

Mbledhja e tetë (8) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur më 27 dhe 28 shkurt 2009. Në këtë mbledhje është raportuar mbi situatën dhe çështjet e trashëguara nga ish Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) e cila në përgjithësi paraqet një barrë të jashtëzakonshme për dinamikën e punës së AKP-së në vitin 2009, siç është rasti i 166 kontratave të mbetura pezull (nga shitjet e bëra prej AKM-së përmes metodës së spin off-it si dhe shitjes me likuidim), një numër i konsiderueshëm i rasteve në gjykatë si dhe ankesat (mbi 45.000 ankesë) dhe problemet gjatë fazës rikonstruktimit dhe riorganizimit të AKP-së.

Në këtë mbledhje Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka aprovuar biznes planin për vitin 2009, ku përveç vazhdimin të procesit të privatizimit do të shpallen edhe 8 Valë, po ashtu do të ketë vazhdimësi të tetë shitjeve të asetëve përmes procedurës së likuidimit. Në planin e biznesit gjithashtu parashihet dinamika e punës së Agjencisë pjesa e publikimit të listave të përkohshme si dhe atyre përfundimtare për punëtorët e pranueshëm të cilët përfitojnë nga pjesa e 20%.

Prandaj, një prej aktiviteteve kryesore që është caktuar si prioritet nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së është shpërndarja e 20% nga shitjet e ndërmarrjeve.

Mbledhja e nëntë (9) e AKP-së është mbajtur më 26-27 mars 2009. Në këtë mbledhje ka marrë pjesë për herë të parë Sekretarja e Bordit të Drejtorëve, e cila së fundi është caktuar nga përfaqësuesit e Zyrës Civile Ndërkombëtare (ZCN). Në këtë mbledhje të radhës vala e 34 e procesit të privatizimit është aprovuar e në të cilën janë përfshirë 11 Ndërmarrje të Reja.

Është me rëndësi të theksohet se duke konsideruar rëndësinë dhe implikimet nga vonesa e shpërndarjes së 20% për punëtorët e pranueshëm AKP-ja ka katërfishuar numrin e punëtorëve të cilët merren me përpilimin dhe rishikimin e listave dhe ankesave lidhur me 20%. Numri i punëtorëve që kanë punuar në ish Agjencinë ishte në total tre, ndërsa tani ekzistojnë dy njësi (njësia për listat e punëtorëve dhe komisioni për rishikimin e ankesave) që në total përbëhen prej 11 punëtorëve të cilët punojnë ekskluzivisht në listat e punëtorëve.

AKP-ja gjithashtu ka pas sukses në ri-hapjen e të gjitha zyrave rajonale (Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan) duke krijuar në këtë mënyrë themelet për funksion të plotë të AKP-së. Me hapjen e zyrave rajonale dhe angazhimin e stafit profesional të nevojshëm AKP ka përbushur të gjitha parakushtet për ri-themelimin e 120 Komisioneve Likuidimi.

Aktivitet tjetër i Agjencisë ishte procedura e përzgjedhjes së Drejtorit Menaxhues për Trepçën jugore, aktivitet ky që ka filluar në tetor të këtij viti përmes konkursit publik. Pas intervistimit të kandidatëve të përzgjedhur nga paneli intervistues i cili ishte i përbërë nga anëtarë të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Ministrisë së Energjisë dhe Minerave dhe përfaqësues së Trepçës, dhe kandidati më i suksesshëm ishte përzgjedhur Z. Ferat Shala i cili do të ushtrojë këtë pozitë prej 15 dhjetorit 2008.

Më 6 prill 2009, Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve e ka dërguar raportin tremujor në Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me aktivitete dhe operimet e AKP-së.



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

6 prill 2009

Për: Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Lënda: Raporti tremujor mbi aktivitetet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP)

I nderuari Kryetar dhe Anëtarë të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Siç jeni në dijeni me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, respektivisht në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës të Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-067 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) si organ të pavarur publik me zotësi të plotë juridike dhe si pasardhëse të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM-së) që ka qenë e themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12.

Bazuar në paragrafin 20, pika 20.1 të Ligjit mbi themelimin e AKP-së, bordi i dorëzon Kuvendit të Kosovës dhe i bën publike raportet tremujore të cilat përmbledhin aktivitetin e Agjencisë dhe i pasqyrojnë rezultate financiare.

Me këtë rast, ju lus të më lejoni t'ju informoj mbi ecurinë e aktiviteteve të AKP-së për periudhën janar – mars 2009.

Mbledhja e shtatë (7) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me 21-22 janar 2009. Në këtë mbledhje për herë të parë kanë marrë pjesë dy anëtarët e rinj së fundi të caktuar nga Zyra Civile Ndërkombëtare (ZCN). Duke pasqyruar faktin se tani me ri-themelimin e 5 (pesë) zyrave rajonale të AKP-së janë krijuar të gjitha parakushtet për ri-themelimin e 120 Komisioneve për Likuidim, në këtë mbledhje Bordi gjithashtu ka miratuar fillimin e ri-themelimit të 120 Komisioneve për Likuidim dhe për caktimin e anëtarëve të Komisioneve për Likuidim. Duhet përmendur fakti se në çdonjërin prej këtyre komisioneve duhet të jetë një përfaqësues i caktuar nga ZCN si anëtarë. Në këtë mbledhje Bordi i Drejtorëve gjithashtu ka miratuar transaksionet e Valës 33 të privatizimit dhe po ashtu është diskutuar ecuria e zhvillimeve të Ndër. të Reja të privatizuara përmes metodës së Spin off-it Special.

Mbledhja e tetë (8) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me 27-28 shkurt 2009. Në këtë mbledhje është raportuar mbi situatën dhe çështjet e trashëguara nga ish Agjencia Kosovare e Privatizimit e cila në përgjithësi paraqet një barrë të jashtëzakonshme dinamikën e punës së AKP-së për vitin 2009, pasi që e kemi rastin e 166 kontratave të mbetura pezull (nga shitjet e bëra nga ish AKM-ja përmes metodës së spin off-it si dhe shitjet nga likuidimi) një numër i konsiderueshëm e rasteve në gjykata si dhe ankesa (mbi 45.000 ankesa) dhe problemet gjatë fazës së rikonstruktimit dhe ri-organizimit të AKP-së.

Në këtë mbledhje Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka miratuar biznes planin për vitin 2009, ku veç vazhdimësisë së procesit të privatizimit do të shpallen edhe 8 Valë të privatizimit, do të ketë vazhdimësi të tetë shitjeve të aseteve përmes procedurës së likuidimit. Në biznes plan gjithashtu është paraparë edhe dinamika e punës së AKP-së pjesa e publikimit të listave të përkohshme si dhe atyre përfundimtare për punëtorët e pranueshëm të cilët përfitojnë nga pjesa e shpërndarjes së 20%. Është më rëndësi të përmendet fakti se në këtë mbledhje pas shqyrtimit të të gjitha ankesave (1.317 ankesa në listat e përkohshme me 480 emra) nga Komisioni i Shqyrtimit mbi ankesat e punëtorëve, Bordi i Drejtorëve ka miratuar listat dhe lista përfundimtare të N. Sh-së Ramiz Sadiku – Prishtina.

Në këtë mbledhje është vazhduar po ashtu me diskutimet lidhur me veprimet e nevojshme sa i përket të gjitha N. Sh-ve të privatizuara përmes metodës së Spin off-it Special.

Gjatë kësaj periudhe AKP-ja gjithashtu ka përpiluar një pasqyrë për tre vjet lidhur me aktivitetet e strategjisë dhe një pasqyrë operative të cilat i janë prezantuar Bordit të Drejtorëve.

Mbledhja e nëntë (9) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me 26-27 mars 2009. Në këtë mbledhje ka për herë të parë ka marrë pjesë Sekretarja e Bordit të Drejtorëve e cila ishte caktuar së fundi nga përfaqësues të Zyrës Civile Ndërkombëtare (ZCN). Në këtë mbledhje të radhës është aprovuar Vala e 34 e procesit të privatizimit në të cilën janë përfshirë 11 Ndër. të Reja, si dhe pas shqyrtimit të ankesave nga Komisioni për shqyrtim të ankesave 5 Lista Përfundimtare të N. Sh-ve janë aprovuar të cilat do të publikohen brenda periudhës kohore të përcaktuar me ligj, përkatësisht për ndërmarrjet në vazhdim: Ballkani në Suharekë; Ramiz Sadiku në Prizren; Aromatiku në Prizren, Krikos në Prishtinë, dhe 16 qershori në Deçan. Duhet të theksohet se një numër i listave të punëtorëve është në proces të rishikimit dhe të njëjtat do t'i prezantohen Bordit të Drejtorëve për aprovim në mbledhjen e ardhshme.

Së fundi në këtë mbledhje është raportuar mbi kategorizimin e të gjitha ndërmarrjeve të privatizuara përmes Spin off-it Special dhe së shpejti pritet të fillohet procedura e veçantë e auditivit të pavarur në të gjitha këto Ndër. të Reja lidhur me zotimet në investime dhe në punësim të raportuara nga ato.

Në këtë kontest dëshiroj t'ju informoj se AKP-ja gjithashtu ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë përmes së cilit janë bërë zyrtare procedurat lidhur me ndryshimet statusore të Ndërmarrjeve të shitura përmes Spin off-it Special.

AKP-ja gjithashtu ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme lidhur me verifikimin e ofertuesve fitues në procesin e privatizimit.

Do të dëshiroja gjithashtu t'ju informoj se sa i përket publikimeve të listave të punëtorëve (qofshin ato të përkohshme apo përfundimtare), publikimi i tyre po vazhdon pa ndonjë problem në territorin e Kosovës dhe gjithashtu në Republikën e Malit të Zi, përderisa publikimi i tyre në Republikën e Kosovës është ndaluar me intervenim të drejtpërdrejtë të autoriteteve të Republikës së Kosovës. Pavarësisht nga marrëveshja për publikim të tillë të cilën AKP-ja ka nënshkruar me të përditshëm BLIC, kjo e fundit e ka lajmëruar AKP-në se pas publikimit të parë ata nuk janë në gjendje të vazhdojnë me publikim pasi që një veprim i tillë mendohet të jetë në kundërshtim me ligjin e

Republikës së Serbisë. Aktualisht Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka vendosur të vazhdojë me publikimin e listave në të përditshmet vendore edhe në Republikën e Malit të Zi si dhe në ueb-faqen zyrtare të AKP-së, dhe në ndërkohë Bordi është duke konsideruar mundësinë e zgjerimit të bazës së informimit me ndihmën e Ministrisë për Kthim dhe Komunitete të Republikës së Kosovës kjo gjë zyrtarisht edhe i është adresuar Ministrisë për Kthim dhe Komunitete.

AKP-ja dëshiron t'ju informon se ka pranuar informatë nga menaxhmenti i Ndërmarrjeve Shoqërore që Agjencia Serbe e Privatizimit është duke e bërë shitjen e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore të Kosovës të cilat janë të vendosura në qytete të ndryshme të Serbisë.

AKP-ja menjëherë ka ndërmarrë masa duke kërkuar nga Agjencia Serbe e Privatizimit të ndalojë shitjet e tilla pasi që ato asete janë në juridiksion të AKP-së. Lidhur me këtë letër është e informuar Zyra Ligjore e Presidentit të Republikës së Kosovës të Kuvendit të Republikës së Kosovës Zyra Ligjore e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Përfaqësuesit e Zyrës Civile Ndërkombëtare si dhe Zyra Ligjore e EULEX-it në Kosovë.

AKP-ja është aktualisht duke bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për përsheptim e procedurave së likuidimit të cilat pritet të përfundohen nga mesi i vitit 2009, AKP-ja gjithashtu ka filluar të përfundojë të gjitha kontratat e mbetura si dhe t'ju informoj se zyra e tanishme e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës është duke bërë auditimin e pasqyrave financiare të AKP-së për periudhën Korrik – Dhjetor 2008.

Duhet të theksohet fakti se AKP-ja ka pranuar një numër të konsiderueshëm të kërkesave të Kuvendeve Komunale dhe nga Institucionet Qendrore të Republikës së Kosovës lidhur me transferin e pronësive të Ndërmarrjeve Shoqërore (p.sh stacionet e reja për Policinë e Kosovës, spitalet, shkollat etj). AKP-ja është duke shqyrtuar legjislacionin ekzistues i cili më parë ka mundësuar veprime të tilla dhe ne besojmë se shumë shpejt do të dorëzojmë propozimet e nevojshme për ndryshimet e duhura në pjesën e legjislacionit i cili e rregullon këtë proces.

Më në fund më lejoni t'ju informoj se bashkangjitur në këtë raport i keni pasqyrat përfundimtare financiare të AKP-së për periudhën raportuese korrik – dhjetor 2008.

Me nderime,

Dino Asanaj,

Kryetar i Bordit të Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Mbledhja e dhjetë (10) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me 29 prill 2009. Në këtë takim të bordit janë aprovuar listat përfundimtare për punëtorët e ndërmarrjeve në vazhdim: "Kosovatrans", Gjilan; "Luboteni Fabrika e Tullave", Ferizaj; "Anamorava" Gjilan; Energomontimi", Prishtinë; "Fabrika e Veglave" Ferizaj, "Fabrika e Kërpudhave" Prishtinë, "Trasing", Prishtinë dhe "Hotel Theranda". Bordi i Drejtorëve i AKP-së ka aprovuar valën e 35 të privatizimit në të cilën janë përfshirë 9 Ndër. të Reja dhe po ashtu valën e 36 në të cilën janë përfshirë 9 Ndër. të Reja. Në këtë Mbledhje Bordi i Drejtorëve ka aprovuar edhe transaksionet e Valës 33 të privatizimit dhe në të njëjtën kohë është diskutuar mbi zhvillimet në Ndër. të Reja të privatizuara përmes metodës së Spin off-it Special.

Më 19 maj 2009, Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve ka dorëzuar një raport me shkrim në Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me pyetjet e bëra nga ana e një grupi anëtarësh të Kuvendit, sa i përket shitjeve me Spin off Special të Feronikelit dhe Llamkosit dhe Tokës Bujqësore.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Në mbështetje të nenit 67.6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Rregullës 6 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 6 prill 2009, pasi shqyrtoi kërkesën e gjashtë deputetëve për të debatuar në seancën plenare lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M


1. Kërkohet nga Agjencia e Privatizimit që ta përgatitë një Informatë për procesin e privatizimit, sipas kërkesës së grupit të deputetëve.
2. Informata e kërkuar, sipas paragrafit një (1) të këtij përfundimi të përgatitet dhe Kuvendit t'i dërgohet në afatin sa më të shpejt të mundshëm.

Nr. 03-P-091/k
Prishtinë, më 6 prill 2009

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përfundimi t'u dërgohet:

- Administratës së Kuvendit
- Agjencisë së Privatizimit dhe
- Arkivit të Kuvendit.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOS

19 maj 2009

Për: Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Lënda: Re në kërkesën tuaj Nr. O3-P-091/k drejtuar Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP)

I Nderuar Kryetar dhe Anëtarë të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Siç jeni në dijeni, me rastin e hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, respektivisht në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës të Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-067 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) si organ të pavarur publik me zotësi të plotë juridike dhe si pasardhëse të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM-së) që ka qenë e themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12.

Fillimisht, me këtë rast më lejoni fillimisht të ju informoj me ecurinë e aktiviteteve të AKP-së deri më sot.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi themelimin e AKP-së është emëruar Bordi i Drejtorëve të AKP-së nga Kuvendi i Republikës së Kosovës si dhe anëtarët ndërkombëtarë të AKP-së nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, dhe ky bord ka të gjitha kompetencat mbi AKP-në.

Hapi i parë ka qenë funksionalizimi sa më i shpejtë i AKP-së, dhe për një gjë të tillë ka qenë e domosdoshme siguri i qasjes në objektet e ish – AKM-së si dhe obligimi ligjor për Bordin e Drejtorëve të AKP-së për ushtrimin e mandatit të përcaktuar me ligj.

Për herë të parë qasja në objektet e ish-AKM-së tani selia kryesore e AKP-se është mundësuar me datë 24 Gusht 2008 dhe duhet të përmendet fakti se nuk ka pas pranim-dorëzim zyrtar prej ish-AKM-se në AKP. Kjo ka shkaktuar që Agjencia e re (pra AKP) të përballët me vështirësi të jashtëzakonshme sepse gjendja në të cilën kemi hasur është se nuk pas asnjë pajisje në zyrat e selisë, kemi hasur në gjurmë të dokumenteve të djegura, në dokumente të ndryshme të hedhura, dhe më brengosëse ka qenë fakti se ka munguar i gjithë dokumentacioni i Vendimeve të Bordit të Drejtorëve të ish-AKM-së.

Duke u ballafaquar me një situatë të tillë jo të rëndomtë, kemi qenë të obliguar që në mënyrë urgjente të kërkojmë angazhimin e disa prej ekspertëve vendorë për të ndërmarrë

veprimet e menjëhershme e ndër to ka qenë fillimi i punëve përgatitore për takimin konstituiv të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, i cili është mbajtur me datë 26 Gusht 2008.

Pas këtij takimi, AKP-ja, (në më pak se tre muaj në vijim) ka arritur së pari të kthejë dokumentacionin që është marrë më herët nga UNMIK-u, që të përgatit dhe nxjerr të gjitha aktet nënligjore që kanë të bëjnë me pjesën ekzekutive të Agjencisë (pra Procedurat Operacionale, Statutin, Aktin e Themelimit, Procedurat Financiare, skemën e plote të Riorganizimit dhe Ristrukturimit të Agjencisë), themelimin dhe hapjen e 5 zyrave regjionale, rekrutimin e pothuajse mbi 200 nëpunësve të Agjencisë në tërë territorin e Kosovës, mbajtjen e tri rundeve të privatizimit, përgatitjen dhe shpërndarjen e shumës së 20% për mbi 1.000 punëtorë (apo në vlerë mbi 2,5 mil Euro), shqyrtimin e mijëra ankesave në listat e shumta të punëtorëve dhe publikimin e tyre (proces që ende vazhdon dhe do të vazhdojë), fillimin dhe përgatitjen e nënshkrimit të kontratave të para (nga mbi 166 kontrata në pritje të trashëguara nga ish-AKM-ja) ri-fillimin e themelimit të 120 komisioneve të likuidimit, nënshkrimin e një numri të caktuar memorandumeve me institucionet relevante dhe në të njëjtën kohë është filluar me një monitorim intensiv të të gjitha ndërmarrjeve të privatizuara me anë të metodës së spin-off special.

Me pak fjalë, duke pas parasysh të gjitha vështirësitë, mund të thuhet se AKP-ja ka bërë një punë të jashtëzakonshme, mirëpo mbetet edhe shumë për tu bërë. Aktualisht, barra e trashëguar nga ish-AKM-ja mund të konsiderohet si i vetmi element që mund eventualisht të ndikojë në dinamikën e punëve të AKP-së, situatë e cila mendohet të tejkalohet brenda gjysmës së parë të vitit 2009.

Siç e përmenda më lartë, që nga themelimi i AKP-së është bërë një punë intensive sa i përket ndërmarrjeve të privatizuara nga ish-AKM-ja përmes metodës së spin-off-it special. Më duhet të them se fillimisht kemi vërejt defekte nga e kaluara (pra nga ish-AKM-ja) që kryesisht kanë të bëjnë me një parakualifikim dhe selektim të dobët të investitorëve potencial dhe eventualisht pronarëve të rinj të këtyre ndërmarrjeve të privatizuara me anë të spin off special, që ju ka mundësuar blerjen e këtyre ndërmarrjeve në disa raste edhe individëve/kompanive që nuk kanë ndonjë ekspertizë të caktuar në lëmit përkatëse. Defekti i dytë është çështja e termave të përgjithësuara të cilat janë përdorur në kontrata me Spin Of Special. Ka raste kur kushtet e përgjithshme ndryshojnë varësisht nga kontrata me Blerësin e caktuar. Kjo krijon shumë probleme në praktikë. Defekt tjetër mund të përmenden edhe mekanizmat shumë të dobët të monitorimit të bërë në të kaluarën nga ish-AKM-ja në raport me nivelin e plotësimit të zotimeve të bëra për investime dhe punësim nga blerësit. Kjo ka rezultuar edhe me një neglizhencë mjaft serioze nga ana e ish-AKM-së sa i përket ndërhyrjes/intervenimit me kohë, që ka qenë edhe obligim ligjor ndaj kompanive që në vazhdimësi kanë dështuar në plotësimin e zotimeve të bëra.

AKP-ja është duke shqyrtuar të gjitha ndërmarrjet e privatizuara përmes metodës së spin-off-it special, në të njëjtën kohë është vendosur një procedurë më efikase i monitorimit të tyre.

Në vazhdim më lejoni të përgjigjem në pyetjet specifike që më janë drejtuar me shkrim nga ana e parlamentit (deputetëve) të Republikës së Kosovës, që kanë të bëjnë me Ferronikelin, Llamkosin si dhe privatizimin e tokave bujqësore në përgjithësi.

Në lidhje me rastin e Ferronikelit, është një prej ndërmarrjeve të privatizuara me spin-off special nga ish-AKM-ja. Kontrata është e nënshkruar me datë 20 Prill 2006. dhe zotimet për investime dhe punësim kanë qenë 20.000.000 € respektivisht 1,000 punëtorë. Deri më tani janë të raportuara si investime 59,677,464,00 Euro (pra rreth tri herë më shumë se sa kanë qenë të zotuarat) ndërsa për punësim 1064 punëtor të punësuar sipas raporteve të fundit. Periudha e monitorimit do të përfundojë më 20 Prill 2009, kur edhe do të bëhet auditimi i jashtëm, i pavarur i investimeve dhe punësimit të raportuar.

Ndërsa Llamkosi, gjithashtu është ndërmarrje e privatizuar me spin-off special nga ish-AKM-ja. Kontrata është e nënshkruar me datë 21 Korrik 2005. dhe zotimet për investime dhe punësim kanë qenë 15.000.000 € respektivisht 500 punëtorë. Deri më tani janë të raportuara si investime 1,670,338.61 Euro ndërsa për punësim kjo kompani ka 599 muaj punëtor më pak se sa e paraparë me kontratë (kjo nënkupton 50 punëtorë më pak në muaj se sa është parashikuar më kontratë). Bordi i Drejtorëve të ish AKM-së, me datë 21 maj 2008 ka marrë vendim për iniciimin e procedurës së ushtrimit të tërheqjes së aksioneve për Ndër. E Re Llamkos Sh.P.K. Të njëjtin vendim, pas ristrukturimit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të AKP-së e ka ri-konfirmuar dhe aktualisht AKP është duke ndërmarrë të gjitha veprimet domosdoshme për të ekzekutuar këtë vendim.

Mund të ju them me kompetencë të plotë që në vazhdimësi në takimet e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është diskutuar (dhe vazhdon të diskutohet) mbi ndërmarrjet e privatizuara përmes metodës së spin-off-it special, pra plotësimit të zotimeve të bëra nga blerësit sa i përket investimeve dhe punësimit. Duhet të kuptohet qartë se si Agjenci e re kërkohet një kohë që të shqyrtohen të gjitha rastet dhe padyshim AKP-ja do të ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme në përputhje të plotë me Ligjin dhe obligimet e ndërsjella kontraktuale.

Aktualisht, AKP-ja është në procedurë të angazhimit të kompanive të pavarura të auditimit, ku përveç auditimit financiar kërkohet edhe ekspertizë profesionale në sektorët e ndryshëm teknikë dhe ligjor, me qëllim të auditimit të gjitha ndërmarrjeve të privatizuara përmes metodës së spin-off-it special. Në varësi të raporteve të pavarura profesionale në momentin e caktuar do të ndërmerren edhe veprimet e domosdoshme.

Ndërsa sa i përket privatizimit të tokave të bujqësore me lejoni të ju informoj se AKP-ja vazhdon me privatizimin e tyre, dhe të gjitha tokat bujqësore privatizohen me po të njëjtin destinim që kanë pas. AKP-ja nuk e lejon dhe nuk mundet edhe po të dëshiroj të ndërroj destinimin një toke të caktuar dhe kjo është e thënë qartë në të gjitha dokumentet e privatizimit të tokave. Në esencë një gjë e tillë është e

rregulluar qartë me legjislacionin në fuqi (siç janë Ligji mbi Planifikimin Hapësinor, Ligji mbi Mbrojtjen e Ambientit Ligji mbi Pyjet e Kosovës, Ligji mbi Token Bujqësore Nr.02/L-26 etj) që përcakton dhe autorizon Kuvendet Komunale përkatëse për një veprim të tillë.

Në vazhdim më lejoni ju informoj dhe për disa zhvillime të fundit që kanë të bëjnë me punën e Agjencisë:

Së pari dëshiroj të ju njoftoj se për sa i përket publikimit të listave të punëtorëve (qoftë atyre të përkohshme ose përfundimtare) shqyrtimit të ankesave të shumta në listat finale si dhe publikimi i tyre tanimë është duke vazhduar me një dinamikë jashtëzakonisht të përshpejtuar. Mbesim me shpresë se Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës si instancë e fundit do të jetë e gatshme që të marrë vendimet meritorë brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Së dyti, dëshiroj të ju njoftoj se AKP-ja ka pranuar informacione nga menaxhmenti i Ndërmarrjeve Shoqërore (rast konkret JATEX- Gjakova) se Agjencia e Privatizimit të Serbisë është duke kryer shitjen e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore të Kosovës që gjinden në qytete të ndryshme të Republikës së Serbisë. AKP ka ndërmarr veprime të menjëhershme duke kërkuar nga Agjencia e Privatizimit të Serbisë të ndërpres shitjet e tilla pasi që këto asete bien nën juridiksionin e AKP-se. Me këtë letër janë të njoftuar Zyra Ligjore e Presidentit të Republikës së Kosovës, Zyra Ligjore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Zyra Ligjore e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Zyra e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar në Kosovë, si dhe Zyra Ligjore e EULEX-it në Kosovë.

Dhe në fund dëshiroj të ju informoj se AKP-ja aktualisht është duke kompletuar të gjitha përgatitjet e domosdoshme për sa i përket përshpejtimit të procedurave të likuidimit të cilat pritet të përfundojnë në mes të vitit 2009 (duke parashikuar dhe emërimet e domosdoshme të përfaqësuesve ndërkombëtarë në këto komitete të emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë), gjithashtu AKP-ja ka filluar me nënshkrimin e kontratave të mbetura, si dhe të ju njoftoj që aktualisht Zyra e Auditorit Gjeneral të Republikës së Kosovës është duke zhvilluar auditimin e pasqyrave financiare të AKP-së për periudhën korrik – dhjetor 2008.

Me respekt,


Drita Asanaj,

Kryetar i Bordit të Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Mbledhja e njëmbëdhjetë (11) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me 29 maj 2009. Në këtë mbledhje lista përfundimtare për punëtorët e ndërmarrjeve në vazhdim janë aprovuar: "Utva", Pejë; "28 Nëntori", Gjilan; "Çyqavica", Vushtrri; "Kosovatrans", Kamenicë; "Mustafë Goga", Ferizaj; "Agromorava", Viti dhe "Stacioni Bujqësorë", Gjakovë. Për më tepër në këtë mbledhje Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka aprovuar edhe Procedurat e Likuidimit dhe format e azhurnuara dhe është raportuar mbi krijimin e bazën e re e të dhënave të likuidimit. Në këtë mbledhje Bordi i Drejtorëve ka aprovuar transaksionet e Valës 34 të privatizimit dhe gjithashtu ka aprovuar Valën 37 ku janë përfshirë 10 Ndër. të Reja.

Mbledhja e dymbëdhjetë (12) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me 26 qershor 2009. Në këtë mbledhje janë aprovuar listat përfundimtare për tri ndërmarrjet në vazhdim: "Birraria e Pejës", Pejë, "Plantacioni", Ferizaj dhe "Kosovarja", Prishtinë.

Bordi i Drejtorëve ka aprovuar Valën 38 të privatizimit me 12 Ndër. të Reja dhe valën 39 me 10 Ndër. të Reja. Për më tepër Bordi ka aprovuar pjesën më të madhe të transaksioneve nga Vala 35.

Dëshiroj t'ju informoj se në këtë mbledhje Bordi i Drejtorëve të AKP-së njëzëri ka miratuar propozimin për pranimin e përputhjes së plotë me marrëveshjen e zotimeve të Ndër. e re Banja e Klllokotit dhe mbi lirimin e saj nga obligimi për raportim të mëtutjeshëm ndaj AKP-së. Strategjia e propozuar për ndërmarrjet e privatizuara përmes Spin off-it Special është aprovuar.

Së fundi, në këtë mbledhje është raportuar mbi procedurën e specializuar të auditimit të pavarur mbi të gjitha Ndër. të Reja që janë privatizuar përmes metodës së Spin off-it Special e cila është në proces e sipër.

Dëshiroj që gjithashtu t'ju informoj se përsa i përket publikimit të listave të punëtorëve (qofshin ato të përkohshme apo përfundimtare) publikimi i tyre po vazhdohet pa vështirësi brenda territorit të Republikës së Kosovës si dhe në Republikën e Malit të Zi, përderisa problemet me publikimin e listave në Republikën e Serbisë janë zgjidhur dhe AKP-ja është në tërësi duke i përmbushur obligimet e saj.

Lidhur me këtë, unë dëshiroj t'ju tërheq vëmendjen mbi OVGJS dhe vendimet e saj lidhur me listat e punëtorëve, përkatësisht listat e N. Sh-së Ramiz Sadiku dhe çështje tjera kur OVGJS nuk e pranon përbërjen Komisioneve për Shqyrtim të AKP-së dhe as AKP-në si pasardhës ligjor i AKM-së.

Për më tepër çështja e listave të punëtorëve është duke u bërë një problem dërrmues për AKP-në e cila kërkon një angazhim më pro-aktiv të palëve të interesuara. Protesta e fundit e punëtorëve të N.Sh-së Ramiz Sadiku është shembulli më i qartë që situata mund të rezultojë me shqetësim shoqëror, dhe si të tillë ne nuk do të mund të ushtrojmë mandatin tonë i cili rrjedh nga Ligji mbi themelimin e AKP-së.

Më 3 korrik 2009, ne kemi përgatitur dhe dërguar rregullisht raportet tremujore për periudhën kohore prill – qershor 2009 Kuvendit të Republikës së Kosovës bazuar në nenin 20, pika 20.1 të Ligjit mbi themelimin e AKP-së, Bordi i dorëzon Kuvendit të Kosovës dhe i bën publike raportet tremujore të cilat përmbledhin aktivitetin e Agjencisë dhe i pasqyrojnë rezultatet financiare.



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

03 Korrik 2009

Për: Kuvendin e Republikës së Kosovës

Tema: Raporti tre mujor mbi aktivitetet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Të nderuar deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Siç jeni në dijeni me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, respektivisht në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës të Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-067 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) si organ të pavarur publik me zotësi të plotë juridike dhe si pasardhëse të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM-së) që ka qenë e themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12.

Në bazë të nenit 20, pika 20.1 të ligjit mbi themelimin e AKP-së, Bordi i dorëzon Kuvendit të Kosovës dhe i bën publike raportet tremujore të cilat e përmbledhin aktivitetin e Agjencisë dhe i pasqyrojnë rezultatet financiare.

Me këtë rast me lejoni të ju informoj për zhvillimet dhe aktivitetet e AKP-së për periudhën Prill-Qershor 2009.

Mbledhja e dhjetë (10) e bordit të drejtorëve të AKP-së është mbajtur me datën 29 Prill 2009. Në këtë mbledhje të bordit janë aprovuar listat finale të punonjësve të NSH: "Kosovatrans", Gjilan; "Luboteni" Fabrika e Tullave, Ferizaj; "Anamorava" Gjilan; "Energomontimi" Prishtinë; "Fabrika e Veglave" Ferizaj; "Fabrika e kërpudhave" Prishtinë; "Trasing" Prishtinë; dhe "Hotel Theranda". Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka aprovuar valën e 35 të Privatizimit në të cilën janë përfshirë 9 Nder të Reja dhe po ashtu valën 36 në të cilën janë përfshirë 9 Nder të Reja.

Në këtë mbledhje Bordi i Drejtorëve po ashtu ka aprovuar transaksionet e valës 33 të privatizimit dhe po ashtu është diskutuar mbi zhvillimet e Ndër të Reja të privatizuar me metodën e spin-off-it special (SS).

Mbledhja e njëmbëdhjetë (11) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me datën 29 Maj 2009. Në këtë mbledhje janë aprovuar listat finale të punonjësve si në vijim: "Utva" Pejë; "28 Nëntori" Gjilan; "Çyçavica", Vushtrri; "Kosovatrans" Kamenicë; "Mustafë Goga", Ferizaj "Agromorava", Viti; dhe "Stacioni Bujqësor" Gjakove. Për më shumë në këtë mbledhje, Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka aprovuar procedurat e likuidimit dhe janë azhurnuar formularët dhe është raportuar se është krijuar një bazë e re e të dhënave për likuidim. Në këtë mbledhje Bordi i Drejtorëve ka aprovuar transaksionet e valës 34 të privatizimit dhe po ashtu ka aprovuar valën 37 në të cilën janë përfshirë 10 Ndër të Reja.

Mbledhja e dymbëdhjetë (12) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me datën 26 Qershor 2009. Në këtë mbledhje janë aprovuar tri listat finale të punonjësve si të shpjeguara më poshtë: "Fabrika e Birrës Pejë; "Plantacioni" Ferizaj dhe "Kosovarja" Prishtinë. Bordi i Drejtorëve ka aprovuar valën 38 të privatizimit dhe valën 39 me 10 Ndër të Reja. Për më shumë Bordi ka aprovuar shumicën e transaksioneve nga vala 35.

Kisha dashur të ju informoj se në këtë mbledhje, Bordi i Drejtorëve ka aprovuar njëzëri propozimin për përputhje të plotë me marrëveshjet e zotimeve në lidhje me Ndër e Re Banja e Kllokotit dhe për ti liruar ata nga detyrimi i raportimi i mëtutjeshëm në AKP. Strategjitë e propozuar për ndërmarrjet e privatizuara me SS po ashtu janë aprovuar.

Po ashtu kisha dashur të ju informoj juve se sa i përket publikimit të listave të punëtorëve (atyre të përkohshme ose përfundimtare), publikimi i tyre po vazhdon pa probleme brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe po ashtu në Republikën e Malit të Zi përderisa problemi me publikim e listave të punëtorëve në territorin e republikës së Serbisë është zgjedhur dhe AKP është duke i përmbushur obligimet ligjore në tërësi.

Në lidhje me këtë, unë do të doja të tërhiqja vëmendjen tuaj tek OVGJS dhe vendimet e saj lidhur me listat e punëtorëve, posaçërisht listën e NSH "Ramiz Sadiku" dhe çështjeve të tjera, ku OVGJS nuk e njeh përbërjen e komisioneve për shqyrtim të AKP-së, e as AKP-në si pasardhëse ligjore të AKM-së.

Dëshiroj të ju informoj se AKP ka pranuar një vendim të Gjykatës së Apelit të Malit të Zi në lidhje me asetet e NSH "Rekreators", ku gjykata e ka kundërshtuar ankesën e AKP-së duke pretenduar se AKP pak nuk është palë në këtë çështje juridike. Prandaj, institucionet e Republikës së Kosovës duhet të kontaktojnë autoritetet malazeze në mënyrë që të ndihmojnë AKP-në në përpjekjet e saj për të mbrojtur dhe për të rritur vlerën e aseteve të NSH që gjinden jashtë territorit të Kosovës.

AKP po ashtu ka ndërmarrë veprime të menjëhershme duke kërkuar nga autoritetet malazeze për të njohur AKP-në si organ i pavarur ligjor i themeluar në bazë të kushtetutës së Republikës së Kosovës. Me këtë letër janë informuar Zyra Ligjore e Presidentit të Republikës së Kosovës, Zyra Ligjore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Zyra Ligjore e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Zyra e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar në Kosovë, si dhe Zyra Ligjore e EULEX-it në Kosovë.

AKP po ashtu ka përfunduar të gjitha përgatitjet e nevojshme në lidhje me procedurat e likuidimit dhe është në pritje për shkak të mos emërimit të përfaqësuesit ndërkombëtarë në komisionet e likuidimit nga ICO.

Duhet të cekët fakti se AKP po vazhdon të merë një numër të konsiderueshëm të kërkesave nga Kuvendet Komunale dhe nga Institucionet Qendrore të Republikës së Kosovës, në lidhje këmbimin e pronave të ndërmarrjeve shoqërore për interes të përgjithshëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ne jemi të njoftuar se Ministria e Administratës Lokale dhe Qeveria po përgatitin një kornizë ligjor që do ti mundësojë komunave dhe AKP-së për të ndërmarrë një këmbim të tilla.

Në fund, në përputhje me kërkesën e fundit të Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa, ju lutem ti gjeni të bashkangjitura raportet financiare për periudhën Janar - Qershor 2009. Në të ardhmen, AKP do të sigurojë raporte tremujore financiare, si të bashkangjitura me raportet e rregullta, dërguar Kuvendnit të Republikës së Kosovës.

Në rast se kërkon informata shtesë, ju lutem mos ngurroni të më kontaktoni.

Me nderime,

Dino Asanaj,

Kryetar i Bordit të Drejtorëve
Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Mbledhja e trembëdhjetë (13) e bordit të drejtorëve të AKP-së është mbajtur me datën 29 Prill 2009. Në këtë mbledhje janë aprovuar tri listat finale të punonjësve të shpjeguara me poshtë: “KHT Kosova”, Prishtinë; “Kosova Hidroteknika”, Prishtinë; dhe Kosova Konstrukt” Vushtrri. Bordi i Drejtorëve ka aprovuar valën 40 të privatizimit me 9 Ndër të reja dhe valën 41 me 10 Ndër të reja. Për më shumë Bordi ka aprovuar shumicën e transaksioneve nga vala 36.

Gjithashtu dëshiroj të ju informoj se në këtë mbledhje, Bordi i Drejtorëve ka aprovuar njëzëri propozimin për përputhje të plotë me marrëveshjet e zotimeve në lidhje me Ndërmarrjet e Reja Ferronikeli, Birraria e Pejës dhe IMN Gjakova dhe ti liroj ato nga detyrimi i raportimi i mëtutjeshëm në AKP. Menaxhmenti po ashtu ka raportuar se disa Ndërmarrje të mëdha do ti prezantohen Bordit të Drejtorëve për aprovim dhe si rrjedhojë të privatizohen.

3. MISIONI

AKP do të vazhdoj privatizimin përmes tri metodave:

“Spin-Off” Asetet dhe një numër i vogël i detyrimeve të NSH transferohen në shoqërinë aksionare të krijuar rishtazi (Ndër e Re) dhe aksionet e kompanive të reja atëherë tenderohen për shitje investitorëve privat. Detyrimet e mbetura dhe punonjësit mbesin me NSH.

“Special Spin-Off” është i ngjashëm me Spin-Off por i lejon AKP-së ti bashkëngjisë kushte tenderit (p.sh mbajtjen e numrit minimal të punëtorëve, zotime për investim, vazhdimi i aktivitetit të njëjtë). Spin-Off-i special do të përdoren kryesisht vetëm për NSH më të mëdha dhe strategjike (nëse Ligji ekzistues ndryshohet. Ashtu si qëndron tani, legjislacioni i mundëson AKP-së të përdor vetëm Spin Off-et e Rregullta dhe shitjet e aseteve në likuidim).

“Likuidimi Vullnetar”- për ato NSH që nuk janë produktive, asetet e tyre zakonisht do të likuidohen përmes ankandit publik.

3.1 Vizioni

Në tri vitet e ardhshme AKP do të privatizoj dhe/ose Likuidoj përafërsisht 599 NSH me synim për të shpërndarë fondet e privatizimit/likuidimit në ekonominë e Kosovës.

3.2 Misioni

Të shes, transferoj ose likuidoj Ndërmarrjet dhe asetet në pajtueshmëri me ligjin mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pa vonesa.

3.3 Synimet


Siç është shpjeguar hollësisht në neni 2 të rregullores së AKP-së, Agjencia në përputhje me kushtet e këtij ligjit, ka autoritet të administroj:

- Ndërmarrjet shoqërore, pa marrë parasysh se a ju kanë nënshtruar transformimeve.
- Çdo aset që gjendet në territorin e Kosovës, si i organizuar ose jo që përbenë pronë shoqërore në ose pas 22 Marsit 1989.
- Pakicë aksionesh, pa marrë parasysh nëse njësia legale relevante i është nënshtruar transformimit.

Për të përmbushur këtë synim, Agjencia do të:

- Mbjaj dhe administroj ndërmarrjet dhe asetet në mirëbesim për të mirën e kreditorëve dhe pronarëve relevant, në pajtueshmëri me ligjet e tanishme dhe ligjin në fuqi.
- Plotësojë, siç parashikohet në këtë ligj, me kohe ankesat e vlefshme nga pronarët dhe kreditorët lidhur me ndërmarrjet ose asete nga të ardhurat monetare që kanë rrjedhur nga administrimi, shitja, transferimi ose likuidimi i ndërmarrjeve të tilla dhe/ose aseteve të tilla, për të cilat arsye fondet e tilla do të mbahen dhe të ruhen nga Agjencia në mirëbesim për të mirën pronarëve dhe kreditorëve.
- Transferoj të gjitha fondet e mbetura, të mbajtura në mirëbesim, nga Agjencia tek Qeveria e Kosovës pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat e pronarëve dhe kreditorëve që janë paraqitura me kohë dhe të përcaktuara si të vlefshme dhe pas kalimit të afatit kohor për parashtrimin e kërkesave të tilla.

3.4 Organogrami i AKP-së



3.5 FINANCAT

Në mbledhjen e parë të Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 26 gusht 2008, ishte parashikuar që pjesa ekzekutive e AKP-së duhet të përqendrohet në prioritetet në vijim lidhur me pjesën financiare si e domosdoshme për funksionimin e AKP-së:

- Identifikimi i shpenzimeve të reja dhe përgatitjen e buxhetit për vitin 2008;
- Përgatitja e procedurës bankar;
- Përgatitja e programeve të reja për raportin financiar të AKP-së (fondet e Buxhetit të Kosovës);
- Përgatitja e programeve të reja për raportin financiar të AKP-së (fondet e donatorëve);
- Përgatitja e projekt buxhetin për vitin fiskal 2009;
- Barazimi mujor i llogarive në mirëbesim;
- Raport mujor lidhur me shpenzimet nga buxheti i Kosovës nga ana e menaxhmentit dhe zyrtarëve të autorizuar të AKP;
- Barazimi i raportit të shpenzimeve me MEF dhe raportimi mujor Drejtorit të Thesarit të MEF;
- Përgatitja mujore e Sistemit Informues të Menaxhmentit dhe raportimet e rregullta, Menaxhmentit dhe Bordit të AKP-së;
- Hartimi dhe përgatitja e bazës së të dhënave që nga fillimi në lidhje me sistemin e pagesave të pagave;

Sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, AKP është e definuar si një organizatë buxhetore; prandaj merr përvetësim buxhetore nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, të nevojshme për të përfunduar mandatin e saj ligjore.

Në përputhje me Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF), për secilin vit fiskal, AKP analizon dhe identifikon nevojat minimale për financim nga BKK, për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve duke paraqitur kërkesë buxhetore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Një nga pengesat në kthimet buxhetore dhe vonesat e shkaktuar në shërbimet kontraktuese është ligji mbi prokurimin publik, i cili duhet ndryshuar në mënyrë që të pasqyroj natyrën ndryshe të punës së institucioneve përkatëse.

Duhet theksuar se kostot operative të Agjencisë janë të mbuluara nga BKK-ja, unë do të doja të falënderoja të gjitha institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës për dhënien e ndihmës së nevojshme për të siguruar fondet për shpenzimet operative. Qëllimi i fondeve të nevojshme është për të siguruar një funksionim më të mirë të AKP-së.

Agjencia Kosovare e Privatizimit vepron në pajtim me procedurat bankar të miratuar nga Bordi i Drejtorëve në lidhje me Privatizimin dhe likuidimin.

Procedurat lidhur me fondet në mirëbesim ishin përgatitur për ti shërbyer AKP-së si udhëzime që kanë të bëjnë me përgatitjen e Urdhërave për Transferim, Deklaratave Bankare, të Pajtimit, Raportim etj.

FONDET NGA BUXHETI I KOSOVËS

AKP vepron me bazën e të dhënave në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe politikat e Departamentit të Thesarit, MEF Freebalance, që përmban në vetvete të gjitha transaksionet brenda AKP-së: të dhënat e buxhetit, dhënit, zotimet dhe shpenzimet. Raporti i këtyre transaksioneve azhurnohet çdo ditë.

Qëllimi kryesor është që të monitorohet dhe kontrollohet buxheti në mënyrë efektive dhe realizimin i tij në pajtim me ligjin në fuqi mbi menaxhimin e financave publike. AKP-ja ka trashëguar detyrimet e ish AKM-së ndaj furnizuesve në shumën prej €40.848, të cilat janë paguar në bazë të ligjit nr. 03/L-067 nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Prandaj, AKP në mënyrë strikte i respekton udhëzimet dhe rregullat e Departamentit të Thesarit dhe të Buxhetit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Një herë në muaj, AKP përmbledh aktivitetet e saj lidhur me privatizimin dhe likuidimin në një raport të quajtur Përmbledhja e Informatave të Menaxhmentit (PIM). PIM i tanishëm çdo herë krahasohet me (PIM-in) e mëparshëm.

Lidhur me vendimin e marrë nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), më 22 janar 2009 në lidhje me të ashtuquajturin "riatdhesimet" e fondeve të mbajtura në mirëbesimit nga AKP, më lejoni t'ju informojë siç vijon:

Në vendimin e tij të datës 22 janar 2009, Bordi i Drejtorëve të AKP-së vendosi me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit (6) se:

1. Fondet e Mirëbesimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit nuk do të investohen e as vendosen në institucionet financiare ndërkombëtare dhe nuk do të depozitohen në bankat korresponduese të e Bankës Qendrore të Kosovës; dhe
2. Të gjitha fondet mirëbesimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit do të kthehen menjëherë në Kosovë.

Për më tepër, kryetari i Bordit të AKP-së ishte i autorizuar të udhëzojë Banka Qendrore të Kosovës për të vepruar në përputhje me vendimin që i referohemi më sipër dhe për ti dërguar letrën e bashkangjitur Bankës Qendrore të Kosovës

Bordi i AKP-së ka marrë këtë vendim në përputhje me Nenin 19/2, i cili në mënyrë eksplicite parashikon Të gjitha të hyrat e mbajtura në mirëbesim nga AKP të "Investohen nga Agjencia [d.m.th AKP] në llogari, instrumente ose mënyra të tjera të investimit të cilat janë ranguar për investim nga agjenci ndërkombëtare të rangimit dhe në përputhje me kriteret e arsyeshme dhe të matura të investimit". Kështu, ligji i zbatueshëm i jep autoritet për të marrë vendime për investime në lidhje me të hyrat e mbajtur në mirëbesimin në AKP dhe asnjë njësi tjetër. Autorizimi i dhënë AKP-së në pajtim me nenin 19,2 duhet të lexohet dhe të kuptohet në ndërturur me nenin 2.1, 2.2, (d) dhe (c), dhe 8.5, i cili e obligon AKP-në ti mbaj të hyrat nga shitja dhe likuidimi i ndërmarrjeve dhe aseteve nën juridiksion e saj në mirëbesim për dobi të kreditorëve dhe pronarëve përkatës. Neni 2.2(e) në mënyrë të prerë kërkon nga AKP të ruaj të hyrat e tilla për të përmbushur detyrimet e referuara si më sipër.

Bordi ka marrë këtë vendim duke pasur parasysh faktin se Banka Qendrore e Kosovës vazhdimisht ka refuzuar që të lëshojë një garanci me shkrim që të hyrat e mbajtura në mirëbesim janë të siguruara. Duke u nisur nga luhatjet e tanishme të tregjeve financiare ndërkombëtare dhe rreziqeve të mëdha financiare të lidhura me të, AKP është e mendimit se do të ishte më sigurt nëse të gjitha fondet do të kthen në Kosovë. Vendimi i datës 22 janar 2009 nuk do të thotë se fondet do të investohen në projekte të infrastrukturës ose bankat komerciale në Kosovë, siç, fatkeqësisht në mënyrë të gabuar pohohet nga mediat dhe prononcimet publike të individëve jashtë AKP-së. Sapo fondet të janë në Kosovë, Bordi i AKP-së do të konsiderojë mundësitë e investimeve në përputhje me parametrat e krijuar në nenin 19,2 të Ligjit të AKP-së në mënyrë që të sigurohet mënyrë e sigurt investimesh që do të ruajnë të hyrat për të mirën e pronarëve dhe kreditorëve.

U tha se vendimi i AKP-së i parapriu disa komunikimeve me Bankën Qendrore të Kosovës, ashtu si me 17 tetor 2008, ku AKP kërkoj nga BQK-së që të sigurojë një garanci me shkrim që të gjitha fondet e mirëbesimit të AKP-së në Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës:

- Nuk kanë qenë të prekura negativisht dhe janë siguruara nga ndonjë humbje për shkak të luhatjeve financiare në tregun botëror apo bankave korresponduese të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës; dhe
- Se fondet e AKP-së janë plotësisht në dispozicion për ekzekutimin e transferove bankare të AKP-së.

AKP ka kërkuar garanci të tilla të shkruara në pikëpamje të luhatjeve financiare dhe humbjeve që kanë ndodhur në tregjet financiare botërore, bankave dhe institucioneve financiare në shtete të ndryshme, duke përfshirë edhe Evropën. Shqetësimet janë ngritur nga AKP duke marrë parasysh përgjegjësinë e saj sipas ligjit për të ruajtur fondet në mirëbesimin të AKP-së siç është shpjeguar më lartë.

Megjithatë, Banka Qendrore e Kosovës nuk ishte në gjendje të ofrojë një garanci të tilla me shkrim dhe në vend të kësaj u përgjigj se ajo "Ju siguron [juve] që të gjitha fondet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit të depozituara në Bankën Qendrore të Kosovës janë të sigurta." shqetësimet e Bordi janë të mbështetura nga dëshmitë për rënien e normave të interesit të fondeve të mbajtur në mirëbesimin në Banka Qendrore të Kosovës si të përshkruara në vijim:

• Nga 1 korrik 2008 deri në 8 gusht 2008	3,00%	p.a
• Nga 9 gusht 2008 deri 17 tetor 2008	3,25%	p.a
• Nga 18 tetor 2008 deri 10 dhjetor 2008	2,50%	p.a
• Nga 11 dhjetor 2008 deri 17 dhjetor 2008	1,75%	p.a
• Nga 18 dhjetor 2008 deri 20 mars 2009	1,25%	p.a
• Nga 20 mars 2009 deri 13 qershor 2009	0,25%	p.a dhe
• Nga 13 qershor 2009 dhe deri në një njoftim tjetër	0,10%	p.a

Përkundër kërkesave të vazhdueshme me shkrim nga AKP që Banka Qendrore e Kosovës të garantoj në mënyrë të qartë (dhe jo vetëm të siguroj) me shkrim që të gjitha fondet e mirëbesimit janë siguruar nga ndonjë humbje, AKP ende nuk ka marrë një përgjigje adekuate.

Përveç përgjigjes joadekuate të BQK-së, Bordi i AKP-së ka marrë parasysh vendim në fjale si në vijim:

1. Mungesa e garancisë me shkrim nga Banka Qendrore e Kosovës se fondet e AKP-së të depozituara në BQK janë të siguruar nga ndonjë humbje dhe këto fonde janë plotësisht në dispozicion për ekzekutimin e transfereve bankare të AKP-së;
2. Luhatjet financiare dhe humbjet që ndodhin në tregjet financiare botërore, banka dhe institucioneve financiare në shtete të ndryshme, duke përfshirë edhe Evropën.
3. Lajmërimet nga agjencitë botërore të lajmeve se një numër i konsiderueshëm i bankave të mirënjohura, me seli në Shtetet e Bashkimit Evropian, kanë raportuar humbje të mundshëm rreth €10 (dhjetë) miliard;
4. Rëniet e vazhdueshme të interesit të depozitave të AKP-së në BQK;
5. Mandati dhe përgjegjësia ligjore e AKP-së për mbrojtjen e fondeve të mirëbesimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
6. Fakti se interesi primar i AKP-së është ruajtja e fondeve të mirëbesimit nga humbjet e mundshme nga investimet e fondeve të AKP-së nga BQK në institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat e saj korresponduese dhe jo interesi i fituar nga investimet e këtyre fondeve.

AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE 2008

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës (ZAP) ka audituar Pasqyrat Financiare të AKP-së për periudhën korrik 2008 – dhjetor 2008.

ZAP ka nxjerrë një opinion të pakualifikuar auditues në raportin e fundit të auditimit. Lidhja për internet faqen e ZAP-së është

<http://www.ks.gov.net/oag/Raportet%20Anglisht/Agjensionet/AKP%20-%202008%20eng.pdf>

Shtojcë IV
Gjendja në xhirollogaritë bankare
(Për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2008)

Deklarat per rrjedhjen e parase viti 2008				
për periudhën 1 Korrik 2008 deri 31 Dhjetor 2008				
Emri	Gjëndja Fillestare 1 Jan 2008	Fakturat	Pagesat	Gjëndja me 31 Dec 08
Para të imta BKK	-	9,965.66	9,965.66	€ -
Xhirollogaria Bankare (BQK)	398,811,984.56	9,629,018.38	5,127,883.63	€ 403,313,119.31
Xhirollogaria Bankare (PKB)	214,107.70	18,750.00	6.00	€ 232,851.70
Xhirollogaria Bankare (RZB)	0.02	-	-	€ 0.02
Xhirollogaria Bankare e / BANKA QËNDRORE E KOSOVËS (BQK)				
	Gjëndja prej 1 Jan 2008		398,811,984.56	
	Të ardhurat dhe interesi 1 Korrik 2008 - 31 Dhjetor 2008		€ 9,629,018.38	
	Shpenzimet 1 Korrik 2008 - 31 Dhjetor 2008		5,127,883.63	
	Gjëndja prej 31 Dhjetor 2008		€ 403,313,119.31	
Xhirollogaria Bankare e / PROCREDIT BANK				
	Gjëndaj prej 1 Jan 2008		214,107.70	
	Të ardhurat dhe interesi 1 Korrik 2008 - 31 Dhjetor 2008		18,750.00	
	Shpenzimet 1 Korrik 2008 - 31 Dhjetor 2008		6.00	
	Gjëndja prej 31 Dhjetor 2008		€ 232,851.70	
Xhirollogaria Bankare e / RAIFFEISEN BANK				
	Gjëndaj prej 1 Jan 2008		0.02	
	Të ardhurat dhe interesi 1 Korrik 2008 - 31 Dhjetor 2008		-	
	Shpenzimet 1 Korrik 2008 - 31 Dhjetor 2008			
	Gjëndja prej 31 Dhjetor 2008		€ 0.02	
Rrjedhja e parasë në të tri Bankat (BQK, PKB dhe RZB)				
A	Gjëndaj prej 1 Jan 2008		399,026,092.28	
B	Të ardhurat dhe interesi 1 Korrik 2008 - 31 Dhjetor 2008		9,647,768.38	
C	Shpenzimet 1 Korrik 2008 - 31 Dhjetor 2008		5,127,889.63	
D=B-C	Gjëndja e rrjedhjes së parasë 1 Korrik 2008 - 31 Dhjetor 2008		4,519,878.75	
E=A+B-C	Gjëndja në AKP prej 31 Dhje 2008		403,545,971.03	

Shtojcë V
Llogarit vjetore të AKP-së 2008

Budget Report (Kosovo Consolidated Budget)						
For period as of 1 July 2008 until 31 Dec 2008						
Description	Original Budget Reg. 2008/13	Mid Year Reviewed Budget Admin. Dir. 2008/xx	Final Budget KFMIS [30 June 2008]	Differences in %	Differences in %	Differences in %
a	b	c	d	e=c/b	f=d/b	g=d/c
Total Budget 2008	€ 4,878,600.00	€ 4,878,600.00	€ 5,078,600.00	100%	104%	104%
Wages and Salaries	2,888.00	2,888.00	35,738.00	100%	1237%	1237%
Goods and Services	2,039,465.00	2,039,465.00	1,972,560.00	100%	97%	97%
Utilities	-	-	34,055.00			
Subsidies and Transfers	784,058.00	784,058.00	984,058.00	100%	126%	126%
Capital Investments	2,052,189.00	2,052,189.00	2,052,189.00	100%	100%	100%
Budget Report (Designated Donor Grants)						
For the period ended on 31 December 2008						
Description	Original Budget Reg. 2008/13	Mid Year Reviewed Budget Admin. Dir. 2008/xx	Final Budget KFMIS [30 June 2008]	Differences in %	Differences in %	Differences in %
a	b	c	d	e=c/b	f=d/b	g=d/c
Total Donor Budget 2008	€ 1,499,949.00	€ 1,499,949.00	€ 1,499,949.00	100%	100%	100%
Wages and Salaries	149,949.00	149,949.00	149,949.00	100%	100%	100%
Goods and Services						
Utilities						
Subsidies and Transfers						
Capital Investments						
Budget Report (Kosovo Consolidated Budget including Donor Grants)						
For the period ended on 31 December 2008						
Description	Original Budget Reg. 2008/13	Reviewed Budget Admin. Dir. 2008/xx	Final Budget KFMIS [30 June 2008]	Differences in %	Differences in %	Differences in %
a	b	c	d	e=c/b	f=d/b	g=d/c
Total Budget 2008	€ 6,378,549.00	€ 6,378,549.00	€ 6,578,549.00	100%	103%	103%
General Grant	€ 4,878,600.00	€ 4,878,600.00	€ 5,078,600.00	100%	104%	104%
Own Source Revenues of 2008	€ -	€ -	€ -			
Own Source Revenues Carried Forward from 2007	€ -	€ -	€ -			
Internal Grants	€ -	€ -	€ -			
External Grants	€ 1,499,949.00	€ 1,499,949.00	€ 1,499,949.00	100%	100%	100%



Republika e Kosovës – Republika Kosovo – Republic of Kosovo
 Agjencia Kosovare e Privatizimit – Kosovska Agencija za Privatizaciju – Privatisation Agency of Kosovo

PERMBLEDHJE E INFORMIMIT PËR MENAXHMENTIN MË DATËN 31-JUL-09

	Të dhënat e fundit 31-Jul-08	Ndryshimet nga muaji i fundit 30-Jun-09	Ndryshimi nga 31-Dec-08	Ndryshimet prej themelimit të AKP-së 1-Jul-08
1* Numri i NSH-ve të tenderuara	249	1	4	5
2 Numri i Ndërmarrjeve të Reja të tenderuara	532	8	18	26
3 Numri i kontratave të shitjes të nënshkruara	467	6	49	48
3a Kontratat e SQR-ve të nënshkruara	443	6	49	48
3b Kontratat e SOS-ve të nënshkruara	24	-	-	-
4 Numri i kontratave të shitjes "Në PRITJE" - (është emëruar ofertuesi Fitues i Përkohshëm)	65	2	(31)	(14)
4a Kontratat e vlerësuara të SQR-ve në PRITJE	64	2	(30)	(13)
4b Kontratat e vlerësuara të SOS-ve në PRITJE	1	-	(1)	(1)
5=3+4 Numri i kontratave të nënshkruara & në PRITJE	532	8	18	35
5a Numri i SQR-ve të nënshkruara dhe në PRITJE, 3a dhe 4a)	507	8	19	36
5b Numri i SOS-ve të nënshkruara dhe në PRITJE, 3b dhe 4b)	25	-	(1)	(1)
6 Gjithësi të ardhurat e privatizimit të pranueshme në bankë (Σ(6c:6g))	€408,270,703	781,533	21,624,893	25,390,196
6a Paratë e Privatizimit (neto e 20% të të drejtave legjitime të punëtorëve)	€327,416,583	625,227	17,299,914	20,312,125
6b Të drejtat legjitime të Punëtorëve (nga të ardhurat e Privatizimit)	€81,854,141	156,307	4,324,979	5,078,031
6c Prej të cilave i janë paguar BSPK-së (nga të ardhurat e privatizimit)	€19,050,869	526,115	1,000,305	3,483,046
6d Bilanci i transferave në llogaritë në mirëbesim për punëtorët minus transferet tjera në BSPK	€1,370	-	(134,034)	(134,034)
6e-6c Mbetur për (u) transferuar në BSPK (nga të ardhurat e privatizimit)	€62,803,272	(369,809)	3,324,674	1,594,986
6e Të transferuara në llogaritë e likuidimit (80% e shitjes nga privatizimi)	€149,331,454	-	41,446,372	41,450,827
6f Paratë e aksionarëve të Ndër. të Reja të paguara nga ofertuesit dhe të transferuara në ME	€436,250	-	8,750	8,750
6g Paratë e Privatizimit të mbetura në Bankë	€240,450,760	255,418	(20,696,500)	(19,418,432)
6h Numri i llogarive të punëtorëve të NSH-ve miratuara nga Dhoma e Vogël dhe të paguara	66	1	1	7
7 Shuma e llogaritë e Kontratave të shitjes NËNASHKRUARA DHE NË PRITJE	€406,791,929	2,955,826	5,165,897	15,685,036
7a Vlera e Kontratave të shitjes të SQR-ve të Nënshkruara	€270,812,339	2,151,666	10,185,381	10,165,381
7b Vlera e Kontratave të shitjes të SOS-ve të Nënshkruara	€91,723,495	-	-	-
7c Vlera e llogaritë e Kontratave të shitjes të SQR të NË PRITJE	€44,153,095	804,160	(844,484)	9,674,655
7d Vlera e llogaritë e Kontratave të shitjes të SOS-ve NË PRITJE	€103,000	-	(4,155,000)	(4,155,000)
8 Shuma e investimit të SOS-ve të dakorduara me kontratë	€196,342,564	-	-	-
9 Numri i punëtorëve të SOS-ve për (i) angazhuar sipas kontratës	8,114	-	-	-
10 Shuma e investimeve të vlerësuara të SOS-ve	€134,323,212	2,000,303	12,604,705	35,315,541
11 Numri i punëtorëve të punësuar të SOS-ve	7,294	136	456	927
12 Numri i investitorëve aktual në bazën e të dhënave (parakualifikuar, qelë)	10,217	80	199	671
12a Numri i investitorëve të para-kualifikuar	2,932	31	140	229
12b Numri i investitorëve qelë të regjistruar	7,285	49	59	442
13 Numri i NSH-ve të miratuara për likuidim	120	-	-	-
13a NSH-të e dërguara drejtpërdrejt në likuidim (pika 13a është përfshirë në pikën 13)	9	-	-	-
14 Numri i Shitjeve me Likuidim të fituara	106	-	-	-
14a Numri i kontratave të shitjes me likuidim (të Nënshkruara)	85	8	49	49
14b Numri i kontratave të shitjes me likuidim (në pritje)	21	(8)	(49)	(49)
15 Vlera e kontratave të shitjes gjatë likuidimit (të Nënshkruara)	€13,418,612	1,599,730	9,125,448	9,125,448
16 Vlera e llogaritë e Kontratave të shitjes gjatë likuidimit (në PRITJE)	€5,063,686	(1,599,730)	(9,125,448)	(9,125,448)
17 Gjithësi para të likuidimit në mirëbesim të pranueshme në bankë	€16,451,428	-	5,355,899	5,355,899
18 Paguar BSPK-së nga të ardhurat e likuidimit	€96,301	-	11,221	11,221
19 Numri i NSH-ve për të cilat ka përfunduar procesi i likuidimit	-	-	-	-

Sqarimet

SQR - Spin-Off / Rregullt; SOS - Spin-off Special

*Total number of additional enterprises re-tendered during July not included in 1 above = 0

** Përfshihet interesin e fituar në llogaritë

Ky PM është përgatitur dhe menaxhohet nga:

Avni J. Jashari, CA, OFE
 Drektor i Financave dhe Buxhetit
 Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nënshkruar më
 7-Ag-09

**Bazuar në informatat e marra nga
 Departamentet e AKP-së.

4. DIVIZIONI I REALIZIMIT TE ASETETEVE

4.1 Privatizimet e Paraardhësit të Agjencisë

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) ishte themeluar si Agjenci përgjegjëse për administrimin e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore dhe publike (NSH), si dhe të bëjë privatizimin dhe likuidimin e të gjitha (NSH-ve) në bazë të rregullores së UNMIK-ut 2002/12 të 13 Qershorit të vitit 2002 (Rregullorja e APK). Kjo rregullore ishte ndryshuar më 22 Prill të vitit 2005 me nxjerrjen e rregullores së re të UNMIK-ut 2005/18.



Një vështrim i përgjithshëm i programit të privatizimit, tregon se deri në 30 Qershor 2008, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM-ja) kishte nisur procesin e 30 valëve të privatizimit. Shumat e mbledhura nga të dy tenderët SOR dhe SOS të zhvilluar nga Maj 2003 deri në janar 2008 është €392.281.978.

498 Ndër. të Reja janë ofruar për shitje dhe janë nënshkruar 397 kontratat të shitjeve, me privatizimin total shuma e të ardhurave arrin në €392.281.978 (të paguara dhe të deponuara).

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) ka pushuar së kryeri veprimtarinë e saj më 30 qershor 2008.

VALA nr	Nr i Ndër. Të reja të shitura	Data e ofertimit	Të hyrat e gjeneruara nga shitja e Ndër. të reja
1	5	Maj/03	€2,335,875
2	14	Korrik/03	€16,934,009
3	16	Korrik/04	€16,617,676
4	17	Janar/05	€18,228,850
5	22	Korrik/05	€43,703,200
6	30	Gusht/05	€16,364,688
7	21	Shtator/05	€19,789,927
8	13	Tetor/05	€10,229,961
9	13	Dhjetor/05	€16,742,836
10	13	Shkurt/06	€7,507,799
8B	4	Shkurt/06	€27,942,900
11	14	Shkurt/06	€10,428,113
12	16	Mars/06	€34,171,066
13	11	Prill/06	€4,638,075

VALA nr	Nr i Ndër. Të reja të shitura	Data e ofertimit	Të hyrat e gjeneruara nga shitja e Ndër. të reja
14	14	Maj/06	€5,674,397
15	16	Qershor/06	€6,810,594
16	24	Korrik/06	€7,199,734
17	18	Shtator/06	€6,443,533
18	19	Tetor/06	€13,340,558
19	35	Dhjetor/06	€21,013,228
20	18	Janar/07	€11,584,839
21	18	Shkurt/07	€5,075,582
22	18	Mars/07	€8,721,695
23	10	Prill/07	€5,867,817
24	19	Maj/07	€7,089,873
25	32	Qershor/07	€23,153,009
26	11	Korrik/07	€2,947,075
27	14	Gusht/07	€3,681,991
28	9	Tetor/07	€2,876,859
29	6	Dhjetor/07	€1,457,255
30	8	Janar/08	€13,707,715
Total:	498		€392,280,728



4.2 Privatizimi nga AKP

Gjatë periudhës shtator - dhjetor 2008, Bordi i Drejtorëve të AKP-së u mbledh në përbërje të rregullt dhe mbajti gjashtë mbledhje(duke përfshirë mbledhjen konstituive të mbajtur më 26 Gusht të vitit 2008). Gjatë kësaj periudhe, u emërua Stafi Menaxhues i AKP (dy Zëvendës Drejtorë Menaxhues) dhe më pas një numër i konsiderueshëm i personelit lokal të ish AKM-së ishte i angazhuar në mënyrë që të rinisë operimi. Më pas AKP-ja ishte në gjendje të përgatisë, shqyrtoj dhe të miratoj politikat operationale të AKP-së, sipas-Ligjeve, Statutit, Procedurave bankare, Strukturave Organizative (Organogramit) etj.

Pas kompletimit të dokumenteve të mësipërme, Bordi i Drejtorëve të AKP-së e miratoi Biznes Planin e AKP-së duke mbuluar periudhën shtator - dhjetor 2008, biznes plani i mundësoi menaxhmentit të AKP-së për të nisur dhe mbajtur me sukses 3 valë të privatizimit (d.m.th. valën 31, 32 dhe valën 33), nga gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) i NSH, duke përmbyllur me (20) Ndërmarrje të reja të ofertuara.

AKP nuk ishte në gjendje të bëjë ndonjë shitje likuidimi për shkak të mungesës së Komisionit të likuidimeve i cili nuk mundi të themelohet në mungesë të Zyrave Rajonale dhe të personelit të nevojshëm. Të gjitha asetet e shitjes duhet të jenë të drejtuara nga Departamenti i Shitjeve dhe në bashkëpunim të ngushtë me komisionet përkatëse të likuidimit. Departamenti i Shitjeve është përgjegjës për procesin e privatizimit dhe likuidimit si dhe shitjen e NSH-ve.

Dita e ofertimit për Valën e 31-të të privatizimit ishte më 19 Nëntor, duke përbërë nga shtatë NSH në nëntë Ndërmarrje të reja. Numri i ofertave të pranuara me spin-off të zakonshëm është 84, me shumën totale prej €4.230.111.

Dita e ofertimit për Valën e 32-të të privatizimit ishte 3 Dhjetor 2008, duke përbërë nga katër NSH në gjashtë Ndërmarrje të reja. Numri i ofertave të pranuara me spin-off të zakonshëm është 18, me shumën totale prej €1.922.150.

Dita e ofertimit për Valën e 33-të të privatizimit ishte 17 Dhjetor 2008, duke përbërë nga katër NSH në pesë Ndërmarrje të reja. Numri i ofertave të pranuara me spin-off të zakonshëm është 15, me shumën totale €909.072.

Dita e ofertimit për Valën e 34 të privatizimit ishte 20 Maj 2009, duke përbërë nga dhjetë NSH në dhjetë Ndërmarrje të reja. Numri i ofertave të pranuara me spin-off të zakonshëm është 39, me shumën totale €7,955, 971.


Dita e ofertimit për Valën e 35-të të privatizimit ishte 10 Qershor 2009, duke përbërë nga nëntë (9) NSH në nëntë (9) Ndërmarrje të reja. Numri i ofertave të pranuara me spin-off të zakonshëm është 28, me shumën totale €2,301,810.


Dita e ofertimit për Valën e 36-të të privatizimit ishte 08 Korrik 2009, duke përbërë nga shtatë (7) NSH në nëntë (9) Ndërmarrje të reja. Numri i ofertave të pranuara me spin-off të zakonshëm është 34, me shumën totale prej €3,011,825.

Dita e ofertimit për Valën e 37-të të privatizimit ishte 12 Gusht 2009, duke përbërë nga nëntë (9) NSH në nëntë (9) Ndërmarrje të reja. Numri i ofertave të pranuara me spin-off të zakonshëm është 34, me shumën totale prej €6,200,756.

Një përmbledhje e programit të privatizimit tregon se gjer me 12 gusht 2009, tregon se AKP ka shpallë shtatë valë të privatizimit.

VALA nr	Nr i Ndër. të reja të shitura	Data e ofertimit	Shuma totale e ofertave
31	9	Nëntor/08	€4,230,111
32	6	Nëntor/08	€1,922,150
33	5	Dhjetor/08	€909,072
34	7	Maj/09	€7,955,971
35	8	Qershor/09	€2,213,010
36	9	Korrik/09	€3,011,825
37	9	Gusht/09	€6,200,756
Total:	53		€26,442,895





4.3 Privatizimi i tokës bujqësore

Në lidhje me tokën bujqësore, do të doja t'ju informoj se AKP vazhdon të privatizoj ato, tokat bujqësore janë privatizuar me të njëjtin destinim siç e kishin më parë. AKP-ja nuk lejon dhe nuk mund të lejojë që edhe në qoftë se pala dëshiron të ndryshojë destinimin e një toke të caktuar dhe kjo është e përcaktuar qartë në të gjitha materialet e privatizimit për tokën bujqësore. Në thelb, çështje të tilla janë qartë të rregulluara me legjislacionin e aplikueshëm si; Ligjin për Planifikim Hapësinor, Ligjin mbi Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin për Tokën Bujqësore Nr.02/L-26 që përcakton dhe autorizon Kuvendet Komunale për veprimet e tilla.

Siç tregon tabela e mëposhtme, që nga fillimi i portofolit total të tokës të besuar AKM/AKP-së në të vërtetë ishte vetëm pak më shumë se 40,000 hektarë, nga të cilat AKM-ja ka shitur gati 60% (112 transaksione në mbi 27 valë - 3:30).

Që atëherë AKP-ja ka shitur pak më shumë se 2000 hektarë (18 transaksione gjatë pesë valëve -30:35). Për sa i përket shitjeve, katër transaksione që në total arrijnë në 543 hektarë në fakt u ri-ofertuan për shumat e ofruara nga AKM-ja për shkak të cilave shumat ofertat u kundërshtuan. Praktikisht kohëve të fundit tregojnë se AKP ishte në gjendje të bëjë dyfish më shumë oferta se ata të mëparshmit (nga €170,000 në €420,000).

Statusi	Hektarë	%
Të shitura nga AKM	23,930	52%
Të shitura nga AKP	2,015	4%
Për tu shitur	20,200	44%
Total	46,145	100%
Sharrprodhimi	22,550	
Total	68,695	

Me pak fjalë, duke shkuar përpara, AKP-ja tani ka vetëm një portofol me pak më shumë se 20.000 hektarë tokë për t'u shitur e shpërndarë në gati mbi 90 NSH

Kjo megjithatë, në vetvete është një paraqitje mashtruese, për aq sa analizat tregojnë, dhe nga kjo shumë, rreth 65% ose 13.100 hektarë është në duart e shtatë NSH-re, me 24% të tjera ose 5.000 hektarë në duart e nëntë NSH-re, duke e lënë bilancin e mbetur me parcela të vogla të tokës në duart e 70 NSH-ve.

Me fjalë të tjera, procesi i shitjes së tokës s137 N.Sh-ve në Kosovë ishte i përfunduar në masë të madhe nga ana e AKM-së, me portofolin e mbetur të përbërë në thelb prej ndërmarrjeve në vështirësi për procedim, shumica nga të cilat kërkojnë zgjidhjen e një sërë vështirësive ligjore problemeve dhe të tjera që duhet të zgjidhen para se të bëhen shitjet.

Tani do të donim të ktheheshim te procesi i shitjeve. Së pari, siç ju duhet ta dini, çështjet rezistuese të tranzicionit - proceset dhe procedurat e përdorura nga AKP-ja ishin të trashëguara nga AKM-ja. Me sa di unë, ato reflektojnë praktikën më të mira ndërkombëtare (ato ishin të zhvilluara nga specialistët ndërkombëtarë, të mbështetur nga konsulentët ndërkombëtarë).

Duke thënë më lart, më lejoni të jem i qartë, unë mendoj se ne të gjithë dëshirojmë që performanca jonë të duket në nivel më të lartë se ajo e AKM-së dhe AKP është e angazhuar për të tejkaluar arritjet e tyre.

Sa i përket tregut, si tregojnë të dhënat në tabelë, çmimet e përgjithshme mesatare të tokës në Kosovë shfaqin një trend rritës, dhe si e keni vërejtur çmimet e arritura janë për tu admiruar.

Lidhur me komentet brengosëse nëse shitja e parcelave të mëdha na sjellë rezultate të dobëta, bazuar në tabelat në vijim ne nuk shohim të dhëna të tilla, veçanërisht kur konsideron se parcelat e vogla janë në mënyrë të pashmangshme të papërballueshme për bujqësi dhe për këtë arsye ato pothuajse gjithmonë hyjnë në radhë të pasurive të patundshme.

SHITJA E TOKËS NGA AKM/AKP NË TOTAL				
Madhësia e Parcelës në Hektarë	Nr i Parcelave	Hektarë në total	Çmimi i paguar	Mesatarisht
<5	100	66	€18.782.702	€283.801
>5<10	7	114	€2.601.051	€22.812
>10<100	50	2.913	€25.189.540	€8.647
>100<500	56	12.515	€33.337.812	€2.664
>500<1000	4	3.009	€3.501.090	€1.163
<1500	2	2.346	€5.398.332	€2.301
<2500	1	2.200	€4.302.900	€1.956
TOTAL	220	23,164	€93,113,427	€4,020

Mesatarja e tokës bujqësore >10 - 2.500ha	22.983	€71.729.674	€3,121
---	---------------	--------------------	---------------

Në përputhje me analizat paraprake të kryera nga AKP në lidhje me çmimin e tokës, indikacionet fillestare bazuar në rezultatet e gjertanishme, AKP e ka dyfishuar çmimin mesatar për një hektar të shitur në krahasim me AKM-në.

Më tej, unë mendoj se ju do të bini dakord se çështja që AKP duhet të jetë e fokusuar është strategjia; se si do ti përmbushim detyrimet tona për të kompletuar procesin e privatizimit dhe likuidimeve. Në këtë drejtim, AKP do ti jap prioritet portofolios së mbetur, në mënyrë që planet e caktuara të veprimit të mund të zhvillohen e më pas të na dërgojnë në mënyrë të efektshme drejt qëllimit tonë.

4.4 Brezovica

Qendra Turistike Brezovica gjendet në komunën e Shtërpçës në këndin jug-perëndimorë të rajonit të Gjilanit. Komunitet qafinje janë Prizreni, Suhareka, Ferizaj, dhe Kaçaniku. Komuna kufizohet me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë jug.

NSH Qendra e Skijimit Brezovica – është e vetmja Qendër Turistike Dimërore në Kosovë e cila ka kushte të jashtëzakonshme natyrore për skijim. Ndërmarrja aktualisht punëson 225 persona të cilët kryesisht punojnë në objektet e hotelit. Si pasojë e faktit se në Kosovë nuk ekzistojnë objekte të ngjashme, nuk ekzistojnë konkurrent lokal të rëndësishëm për turizmin dimëror për Qendrën Turistike Brezovica, veçanërisht sa i përket skijimit. Qendra e Skijimit Brezovica është në gjendje të tërheq 100% të këtij tregu në Kosovë. Qendra Turistike Brezovica posedon të gjitha kushtet paraprake për t'u bërë rezorti më i mirë rekreativ/për skijim në këtë pjesë të Ballkanit. Ajo ofron pamje atraktive nga vargu i malit të Sharrit si dhe ofron kushte të shkëlqyeshme klimatike të cilat e mundësojnë skijimin nga Nëntori deri në Maj.

Përpjekjet për marketing të Qendrës Turistike Brezovica janë shumë të kufizuara pasi që aktiviteti kryesor konsiston në kontaktet e drejtpërdrejta personale me klientë. Rezorti nuk i mbështetë produktet e veta turistike përmes aktiviteteve tjera turistike. Rezorti ka fituar njohje të konsiderueshme përgjatë viteve, mirëpo aktualisht ka nevojë për një plan të përgjithshëm marketingu si dhe promovim të zgjeruar në mënyrë që të kapitalizoj mundësitë e disponueshme të zhvillimit të tregut.

AKP në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Evropian i ka planifikuar në mënyrë të kujdesshme hapat e nevojshëm të cilët duhet të ndërmerren, para Privatizimit të Qendrës Turistike Brezovica.

Prandaj një fushatë e gjerë marketingu me përmasa ndërkombëtare duhet të ndërmerret në mënyrë që të tërheq investitor të huaj të cilët janë të specializuar në këtë fushë të turizmit.

Për më tepër, AKP është po ashtu duke planifikuar organizimin e një Konferencë të Madhe Ndërkombëtare të Investitorëve e cila do t'i mbledhë të gjitha kompanitë e mëdha ndërkombëtare të interesuara për të investuar në këtë aset tërheqës.

Qendra Turistike Brezovica është atraktive për arsye të vijim:

- Gjendet në jugun e largët të Kosovës, në Malet e Sharrit
- Vetitipike të maleve Alpine.
- Objektet shtrihen në 900m mbi nivelin e detit.
- Trsenja në rrëzë të malit masiv është 1200m mbi nivelin e detit.
- Qendra e Skijimit është rreth 230 ha dhe shtrihet 1.700 deri 2.500 m mbi nivelin e detit

Brezovica shtrihet midis dy aeroporteve të mëdha ndërkombëtare, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (60 km) dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Shkupit (70 km) në Maqedoni. Koha e transferimit të udhëtarëve të cilët vijnë me fluturime ndërkombëtare qoftë në Shkup apo Prishtinë është më pak se dy orë dhe treguesit në vijim janë parakushte të fuqishme për investitorët e ardhshëm:

- Rezort përgjatë-tërë-vitit, duke përfshirë sporte dimërore dhe verore, konferenca, dhe festivale muzikore
- Potencial të madh për nën-zhvillime të reja nën kontrollin e një master zhvilluesi
- Renovimin apo zëvendësimin e nëntë teleferikëve të skive
- Projekte madhore të reja të mikpritjes, përveç renovimit të objekteve ekzistuese
- Akomodime të reja rezidenciale për vizitorët afat-gjatë
- Standarde arkitekturale në ruajtjen e traditës së rajonit
- Kufizime në lartësi të ndërtesave dhe kufizime në shfrytëzimin e fushave të disponueshme të tokës
- Vet-furnizim i mundshëm me energji elektrike, duke shfrytëzuar potencialin lokal hidro-elektrik

E vlen të përmendet se ka qenë një mirëkuptim i përgjithshëm se Brezovica ka potencialin të bëhet Qendra Turistike më e mirë në rajon, mirëpo kjo kërkon investime substanciale si dhe planifikim shumë të kujdesshëm. Qendra Turistike Brezovica kërkon një master plan përgjatë-tërë-vitit i cili do t'i tërheqë vizitorët jo vetëm gjatë dimrit, mirëpo për gjatë tërë vitit.

4.5 Ndërmarrjet e Gjakovës

Një nga sfidat me të cilat është duke u përballur AKP dhe të cilën e ka trashëguar nga Agjencia paraardhëse është statusi i pazgjedhur i Ndërmarrjeve të Gjakovës. Kryetari i AKP-së dhe ekipi menaxhues i AKP-së kanë mbajtur disa takime me Kryetarin e Komunës së Gjakovës dhe me drejtorët e Ndërmarrjeve të Gjakovës. Një konsensus ishte arritur se çështja e Ndërmarrjeve të Gjakovës do të jetë në listë e prioritetëve të Agjencisë dhe një ekip i përbërë nga avokatët e AKP-së, auditorët e brendshëm, ekspertë të siguruar nga Ekipi i Pohl Consulting (projekt i financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në përkrahje të AKP-së) si dhe përfaqësues të atyre kompanive do të themelohet në mënyrë që të rishikoj statusin e tyre mbi bazën e “rast për rast”.

Kjo është një pasqyrë në lidhje me lëndën dhe gjendjen në vijim sa i përket Përcaktimit të Statusit të Ndërmarrjeve të Gjakovës:

Gorenje Elektromotori – Bordi i AKM-së ka hequr dorë nga juridiksioni i tij mbi Kompaninë në Dhjetor 2006.

Dukagjini – Bordi i AKM-së ka hequr dorë nga juridiksioni i tij mbi Kompaninë në Prill 2006.

Jatex- Bazuar mbi draft Rishikimin e Përcaktimit të Statusit (RPS) për Jatex, Departamenti Ligjor i Agjencisë paraardhëse ka kërkuar një rishikim të auditorit për përqindjen e transformimit.

Emin Duraku - Departamenti Ligjor i Agjencisë paraardhëse po ashtu ka kërkuar një auditim në lidhje me përqindjen e transformimit, bazuar në ekzaminimin e saj të draft RPS-së. Emin Duraku dhe Jatex më parë kanë qenë pjesë e të njëjtës NSH, dhe si rrjedhojë rrethanat e tyre janë të ngjashme.

Deva – Departamenti Ligjor i AKP-së do të përcaktoj statusin e këtij entiteti gjatë muajve në vijim, megjithëse ndërmarrja kë dështuar të siguroj dokumente financiare në lidhje me transformimin. Menaxhmenti i ndërmarrjes si dhe menaxherët tjerë të SH.A. pretenduese vazhdojnë të kërkojnë nga AKP të heqë dorë nga juridiksioni i saj mbi kompanitë e Gjakovës bazuar mbi Regjistrimin në Gjykatë, duke u bazuar në faktin se dokumentet financiare mungojnë si rezultat i ngjarjeve të 15 viteve të fundit në Kosovë. AKP do të kërkoj nga menaxhmenti të siguroj dokumente shtesë në mënyrë që ta dëshmoj transformimin.

Ening- Menaxhmenti i ndërmarrjes ka treguar bashkëpunim dhe ka parashtruar dokumentet për përpilimin e RPS-së. Dokumenti është përgatitur dhe do të rishikohet në kohën në vijim.

Ereniku Group – AKP dhe menaxhmenti i Ereniku janë pajtuar për bashkëpunim të mëtutjeshëm. AKP do të dërgoj kërkesë zyrtare për parashtrimin e dokumenteve për përpilimin e RPS-së.

Metaliku – RPS-ja ka konkluduar se transformimi nuk është i dëshmuar. NSH-ja është në listë të entiteteve të cilat bien nën Moratoriumin Trepça (pavend, siç duket) dhe si e tillë ajo nuk mund të privatizohet përveç nëse DVGL (Dhoma e Veçantë e Gjykatës së Lartë) vendos ta merr NSH-në nga lista e entiteteve të cilat bien nën Moratoriumin Trepça. Rrjedhimisht, ajo do të duhet të tërhiqet nga një valë e freskët e privatizimit. AKP është duke u përpjekur ta shtyj DVGL ta tërheq Metaliku nga lista e moratoriumit.

Metaliku Ena - pretendon se është ndarë në mënyrë valide nga holdingu i Metaliku në vitin 1991. Drejtori i NSH-së ishte këshilluar nga Agjencia paraardhëse se nëse Agjencia e shpërfillë transformimin e Metalikut, atëherë ndarja e Ena nga ndërmarrja mëmë Metaliku duhet të konsiderohet automatikisht si jo valide. Departamenti Ligjor i AKP-së nuk është në gjendje ta nënshkruaj RPS-në, duke pritur vendimin e DVGL mbi Moratoriumin Trepça.

Menaxhmenti i AKP-së i ka përkujtuar menaxherët e kompanisë se ata kanë të drejtë t'i paraqesin kërkesat e transformimit të tyre tek DVGL nëse AKP përcakton se ky entitet bie nën juridiksionin e tij dhe i shpërfillë transformimet e mëparshme. Ata po ashtu janë këshilluar t'i konsiderojnë aspektet pozitive të procesit të privatizimit si një mjet për tërheqjen e investimit dhe rivitalizimin e këtyre kompanive.

Agjencia paraardhëse deri më tani me sukses i ka privatizuar një numër të konsiderueshëm të ndërmarrjeve, si dhe shumica e transformimeve të pretenduara në shumicën e rasteve janë shpërfillur nga Agjencia si jo valide

dhe të cilat nuk ishin kryer në përputhje me Ligjin.

Ndërmarrjet e Privatizuara të Gjakovës, të cilat më parë ishin në mesin e shoqatës së "SH.A.-ve" të Gjakovës të cilat i rezistojnë privatizimit:

Modeli

IMN Fabrika e Tullave

Mulliri

Agimi Mishi

Agimi,

Ereniku – Pulari

Ereniku – Prodhime Primare,

Kompanitë e Privatizuara të Gjakovës, të transformuara në mënyrë të ndryshme por të cilat nuk janë pjesë e shoqatës së NSH-ve të Gjakovës:

Elast

Pashtriku

Kompresori

Agricultural Station

AC Skivjan,

AC Lipovec

4.6 NSH Miniera e Boksitit

Miniera e Boksitit në Voljakë gjendet në pjesën perëndimore të Kosovës dhe është i vetmi operim mihës në Rajonin e Pejës. Në këtë zonë boksiti ka filluar të eksplorohet për herë të parë në vitin 1953. Në mes të viteve 1953 dhe 1956 Shërbimi Gjeologjik i "Trepça" ka kryer atje hulumtime minerale rajonale. NSH "Boksitet e Kosovës" ishte krijuar në vitin 1966 në mënyrë që të nxjerr burime minerare në rajonin e Klinës. Që nga krijimi i saj deri më 1990, 3 milion tonë të rezervave të boksitit ishin shfrytëzuar dhe përafërsisht 1.7 milion ton janë lënë të pa përdorura. Në vitin 1987, një objekt për përzierje dhe pëlhurë thasësh i është shtuar, për t'i mundësuar NSH-së të prodhoj material të përshtatshëm për suvatimin e mureve dhe kryerjen e riparimeve të shtëpive. Kjo uzinë ka operuar deri në vitin 1990, duke prodhuar dhe shitur rreth 5,000 ton të suvasë në thasë 20-40 kg për tregjet e Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Shpenzimet e shoqëruara me distancën e gjatë të transportimit të boksitit do të duhet të studiohen intensivisht nga çfarëdo blerësi i mundshëm. Megjithatë, çmimet historikisht të larta të mineraleve, afërsia e transportit hekurudhorë ndërkombëtar së bashku me shkallën relativisht të lartë të materialeve, mund ta bëjë këtë operim të mihjes një propozim interesant për kompanitë e minierave. Megjithatë, është e mundshme të transportohen materialet në uzinën e shkrirjes sapo të privatizuar në Mal të Zi. Po ashtu ekzistojnë dy uzina të aluminit në Bosnje dhe Hercegovinë, në Mostar në Federatë dhe në Zvornik në RS, të cilat janë objektet kryesore të përpunimit në rajon.

Boksitet e Kosovës është e vetmja miniere e boksitit në Kosovë. Boksiti mund të gjendet në rajon po ashtu në vendet në vijim: Shqipëri, Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Mali i Zi dhe Serbi.

Me rezerva të dëshmuara prej 1,700,000 tonësh të boksitit, i cili është xehe e metalit të aluminit, rezervat e Minierës së Boksitit duhet të prodhojnë rreth 425,000 tonë të metalit të aluminit pasi kjo është një rregull e minierave, katër tonë boksit mbajnë dy tonë alumin, i cili si rezultat jep një ton të metalit të aluminit. Me çmim prej përafërsisht \$2,600 për ton në kohën e shkrimit, Miniera e Boksitit paraqet në mundësi për zhvillim të mëtejshëm. Një mundësi tjetër për treg është balta e kuqe i cili është një nën produkt i ekstraktimit, i cili tradicionalisht ka qenë një rrezik mjedisor, megjithatë, zhvillimet e fundit sa i përket drenazhimit të minierave acidike e bëjnë këtë një produkt sekondar potencialisht të vlefshëm. Mbingarkesa e Gurit gëlqeror të shoqëruar është në total prej përafërsisht 40 milion tonësh. Guri gëlqeror po ashtu përdoret për shumë aplikime tjera në ndërtimtarë. Për më tepër, mundësia për furnizim të Trepçës, Feronikelit dhe shkretoreve të FeNi është e madhe.

NSH "Boksitet e Kosovës" është licencuar nga KPMM (Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale) për eksploatin e Boksitit; thëngjillit dhe bitumenit si dhe Materialeve Ndërtimore. Pas vitit 1999 "Boksitet e Kosovës" kanë punësuar rreth 247 njerëz.

Boksitet janë një pronë e pazakontë, të cilat, në një shkallë të madhe, gjenden në mëshirën e kostos së transportit si dhe çmimeve botërore të mallrave. Megjithatë, asetet e gurit gëlqeror ofrojnë potencial të besueshëm për ndërtim, dhe tregu aktual për minerale paraqet një mundësi ideale për rivitalizimin potencial të këtyre aseteve të minierës.

4.7 NSH Sharr Prodhimi

NSH Sharrprodhimi në Komunën e Dragashit posedon më shumë se 50% të tokës me përafërsisht 23.000 ha në këtë zonë të bukur por të kufizuar gjeografikisht. Agjencia paraardhëse ka autorizuar një specialist të zonave malore, i cili ka punuar ngushtë me ekipet Rajonale dhe Bujqësore për t'i rishikuar opsionet për këtë NSH. Puna e ndërmarrë nga ky grup ka përfshirë konsultimin me një numër të madh të palëve të interesuara duke përfshirë: Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZR), Agjencinë Kosovare të Pylltarisë (AKP), AER-in, USAID-in, Bankën Botërore, GTZ, SIDA, Agjencinë Austriake për Zhvillim, FAO, UNDP, Komunën e Dragashit, punëtorët e NSH-së, investitorët privat si dhe buqit privat të zonës. Kjo zonë karakterizohet nga një zonë e lartë alpine e cila kullon në një ultësi të pëlleshme të cilës shpesh i referohen si Kopshti i Kosovës. Zhvillimi ekonomik do të arrihet duke i shfrytëzuar disa prej potencialeve të gjenerimit hidro-elektrik, duke ri-forcuar ekonominë bujqësore, si dhe, përfundimisht përmes eko turizmit dhe atij malorë.

Propozimi i specialistit për Agjencinë ka përshkruar një metodologji të re për Sharrprodhimi. Sharrprodhimi paraqet një rast unik: është NSH më e madhe në këtë territor, dhe është në mënyrë kritike e rëndësishme për ruajtjen/mbrojtjen e një numri të sektorëve: bio-diversitetit dhe faunës së madhe, ujëndarëseve dhe menaxhimit të ujit, zhvillimit të bujqësisë dhe mbrojtjes së kullotave, dhe çka është me rëndësi zhvillimin ekonomik për ta luftuar migrimin nga komuna dhe humbjen e trashëgimisë kulturore të grupeve minoritare emigruese.

Janë kryer hulumtime të ekspertëve turistik në mënyrë që të theksohet zhvillimi ekonomik dhe të ripozicionohen mundësitë për rajonin duke marrë parasysh posedimin e madh të tokës të Ndërmarrjes në Pronësi Shoqërore (NSH) Sharrprodhimi. Ky Vlerësim i Mundësisë ka qenë hapi i parë drejt krijimit të një vizioni për ripozicionimin ekonomik të komunitetit si dhe po ashtu si hapa fillestar për implementimin e atij vizioni.

Sa i përket kësaj çështje dhe propozimeve të ekspertit të turizmit ato i janë prezantuar Bordit të Agjencisë paraardhëse (AKM) ku është kërkuar Aprovimi për strategjinë e NSH Sharrprodhimi i datës 20 Shkurt 2007. Aprovimi i strategjisë ka qenë thjeshtë një çështje e mbështetjes së studimeve të mëtejme, dhe se ajo strategji do të ushtrohej në konsultim me palë tjera relevante, dhe kjo çështje ishte aprovuar unanimisht nga anëtarët e Bordit të Agjencisë paraardhëse më datë 5 Prill 2007.

Bazuar në diskutimet me Komunën e Dragashit si dhe me ministrinë përkatëse qeveritare, rekomandimi i ekspertit ka qenë të krijohet një lloj autoritetit i administrimit të Sharrprodhimit (apo menaxhimi i mirëbesimit) i përbërë nga Komuna e Dragashit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe Agjencia (AKM).

UNDP ka iniciuar një projekt zhvillimi për Komunën e Dragashit për t'i përkrahur rekomandimet e Agjencisë në lidhje me zhvillimin rajonal, studimet e fizibilitetit të sektorit për zonën e Dragashit duke përfshirë kullotat dhe pyllin e NSH

Qëllimi i këtij projekti është të siguroj mbështetje për Komunën e Dragashit në formulimin e një strategjie zhvillimore të integruar si dhe duke implementuar një sërë pilot aktiviteteve në disa sektorë. Në shtesë, një prej qëllimeve është që të ndihmohet Komuna e Dragashit në përgatitjen e Planit Komunal Zhvillimor i cili do të fokusohet në Bujqësi dhe potencialisht në zhvillimin e përpunimit të produkteve bujqësore, zhvillimin e infrastrukturës, menaxhimit të bio-diversitetit, zonat potenciale të eko turizmit, etj. Zhvillimi i planeve të tilla do t'i ndihmoj AKP-së në fazat përgatitore të privatizimeve potenciale në këto zona.

5. LIKUIDIMI

Me themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) si një pasardhës i ish AKM-së, Agjencia e ushtron mandatin e saj për likuidimin e Ndërmarrjeve në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-067 dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2005/48 përmes Komisioneve të Likuidimit.

Gjatë mandatit të kaluar të ish Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), përmes Bordit të Drejtorëve të saj dhe nën autoritetin e saj, ka iniciuar procesin e likuidimit më 6 Korrik 2005 dhe më pas ka aprovuar fillimin e likuidimit të rreth 120 pronave të NSH-ve, deri në fund të mandatit të tyre.

Nga Bordi i Drejtorëve është dakorduar se (i) Procesi i Likuidimit është rikonfirmuar dhe ka rifilluar më 01 Shkurt 2009 apo në një datë më të vonshme pasi që dy Zëvendës Drejtorët Menaxhues munden, në diskrecionin e tyre, të përcaktojnë dhe kushtëzojnë, aty ku është e aplikueshme, shitjet e privatizimit të cilat hyjnë në fuqi; dhe (ii) dy Zëvendës Drejtorët Menaxhues janë të autorizuar të emërojnë anëtarë të Komisionit të Likuidimit për secilin likuidim dhe të emërojnë zëvendësime të tilla të cilat mund të jenë të nevojshme kohë pas kohe.

Në takimin e Bordit të mbajtur më 29 Maj 2009, në lidhje me çështjet e Likuidimit është vendosur se Komisionet e Likuidimit të Ndërmarrjeve të rikonfirmuara dhe të rifilluara më 1 Shkurt 2009 të kompletojnë fazën përgatitore për shitjet e aseteve deri sa anëtarët e mbetur të Komisioneve të Likuidimit të emërohen nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë.

Ekzistojnë 120 Komisione të Likuidimit të cilat janë duke punuar në likuidimin e 120 aseteve të NSH-ve. Secili komisioni i likuidimit duhet të ketë një anëtarë ndërkombëtar, i cili emërohet nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil (ICO) (*paragrafi 9.2 Ligji mbi Themelimin e AKP-së*). Anëtarët e ICO-së janë të shpërndarë në Zyrat Rajonale të AKP-së, dhe përgatitjet për shitjen e likuidimeve tjera do të fillojnë.

Duhet të theksohet se gjatë mandatit të agjencisë paraardhëse nuk ka pasur procedura unike të likuidimit për t'i ndihmuar Komitetet e Likuidimit në kryerjen e detyrave të tyre ditore të cilat dalin nga ligjet e zbatueshme dhe politikat operacionale të Agjencisë. Megjithatë, ka pasur vetëm copëza dhe pjesë të krijuara nga i ashtuquajti Komiteti Drejtues Rajonal i Likuidimit, i cili ishte themeluar për t'i koordinuar aktivitetet e Departamentit të Privatizimit dhe Njësisë së Likuidimit (gjatë mandatit të AKM-së).

AKP ka përpiluar me sukses Udhëzuesin e Likuidimit për Komisionet e Likuidimit, duke reflektuar ndryshimet e ligjit të zbatueshëm, më saktësisht Ligjit mbi Themelimin e AKP-së, Ligji mbi Shoqëritë Tregtare si dhe Politikat Operative të AKP-së.

Po ashtu, ekipi nga Departamenti i Likuidimit dhe Pohl & Consulting kanë kryer trajnime – prezantime për zyrtarët në pesë Zyra Rajonale të AKP-së si dhe në departamentet relevante të Selisë Qendrore të AKP-së, është prezantuar Udhëzuesi i Likuidimit si dhe Konspekti i ligjeve relevante të Kosovës në lidhje me likuidimin.

AKP po ashtu i ka amandamentuar të gjithë formularët në lidhje me procedurat e likuidimit për t'i reflektuar ndryshimet e ligjeve dhe procedurave të sipërpërmendura.

Përfaqësuesit e ICO-së janë furnizuar me Udhëzimin e Likuidimit, Konspektin e ligjeve relevante Kosovare mbi likuidimin, diagramin e likuidimit si dhe dokumente të tjerë sipas kërkesës së tyre.

THE PROCESS OF LIQUIDATION AND DEALING WITH CLAIMS

**Pursuant to Pak Law, PAK Operation policies, UNMIK “SCSC” Regulations 2008/4
and 2008/19 & Administrative Direction 2008/6**

No	Phase	Controlling Body	Step	Reference	Ready Reckoner		
					Days	Cum Days from Start	Days to End
1	Liquidation	Liquidation Committee (“LC”) (1 ICO Member)	1	Board Decision to Liquidate SOE			1,264
			2	Liquidation notice to Business Registry	PAK Op Pol 6.4	5	1,259
			3	Minimum notice of sale of assets	PAK Op Pol 6.4 (d)	30	1,229
			4	Examination of SOE Books and Records	PAK Op Pol 6.5		1,229
			5	Inventory of Assets	PAK Op Pol 6.5		1,229
			6	Notices to all known Creditors	PAK Op Pol 6.5		1,229
			7	Determination of method of Assets Sale	PAK Op Pol 6.5		1,229
			8	Advertise Liquidation - 1st Advert	PAK Op Pol 6.5		1,229
			9	Advertise Liquidation - 2nd Advert	PAK Op Pol 6.5		1,229
			10	Publish List of Assets for Sale	PAK Op Pol 6.5		1,229
			11	Notification to Courts to suspend legal actions	UNMIK Reg 2005/48 S.49.1		1,229
			12	Claims to be received within 60 days of 2nd advert	PAK Op Pol 6.9.1	60	1,169
			13	Organise Sale of Assets	PAK Op Pol 6.11.1 (Sale< 60 days of step 9) - LC may adjourn		1,169
			14	LC assessment of Creditor Claims	PAK Op Pol 6.9.2	30	1,139
			15	LC notification of its assessment of Creditors Claim	PAK Op Pol 6.9.2	5	1,134
			16	Creditor appeal against LC assessment of claim	PAK Law S.24.3	60	1,074
2	Appeal 1 (Internal)	Liquidation Case Review Committee (“LCRC”) -ICO Chair-	17	LCRC review of LC assessment of claim	PAK Law S.24.6	60	1,014
			18	Time allowed for LCRC review	PAK Law S.24.7	30	984
			19	Notification of LCRC decision	UNMIK 2008/6 s.69.3	14	970
			20	LCRC Advert in the event of non delivery or returned notifications	UNMIK AD 2007/1 S.8.3	14	956
			21	Notification of Creditor appeal against LCRC decision	UNMIK 2008/6 s.69.5	30	926
			22	Creditor appeal to SCSC against LCRC review	PAK Law S.24.8 & UNMIK 2008/6 S.28.2 (d)	270	656
3	Appeal 2 (1st Instance)	SCSC Trial Panel	23	PAK defence of a Claim to be filed with SCSC	UNMIK 2008/6 S.29.1 - may be extended by SCSC	30	626
			24	SCSC Proceedings to consider Claims	UNMIK 2008/6 S.28. Duration not specified - Estimated	90	536
			25	Creditor deadline for submission of corrected Claim	UNMIK 2008/6 S.28.5 Duration not specified - Estimated	14	522
			26	SCSC Proceedings to consider corrected Claims	UNMIK 2008/6 S.28.5 Duration not specified - Estimated	30	492
			27	Supplementation of Claim & defence by reply and rejoinder	UNMIK 2008/6 S.30 Duration not specified - Estimated	90	402
			28	SCSC preliminary report following close of written proceedings	UNMIK 2008/6 S.34.1	30	372
			29	SCSC orders further burdens of proof	UNMIK 2008/6 S.34.3 Duration not specified - Estimated	30	342
			30	Application to set a default judgment aside	UNMIK 2008/6 S.53.2	30	312
			31	Appeal to the SCSC Appellate Panel	UNMIK 2008/6 S.59.1	60	252
			32	Filing a response to appeal to the SCSC Appellate Panel	UNMIK 2008/6 S.61.1	60	192
4	Appeal 3 (2nd Instance)	SCSC Appeal	33	SCSC Proceedings to appeal and response	UNMIK 2008/6 S.61.4 Duration not specified - Estimated	60	132
			34	Reply and rejoinder by parties to the appeal	UNMIK 2008/6 S.62	30	102
			35	Parties may submit additional evidence to Appellate Panel	UNMIK 2008/6 S.64	15	87
			36	SCSC Disposal of Appellate Proceedings	UNMIK 2008/6 S.65 Duration not specified - Estimated	30	57
			37	Final Distribution of Funds	PAK Law S.5.7 (b) Interims not ruled out	10	47
5	Closure	LC (1 ICO Member)	38	Board Approval of Conclusion of Liquidation	Board Meetings Once a Month (PAK Op Policy 6.17.1)	29	18
			39	Application to SCSC for Order of Closure	Estimated	15	3
			40	Notice to Business Registry of Case Closure	Estimated	3	


Afatet Kohore të Likuidimit

Ligjet dhe rregulloret të cilat e qeverisin likuidimin janë hulumtuar dhe janë hartuar hapat individual dhe afatet kohore. Tani është e qartë se një likuidim i cili përshkon të gjithë hapat e përcaktuar do të zgjasë, mesatarisht, 42 muaj për t'u përfunduar. Është identifikuar një dispozitë relativisht e panjohur në ligjin DVGL (siç duket e panjohur ose e papranuar nga AKM) e cila i lejon një paditësi 9 muaj që të depozitoj një ankesë pranë DVGL. Në fakt, harta e afateve kohore të likuidimit thekson se shumica e kohës së duhur (përafërsisht 19 muaj) është jashtë kontrollit të AKP-së. **Ne do të dëshironim që këto afate kohore të jenë shumë më të shkurtra sesa ato aktuale.**

AKP në vazhdimësi po zhvillon procedurat mbi krijimin e Bazës së të Dhënave të Likuidimit. Kjo e fundit është një aplikacion me bazë në rrjet (ueb) i dizajnuar për ta bërë të mundshëm regjistrimin, editimin dhe kërkimin e informacionit për NSH-të në likuidim dhe asetet e tyre. Versioni i parë i aplikacionit në format SQL është instaluar dhe prezantuar para stafit të ZR (Zyrave Rajonale (Zyrave për Zhvillimin e Ndërmarrjeve – ZZN), dhe po funksionon shumë mirë. Në të gjitha ZR të AKP-së, janë zhvilluar trajnime për Bazën e re të të Dhënave të Likuidimit, kështu që punëmarrësit e AKP-së të cilët janë të autorizuar ta përdorin aplikacionin janë njoftuar me të, dhe kanë filluar t'i fusin informacionet e nevojshme. Aktualisht, të dalat financiare janë duke u modifikuar, dhe së shpejti do të filloj faza e dytë e zhvillimit të aplikacionit e cila do të përbëhet kryesisht nga teknikalitete dhe forma të raporteve për menaxhmentin e AKP-së në Selinë Qendrore. Ne besojmë se kjo është një bazë e të dhënave e sofistikuar. Deri më sot 201 kontrata për Ofruesit e Shërbimeve janë nënshkruar (126-Privatizimi dhe 75- Likuidimi).

AKP ka trashëguar nga AKM 166 Kontrata në pritje. Me fjalë të tjera AKM që nga themelimi apo për 6 vite operimi, ka përfunduar 394 Kontrata Shitje me Spin-Of të Rregullt, 24 Kontrata Shitje me Spin-Of Special, dhe 36 Kontrata Likuidimi apo në total 454 Kontrata. Pas konsolidimit të Departamentit Ligjor të AKP-së në fillim të Marsit 2009 dhe deri më sot, në total janë përfunduar 110 Kontrata Shitje dhe të tjerat janë në përpunim e sipër (duke përfshirë kontratat e reja nga shitjet e AKP-së). Tabela dhe diagrami më poshtë tregojnë në detaje arritjen e AKP gjatë periudhës kohore prej javës së parë të Marsit 2009, deri në fund të muajit Korrik 2009 apo në më pak se 5 muaj.

	Spin-of i Rregullt		Spin-of Special		Likuidimi	
	Në numër	Në vlerë (€)	Në numër	Në vlerë (€)	Në numër	Në vlerë (€)
Kontrata të Nënshkruara nga AKM	394	€260,646,958	24	€91,723,495	36	€4,293,164
Kontrata në Pritje nga AKM	77	€34,478,440	2	€4,258,000	70	€14,189,134
Kontrata të Nënshkruara nga AKP	54	€12,337,132	0	€0.00	56	€11,456,438.90



Lista e Punëtorëve


Njësia e Listës së Punëtorëve mbetet e përkushtuar ta shtyj përpara procesin e shpërndarjes së 20% të kualifikueshmërisë së punëmarrësve. Kështu që, që nga themelimi i AKP-së Njësia për Listën e Punëtorëve ka kryer një punë të paprecedent në mënyrë që t'i përmbushë zotimet e Agjencisë për shpejtimin e këtij procesi shumë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e mirëqenies sociale të qytetarëve të Kosovës po ashtu.

AKP ka shpërndarë më shumë se €3.5 milion tek 2,752 punëmarrës të 16 NSH-ve duke e arritur totalin e shumë të shpërndarë deri më tani në €19.2 milion. Kjo do të thotë se nëse paraardhësi i AKP-së (AKM) gjatë tërë mandatit të saj ka shpërndarë €15.5 milion, në anën tjetër vetëm gjatë 10 muajve të parë të operimit të AKP-së më shumë se 18% e shumës totale është shpërndarë tek punëmarrësit e kualifikuar.


Tabela më poshtë tregon shumë e 20% të shpërndarë të secila NSH si dhe numrin e punëmarrësve të cilët kanë realizuar 20% shitje të aksioneve të NSH-së ku ata kanë punuar, ndërsa diagrami tregon shpërndarjen e 20% muaj për muaj që nga themelimi i AKP-së si dhe paralelen e pagesave të 20% gjatë mandatit të AKM-së dhe AKP-së.

Emri i NSH	Rajoni	Shuma e shpërndarë	Nr. i punëmarrësve
IMN Dukagjini	Pejë	€1,216,899.39	227
Fabrika e Plastikës	Mitrovicë	€185,335.61	142
FAN	Prishtinë	€496,765.43	420
Eximkos	Prishtinë	€605,156.20	110
Kosova Kontroll	Prishtinë	€17,476.67	6
Stacioni i Veterinarisë Prizren	Prizren	€32,573.39	5
Bujqësia Pejë	Pejë	€145,933.60	115
Llapi	Prishtinë	€39,541.02	123
Lux	Mitrovicë	€87,790.36	438
IMB	Mitrovicë	€28,403.61	182
Konfeksioni Trepça	Mitrovicë	€11,221.34	46
1 Maj	Mitrovicë	€14,682.72	160
17 Nëntori	Pejë	€90,304.37	345
Auto Shtëpia "Mustafë Rexhepi"	Gjilan	€40,592.69	262
TE Rugova	Pejë	€8,728.51	14
NHTT Rugova	Pejë	€526,115.44	157

Tabela 1: Shpërndarja e 20% nga AKP – Lista e NSH-ve



Diagrami 1: Shpërndarja e 20% nga AKP – E ndarë në muaj



Diagrami 2: Shpërndarja e 20% – Krahasoni në mes AKP-së dhe paraardhësit të saj (AKM-së)

Numri total prej 80 listave të punëtorëve është publikuar që nga Marsi 2009 ku 27 kanë qenë përfundimtare kurse 53 preliminare. Përgjatë javëve në vijim ne synojmë të publikojmë në mesatare 10 Lista të Punëtorëve për çdo javë.

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur emrat e listave të punëtorëve të NSH-ve të cilat AKP tanimë i ka publikuar në gazeta të përditshme (në gjuhë Shqipe dhe Serbe) si dhe në ueb-faqen e AKP-së po ashtu.

Emri i NSH-së	Rajoni	Data Finale e publikimit të listës përfundimtare – Data e fundit	Afati i fundit për parashtrimin e ankesave në DVGL	Nr. i punëtorëve në listë
KNI Ramiz Sadiku Prishtinë	Prishtinë	7-Mar-09	27-Mar-09	536
Ramiz Sadiku Prizren	Prizren	9-Maj-09	30-Maj-09	323
Ballkan	Prizren	9-Maj -09	30-Maj -09	1259
Krikos	Prishtinë	9-Maj -09	30-Maj -09	14
Aromatik	Prizren	9-Maj -09	30-Maj -09	22
16 Qershori	Pejë	9-Maj -09	30-Maj -09	16
Trasing	Prishtinë	23-Maj -09	13-Qer-09	242
Energomontimi	Prishtinë	23-Maj -09	13-Qer-09	48
Theranda	Prizren	23-Maj -09	13-Qer-09	56
Mushrooms Factory	Prishtinë	23-Maj -09	13-Qer-09	25
Anamorava	Gjilan	23-Maj -09	13-Qer-09	13
Tools and Apparatus Factory	Gjilan	23-Maj -09	13-Qer-09	229
Kosovatrans Gjilan	Gjilan	30-Maj -09	20-Qer-09	158

Emri i NSH-së	Rajoni	Data Finale e publikimit të listës përfundimtare – Data e fundit	Afati i fundit për parashtrimin e ankesave në DVGL	Nr. i punëtorëve në listë
Fabrika e Tullave Luboten	Gjilan	30-Maj-09	20-Qer-09	4
Fabrika e Tullave Luboten	Gjilan	30-Maj-09	20-Qer-09	
28 Nëntori	Gjilan	13-Qer-09	4-Korr-09	255
Agromorava Viti	Gjilan	13-Qer-09	4-Korr-09	123
Kosovatrans Kamenica	Gjilan	13-Qer-09	4-Korr-09	42
Mustafë Goga	Gjilan	13-Qer-09	4-Korr-09	115
Çyçavica	Mitrovicë	13-Qer-09	4-Korr-09	186
Agr. Stacioni Gjakova	Pejë	13-Qer-09	4-Korr-09	4
Utva	Pejë	13-Qer-09	4-Korr-09	179
Birraria Peja	Pejë	11-Korr-09	01-Gusht-09	508
Kosovarja	Prishtinë	11-Korr-09	01-Gusht-09	138
Plantacioni Ferizaj	Gjilan	11-Korr-09	01-Gusht-09	26
KHT Kosova	Prishtinë	08-Gusht-09	28-Gusht-09	692
Kosova Construction	Mitrovicë	08-Gusht-09	28-Gusht-09	252
Kosova Hidroteknika	Prishtinë	08-Gusht-09	28-Gusht-09	58

Tabela 2: Listat përfundimtare të publikuara

Emri i NSH-së	Rajoni	Publikimi i listës (data e fundit)	Afati i fundit për parashtrimin e ankesave në AKP	Nr. i punëtorëve në listë
Bujqësia Prishtinë	Prishtinë	09-Maj-09	30-Maj-09	49
KB Orllani	Prishtinë	09-Maj-09	30-Maj-09	8
Fertrans Ferizaj	Gjilan	09-Maj-09	30-Maj-09	13
KB Skivjani	Pejë	09-Maj-09	30-Maj-09	11
Universiteti i Punëtorëve	Gjilan	09-Maj-09	30-Maj-09	3
Standard	Pejë	16-Maj-09	8-Qer-09	111
KBI Agro-kultura	Gjilan	16-Maj-09	8-Qer-09	255
Metalografika	Gjilan	16-Maj-09	8-Qer-09	11
Filigran	Prizren	16-Maj-09	8-Qer-09	44
Ferronikeli	Prishtinë	06-Qer-09	27-Qer-09	1866
Inginiering	Prishtinë	06-Qer-09	27-Qer-09	28
Jometalet Kaolini	Gjilan	04-Korr-09	30-Maj-09	11
KB Banja	Pejë	04-Korr-09	30-Maj-09	3
KB Bujku-Rogana	Gjilan	04-Korr-09	8-Qer-09	111
KB Vitia	Gjilan	04-Korr-09	8-Qer-09	255
KB Mirusha	Gjilan	04-Korr-09	8-Qer-09	11
Qëndresa/Morava-Kamenice	Gjilan	04-Korr-09	8-Qer-09	44
Vetfarm-Viti	Gjilan	04-Korr-09	27-Qer-09	1866
Teuta/Vrella	Pejë	04-Korr-09	27-qer-09	28
AC Istog	Pejë	18-Korr-09	8-Gusht-09	9
AC Kosova Lipjan	Prishtinë	18-Korr-09	8-Gusht-09	47
Fabrika e Farërave	Pejë	18-Korr-09	8-Gusht-09	40


Emri i NSH-së	Rajoni	Publikimi i listës (data e fundit)	Afati i fundit për parashtrimin e ankesave në AKP	Nr. i punëtorëve në listë
Drithnaja	Prishtinë	18-Korr-09	8-Gusht-09	6
Pioniri	Gjilan	18-Korr-09	8-Gusht-09	178
SHAM Drita	Gjilan	18-Korr-09	8-Gusht-09	4
XIQ Karaqeva	Gjilan	18-Korr-09	8-Gusht-09	459
Malishgan	Pejë	18-Korr-09	8-Gusht-09	95
Agimi - Mishi Gjakove	Pejë	25-Korr-09	15-Gusht-09	70
Bentokos	Gjilan	25-Korr-09	15-Gusht-09	25
Dardania	Prishtinë	25-Korr-09	15-Gusht-09	170
IMF Kosova-Industria e mishit F.Kosovë	Prishtinë	25-Korr-09	15-Gusht-09	109
KB Ferizaj	Gjilan	25-Korr-09	15-Gusht-09	8
Mulliri Gjakovë	Pejë	25-Korr-09	15-Gusht-09	86
Qarkullimi/Promet	Gjilan	25-Korr-09	15-Gusht-09	68
Stacioni për mbrojtjen e bimëve	Pejë	25-Korr-09	15-Gusht-09	5
Pasuria Bujqësore	Gjilan	25-Korr-09	15-Gusht-09	16
Tregtia e Kosovës	Prishtinë	25-Korr-09	15-Gusht-09	12
Dobrusha	Pejë	01-Gus-09	21-Gusht-09	9
Dubrava	Pejë	01-Gus-09	21-Gusht-09	79
Dardania/Putnik	Prizren	01-Gus-09	21-Gusht-09	59
Hidromont	Pejë	01-Gus-09	21-Gusht-09	11
Kosovashped	Prishtinë	01-Gus-09	21-Gusht-09	36
Kosovatek	Prishtinë	01-Gus-09	21-Gusht-09	386
Prizrencoop	Prizren	01-Gus-09	21-Gusht-09	15
Vet. Station Skenderaj	Mitrovicë	01-Gus-09	21-Gusht-09	5
Elan	Mitrovicë	15-Gus-09	5-Shtat-09	218
Artizanati	Prizren	15-Gus-09	5-Shtat-09	31
Banesa	Prizren	15-Gus-09	5-Shtat-09	10
1 Maj Rahovec	Prizren	15-Gus-09	5-Shtat-09	77
IFS Progresi	Prizren	15-Gus-09	5-Shtat-09	864
Klinapremix	Pejë	15-Gus-09	5-Shtat-09	45
Thertorja Eksportuese Prizren	Prizren	15-Gus-09	5-Shtat-09	68
Vinex	Gjilan	15-Gus-09	5-Shtat-09	228

Tabela 3: Listat preliminare të publikuara

Që prej se AKP ka marr përsipër Procesin e Privatizimit në Kosovë një nga sfidat kryesore të Agjencisë ka qenë shpejtimi i Procesit të 20% të kualifikueshmërisë së punëtorëve.


Në mënyrë që ta përmbushë suksesshëm një proces kaq të rëndësishëm, AKP i ka rritur kapacitetet e veta njerëzore dhe në këtë mënyrë ka themeluar një njësi të veçantë brenda Departamentit Ligjor të quajtur Paneli Rishqyrtues i Listave të Punëtorëve (PRLP) i cili do të merret vetëm me rishqyrtimin e ankesave në lidhje me 20%.

Si rezultat i përpjekjeve të përkushtuara nga AKP janë publikuar 80 lista të punëtorëve të NSH-ve brenda pesë muajsh, derisa AKM gjatë tërë mandatit të saj në total ka publikuar 106 lista (40 preliminare dhe 66 përfundimtare).



Diagrami 3: Listat e Punëtorëve të NSH-ve të Publikuara që nga Marsi 2009

Edhe pse ka pasur disa pengesa politike në lidhje me publikimin e Listës së Punëtorëve në gazetën Serbe, AKP ka mbetur këmbëngulëse në zotimet e saj dhe prandaj e ka zhbllokuar procesin përmes zgjidhjeve alternative. Avancimet janë mjaft të dukshme – në mesatare 16 lista të punëtorëve janë publikuar për çdo muaj. Ky progres i veçantë paraqitet në diagramin në vijim.



Diagrami 4: Listat e Punëtorëve të NSH-ve të Publikuara – Krahasoni në mes AKP dhe paraardhësit të saj (AKM)

Duhet të theksohet se si pasojë e mosefikasitetit të Dhomës së Veçante të Gjykatës së Lartë që të procedoj me të gjitha listat përfundimtare të publikuara, AKP mund të mos vazhdoj me shpërndarjen e 20% tek punëtorët e kualifikuar pasi që kjo e fundit është ligjërisht e kufizuar të pres për vendimin përfundimtar të DVGL për secilën Listë të Punëtorëve të publikuar, para se të shpërndaj mjetet.

Bazuar në përvojat e deri më sotme, në mesatare DVGL-së i merr 3-6 muaj për të rishikuar ankesat e parashtruara për secilën listë të publikuar dhe të lëshoj një vendim përkatës.

Pavarësisht këtij fakti AKP është fuqishëm e përcaktuar të vazhdoj publikimin e Listës së Punëtorëve pasi që procesi është ndalur dhe një numër i konsiderueshëm i Listave është i gatshëm për publikim.

AKP ka kompozuar një plan të detajizuar rreth publikimit të Listës së Punëtorëve në veçanti. Deri në fund të këtij viti parashihet të publikohen të gjitha listat e mbetura të pa publikuara.

Njësia e Listës së Punëtorëve në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin Ligjor është në proces të finalizimit të Udhëzimit të 20% i cili kryesisht fokusohet në kriteret e kualifikimit, procedurat e ankesës dhe shpërndarjes.

6. DIVIZIONI I QEVERISJES KORPORATIVE

6.1 Spin Off-i Special

Gjatë procesit të privatizimit disa N.Sh vlerësohet të kenë ndikim domethënës për ekonominë e Kosovës në kuptim të asaj që një industri apo biznes i veçantë vlerësohet të jetë i një rëndësie kyçe në zhvillimin e mëtutjeshëm ekonomik për rajonin ku është e vendosur veprimtaria dhe për ekonominë në përgjithësi, punëson një numër të madh njerëzish, ka potencial për zgjerim, posedon histori të njohur të markës së saj, atëherë aplikohet metoda e Spin of-it Special.

Privatizimet me Spin Of Special janë bërë gjatë mandatit të AKM-së bazuar në nenin 10.2 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, e cila deklaron se politikat operative (të nxjerra nga Bordi si udhëzues për Agjencinë) do të përcaktojnë “rrethanat sipas së cilave Agjencia mund të kërkoj nga palët ofertuese për akcione në Korporata të prezantojnë një biznes plan të qëndrueshëm përfshirë veprimtaritë e propozuara, nivelet e investimeve dhe punësimit, dhe prova për mjetet financiare për të bërë investimet e parapara në biznes plan...”.

Ndërsa, Ligji nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nuk përmban nenin specifik siç e përmban Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12, neni 10.2 (b) i cili në mënyrë specifike i përcakton kushtet e Spin Of-it Special. Sa i përket kësaj baza ligjore për privatizimin me Spin Of Special sipas këtij Ligji duhet të përmirësohet.

Në përgjithësi privatizimi me “Spin Of Special” (SOS) përmban kërkesa shtesa për ofertuesit të dorëzojnë zotimet mbi investime dhe punësim, planin e biznesit dhe investimit. Politikat Operative të AKP-së definojnë spin of-in special si proces në të cilin Agjencia përveç ofertës me çmimin më të lart vlerësojnë edhe kriteret në vazhdim:

- Investimet që ofertuesi ofron të ndërmerr.
- Plani i biznesit dhe investimeve që dorëzohet nga ofertuesi.
- Kërkesa shtesë mbi performancën të përcaktuara nga Menaxhmenti dhe miraturara nga Bordi.

Kriter tjetër i cili mund të jetë i rëndësishëm në raste të veçanta të SOS mund të jetë dëshmia e ekspertizës së mjaftueshme në atë fushë në mënyrë që të jetë në gjendje të zhvilloj aktivitetet e veprimtarisë së caktuar për Ndër. Të Rë, dhe nëse është e nevojshme provë mbi kualifikimin për ndonjë licensë operimi, e cila duhet t’i transferohet apo duhet të lëshohet përsëri për Ndër. e Re. Të gjitha kërkesat mbi kriteret e ofertimit për SOS do të parashihen në Rregullatë e Tenderit që i nënshtohen miratimit nga Bordi i Drejtorëve në mënyrë specifike për çdo SOS. (Vërejtje: Nuk do të ndodhë asnjë Spin Off Special pa ndryshimin e legjislacionit aktual).

Që një ndërmarrje të kualifikohet për procedurat e Spin Off-it Special ajo duhet t’i plotësoj kriteret e caktuara në kuptim të punësimit dhe pagesës së rregullt të taksave për një periudh të caktuar kohore dhe për një numër të caktuar punëtorësh dhe të ardhurat e përgjithshme në një shumë të caktuar para privatizimit.

Menaxhmenti apo ndonjë anëtarë i Bordit mund t’i propozoj Bordit që një N.Sh e caktuar e cila nuk plotëson ndonjë prej kriterëve të përcaktuara si kriteret specifike në politikat operative ajo megjithatë do të privatizohet përmes Spin Off-it me procedurat e Spin Off-it Special po që se ajo N.SH do të ketë ndikim të jashtzakonshëm në ekonominë e Kosovës, dhe nëse Bordi e miraton një gjë të tillë.

Në përputhje me Politikat Operative të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të AKP-së do të autorizoj vlerësimet lidhur me Spin Of-et Speciale dhe për situata tjera kur Bordi konsideron se është e nevojshme. Vlerësimet duhet të kryhen nga institucione ose ekipe të përbëra nga ekspert vendor dhe ndërkombëtar. Rezultatet e vlerësimeve nuk mund të bëhen publike dhe nuk e obligojnë Bordin në procesin e selektimit të ofertave. Për Spin Of-et Speciale, Agjencia kërkon nga ofertuesit fitues të nënshkruanë një kontratë me Agjencinë e cila përcakton dispozitat për ofertuesit fitues në kuptim të performancës, investimeve, dhe kriteret e punësimit për çdo rast veç e veç.

Shitja e parë SOS është bërë me 23 mars 2005. Deri më tani kemi 24 N.Sh të cilat janë shitur përmes procedurës së SOS. Gjatë mandatit të AKM-së dy SOS janë liruar nga raportimi dhe monitorimi i mëtutjeshëm si rezultat i përmbushjes së zotimeve të tyre. Gjatë mandatit të AKP-së 4 (katër) SOS janë liruar nga raportimi dhe monitorimi i mëtutjeshëm pasi që auditimi i jashtëm ka treguar që ata i kanë përmbushur zotimet e tyre në përputhje

me Marrëveshjen e Zotimeve. Në anën tjetër ne kemi një numër të SOS të cilat tani më kanë bërë shkelje të jashtazakonshme të Marrëveshjes së Zotimeve sa i përket investimeve dhe zotimeve të punësimit. Për 1 (një) SOS AKP po e ushtron të drejtën e saj në përputhje me Marrëveshjen e Zotimeve për të kthyer aksionet nën Administrimin e AKP-së për shkak të shkeljes së Marrëveshjes së Zotimeve nga Blerësi.

Në lidhje me këtë, që nga themelimi i AKP-së, është bërë një punë intensive lidhur me ndërmarrjet e privatizuara nga ish AKM-ja përmes metodës së spin off-it special. Mangësitë e para të vërejtura nga e kaluara (nga ish AKM-ja), kryesisht kanë të bëjnë me parakualifikimin dhe zgjedhjen e dobët të investitorëve potencial dhe potencialisht pronarëve të rinj të këtyre ndërmarrjeve të privatizuara përmes spin off-it special, e cila ka mundësuar blerjen e këtyre ndërmarrjeve, ne disa raste, nga individë/kompani të cilët nuk kanë përvojë të duhur në fusha të caktuara. Mangësia e dytë është çështja e kontratave (marrëveshjeve të shitjes) me spin off special. Si mangësi tjetër mund të përmendet mekanizmi shumë i dobët i monitorimit që është bërë në të kaluarën nga ish AKM-ja në lidhje me nivelin e plotësimit të zotimeve për investime dhe punësim nga blerësi. Kjo ka rezultuar më një neglizhencë nga ana e ish AKM-së lidhur me ndërhyrjen/intervenimin me kohë, e cila ishte edhe obligim ligjor ndaj, gjë që në vazhdimësi ka dështuar t'i plotësoj zotimet e bëra.

Duhet të theksohet se Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka aprovuar strategjine e detajizuar mbi trajtimin e N.Sh-ve të privatizuara nga AKM-ja përmes metodës së Spin Of-it Special.

Në pjesën në vijim të këtij raporti ju do të gjeni informacione të detajizuara për secilën ndërmarrje të privatizuar me Spin Of Special:

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Banja e Kllokotit
Vendi/Komuna:	Viti / Rajoni i Gjilanit
Fillimi i Kontratës:	24/11/2005
Çmimi i Shitjes:	€1,805,550.00
Zotimi i Investimit:	€3,100,000.00
Zotimi i Punësimit:	50 punëmarrës në gjashtë muajt e parë, 101 në fund të gjashtë muajve dhe 201 deri në fund të vitit të parë, 201 të mbahen edhe për një vit.

Afarizmi / Sektori: Prodhimi i CO₂ dhe ujit mineral

Ndërmarrja / Produkti: Banja e Kllokotit ka një reputacion të shkëlqyer në tregun lokal për cilësinë dhe shijen e ujit mineral. Ndërmarrja posedon dy puse të ujit mineral të cilat gjinden në një distancë prej 150 metrash respektivisht 7 km nga fabrika. Përveç kësaj, emri i saj është mjaft mirë i njohur në një pjesë të madhe të ish Jugosllavisë. Ndërmarrja është duke punuar në kufij të kapaciteteve teknike të saj, dhe së fundi është përhapur edhe në tregun Evropian. Për më tepër, ndërmarrja është e vetmja prodhuese e CO₂ në Kosovë.

Investimet: Edhe pse deri më 31/12/2005, kompania nuk ka qenë e zotuar të bëjë asnjë raportim, ata kanë filluar menjëherë me investime të reja ta rivitalizojnë prodhimin. Blerësi i ka raportuar deri më 23.11.2007, TM8 (tremujori fundit) €4,096,000 nga të cilat sipas raportit të auditimit €844,000 nuk janë njohur si investime kapitale në përputhje me Marrëveshjen e Zotimeve. Auditori ka konstatuar se ndërmarrja deri më 23.11.2007, TM8 (tremujori fundit) ka bërë investime në shumë prej €3,252,000 ose 105 % të investimeve të zotuar. Investimet kryesisht janë bërë në riparimin e objekteve ekzistuese, ndërtimin e objekteve të reja, avancimin e teknologjisë informative të Ndër. së Re, në riparimin e linjave të prodhimit dhe instalimit e linjës së re të prodhimit, në blerjen e makinave të transportit etj.

Punësimi: Edhe pse Blerësi është zotuar t'i punësoj 201 në gjashtë muajt e parë, pronari i ri i kompanisë ka punësuar 139 punëmarrës në fillim të punës së tij. Bazuar në raportin e auditorëve të jashtëm deri më 23.11.2007 (TM8 - i fundit) kompania ka punësuar 201 punëmarrës apo 100.00% të zotimit të punësimit.

Çështjet: Sipas marrëveshjes për zotim dhe monitorimit të kësaj ndërmarrje me Spin Of Special nuk ka asnjë çështje për ta raportuar, Blerësi ka bërë investime të mrekullueshme në NSH-në e cila është vërejtur nga komuna dhe rajoni dhe po ashtu nga ekonomia Kosovare në përgjithësi.

Përmbledhje: Raporti përfundimtar i Auditorëve të Jashtëm tregon se Ndër.e.Re Banja e Kllokotit ka arritur të përmbushë suksesshëm zotimet e punësimit dhe investimit. Bordi i Drejtorëve të AKP-së në takimin e tij të mbajtur në Qershor 2009 ka vendosur të liroj Ndër.e.Re nga monitorimi dhe raportimi i mëtejshëm.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Ferronikeli
Vendi/Komuna:	Drenas/Rajoni i Prishtinës
Fillimi i Kontratës:	20/12/2005
Çmimi i Shitjes:	€30,554,371.00
Zotimi i Investimit:	€20,000,000.00 për tri vite
Zotimi i Punësimit:	250 punëtorë në gjashtë muajt e parë, 500 në fund të gjashtë muajve dhe 1,000 deri në fund të vitit të parë 1,000 punëtorë të mbahen edhe për dy vite

Afarizmi/Sektori: Miniera dhe Përpunimi i Mineraleve

Ndërmarrja / Produkti: Operimi i Mihjes së Xehes/Metalurgjik i Ferronikelit në lartasin e tij në vitin 1989; ka punësuar 2,000 persona dhe ka prodhuar dhe eksportuar 6,800 tonë të Nikelit të përmbajtur në shufra të ferro-nikelit. Fillimisht e ndërtuar në 1984 për të prodhuar fero-nikel për eksport, mihja dhe uzina kanë qenë të dyja të mos-mirëmbajtura dhe të degraduara gjatë viteve 1990-ta, dhe përfundimisht e ka ndërprerë funksionin në vitin 1998.

Prodhuar i Nikelit prej 12,000 tonë për vit me 12 apo më shumë vite jete të mbetura (mihje në shkallë të dizajnuar prej 1.2 milion ton të xehes për vit). Aktualisht ekzistojnë 13.8 Milion tonë të xehes me shkallë prej 1.32% të Nikelit në rezerva.

Investimet: Bazuar në raportin e auditorëve Blerësi deri më 30.06.2009, TM12, ka bërë investime në shumë prej €60,000,000 apo 300% të investimeve të zotuar. Investimet janë bërë kryesisht në riparimin e pajisjeve ekzistuese, blerjen e makinerisë së re dhe pjesëve për makinerinë, instalimin e linjave elektrike, përmirësimin e sistemeve në përgjithësi.

Punësimi: Sa i përket punësimit, bazuar në raportin e auditorëve deri më 30.06.2009, TM12-tremujori i fundit, Blerësi ka punësuar 1,045 punëtorë apo 104 % të punësimit të zotuar.

Çështjet: Sipas marrëveshjes për zotim dhe monitorimit të kësaj ndërmarrje me Spin Of Special nuk ka asnjë çështje për ta raportuar, Blerësi ka bërë investime të mrekullueshme në Ndërmarrje.

Përmbledhje: Raporti përfundimtar i Auditorëve të Jashtëm tregon se Ndër.e.Re Ferronikeli ka arritur të përmbushë dhe tejkaloj zotimet e punësimit dhe investimit, Bordi i Drejtorëve të AKP-së në takimin e tij të mbajtur në Korrik 2009 ka vendosur të lirojë Ndër.e.Re nga monitorimi dhe raportimi i mëtejme.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Fabrika e Tullave IMN SHPK
Vendi/Komuna:	Gjakovë/ Rajoni i Pejës
Fillimi i Kontratës:	28/07/2006
Çmimi i Shitjes:	€5,689,432
Zotimi i Investimit:	S'ka
Zotimi i Punësimit:	167 punëmarrës në fillim të periudhës gjashtë mujore, 333 në fund të gjashtë muajve dhe 666 deri në fund të vitit të parë, 666 punëtorë të mbahen edhe për një vit.

Afarizmi/Spektori: Prodhimi i tullave, tjegullave për kulm si dhe produkteve tjera për ndërtimtari / Spektori i Ndërtimtarisë.

Ndërmarrja / Produkti: Ndërmarrja është themeluar në vitin 1974 dhe ka prodhuar tulla dhe tjegulla. Ndërmarrja prodhon tulla të madhësisë së ndryshme dhe ka një shkallë të fleksibilitetit në lidhje me llojin e tullave të cilat mund t'i prodhoj. Makina prerëse brenda kapacitetit të saj mund të prodhoj tulla të dimensioneve të ndryshme varësisht nga kërkesat. Pra, linja e produkteve të cilat kjo ndërmarrje mund t'i prodhoj është e gjerë. Tregu i materialeve ndërtimore zakonisht ka kërkesë për tulla të standardizuara kështu që ndërmarrja është kryesisht e fokusuar në furnizimin e tregut me këso lloj produktesh. Ndërmarrje e Re gjithashtu prodhon beton për përdorim në ndërtim, qeramikë të llojit të ndryshëm, zhavorr etj.

Investimet: Fabrika e Tullave IMN nuk ka asnjë zotim të investimit në kontratën e shitjes.

Punësimi: Edhe pse ndërmarrja ka premtuar se do të punësoj 167 punëtorë në gjashtë muajt e parë, pronari i ri i kompanisë ka punësuar gati 333 në fillim të aktivitetit të tij. Deri më 27 Korrik 2008 (TM8 i fundit), kompania ka raportuar 667 punëtorë apo 100% të numrit të punëmarrësve të zotuar.

Çështjet: Sipas raportit të auditorit, investitori ka arritur t'i përmbush zotimet e punësimit dhe nuk ka asnjë çështje për të raportuar.

Përmbledhje: Raporti përfundimtar i Auditorëve të Jashtëm tregon se Ndër.e.Re ka arritur të përmbushë zotimet e punësimit, Bordi i Drejtoreve të AKP-së në takimin e tij të mbajtur në Korrik 2009 ka vendosur të lirojë Ndër.e.Re nga monitorimi dhe raportimi i mëtejshëm.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Birraria Peja
Vendi/Komuna:	Pejë / Rajoni i Pejës
Fillimi i Kontratës:	29/06/2006
Çmimi i Shitjes:	€11,130,000.00
Zotimi i Investimeve:	€15,206,000.00
Zotim i Punësimit :	153 punëtorë gjashtë muajt e parë, 306 në fund të gjashtë muajve dhe 612 deri në fund të vitit të parë, 612 punëtorë të mbahen edhe për një vit.

Afarizmi/Spektori: Prodhimi i Birrës

Ndërmarrja / produktet: Birraria Peja është e vetmi prodhues i Birrës në Kosovë, e cila mbanë 45% të tregut lokal të birrës. "Birra e Pejës" është e mirënjohur në disa vende të Ballkanit, veçanërisht ato me popullatë etnike Shqiptare. Prodhimi kryesor i Birrarisë Peja është një lloj i birrës Pilsner e lehtë, me aromë të plotë, e cila është e etiketuar "Birra e Pejës". Ajo shitet në shishe të qelqit (0.5 litra dhe 0.33 litra) dhe në tinar (50 litra). "Birra e Pejës" është birra lider në Kosovë, ku ajo gëzon njohje të fuqishme të markës (brendit). Kompania po ashtu prodhon malt (lënda e parë kryesore në birrë) nga elbi, për përdorim të vetin dhe për shitje për palët e treta. Që nga privatizimi Ndër. e Re ka zëvendësuar linjat e paketimit në shishe dhe ka instaluar linjën e re për birrat në kanaqe. Së fundi Ndër. e Re prodhon përveç birrës së rregullt, birrën Premium dhe birrën pa alkool. Kjo ndërmarrje mban dhe vazhdon të mbaj markë të njohur brenda Kosovës si dhe jashtë vendit.

Investimet: Investimet bëhen në përbërjen e prodhimit të birrës, linja të reja paketimi, prodhime të reja, instalimi i fabrikës së birrës, përmirësimi i procesit të zierjes dhe fermentimit si dhe në riparimin e pajisjeve ekzistuese, përmirësimin e rrjetit elektrik dhe instalime elektrike në fabrikë. Me kërkesë të blerësit, Ndërmarrjes i është zgjedhur edhe për një vit afati për përmbushjen e zotimeve. Blerësi ka raportuar €15,800,000 investime nga të cilat auditori i jashtëm i pavarur shumë prej €565,000 nuk e ka njohur si investime kapitale në përputhje me Marrëveshjen e Zotimeve. Sipas raportit të auditorit të jashtëm të pavarur Blerësi deri më 28.06.2009 Q 12 (i fundit) ka bërë investime në shumë prej €15,235,000 apo mbi 100 % nga investimet e zotuar. Ndër. e Re siç specifikohet në Marrëveshjen e Zotimeve ishte e obliguar të blejë për periudhën dy vjeçare së paku 5,000 ton elb nga fermerët furnizues vendor dhe sipas auditorit Blerësi ka përmbushur këtë zotim duke blerë 5,114 ton në vlerë prej €1,050,000 të elbit për periudhën e parashikuar në Marrëveshjen e Zotimeve.

Punësimi: Bazuar në raportin e auditorëve, deri në 28 qershor 2008, (tremujori i fundit), ndërmarrja ka punësuar 612 punëmarrës apo 100% të punësimit të zotuar.

Çështjet: Rezultatet e raportit të auditorit të jashtëm të pavarur tregojnë se kjo Ndër. e Re ka përmbushur investimet në nivel të shumës së zotuar të investimeve dhe ka arritur nivelin e punësimit për dy vite ashtu siç është përcaktuar me Marrëveshje.

Përmbledhje: Për faktin se Blerësi ka bërë investime të mrekullueshme në NSH dhe i ka përmbushur zotimet e investimit dhe punësimit sipas marrëveshjes, Bordi i Drejtorëve të AKP-së në takimin e tij të mbajtur në Korrik 2009 ka vendosur të lirojë Ndër.e.Re nga monitorimi i mëtejshëm dhe ta përfundojë marrëveshjen me Blerësin. Sa i përket privatizimit me Spin Of Special Ndër.e.Re Birraria Peja është një tregim i suksesshëm jo vetëm për AKP por për Rajonin e Pejës dhe për ekonominë Kosovare po ashtu. Kjo ndërmarrje është një markë (brend) e njohur brenda Kosovës, si dhe jashtë saj.

Lidhur me këtë ndërmarrje të lart-përmendura të cilat janë liruar nga monitorimi dhe raportimi i mëtutjeshëm duhet të theksohet se ato paraqesin tregime të suksesshme jo vetëm për AKP-në por edhe për komunat përkatëse dhe për ekonominë e Kosovës gjithashtu.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Ballkan
Vendi/Komuna:	Suharekë/Rajoni i Prizrenit
Fillimi i Kontratës:	21/07/2005
Çmimi i Shitjes:	€1,400,000.00
Zotimi i Investimit:	€6,000,000 për tri vite
Zotimi i Punësimit:	50 punëtorë për gjashtë muaj, 179 deri në fund të vitit të parë dhe 375 punëtorë të mbahen edhe për një vit.

Afarizmi / Sektori: Prodhimi i bazës të gomës

Ndërmarrja/Prodhimet: Ndodhet në qytezën e Suharekës në Rajonin e Prizrenit, Ndër.e.Re gjendet në zonën industriale me një sipërfaqe prej 15 hektarë. Ndërtesat e Ndër.e.Re përfshijnë vendndodhjet e prodhimit dhe objektet administrative, si dhe depot (të cilat paraqesin gjithsej 58,088 m²). Ndër.e.Re prodhon një shumëllojshmëri të shiritave transportues duke përfshirë shirita transportues me strukturë tekstili. Po ashtu prodhon rripa-V të ngushtë, poli-rripa, pëlhurë teknike, masë e butë gome, si dhe një numër të pjesëve rezervë dhe pajisjeve për industri tjera. Produktet zakonisht bëhen me porosi dhe shërbejnë një numër të madh të sektorëve, sidomos në industrinë e prodhimit të automjeteve, atë kimike, furnizimi me energji, përpunimin e ushqimit dhe mihjeve.

Investimet: Sipas raportit të auditorëve Blerësi thekson se investimet totale të bëra në ndërmarrje janë €6,035,000 nga të cilat auditori ka hequr shumën prej €133,000 pasi që ai ka konstatuar se është bërë një gabim matematikor në kalkulimin e shumave individuale mbi investimet e raportuara. Auditori i jashtëm i pavarur ka deklaruar se nga shume totale e investimeve €5,902,000 shume prej €4,160,000 paraqet investimet e bëra në makineri të blera kryesisht nga ndërmarrja ÖZER KONVEYOR BAND nga Turqia, e cila është e njëjta ndërmarrje që e ka privatizuar Ndër. e Re dhe disa ndërmarrje tjera gjithashtu nga Turqia.

Auditori i ka rekomanduar AKP-së të verifikoj çmimet e blerjes së pajisjeve të raportuara si investime, pasi që Blerësi nuk e ka bërë të ditur informata mbi blerjen në mes Ndër. së Re dhe ÖZER KONVEYOR BAND si palë e përfshirë, dhe kompania audituese është dashur të përdore mënyra alternative për të verifikuar dhe krahasuar çmimet me ç'rast ka konstatuar se çmimet dhe dallimet në mes tyre ishin të pazakonshe gjë që e ka pamundësuar auditorin të bëjë një konkludim përfundimtar lidhur me vlerën e saktë të makinave (pajisjeve). Rekomandimi është që AKP-ja të angazhojë një kompani të pavarur të specializuar për të vlerësuar vlerën e saktë të kësaj shume të investuar në makineri. Shumica e investimeve janë bërë në renovimin e ndërtesës, makinerinë e re dhe pajisje transporti, riparim të pajisjeve. AKP-ja ende nuk ka pranuar raportin tremujor nga Blerësi.

Punësimi: Edhe pse ishte zotuar se do të angazhohen 179 punëtorë në 6 muajt e parë, pronari i ri ka punësuar 182 punëtorë pothuajse që nga fillimi i aktivitetit të tij. Bazuar në raportin e auditorëve deri më 21 Prill 2009, (TM15 – i fundit), ndërmarrja ka punësuar 375 punëmarrës apo 100% të punësimit të zotuar. AKP-ja ende nuk e ka pranuar raportin tremujor mbi punësimin.

Çështjet: Edhe pse investimet e raportuara janë shpresëdhënëse, ekzistojnë çështje lidhur me çmimet blerëse të pajisjeve të caktuara. Auditori i jashtëm i pavarur e ka renditur këtë makineri në raport (që përbën shumën më të madhe të investimeve) dhe rekomandon që më tutje të vlerësohen çmimet dhe vlera e tyre e saktë. Sa i përket punësimit, mendimi i auditorit të jashtëm është se numri i punëtorëve të punësuar nga Blerësi i përgjigjet numrit të punëtorëve sipas Marrëveshjes së Zotimeve.

Përmbledhje: Bazuar në raportin përfundimtar të auditorit të jashtëm, ekziston bazë për dyshim që çmimet e makinerisë së caktuar nuk janë raportuar ashtu siç janë çmimet e vërteta të blerjes, dhe AKP-ja do të ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm në përputhje me mendimin e auditorit të jashtëm në angazhimin e një trupi të pavarur të specializuar për artikulim të renditur në raportin e auditorit.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Modeli SHPK
Vendi/Komuna:	Gjakovë/Rajoni i Pejës
Fillimi i Kontratës:	13/04/2008
Çmimi i Shitjes:	€630,000.00
Investimet e Zotuara:	€2,200,000.00
Punësimi i Zotuar:	29 punëtorë në gjashtë muajt e parë, 85 në fund të gjashtë muajve dhe 170 deri në fund të vitit të parë, 170 punëtorë do të mbahen për 12 muajt e ardhshëm.

Afarizmi / Sektori: Përpunim i drurit, prodhimi i pjesëve të drurit dhe produktet përfundimtare të drurit.

Ndërmarrja / Produkti: Ndërmarrja ishte themeluar në vitin 1947 nga një grup i zejtarëve. Deri më 1950 Ndërmarrja punësonte 40 punëtorë dhe deri më 1977 Ndërmarrja kishte kapacitet të instaluar për 60,000 dritare të drunjta për vit, dhe punësonte 500 persona. Gjatë viteve të 1990-ta rezultatet dhe operimet e saj u zvogëluan dhe në vitin 2001 numri i punëmarrësve ra në 176. Ndër. e Re nuk ka filluar me prodhim që nga privatizimi.

Investimet: Ndërmarrja deri me 13 prill 2009 (tremujori i fundit– TM8), ka raportuar investime në shumë prej €1,550,000 apo 70% nga investimet e zotuar por sipas auditorit të jashtëm të pavarur kjo shumë është diskutabile pasi që shumë prej kontratave janë bërë me individë dhe persona të cilët nuk janë të regjistruar si subjekte biznesi dhe nuk mund të gjurmohen dhe vlerësohen në mënyrë efektive. Disa nga faturat janë në emër të ndërmarrjes e cila ka blerë Ndër. e Re; disa nga faturat e raportuara nuk përmbajnë vulë, etj.

Punësimi: Sipas auditorit të jashtëm të pavarur, Ndër. e Re edhe pse deri me 13 prill 2009 (tremujori i funditTM8) ka raportuar 171 të punësuar në raport të auditorit të pavarur mund të shihet se një numër i madh i të punësuarve në ndërmarrje nuk kanë punuar me orar të plotë dhe ata kanë pranuar një pagesë minimale prej vetëm €80. Të gjitha pagat janë paguar nga arka. Vetëm 10 deri në 15 punëtorë vlerësohet të kenë punuar me orar të plotë siç specifikohet në Marrëveshjen e Zotimeve në kushtet e zotimit për punësim.

Çështjet: Sipas auditorit të jashtëm kompania nuk ka prodhuar gjatë gjithë periudhës midis 13.04.2007 deri më 13.04.2009 dhe nuk ka gjeneruar të hyra nga veprimtaria e saj thelbësore.

Përmbledhje: AKP-ja është në proces të vlerësimit të këtij raporti dhe në të ardhmen e afërt do të vendos për të ndërmarr të gjithë hapat e nevojshëm në përputhje të plotë me Marrëveshjen e Zotimeve dhe strategjinë e miratuar për SOS nga Bordi i AKP-së.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re FAN SHPK
Vendi/Komuna:	Podujevë/Rajoni i Prishtinës
Fillimi i Kontratës:	23/03/2006
Çmimi i Shitjes:	€2,310,000.00
Investimet e Zotuara:	€2,800,000.00
Punësimi i Zotuar:	59 punëmarrës gjashtë muajt e parë, 118 në fund të gjashtë muajve dhe 236 deri në fund të vitit të parë, 236 të mbahen edhe për një vit.

Afarizmi / Sektori: Prodhimi i formave të çelikut, për përforcim

Ndërmarrja / Produkti: FAN është prodhues i armaturës së profilizuar nga çeliku i përdorur në industrinë e ndërtimit. Gjendet në qytezën e Komunës së Podujevës një Kosovën veri-lindore. PE FAN ishte themeluar si një ndërmarrje shoqërore në vitin 1983, në kohën kur ndërtimi dhe instalimi i shumicës së objekteve ekzistuese ishin përfunduar. FAN ka operuar me rreth 90% të kapaciteteve të instaluar deri më 1990, deri kur prodhimi ishte zvogëluar si pasojë e masave dhe kushteve të paraqitura në rajon.

Operimi primar i FAN është transformimi i shufrave të çelikut të butë në forma të thjeshta dhe të komplikuar të çelikut të profilizuar përforcues. Një përforcim i tillë i mundëson çimentos të absorboj zgjatje të shtuar dhe forcë lakimi. Fijet e çelikut fillimisht të ftohta tërhiqen për ta arritur fuqinë e tyre të lartë të zgjatjes, pas së cilës profilet shtypen në të për t'i mundësuar të mbes e mire e ankoruar në çimento. Krijimi i kornizave të madhësive dhe formave të ndryshme pastaj bëhet sipas kërkesës së tregut.

Investimet: Bazuar në raportin e auditorit të jashtëm të pavarur (periudha 24 mars 2006 – 23 mars 2008) nga shume e investimeve të raportuara nga Blerësi €4,550,000, shume prej €3,367,500 e këtyre investimeve paraqitet të jetë bërë jashtë veprimtarisë dhe objekteve të ndërmarrjes, gjë që nuk i plotëson kërkesat e specifikuar në Marrëveshjen e Zotimeve tek termet dhe kushtet e Investimeve Kapitale. Shume e investimeve kapitale sipas Marrëveshjes së Zotimeve është €1,186,000 apo 42 % e investimeve të zotuar.

Punësimi: Sa i përket punëtorëve sipas raportit të auditorit të jashtëm Blerësi deri më 23 mars 2008 (TM8 – e fundit) ka punësuar 236 punëtorë apo 100 % e punëtorëve të zotuar.

Çështjet: Raporti përfundimtar i auditorit të jashtëm tregon se shuma totale e investimeve €3,367,500 është bërë jashtë veprimtarisë dhe objekteve të ndërmarrjes dhe nuk përputhet me termet dhe kushtet e investimeve të zotuar. Në këto investime përfshihet mulliri i miellit i blerë në Gjilan, pjesë të tokës të blera në vende të ndryshme, banesa të blera në Prishtinë. Blerësi deklaron se shuma e investuar është më e lartë se sa ajo e paraqitur në raport, por AKP-ja do të ndërmarr të gjithë hapat e nevojshëm për të vërtetuar këto deklarime dhe të marr vendimin final.

Përmbledhje: Blerësi pohon se për shkak të krizës financiare ai është detyruar të investojë jashtë objekteve të N. Sh-së. Sidoqoftë termet dhe kushtet e caktuara në Marrëveshjen e Zotimeve janë të qarta sa i përket investimeve kapitale dhe AKP-ja do të zbatoj Marrëveshjen e Zotimeve dhe do të ndërmarr të gjithë hapat në përputhje me të dhe me strategjinë për SOS të miratuar nga Bordi i Drejtorëve.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re IDGJ Duhani
Vendi/Komuna:	Gjilan/ Rajoni i Gjilanit
Fillimi i Kontratës:	14/08/2006
Çmimi i Shitjes:	€1,400,000.00
Investimet e Zotuara:	€5,599,504.00 për dy vite
Punësimi i Zotuar:	200 punëtorë gjashtë muajt e parë 400 në fund të gjashtë muajve dhe 799 punëtorë deri në fund të vitit të parë, 799 të mbahen edhe për një vit.

Afarizmi / Sektori: Agrobiznes dhe agro-përpunim (duhani)

Ndërmarrja / Prodhimi: NSH. IDGJ Duhani është i vetmi prodhues i duhanit në Kosovë. Është themeluar në vitin 1960 dhe deri më 1980 IDGJ Duhani ka pasur një marrëveshje prodhimi me "Rothman's International" për përdorimin e fletëve të duhanit të blera nga 8.000 bujq lokal. Kapacitetet ishin ulur gjatë të 90-tave gjatë sanksioneve ndërkombëtare dhe ishin ndërprerë gjatë konfliktit të vitit 1999. Edhe pse prodhimi rifilloi pas 1999, shitja ishte ndalura deri më 2005. Pajisjet e prodhimit janë në gjendje të pranueshme dhe lokacioni kryesor i cili është në skaj të Gjilanit është rreth 4.05ha, duke i shtuar tri pika nën-urbane apo qendra grumbulluese (për duaj të duhanit) ku 0.5ha janë të regjistruara si një NSH dhe 0.38 janë të regjistruara si një NSH tjetër (vlerë e barabartë e tokës me 307,000 për ha). Ndërmarrja ka prodhuar lloje të ndryshme të makrave (brendeve) të duhanit.

Investimet: Bazuar në raportin e auditorit të jashtëm të pavarur Blerësi deri me 14.08.2008 TM8 (tremujori fundit), ka bërë investime në shumë prej €1,060,000 apo 19 % të investimeve të zotuar. Këto investime janë bërë kryesisht në pjesët siç janë: pajisje për zyra, vetura për transport/shpërndarje, sistemi i kondicionimit të ajrit, qendër për agro-trajnime, pajisje bujqësore, etj. Auditori në raportin e tij deklaroi se Blerësi ka shitur veturat e raportuara si investime për të paguar pagat e disa prej punëtorëve që do të thotë se ai kishte raportuar të njëjtën shumë të parave në dy pozitat e zotimit.

Punësimi: Sa i përket punësimit bazuar në raportin e auditorit deri më 14.08.2008 Blerësi ka përmbushur vetëm 34% nga zotimet e investuara. Duhet të theksohet se Blerësi i ka raportuar fermerët individual si punëtor në listë të pagave të Ndër. së Re. Sidoqoftë sipas raportit të auditorit dhe mendimit ligjor të Departamentit Ligjor të AKP-së ata nuk mund të njihen si punëtorë në përputhje me Zotimet për Punësim dhe ligjeve në fuqi. Kjo Ndër. e Re dhe Blerësi kanë mbajtur shumicën e punëtorëve të raportuar në shkallën e pagesës prej €80 për muaj vetëm e vetëm t'i shmangen pagesës së taksave për punëtorët e raportuar.

Çështjet: Raporti i auditorit të jashtëm tregon se Ndër.e.Re nuk i ka përmbushur zotimet e investimeve dhe punësimit sipas marrëveshjes të zotimeve. Për më tepër, ai përdorte mjete të paligjshme për të arritur zotimet e punësimit dhe kur ndjeu se është duke u zbuluar filloi me shitjen e pajisjeve të investuara që tregon qartë se Blerësi nuk ka për qëllim zhvillimin e mëturshëm të Ndër. së Re. Në takimin e Bordit të mbajtur më 26 dhe 27 Shkurt 2009, është diskutuar rreth gjendjes së përgjithshme të krijuar në Ndër.e.Re dhe Bordi i ka rekomanduar Menaxhmentit të AKP-së t'i kalkuloj dhe zbatoj ndëshkimet bazuar në paragrafin 6.1 të Marrëveshjes për Zotim. Gjithsej ndëshkimet e llogaritura sipas marrëveshjes janë: ndëshkimet për mos-përmbushje të investimeve €1,223,000 ndëshkimet për mos-përmbushje të punësimit €1,547,000. AKP vazhdimisht ka kontaktuar Blerësin, në përputhje të plotë me dispozitat e marrëveshjes së nënshkruar duke u munduar të gjejë një zgjidhje me Blerësin si dhe një rrugëdalje prej kësaj situatë. Blerësi në të shumtën e rasteve nuk është përgjigjur, dhe nuk ka treguar vullnet serioz për të punuar me ne deri më tani. Aksionarët e ndërmarrjes nuk e kanë kontaktuar AKP-në dhe së fundi menaxhmenti i N.Sh-së është ndërruar shumë shpesh dhe ne e kemi pas të vështirë të kuptojmë së kush po e menaxhon N. Sh-në. Kohën e fundit AKP është takuar me përfaqësuesen ligjore e cila nuk ishte e sigurt nëse ajo përfaqëson të gjithë aksionarët dhe ka kërkuar më shumë kohë që të provoj të gjej investitor të ri për të ndihmuar në arritjen e zotimeve për investime. Sipas saj Blerësi i N.Sh-së aktualisht është nën falimentim.

Përmbledhje: Në këtë pikë AKP-ja është duke zbatuar me përpikëshmëri dispozitat e Marrëveshjes së Zotimeve dhe është në pritje të një propozimi konkret nga Blerësi. Pasi që situata nuk është mjaft premtuese sa i përket pritjes së mëturshme që Blerësi të përmbush zotimet në marrëveshje në të ardhmen e afërt, menaxhmenti i AKP-së do të detyrohet t'i rekomandoj Bordit të Drejtorëve të ushtroj opsionin për kthimin e aksioneve të njohur si e drejta për të kthyer aksionet e Ndër. së Re nën AKP në përputhje të plotë me Marrëveshjen e Zotimeve.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Mulliri Silosi SHPK
Vendi/Komuna:	Rahovec-Xërxë/Rajoni i Prizrenit
Fillimi i Kontratës:	11/05/2005
Çmimi i Shitjes:	€1,000,000.00
Investimet e Zotuara:	€19,887,564.00
Punësim i Zotuar:	50 punëmarrës në gjashtë muajt e parë 179 në fund të gjashtë muajve dhe 358 deri në fund të vitit të parë, 358 punëtorë të mbahen edhe për një vit.

Afarizmi / Sektori: Përpunimi i Agro-ushqimit: deponimi i grurit: prodhim i miellit, antipastave dhe tortave.

Ndërmarrja / Produkti: Ndërmarrja ka një linjë të gjerë të pajisjeve për deponimin e grurit si dhe për prodhimin e miellit, mezeve, antipastave dhe pastave të vogla, dhe shumica e këtyre linjave aktualisht janë funksionale. Ndërmarrja prodhon tipe të ndryshme të miellit si dhe produkteve tjera të cilat dalin nga prodhimi i miellit dhe të cilat përfshijnë:

- Tipet e miellit: T500 (për bukë të bardhë: 75% e prodhimit), T400 (simite), T850 (për bukë të zezë), krunde (ushqim për bagëti)
- Antipasta dhe pasta të vogla (makarona)
- Pasta speciale (shpagesa). Duhet të merret parasysh se kjo linjë nuk ka qenë plotësisht e instaluar si pasojë e sanksioneve të imponuara ndaj ish Jugosllavisë gjatë vitet të 1990-ta.

Investimet: Ndërmarrja deri në tremujorin e fundit i cili mbaroi me 10 nëntor 2007 ka raportuar €18,534,000. Së fundi Divizioni për Qeverisje Korporative ka pranuar një raport tjetër nga Blerësi ku raportohet se Blerësi veç tjerash ka investuar shumën prej €1,315,000. Ndër. e Re është në proces të auditimit të jashtëm të pavarur dhe brenda një periudhe të shkurtë kohore AKP do të pranojë raportin e auditimit mbi Investimet.

Punësimi: Ndërmarrja deri më 10 Nëntor 2007 (tremujori i fundit - TM10), ka raportuar 370 punëmarrës apo 103 të numrit të zotuar të punëmarrësve. Ky punësim i raportuar momentalisht është duke u audituar dhe do t'i nënshtrohet mendimit të auditorit të jashtëm të pavarur.

Çështjet: Për shkak të përfundimit të mandatit të AKM-së dhe dorëzimit të papërshtatshëm të mandatit AKP-së, ky SOS nuk është monitoruar siç duhet pasi që auditimi është dashur të kryhet më herët dhe raportet të merren me kohë nga AKM-ja. AKP-ja ka kontaktuar me blerësin menjëherë pas shqyrtimit të të dhënave në posedim të saj dhe ka kërkuar që raportet të dërgohet dhe ka iniciuar auditimin siç parashihet në Marrëveshjen e Zotimeve.

Përmbledhje: Në përgjithësi Blerësi e ka aktivizuar ndërmarrjen dhe ka bërë investime të dukshme sipas raporteve të dorëzuara nga Blerësi. Pasi që AKP-ja të pranojë raportin e auditorit ajo do të ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm në përputhje të plotë me rezultatet e raportit të auditimit dhe dispozitave në Marrëveshjen e Zotimeve.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Veraria Rahoveci
Vendi/Komuna:	Rahovec/Rajoni i Prizrenit
Fillimi i Kontratës:	31/07/2006
Çmimi i Shitjes:	€4,302,900.00
Zotimi i Investimit:	€5,000,000.00
Zotimi i Punësimit:	125 punëmarrës në fillim të periudhës gjashtë mujore. 125 në fund të gjashtë muajve dhe 250 deri në fund të vitit të parë, 250 punëtorë të mbahen edhe për një vit.

Afarizmi / Sektori: Pije Alkoholike – Verë e kuqe dhe e bardhë

Ndërmarrja / Produkti: Ndër.e.Re Veraria Rahoveci dhe vreshtat e përbëra nga Brnjaka 1 dhe Brnjaka 2 të njohura si kompleksi më i madh i rrushit dhe prodhimit të verës në Kosovë. Aktualisht, veraria është e zotuar t'i mbaj vreshtat dhe prodhimin e shisheve të verës së kuqe dhe të bardhë. Një pjesë e madhe e shitjeve është e përqendruar në eksport ku ata kanë një kontratë me Amselfelder Weinhandel GmbH Gjermani, si distribuimin e verës në tregun lokal të Kosovës, menaxhmenti i ndërmarrjes në bashkëpunim me AKM-në ka arritur progres në për të gjetur tregje në rajon dhe më tej. Është e njohur si prodhuesi më i madh i verës në Kosovë dhe prodhon Cabernet Sauvignon, Merlot, Vranac, Game, Kosovo Red, Chardonnay, në Italian Riesling, Riesling Rigne, dhe vera nga rrushi vendor, varietet siç janë Prokupe (i kuq) dhe Smederevka (i bardhë).

Investimet: Investimet e reja janë raportuar kryesisht në rehabilitimin e vreshtave ekzistuese, ndërtimin e zyrave kryesore dhe punëtorive të verarisë. Ndërmarrja deri me 10 gusht 2009 ka raportuar investime në shumë prej €5,440,000 apo 108 % të investimeve të zotuar. Këto investime të raportuara momentalisht janë duke u audituar nga auditor të jashtëm të pavarur në përputhje me Marrëveshjen e Zotimeve.

Punësimi: Edhe pse kompania është zotuar të punësoj 125 punëtorë në gjashtë muajt e parë, pronari i ri i kompanisë ka punësuar afër 162 punëtorë që nga fillimi i aktivitetit të tij. Deri në gusht 2009 Blerësi ka raportuar 252 punëtor apo 101% të numrit të zotuar të punëtorëve. Këto raporte janë gjithashtu duke u audituar nga auditori i jashtëm i pavarur.

Çështjet: Për shkak të pengesave reale me të cilat është përballur gjatë dy viteve të para, ndërmarrja ka kërkuar për zgjatje të afatit të fundit për përmbushjen e zotimeve për investim. Bordi i AKM-së më 13.06.2008 pas shqyrtimit të kërkesës për shtyrje të afatit të fundit të investimit e ka aprovuar kërkesën e saj për zgjatje prej një viti. Problemi lidhet me ankesat e disa fshatarëve në lidhje me një pjesë të pronës së ndërmarrjes, të cilët pretendojnë se toka iu përket atyre, duke pohuar se ajo iu është marrur nga komuna në vitin 1958. Shumica e problemeve tani më janë tejkaluar dhe ndërmarrja është duke operuar normalisht.

Përmbledhje: Të dhënat në dispozicion nga raportet e parashtruara tregojnë se Ndër.e.Re Veraria Rahoveci është në pozitë të mirë sa i përket afateve të investimeve në njërin anë, ndërsa sa i përket punësimit, bazuar në raportet e parashtruara ndërmarrja i ka përmbushur zotimet e punësimit. Megjithatë, AKP ka angazhuar një auditor të jashtëm të pavarur për t'i audituar kushtet e kontratës dhe bazuar në këtë raport, do të ndërmerren hapat e më tutjeshëm.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Zhitopromet Mulliri F. Kosovë SHPK
Vendi/Komuna:	F. Kosovë/Rajoni i Prishtinës
Fillimi i Kontratës:	10/07/2007
Çmimi i Shitjes:	€2,505,555.00
Zotimi i Investimit:	€15,000,000.00 për dy vite
Zotimi i Punësimit:	10 punëmarrës gjashtë muajt e parë 130 në fund të gjashtë muajve dhe 130 deri në fund të vitit të parë, 260 të mbahen edhe për një vit.

Afarizmi / Sektori: Prodhimi i Miellit dhe Bukës dhe deponimi i grurit dhe miellit

Ndërmarrja/Produkti: Ndërmarrja ka në histori të gjatë të zhvillimit. Ndërmarrja ka filluar që nga viti 1950 kur ishte ngritur një mulli privat primitiv i quajtur Mlini në Fushë Kosovë. Mlini ka bashkëpunuar me kooperativa private dhe ferma dhe ka pasur një kapacitet prej 55 MT/ për orë. Në fund të viteve 70-ta ndërmarrja e zgjeron kapacitetin e saj dhe ndërton një mulli me një kapacitet prej 200 MT/për 24 horë. Silosi ka pasur një kapacitet prej 4,200 MT për tu mbushur si dhe një depo me një kapacitet për t'i mbajtur 600 MT. Ndërmarrja e ka arritur kulmin e saj gjatë 1980-tave duke e shpërndarë produktin e saj përmes dyqaneve dhe stacioneve zinxhirë. Pas përfundimit të konfliktit në 1999 pavarësisht kufizimeve financiare të ndërmarrjes ajo ndërmerr veprime për fillimin e punës, megjithatë në 2003 aktivitetet e saj ndërpriten si pasojë e mungesës së mjeteve financiare.

Investimet: Që nga 10/07/2007 deri më 10/07/2009 TM8 (tremujori i fundit) ndërmarrja ka raportuar investime në shumë prej €12,502,000 apo 83% të zotimeve për investime. Investimet e raportuara momentalisht janë duke u audituar nga auditori i jashtëm i pavarur. Sa i përket raporteve, investimet janë bërë kryesisht në blerjen e pajisjeve të reja për ndërmarrjen, ndërtimin e ndërtesës së re, riparimin e objekteve ekzistuese, azhurnimi i sistemit elektrik brenda objekteve etj.

Punësimi: Sa i përket zotimit të punësimit, numri i punëtorëve të raportuar nga ndërmarrja deri më 10/07/2009, (TM8)-final është 260 punëmarrës apo 100% e zotimit të punësimit. Punësimi i raportuar gjithashtu është duke u audituar.

Çështjet: Në Ndër.e.Re IMB Mulliri në Fushë Kosovë janë të punësuar 260 punëmarrës, megjithatë nga numri i përgjithshëm 220 punëmarrës marrin një pagë prej €80. Blerësi ka dorëzuar një kërkesë për zgjatjen e periudhës së zotimeve.

Përmbledhje: Divizioni për Qeverisje Korporative është duke monitoruar për së afërmi këtë SOS dhe pas raportit përfundimtar të auditorit të jashtëm do të jap rekomandimet për Bordin e AKP-së.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Fabrika e Gypave SHPK
Vendi/Komuna:	Ferizaj/ Rajoni i Gjilanit
Fillimi i Kontratës:	20/11/2007
Çmimi i Shitjes:	€3,657,000.00
Zotimi i Investimit:	€13,200,000.00
Zotimi i Punësimit:	60 punëmarrës gjatë gjashtë muajve të parë, 180 deri në fund të muajit të gjashtë, 360 deri në fund të vitit të parë, 360 punëtorë të mbahen edhe për një vit.

Afarizmi / Sektori: prodhimi i gypave të salduar të çelikut

Ndërmarrja / Produkti: Fabrika e Gypave me bazë në Ferizaj, është një nga fabrikat më të mirënjohura në aktivitetet e përpunimit të metalit në Kosovë. Ajo është themeluar në vitin 1979 dhe, nga viti në vit, ka bërë hapa përpara drejt zgjerimit. Fabrika prodhon produkte të ndryshme, siç janë gypa për linja-gazi, gypa naftës-jellësi të të gjitha dimensioneve (nga 114 deri 2.020 mm). Produktet e kësaj ndërmarrje janë të një kualiteti të lartë, bazuar në standardet më të njohura ndërkombëtare për prodhim dhe inspektim, siç janë: API, DIN, ASTM, BS, ISO, NF, UNI etj.

Investimet: Ndërmarrja deri më 12 gusht 2009, tremujori i 7 ka raportuar investime në shumë prej €2,298,000 apo 18% e investimeve të zotuar. Duke pas parasysh se ka shumë pak kohë për përmbushjen e investimeve të mbetura AKP-ja është duke vëzhguar për së afërmi seriozitetin dhe dinamikën e investimeve aktuale. Shuma e raportuar e investimeve i nënshtrohet auditimit të jashtëm i cili do të bëhet së shpejti.

Punësimi: Më 12 gusht 2009 ndërmarrja ka raportuar 366 të punësuar apo 101 % të punëtorëve të zotuar. Punësimi i raportuar i nënshtrohet auditimit të jashtëm i cili do të bëhet së shpejti.

Çështjet: AKP ka përcaktuar se kompania nuk i ka përmbushur zotimet e punësimit në disa raste dhe ka dështuar t'i përmbushë zotimet e investimit për këtë arsye kompanisë i është kërkuar një raport i hershëm për tremujorin e gjashtë. Në këto raporte kompania ka paraqitur numrin e tejkaluar të punëmarrësve dhe investimet në vlerë prej €1,033,856.

AKP ka angazhuar një auditor të jashtëm dhe bazuar në raportet e këtij auditimi ne do të shohim gjendjen reale mbi përmbushjen e zotimeve për punësim dhe investim. Blerësi tanimë ka dorëzuar kërkesën për zgjatje njëvjeçare të periudhës së zotimeve.

Përmbledhje: Fabrika ka rifilluar funksionimin e saj kohët e fundit, dhe bazuar në informatat në disponim të AKP-së ndërmarrja ka ngritur numrin e të punësuarve. Kjo Ndër. e Re rregullisht raporton investime të reja dhe bazuar në rezultatet e auditorit të jashtëm Divizioni për Qeverisje Korporative do t'i jap rekomandimet e nevojshme Bordit të AKP-së për hapa të mëtejshëm.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Iliria
Vendi/Komuna:	Prishtina/ Rajoni i Prishtinës
Fillimi i Kontratës:	31/07/2006
Çmimi i Shitjes:	€1,610,000.00
Zotimi i Punësimit:	€3,000,000.00 për dy vite
Zotim i Investimit:	65 punëmarrës gjashtë muajt e parë, 125 në fund të gjashtë muajve dhe 250 deri në fund të vitit të parë, 250 të mbahen edhe për një vit.

Afarizmi / Sektori: Akomodim, ushqim dhe shërbim

Ndërmarrja / Produkti: Hotel "Iliria" gjendet në Prishtinë në qendër të qytetit. Ajo është një ndërtesë e ndërtuar specifikisht për qëllime hoteliere. Ndërtesa është ndërtuar në vitin 1958 dhe është e ndërtuar me materialet ndërtimore të disponueshme në atë kohë që do të thotë kombinime të çimentos, tullave dhe lëndës drunore. Në vitin 1999 një pjesë e ndërtesës ishte shkatërruar sepse ishte përdorur si strehë për refugjatë nga Kroacia dhe Bosnja. Vizitorët e hotel Iliria janë punëmarrës ndërkombëtar dhe vendor. Përveç kësaj Hotel Iliria ofron shërbime dhe akomodim për shumë individ dhe organizata ndërkombëtare të cilat operojnë në Kosovë. Është e përshtatshme për konferenca, trajnime, seminare si dhe po ashtu për ngjarje shoqërore.

Investimet: Deri me 31 qershor 2009 TM12 (tremujori i fundit) Blerësi ka raportuar investime në shumë prej €2,950,000 apo 98% nga zotimet e investuara të cilat i nënshtrohen auditimit të jashtëm të pavarur.

Punësimi: Edhe pse në fillim raportoheshin përmbushje të kënaqshme të punësimit duke filluar nga TM6 (nëntor 2007) një ulje e dukshme në punësim është vënë re. Deri me 31.07.2009 TM12 (tremujori i fundit) 195 punëtorë apo 78 % janë raportuar. Punësimi i raportuar i nënshtrohet auditimit të jashtëm të pavarur.

Çështjet: Blerësi ka kërkuar zgjatje të periudhës për përmbushjen e investimeve dhe punësimit të zotuar duke deklaruar se ata kanë pas vështirësi në marrjen e lejeve komunale të nevojshme për të vazhduar me kryerjen e investimeve të zotuar për shkak të taksave të papaguara nga N. Sh-ja. Bordi i Drejtorëve i AKM-së ka kërkuar për informata shtesë për të përkrahur kërkesën e tij për arsye të kësaj situatë të paqartë. Pasi që nuk ka pas mbledhje të drejtorëve në muajt pasues kjo kërkesë nuk është diskutuar.

Përmbledhje: Blerësi është duke punuar në tërë ndërtesën dhe pritet që ata të përmbushin investimet e zotuar pasi që ata janë duke punuar me kapacitet më të lartë. Ata janë duke punuar në ndërtimin e vend parkingut nëntokësor, aranzhimet e dhomave, sallave etj. Aktualisht AKP-ja është duke monitoruar për së afërmi zhvillimet e investimeve që janë duke u bërë nga Blerësi dhe në njërin nga mbledhjet vijuese të Bordit do të bëhen rekomandimet e duhura në përputhje me raportin e auditorit i cili pritët të merret së shpejti.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re NBI Suhareka SHPK
Vendi/Komuna:	Suharekë/ Rajoni i Prizrenit
Fillimi i Kontratës:	27/08/2007
Çmimi i Shitjes:	€4,175,999.00
Zotimi i Investimit:	€8,600,000.00
Zotimi i Punësimit:	80 punëmarrës gjatë gjashtë muajve të parë. 173 në fund të gjashtë muajve të parë dhe 345 në fund të vitit të parë, 345 të mbahen edhe për një vit.

Afarizmi / Sektori: Pije Alkoolike/Verë e kuqe dhe e bardhë.

Ndërmarrja / Produkti: Ndërmarrja ishte themeluar si Kooperativa Bujqësore Suhareka në vitin 1965. fillimisht, Ndërmarrja ka qenë pjesë e agro-kombinatit më të madh, KBI "Progres-Eksport" Prizren e themeluar në vitin 1959. Në vitin 1975, Ndërmarrja ndahet nga agro-kombinati KBI "Progres-Eksport" dhe vazhdon punën si Ndërmarrja Industriale Bujqësore Suhareka. Në vitin 1978 Ndërmarrja e themelon një njësi për mbushjen e shisheve me pije jo-alkoolike. Në vitin 1981 i shtohet një seksion i ri verarisë dhe në vitin 1983 themelohet njësi për mbushjen e pijeve alkoolike. Një seksion shtesë i shtohet Ndërmarrjes pas vendimit Komunal për transferim të tokës të datës 25 Nëntor 1992. Ky seksion për një periudhë kohore ka qenë objekt i disa vendimeve të shfrytëzuesit për transfero mirë po i është rikthyer Ndërmarrjes në Maj 2006. Në vitin 2001, njësi për mbushjen e shisheve të pijeve jo-alkoolike është ndarë nga Ndërmarrja përmes një referendumi të punëtorëve dhe është bërë një ndërmarrje e pavarur. Aktualisht kjo ndërmarrje është privatizuar përmes metodës së Spin Of-it Special dhe është duke hasur në vështirësi për ri-aktivizimin e kapaciteteve të saj për shkak të investimeve të ulëta të bëra nga Blerësi.

Investimet: Deri më datë 27 Maj 2009, TM7, ndërmarrja ka raportuar investime në shumën €273,000 apo 6% të investimeve të zotuar. Sipas kërkesës së AKP-së për raportin e jashtëzakonshëm mbi investimet, Blerësi ka deklaruar se nuk ka ndryshime nga raporti i fundit i dorëzuar në këtë aspekt.

Punësimi: Edhe pse Blerësi është zotuar se do të punësoj 167 punëtorë në gjashtë muajt e parë, pronari i ri i ndërmarrjes ka punësuar afër 333 punëmarrës në fillim të aktivitetit të tij. Deri më 27 Maj 2008 (TM8 i fundit), kompania ka raportuar 298 punëmarrës apo 86% të numrit të punëmarrësve të zotuar.

Çështjet: Një numër i kontesteve në mes të aksionarëve kanë rezultuar me dështime në përmbushjen e zotimeve të investimit. Duke e marrë parasysh këtë gjendje, në fund afatit të fundit të përmbushjes së investimeve, menaxhmenti i AKP-së vazhdimisht ka shprehur brengën e tij në lidhje me shkallën e ulët të përmbushjes së zotimeve dhe për këtë arsye ka mbajtur disa takime me aksionarët, zyrtarët e lartë të menaxhmentit, përfaqësuesit ligjorë të blerësve ku është kërkuar nga ta që sa më shpejt që është e mundur të gjendet një zgjidhje e përshtatshme për këtë gjendje, përndryshe AKP do të jetë e obliguar të ndërmarr masa të cilët janë në mënyrë të qartë të specifikuar në marrëveshjen e shitjes në rast se blerësi dështon t'i përmbushë zotimet. AKP ka angazhuar në auditorë të jashtëm të pavarur për të verifikuar përmbushjen e marrëveshjes së zotimit; ky proces auditimi është në progres e sipër.

Përmbledhje: Në mënyrë që të gjen një zgjedhje të arsyeshme menaxhmenti i AKP-së ka mbajtur takime me aksionarët e ndërmarrjes disa herë. Aksionarët kanë premtuar se ata do të përpiqen të dalin me një propozim konkret për AKP-në në mënyrë që t'i përmbushin zotimet, dhe AKP është duke e pritur këtë propozim. Varësisht nga rezultati i këtij diskutimi dhe varësisht nga raporti i auditorit të jashtëm të pavarur, AKP do të vendosë për hapat e mëtejshëm. Duhet të theksohet se situata me këtë SOS është shumë e vështirë, dhe nuk ka indikacione se Blerësi mund të arrijë ndonjë zgjidhje të përshtatshme për këtë situatë. Në këtë pikë e vetmja mundësi që ka AKP-ja është të ushtrojë opsionin për tërheqje të aksioneve të njohur si e drejta për kthimin e aksioneve nga kjo Ndër. e Re nën pronësinë e AKP-së.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Tullara SHPK
Vendi/Komuna:	Kamenicë/Rajoni i Gjilanit
Fillimi i Kontratës:	04/06/2008
Çmimi i Shitjes:	€160,189.00
Zotimi i Investimit:	S'ka
Zotimi i Punësimit:	40 punëmarrës gjatë periudhës së parë gjashtë mujore. 40 në fund të gjashtë muajve dhe 80 në fund të vitit të parë, 80 të mbahen edhe për një vit.

Afarizmi / Sektori: Prodhim i tullave/materialit ndërtimor

Ndërmarrja / Produkti: Kompania ndërtimore N.SH "Tullara – Cigllana" ishte themeluar në vitin 1945 si "CREPO -CIGLLANA" Donje Korminjan, Kamenicë. Më 1977 ndërmarrja ishte bashkuar me ndërmarrjen "GRADEVINA" nga Kamenica dhe pas bashkimit e tërë kompania ishte emëruar GPP Trajko Peric. Më 1989 NSH ndahet nga Trajko Peric dhe bëhet DPP "Trajko Peric"- Cigllana. Prodhimi i tullave ka qenë gjithmonë afarizmi qenësor i Ndërmarrjes. Prodhimi i tullave ka dëshmuar të jetë një operim i qëndrueshëm i cili i ka mundësuar kompanisë të furnizoj tregun vendor të Gjilanit dhe zonave për rreth – si dhe po ashtu tërë tregun e Kosovës. Kapaciteti aktual i operimit është rreth 10,000 5 NF specifikimi (19*20*25) tulla për ditë.

Investimet: Ndër.e.Re Tullara nuk ka zotime të investimit në kontratën e shitjes.

Punësimi: Deri më datë 04 Maj 2009, TM4 ndërmarrja ka raportuar 83 punëtorë apo mbi 200% të numrit të zotuar të punëmarrësve për këtë periudhë.

Çështjet: Kjo Ndër. e Re aktualisht është duke u audituar nga auditor i jashtëm i pavarur.

Përmbledhje: Ndërmarrja është në proces të auditimit të jashtëm dhe, varësisht nga raporti i auditorit do të ndërmerren hapat e nevojshëm.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Mulliri/Fabrika e Bukës Ferizaj SHPK
Vendi/Komuna:	Ferizaj/Rajoni i Gjilanit
Fillimi i Kontratës:	28/04/2008
Çmimi i Shitjes:	€568,750.00
Investimet e Zotuara:	€5,000,000.00
Punësimi i Zotuar:	40 punëmarrës në gjashtë muajt e parë dhe në fund të gjashtë muajve të parë dhe 80 deri në fund të vitit të parë, 80 punëmarrës të mbahen edhe për një vit.

Afarizmi / Sektori: Prodhimi i miellit dhe bukës dhe deponimi i miellit

Ndërmarrja / Produkti: Njësia e furrës ishte themeluar në vitin 1984 dhe ka filluar prodhimin në vitin 1985. Gjendet në zonën industriale të Ferizajt. Njësia e furrës ndahet në katër departamente të ndryshme:

- Njësia për prodhimin e bukës, duke përfshirë një njësi të madhe dhe një njësi të vogël të prodhimit
- Njësia për prodhimin e listave
- Njësia për deponimin e miellit me një kapacitet prej rreth 360 tonë
- Njësia për grumbullimin dhe deponimin e grurit me një kapacitet prej 13.000 tonësh.

Investimet: Deri më 28 Korrik 2009, TM5, ndërmarrja ka raportuar investime në shumën prej €940,000 apo 19% të investimeve të zotuar. Kjo shumë e investimit të raportuar do t'i nënshtrohet auditivit të jashtëm të pavarur.

Punësimi: Deri më 28 Korrik 2009, TM5, ndërmarrja ka raportuar 80 punëmarrës apo 100% të numrit të punëmarrësve të zotuar për këtë periudhë që poashtu do t'i nënshtrohet auditivit të jashtëm të pavarur.

Çështjet: AKP ka angazhuar auditorë të jashtëm për auditimin e nivelit të përmbushjes së zotimeve për punësim dhe investime. Nëse gjykojmë në bazë të raportit për investime dhe kohës së mbetur për përmbushje të zotimeve për është e qartë se Blerësi ka mbetur prapa në kompletim të investimeve në bazë të zotimeve të planit për investime.

Përmbledhje: Auditimi i jashtëm i pavarur do të bëhet për investime dhe punësim sipas marrëveshjes së zotimeve. Pasi që AKP-ja të pranojë raportin e auditorit do të vendosë më pas për hapat e mëtejshëm në përputhje të plotë me marrëveshjen e zotimeve dhe strategjinë për SOS të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Kosovatex
Vendi/Komuna:	Komuna e Prishtinës/Rajoni i Prishtinës
Fillimi i Kontratës:	31/08/2006
Çmimi i Shitjes:	€3,112,001.00
Investimi i Zotuar:	€4.000.000 për dy vite
Punësimi i Zotuar:	50 punëtorë gjashtë muajt e parë, 100 në fund të gjashtë muajve dhe 200 deri në fund të vitit të parë, 200 punëtorë të mbahen edhe për një vit

Afarizmi / Sektori: Industria e tekstilit dhe konfeksionit

Ndërmarrja / Produkti: Kosovatex ka qenë prodhuesi më i madh i tekstilit dhe konfeksionit në Kosovë që prej themelimit në vitin 1952 deri në vitet e hershme të viteve 1990-ta, si dhe një ish punëdhënës i 1,700 personave. Kosovatex kryesisht ka prodhuar stof për veshmbathje mirëpo ka furnizuar me stof/pëlthurë për produktet industriale. Ndër.e.Re ka potencialin për t'i shërbyer tregut të Kosovës në lidhje me shumë produkte, siç janë rrobat e punës, rroba bazike, etj.

Investimet: Deri me 31 maj 2009 (QR11), Kosovatex ka raportuar €1,356,000 ose 34%. Prej shumës së raportuar, €453,300 janë raportuar si investime brenda Ndër. së re përderisa €900,000 është shuma e paguar për marrjen e lejes/licencës nga komuna për të ndërtuar qendrën e biznesit.

Punësimi: Deri në fund të Q11, prej zotimit për 200 punëtorë, janë raportuar 198 persona të punësuar ose 99% të punësimit të zotuar. Sipas zyrave monitoruese bazuar në vizitat në terren, punëtorët nuk janë duke punuar me orar të plotë në fabrikë dhe janë në pushim me pagesë. Ata pranojnë pagën prej €80 për muaj.

Çështjet: Privatizimi i kësaj NSH-je është bërë përmes spinofit special mirëpo në këtë rast pas fitimit të tenderit dhe pak para se Blerësi të nënshkruajë kontratën, ai ka kërkuar prej ish-AKM-së të shqyrtoj kërkesën për mirëmbajtje të aktivitetit të njëjtë të biznesit të NSH-së që parashikohet sipas Rregullave të Tenderit për SOS. Blerësi ka arsyetuar këtë kërkesë me analizat e disa ekspertëve ndërkombëtarë që kanë arritur të konkludimi se industria e tekstilit dhe konfeksionit nuk është fitimprurëse më në Kosovë, kështu që aktiviteti aktual i biznesit të Kosovatex-it nuk ishte i mundshëm. Në atë kohë Kryetari i Bordit të AKM-së ka vendosur që të lejojë Blerësin të ndryshojë destinimin e investimeve dhe aktivitetit të biznesit të ndërmarrjes përmes një vendimi ekzekutiv. Që atëherë Blerësi ka dorëzuar një kërkesë për ndërtim të qendrës së biznesit brenda territorit të ndërmarrjes, mirëpo kurrë nuk e ka qartësuar të ardhmen për aktivitetin e biznesit të Ndër. së re dhe objekteve të saj. Sa i përket punësimit opinioni ligjor rekomandon vendosjen e gjobave për Blerin pasi që ai nuk ka përmbushur zotimet për punësim. Kosovatex ka fituar nga ish-AKM-ja zgjatje të afatit për dy vite për përmbushje të zotimeve për investime dhe punësim.

Përmbledhje: Ndër. e re nuk është në gjendje të mirë pasi që Blerësi nuk ka investuar në biznesin e Ndër. së re. Kjo ka rezultuar me ndalje të plotë të prodhimit dhe për këtë shkak punëtorët janë dërguar në shtëpi me pagesë minimale. Në këtë fazë, auditori i jashtëm i pavarur është duke bërë auditivin e nivelit të përmbushjes së zotimeve për investim dhe punësim. Pasi që të pranojë raportin final të auditimit, AKP-ja do të ndërmerr të gjithë hapat e domosdoshëm në përputhje me rezultatet e raportit dhe marrëveshjen për zotime. Për më tepër, AKP-ja do të bëjë kërkime për informata ligjore me qëllim që të qartësojë legalitetin e vendimit ekzekutiv sa i përket ndryshimit të aktivitetit të biznesit.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Hotel Grand
Vendi/Komuna:	Komuna e Prishtinës/Rajoni i Prishtinës
Fillimi i Kontratës:	13/10/2006
Çmimi i Shitjes:	€8,160,000.00
Zotimi i Investimit:	€20,200,000.00 për dy vite
Zotimi i Investimit:	135 punëmarrës gjashtë muajt e parë 270 në fund të gjashtë muajve dhe 570 deri në fund të vitit të parë, 570 të mbahen edhe për një vit.

Afarizmi / Sektori: Akomodimi dhe shërbime ushqimi

Ndërmarrja / Produkti: Grand Hotel Prishtina është inauguruar më 25 Prill 1978. "Grand Hotel Prishtina" përbëhet nga përafërsisht 32.000 m². Hoteli ka 202 dhoma me një shtrat, 142 dhoma me dy shtretër, 9 dhoma me tre shtretër, 9 apartamente dhe 2 rezidenca (526 shtretër gjithsej). Hoteli është i pajisur me objekte tjera: restaurant, tavernë, kafe bar, bar i natës si dhe po ashtu ofron salla për konferenca. Grand Hotel Prishtina ofron vendtakime elegante ngjarje afariste, takime korporatave, bankete gala, si dhe pritje private dhe ndeja të madhësive të ndryshme. Takime për deri në 340 persona mund të mbahen në sallën elegante të kongresit e cila e rritë atmosferën private dhe relaksuese. Hoteli Grand mund të pres deri në 100 mysafir në sallën e banketeve, 60 për një konferencë dhe deri në 30 për sallën e takimit të kolegjiuemeve.

Investimet: Nga data e hyrjes në fuqi të kontratës deri më 13 Korrik 2009, TM11, investime në shumë prej €3,025,000, apo 15% të zotimit të investimeve janë raportuar.

Punësimi: Sa i përket punësimit, deri më 13 Korrik 2009, TM10, 541 punëmarrës apo 100% e punëmarrësve të zotuar janë raportuar.

Çështjet: Bazuar në investimet e raportuara Grand Hoteli ka bërë shkelje të rëndë të marrëveshjes për zotime. AKP-ja ka angazhuar auditorin e jashtëm për të kryer auditimin e investimeve dhe punësimit të bërë deri më tani. Në anën tjetër punëtorët e raportuar nuk korrespondojnë me biznesin e Ndër. së re. Në përgjithësi struktura e punësimit të raportuar më tepër korrespondon me kompani ndërtimore se sa me biznes për shërbime akomodimi dhe ushqimi. Blerësi ka fituar prej ish-AKM-së zgjatjen e periudhës për përmbushje të zotimeve dhe të drejtën të vë Hotelin si hipotekë për kredi. Rishtazi blerësi ka deklaruar se është në pritje e sipër për miratim të kredisë prej institucioneve të reja financiare. Deri tani AKP-ja nuk ka marrë ndonjë informatë rreth miratimit të kësaj kredie..

Përmbledhje: Në bazë të vizitave në terren që i ka bërë Njësia e Monitorimit, është vërejtur se një pjesë e hotelit është demoluar dhe puna është bërë kryesisht në ndërrim të pllakave të pjesës së jashtme të ndërtesës duke i ndërruar ato me pllaka alumini. Në përgjithësi punët dhe investimet nuk mund të kualifikohen si të dukshme në krahasim me shumën e investimeve të zotuar dhe kapaciteteve të kësaj Ndër. të re për tu zhvilluar në masë të madhe në lëmin e këtij biznesi. AKP-ja po mbikëqyr nga afër zhvillimet me këtë Ndër. të re dhe posa të kryhet auditimi do të bëhet rekomandimi i domosdoshëm në përputhje me marrëveshjen e zotimeve dhe strategjinë për SOS.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Miniera e Magnezitit XIM Strezoc SHPK
Vendi/Komuna:	Kamenicë/Rajoni i Gjilanit
Fillimi i Kontratës:	13/12/2007
Çmimi i Shitjes:	€730,000.00
Zotimi i Investimeve:	€14,200,000.00
Zotimi i Investimit:	40 punëmarrës në gjashtë muajt e parë 119 në fund të 6 muajve dhe 238 deri në fund të vitit të parë, 238 punëtorë të mbahen edhe për një vit

Afarizmi / Sektori: Miniera dhe Përpunim Mineral (magnezit)

Ndërmarrja / Produkti: Rezerva e minierës së magnezitit, e njohur po ashtu edhe si rezerva e Shkëmbit të Bardhë në fillim është llogaritur se përmban 1.75 milion tonë të magnezitit. Zbulimet e mëvonshme llogarisin se rezervat e magnezitit janë rreth 5.5 milion tonë. Në vitin 1960 ka filluar nxjerrja e magnezitit i cili pastaj është transportuar 48 km në Bujanofc për transportim të mëtejme me tren. Një fabrikë e seperacionit me kapacitet prej 40/t/h ishte ndërtuar në vitin 1972, dhe në vitin 1973 miniera ka prodhuar 97,227 tonë të magnezit. Në të njëjtën periudhë është ndërtuar një fabrikë prodhuese/furrë rrotulluese me kapacitet prej 45,000t/v.

Si pasojë e embargos XIM ka ndaluar prodhimin e magnezitit në mes të viteve 1991-1999, pas konfliktit të vitit 1999 punëmarrësit ishin kthyer në Ndërmarrje dhe kanë filluar të operojnë kryesisht në shitjen e zhavorrit.

Investimet: Deri më 31 Korrik 2009, TM7, (vetëm muaji i parë i TM7) ndërmarrja ka raportuar investime në shumën prej €546,000 apo 7% të investimeve të zotuar, që do t'i nënshtrohen auditimit të jashtëm të pavarur.

Punësimi: Deri më 31 Korrik 2009, TM7, (vetëm muaji i parë i TM7) ndërmarrja ka raportuar 30 punëmarrës apo 12% të numrit të punëmarrësve të zotuar, që do t'i nënshtrohen auditimit të jashtëm të pavarur.

Çështjet: Si pasojë e nivelit jashtëzakonisht të ulët të përmbushjes së zotimeve nga Blerësi, ndërmarrja është në kushte të këqija. Blerësi ka qenë i njoftuar se është në shkëlqje të marrëveshjes së zotimit, dhe hapat e mëtejme do të ndërmerren nëse nuk ndërmerren hapa konkret nga Blerësi për të plotësuar mungesat në përmbushjen e zotimeve të tij. Blerësi pohon se nuk ka qenë në gjendje të investojnë për shkak se nuk kanë mundur të sigurojnë licencat prej Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Megjithatë sipas interpretimit të kontratës së shitjes nga ana e Zyrës Ligjore të AKP-së, AKM-ja nuk ishte e obliguar të lëshojë ndonjë licencë dhe përgjegjësia për fitim ose përsëritjen e çfarëdo leje ose licence mbetet vetëm tek Blerësi dhe Ndër. e re. Sipas informatave që ka AKP-ja, minierat nuk janë aktivizuar fare dhe shumica e punëtorëve nuk janë duke punuar, objektet kryesisht janë përdorur për prodhim të zhavorrit për ndërtim të rrugëve dhe për ndërtim të përgjithshëm. Pajisjet për miniera vazhdimisht po prishen. Blerësi ka dorëzuar kërkesën për vazhdim të periudhës së përmbushjes së zotimeve mirëpo nuk ka dorëzuar në AKP dëshmi të mjaftueshme me qëllim që të rekomandohet kjo për miratim të Bordit.

Përmbledhje: Duhet të theksohet se kjo Ndër, e re ka pësuar dëme të konsiderueshme duke mos i përmbushur zotimet për investime dhe duket se Blerësi nuk ka ofruar dëshmi serioze që do të tregonin se synimet e tij ishin të investojë dhe të ri-aktivizojë minierat. Në vend të kësaj, çdoherë që AKP-ja ka kërkuar informata ai ka ofruar vetëm ankesa dhe dokumente që janë të lidhura me licencat dhe lejet për të cilat AKP-ja nuk ka kompetenca. Auditimi i jashtëm i pavarur është në proces dhe pas raportit final AKP-ja do të bëjë të gjitha rekomandimet e nevojshme tek Bordi i Drejtorëve për vendime të mëtejme në këtë rast.

Emri i Ndër.e.Re:	Ndër.e.Re Miniera&Industria e Magnezitit Golesh SHPK
Vendi/Komuna:	Lipjan/Rajoni i Prishtinës
Fillimi i Kontratës:	11/12/2007
Çmimi i Shitjes:	€810,000.00
Zotimi i Investimeve:	€16,200,000.00
Zotimi i Punësimit:	40 punëmarrës në gjashtë muajt e parë, 178 në fund të gjashtë muajve dhe 355 deri në fund të vitit të parë, 355 punëmarrës të mbahen edhe për një vit.

Afarizmi/Spektori: Prodhimi i mineraleve dhe miniera (magneziti)

Ndërmarrja / Produkti: Ndër.e.Re ofron mundësinë për të siguruar një minierë të vërtetë të magnezitit si dhe operimin e prodhimit në Kosovë, me rezerva të evidencuara prej rreth 2.4 milion të magnezitit të nivelit të mesëm dhe nivelit të lartë, rreth 45,000 t/v prodhim i fabrikës (furra rrotulluese), po ashtu makineri për bartjen e argjilës dhe makina për pajisje tjera. Rezervat e shpërndara me material për ndërtim rrugësh aftër Prishtinës, me qasje të mirë në rrugë dhe rrjetin hekurudhorë, e bëjnë këtë zonë tërheqëse për allçi.

Investimet: Deri më 10 Gusht 2009, ndërmarrja ka raportuar investime në shumë prej €788,000 apo 8% të investimeve të zotuar, që do t'i nënshtrohen auditimit të jashtëm të pavarur.

Punësimi: Deri më 10 Gusht 2009, ndërmarrja ka raportuar 67 punëmarrës apo 17% të numrit të punëmarrësve të zotuar, që do t'i nënshtrohen auditimit të jashtëm të pavarur.

Çështjet: Kompania është duke shkelur marrëveshjen e zotimeve si rezultat i mos-përbushjes së zotimeve të investimeve dhe punësimit Pasi që Blerësi i kësaj Ndër. të re është poashtu Blerësi i Ndër. së re XIM & Strezoc Miniera e Magnezitit sh.p.k. në jemi duke u ballafaquar me të njëjtat probleme në të dyja rastet. Ai gjithashtu pohon se nuk ka qenë në gjendje të përmbushë zotimet për shkak se AKM-ja nuk ka transferuar licencën e operimit tek Blerësi në kohën kur NSH-ja është privatizuar. Pas qartësimit të kushteve të kontratës në këtë aspekt AKP-ja ka konkluduar se ripërtëritja e licencave qartë është përgjegjësi e Blerësit dhe asnjë licencë nuk i është transferuar asnjë Blerësi në momentin e privatizimit. Blerësi është lajmëruar se ai po e shkel marrëveshjen e zotimeve dhe hapat e mëtejme do të ndërmerren nëse Blerësi nuk bën asgjë në drejtim të përmirësimit të mangësive sa i përket përmbushjes së zotimeve. Sipas informatave që ka AKP-ja minierat nuk janë aktivizuar fare dhe shumica e punëtorëve nuk janë duke punua, objektet kryesisht janë përdorur për prodhim të zhavorrit për ndërtim të rrugëve he ndërtim të përgjithshëm. Pajisjet për miniera vazhdimisht po prishen. Blerësi ka dorëzuar kërkesën për zgjatje të periudhës për përmbushje të zotimeve, mirëpo nuk i ka ofruar AKP-së dëshmi të besueshme me qëllim që të rekomandohet një gjë e tillë ose gjendjen reale të përmbushjes së zotimeve dhe pas pranimit të raportit AKP-ja do të veprojë siç është e domosdoshme.

Përmbledhje: Të dhënat e disponueshme prej raporteve të dorëzuara, tregojnë se Ndër. e re M&M Goleshi sh.p.k. është në pozitë shumë të pafavorshme sa i përket zotimeve për investime dhe punësim. AKP-ja ka angazhuar auditor të jashtëm të pavarur për të bërë auditimin e kushteve të kontratës dhe duke u bazuar në këtë raport AKP-ja do të bëjë rekomandimet e domosdoshme tek Bordi i Drejtorëve për vendime të mëtejme.

Emri i ndër. së re:	Ndër, e re Llamkos
Vendi:	Vushtrri/ Rajoni i Mitrovicës
Fillimi i kontratës:	21/07/2005
Çmimi i shitjes :	€4,151,000.00
Zotimet për investime:	€15,000,000.00
Zotimet për punësim:	200 punëtorë në gjashtë muajt e parë 250 pas gjashtë muajve dhe 500 në fund të vitit të parë dhe 500 punëtorë të mbahen për vitin e parë pasues

Biznesi/ Sektori: Përpunim i metaleve

Ndërmarrja/ Produktet:

Kompania gjendet në tokën e rrethuar industriale me sipërfaqe prej 183,288 m². Kompania përfshin disa objekte prej përafërsisht 40,000 m² sipërfaqe për prodhim dhe zyre. Ndër. e re prodhon bobina dhe llamarinë të çelikut të galvanizuar. Fabrika e galvanizimit është planifikuar të prodhojë deri në 120,000 ton të çelikut të galvanizuar për vit. Gjithashtu, kompania ka njësinë e prodhimit që është dizajnuar të prodhojë deri në 50,000 ton për vit të produkteve të kryera prej llamarinës së galvanizuar. Pjesa më e madhe e produkteve të kryera është synuar drejt shërbimeve dhe industrisë së ndërtimit.

Investimet: Deri me 21 korrik 2007, Blerësi ka raportuar €1,545,000 të investimeve ose 10%.

Punësimi: Deri me 21 korrik 2007, Blerësi ka raportuar 450 punëtorë që përbën rreth 90% të zotimeve për punësim.

Çështjet: Bordi i Drejtorëve të AKM-së në mbledhjen e tyre të mbajtur me 21 maj 2008 ka sjellë vendimin të vendosë gjoba dhe të ushtrojë tërheqjen e aksioneve për shkak të shkeljes së rëndë të marrëveshjes së zotimeve nga ana e Blerësit. Bordi i Drejtorëve të AKM-së kurrë nuk e ka mbajtur mbledhjen tjetër të radhës që do të rezultonte me ratifikimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit që kërkohet për të shpallur të vlefshme vendimet. Duke pasur këtë parasysh, Bordi i Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e mbajtur me 22 janar 2009 ka rikonfirmuar ushtrimin e tërheqjes së aksioneve dhe vendosjen e gjobave si rezultat i shkeljes së marrëveshjes së zotimeve dhe mospërbushjes së zotimeve. Në atë kohë, AKP-ja është informuar se Blerësi, Kremikovtzi AD nga Bullgaria është në proces të falimentimit. AKP-ja ka vlerësuar situatën dhe ka iniciuar procedurat për ushtrim të tërheqjes së aksioneve duke kalkuluar dhe vënë gjobat si padi tek Administratori i Kremikovtzit dhe gjykata kompetente Bullgare. Për këtë qëllim AKP-ja ka angazhuar kompaninë ligjore në Bullgari që të përfaqësojë interesat e AKP-së. Që nga gjysma e dytë e 2008, Ndër. e re ka ndalur prodhimin dhe punëtorët nuk kanë marrë paga. Ka indikacione se Blerësi me qëllim ka vënë hipotekë dhe obligime tjera mbi Ndër. e re për ta ngarkuar ndërmarrjen me borxhe. Dëmi në ndërmarrje për sa i përket pagave të papaguara të punëtorëve dhe detyrimeve tjera është i konsiderueshëm dhe AKP-ja po ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të përcaktuar shumën e saktë.

Përmbledhje: Llamkos sh.p.k. është privatizimi i parë i dështuar përmes metodës së spinofit special. Dështimi ka ardhur si rezultat i dështimit të Blerësit për të mirëmbajtur nivelin e duhur të investimeve dhe ndryshimet në "pronësinë" e kompanisë amë që kanë reflektuar direkt në zhvillimin e Ndër. së re dhe kanë pasur një efekt negativ në përmbushjen e zotimeve. Posa të aplikohet ndryshimi i pronësisë së aksioneve, kërkesë që është dorëzuar nga AKP-ja dhe posa të procedohet nga Zyra për Regjistrim të Bizneseve dhe aksionet të kthehen tek AKP, AKP-ja do të ndërmerr hapat e domosdoshëm sa i përket administrimit të ndërmarrjes, vlerësimit të aseteve dhe përgjegjësisë si dhe do të propozojë strategjinë për trajtim të mëtejshëm të Ndër. së re tek Bordi i Drejtorëve të AKP-së.

6.2 NSH-të e Komercializuara

Historiku

Në mes të viteve 2000 dhe 2003, Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë ka aplikuar koncesionin e Ndërmarrjeve Shoqërore "NSH" në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/1 me të gjitha ndryshimet të cilat kanë pasuar.

Të gjitha Kontratat e Komercializimit përmbajnë dhe specifikojnë detyrat dhe përgjegjësitë e komercializuesve përgjatë periudhës së komercializimit.

Në përgjithësi ky program është treguar të jetë i suksesshëm vetëm në disa raste ku ka krijuar të hyra nga pagesat e qirasë, ka ofruar punësim për punëmarrësit e NSH-ve, ka ngritur përvojën dhe njohurinë e punëmarrësve të disa ndërmarrjeve për punë dhe mbi ta gjitha ka ruajtur dhe madje edhe ngritur vlerën e asetëve duke bërë investimet e duhura. Në raste tjera NSH-të e Komercializuara nuk kanë arritur rezultatet e pritura dhe kanë pësuar dëme të konsiderueshme në asetet dhe biznesin e tyre.

Monitorimi dhe verifikimi i Kontratave të Komercializuara

Komercializimi i parë është bërë më 13 Qershor 2000. Deri më 2003, 18 (tetëmbëdhjetë) ndërmarrje janë dhënë me koncesion të cilat me fjalë të tjera njihen si Ndërmarrjet e Komercializuara. Pas nënshkrimit të kontratës, marrësi e ka marr për sipër ndërmarrjen në të njëjtën kohë dhe kanë filluar procedurat e monitorimit. Më poshtë është tabela përmbledhëse e Ndërmarrjeve të Komercializuara, ku vërehet se nga 18 (tetëmbëdhjetë) ndërmarrje, 9 (nëntë) janë aktive, 4 (katër) janë privatizuar dhe për pesë prej tyre kontratat janë shkëputur për shkak të mos-përbushjes së obligimeve nga marrësi.

Tabela Përmbledhëse e NSH-ve të Komercializuara

Nr.	Emri i NSH	Komuna	Komercializuesi	Data e nënshkrimit të kontratës	Gjendja aktuale
1	SharrCem	Elez Han	Holderbank (Zvicër)	13.06.2000	Aktive
2	Industria e Ushqimit	Prizren	Abi/Elif 19	19.04.2001	Aktive
3	Betonjerka	Mitrovicë	2K group (Shqipëri)	25.06.2001	Aktive
4	Fapol	Podujevë	CRK/Kosovë	03.07.2001	Aktive
5	Pularia	Lipjan	ADI/ Kosovë	03.07.2001	Aktive
6	Termovent	Lipjan	Dajti/ Kosovë	01.12.2001	Aktive
7	Fan Besiana	Podujevo	CRK/ Kosovë	01.12.2002	Aktive
8	Zdrukthëtaria	Prizren	Egi Bau/Prizren	16.09.2002	Aktive
9	Remont Servis	Prizren	Euro Food	08.09.2003	Aktive
10	Fabrika e Vajit	Ferizaj	Alcon	N/A	Privatizuar
11	Minex	Ferizaj	Neraimpex	N/A	Privatizuar
12	Zejtaria	Prizren	Astra-B	N/A	Privatizuar
13	Tullara	Kamenica	Vëllezërit Borovci	N/A	Privatizuar
14	Industria për përpunimin e mishit	Prizren	Fructus	N/A	Kontrata e shkëputur
15	IMN Kosova	Prishtina	Ital Kosova	N/A	Kontrata e shkëputur

Nr.	Emri i NSH	Komuna	Komercializuesi	Data e nënshkrimit të kontratës	Gjendja aktuale
16	Fabrika e Tullave "M.Goga"	Ferizaj	Tullorja	N/A	Kontrata e shkëputur
17	Mirusha	Klina	Sacet	N/A	Kontrata e shkëputur
18	Gjeravica	Deçan	Wood Industry	N/A	Kontrata e shkëputur

Periudha kalimtare nga AKM në AKP

Me shuarjen e AKM-së dhe themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit "AKP", si pasardhëse e AKM-së, menjëherë është filluar me rekrutimin e personelit dhe njoftimin e NSH-ve të komercializuara se jemi duke i rifilluar aktivitetet tona monitoruese, sistematizimi i dokumenteve në posedim të AKP-së (informata të kufizuara janë gjetur në dosje), dhe në të njëjtën kohë, janë kryer vizita dhe është bërë rishikimi i të dhënave.

Pengesa kryesore që nga fillimi deri më tani është ajo se Njësia Monitoruese nuk ka trashëguar ndonjë pasqyrë të qartë dhe të saktë mbi përmbushjen e kushteve të kontratave të komercializimit. Të gjitha të dhënat elektronike janë shlyer dhe AKM nuk ka mbajtur bazë të të dhënave mbi monitorimin e Ndërmarrjeve të Komercializuara siç është rasti me spin of-et speciale. Po ashtu raportet nuk janë azhurnuar dhe pothuaj se të gjitha ndërmarrjet kanë raportuar vetëm deri në fund të vitit 2007.

Auditimi i Ndërmarrjeve të Komercializuara

Për ta tejkaluar këtë gjendje, Divizioni i Qeverisjes Korporative ka bërë një plan për auditimin e ndërmarrjeve mbi përmbushjen e obligimeve kontraktuale të specifikuar në kontratat e komercializimit, duke përfshirë investimet, punësimin, qiranë dhe raportimin. Procedura e prokurimit është iniciuar dhe tenderi është shpallur.

Qëllimi i auditimit të jashtëm është t'i siguroj AKP-së një mendim të pavarur mbi investimet e ndërmarrja si dhe vlerën monetare të paguar nga marrësi në mënyrë që të përmbushë zotimet e investimit mbi planin investiv, i cili është pjesë e Kontratës së Komercializimit. Auditorët po ashtu do të verifikojnë përmbushjen e zotimeve të punësimit si dhe pagesën e qirasë.

E vlen të theksohet se AKM ka angazhuar auditorët e jashtëm për periudhën e kontratave të nënshkruara deri më 2005, por këto auditime kanë përfshirë vetëm investimet, ndërsa zotimi i punësimit dhe pagesa e qirasë nuk janë audituar.

Dizajnimi i një baze të të dhënave mbi monitorimin e Ndërmarrjeve të Komercializuara

Divizioni i Qeverisjes Korporative ka iniciuar procedurën e prokurimit për dizajnimin e një baze të të dhënave, e cila do të mundësoj sigurimin e informatave në kohë për nivelin e përmbushjes së kushteve të kontratës.

Çështjet

Njësia Monitoruese do të vazhdoj me procedurat e auditimit dhe dizajnit të bazës së të dhënave gjatë vitit 2009. Raportet e pranuar nga auditimet e jashtme do të jenë baza për hapat e mëtejshëm të përcaktuar në kontratë, siç përcaktohet në kontratat e komercializimit në mënyrë që të qartësohet secila gjendje individualisht.

Raporti specifik në lidhje me secilën NSH të komercializuar është i përshkruar më poshtë:

Emri i Ndërmarrjes:	Industria e Ushqimit/Abi&Elif 19
Vendi/Komuna:	Prizren/Rajoni i Prizrenit
Data e nënshkrimit të kontratës:	19 Prill 2001
Data e shkëputjes së kontratës:	18 Prill 2011
Zotimi i investimit:	€3,558,591.49
Zotimi i punësimit:	145-240 punëmarrës të rregullt dhe 200-270 punëmarrës sezonal
Qiraja Vjetore:	€30,677.51

Afarizmi/Spektori: Përpunim i frutave dhe perimeve si dhe paketimi i produkteve të gatshme.

Ndërmarrja dhe produktet:

Ndërmarrja ka një sipërfaqe prej 8.76 hektarësh dhe gjendet në zonën industriale të komunës së Prizrenit. Në këtë sipërfaqe përfshihen ndërtesa administrative, depot, ndërtesat e prodhimit, frigoriferët, etj. Ekzistojnë disa linja të përpunimit të frutave dhe perimeve si dhe disa linja për paketimin e ushqimit (duke përfshirë këtu trangujt, specat, domatet, bizelet etj.) linjën e paketimit të plastikës, metalit dhe qelqit, linjën për përpunimin e ushqimit të ngrirë si dhe një linjë për produkte të bulmetit.

Gjatë viteve 1999 dhe 2000 (para komercializimit), ndërmarrja ka punuar me humbje dhe ka qenë shumë afër të shkatërrimit total si dhe ka pasur borxhe të papaguara për paga, shpenzime komunale dhe për furnitorë.

Më 19 Prill 2001, është nënshkruar kontrata për komercializim me “Abi & Elif 19”, me tej si “marrësi”, i cili është i kualifikuar të operoj, menaxhoj, përmirësoj dhe shfrytëzoj kompleksin industrial për dhjetë vite.

Që nga vitet e para të komercializimit, marrësi ka arritur jo vetëm ta rivitalizoj dhe riaktivizoj procesin e prodhimit, por po ashtu ta riaktivizoj bujqësinë në tërë rajonin e Prizrenit. Në fillim të komercializimit nevojat për produkte lokale bujqësore janë përmbushur në një nivel prej 45-50% nga fermerët lokal, ndërsa tani nevojat e prodhimit përmbushen 90-95% nga fermerët lokal, që do të thotë se do të bëhet absorbimi i disa tonëve të produkteve bujqësore tepriçë.

Produktet e “Abi & Elif 19”, janë mjaftë konkurrense në Kosovë dhe po ashtu eksportohen jashtë vendit, si në: Angli, Gjermani, Holandë, Belgjikë, Zvicër, Suedi, Australi, Dubai, Shqipëri, etj.

Investimet:

Bazuar në raportin e auditorit të pavarur, marrësi ka investuar €1,826,000 gjatë periudhës Janar 2003 - Qershor 2006, prej të cilave €1.695.000 janë investuar në mjete themelore. Kryesisht investimet janë bërë në: ndërtesa, pjesë të pajisjeve dhe automjete.

Investimet për periudhën 2001-2002 nuk janë dokumentuar mirë prandaj nuk janë përfshirë në raportin e auditorit për totalin e investimeve të realizuara, edhe pse në këtë periudhë pothuajse të gjitha linjat e prodhimit për ushqim dhe përpunim të perimeve kanë qenë të aktivizuara. Arsyeimi i marrësit për mos dëshmimin se ka bërë investime është gjatë kësaj periudhe ata kanë qenë nën presion të madh për fillimin e procesit të prodhimit dhe nuk i kanë kushtuar vëmendje faktit të evidencimit të investimeve. Megjithatë, ndërmarrja është në proces të auditimit nga auditorët e jashtëm të pavarur.

Punësimi:

Që nga fillimi i komercializimit, niveli i punësimit me orar të plotë punë ka qenë 145 deri në 150 punëmarrës dhe të gjithë ata janë punëmarrës të Ndërmarrjes Shoqërore para komercializimit. Bazuar në raportet e pranuar deri në Dhjetor 2008, €3,666,000 janë paguar për paga. Po ashtu niveli i punësimit sezonal arrin deri në 300 punëmarrës të angazhuar.

Kompania ka një përkrahje të fuqishme nga Këshilli i Punëtorëve dhe deri më tani nuk është vërejtur ndonjë konflikt në mes të menaxhmentit dhe punëmarrësve, në të kundërtën ata janë mjaft të kënaqur me trajtimin e tyre.

Çështjet:

Agjencia ka pranuar një kërkesë për privatizim nga "ABi & Elif 19" para ndërprerjes së kontratës së komercializimit. Kjo ndodhë për arsye se kompania është në gjendje të bëjë investime të reja të cilat nuk parashihen me kontratën e komercializimit. Po ashtu komercializimi i kontratës do të mundësonte nënshkrimin e kontratave afat gjata me blerës të jashtëm dhe në këtë mënyrë do të ndikonte në rritjen e punës dhe stimulimin e bujqësisë në rajonin e Prizrenit.

Përmbledhje:

Marrësi ka bërë një punë të shkëlqyer në rritjen e produktit ditor, duke zhvilluar produkte të reja dhe duke depërtuar në tregjet ndërkombëtare. Agjencia ka angazhuar auditorë të jashtëm dhe të pavarur për të audituar përmbushjen e kushteve të kontratës së komercializimit dhe është në proces të azhurnimit të të dhënave të listës poseduese dhe kopjes së planit në mënyrë që Bordi i Drejtorëve të aprovoj privatizimin e ndërmarrjes.

Emri i Ndërmarrjes:	Sharr Cement/Sharr Beteiligungs GmbH
Vendi/Komuna:	Hani i Elezit, Rajoni i Gjilanit
Data e Nënshkrimit të Kontratës:	13 Qershor 2000
Data e Përfundimit të Kontratës:	12 Qershor 2010
Zotimet e Investimit:	€11,043,905, maksimum €16,361,340
Zotimet e Punësimit:	750 deri më 2005
Qiraja Vjetore:	€511,292 deri në maksimum €1,022,584 apo 10 % e EBITDA

Afarizmi/Spektori: Prodhimi i çimentos

Ndërmarrja dhe produktet

Sharr Cement është një nga katër njësitë e Sharr Holding e cila gjendet në komunën e Hanit të Elezit. NSH përbëhet nga gurorja e argjilës së çimentos, guri gëlqeror, argjila dhe fushat kolektive, objektet për përgatitjen e lëndës së parë, objektet për prodhimin e skories, zona për prodhimin e çimentos dhe laboratorit.

Më 13 Qershor 2000, është nënshkruar kontrata për komercializim në mes Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Sharr Beteiligungs GmbH, në tekstin e mëtejshëm si "Qiramarrësi" i cili ka të drejtë të operoj dhe menaxhoj me ndërmarrjen për një periudhë kohore prej dhjetë vitesh. Në të njëjtën kohë kjo ndërmarrje është e njohur si ndërmarrja më e madhe dhe më e suksesshme në rangun e ndërmarrjeve të komercializuara. Sharr Cement ka arritur të jetë prodhuesi më dominant i çimentos në Kosovë ku i shet produktet e veta po ashtu. Ndërmarrja punon me kapacitet prej 80%. Pavarësisht konkurrencës e cila është rezultat i importit, Sharr Cement me prodhimin e vet mbulon shumicën e tregut dhe planifikon ta rritë kapacitetin e saj edhe më tej. Rritja në prodhim dhe prani në treg vit pas viti vërehet në pasqyrat financiare të parashtruara nga qiramarrësi të cilat sipas nenit 5.3 të kontratës së komercializimit, duhet të auditohen nga një kompani auditimi ndërkombëtare. Në tri vitet e para të komercializimit, ndërmarrja ka punuar me humbje si pasojë e investimeve të bëra në ndërmarrje. Ndërsa, duke filluar nga viti 2004, ndërmarrja ka filluar të gjeneroj fitim e cili rritet vit pas viti.

Investimet:

Investimet e fundit të raportuara gjatë periudhës 2000-2005 janë përafërsisht €21 milion, kryesisht të bëra në makineri dhe linja të prodhimit.

Punësimi:

Sharr Cement është ndërmarrja më e madhe e komercializuar me numrin më të madh të punëmarrësve. Qiramarrësi ka një përkrahje të madhe nga punëmarrësit për shkak të trajtimit të mirë nga ana e tij siç janë: kushtet e mira të punës, pagat e larta, bonuset vjetore etj.

Fillimisht ishin punësuar 750 persona dhe ky numër është zvogëluar gradualisht në 650 në vitin e pestë të komercializimit, siç ka qenë e parashikuar me kontratë. Kurse, aktualisht, janë rreth 500 punëmarrës të rregullt. Duke filluar nga viti 2006, Sharr Cement dhe Agjencia kanë arritur një marrëveshje për programin e pushimit me pagesë për 137 punëmarrës: pagat e tyre ju jepen 60% nga të hyrat e qirasë dhe 40% nga Sharr Cement. Përveç pagës së rregullt, Qiramarrësi është i obliguar t'i paguaj bonuset vjetore në shumën prej 20% të fitimit.

Bazuar në raportet të cilat i kemi pranuar, qiramarrësi për vitin 2008 ka paguar €3,630,200 për paga. Totali i pagave të paguara nga viti 2000 deri në fund të vitit 2008 është €28,900,000.

Qiraja:

Bazuar në kontratën e komercializimit, qiramarrësi është i obliguar të paguaj në emër të qirasë së paku €511,300 deri në maksimum prej €1,022,600, bazua në 10 % të EBITDA. Që nga fillimi i komercializimit deri në fund të vitit 2008, qiramarrësi ka paguar në emër të qirasë €5,921,000 dhe nuk ka ndonjë obligim të papaguar.

Çështjet:

Sharr Cement ka aplikuar për zgjatje të licencës në Komisionin e Pavarur, në përputhje me legjisllacionin dhe rregulloret e zbatueshme. Përdërisa, çështja e licencës varet nga pagesa e tantiemave për argjilën e çimentos të nxjerrur e cila shërben si lëndë e parë për prodhimin e çimentos. Sharr Cement është ankuar për vendimin dhe e ka kontestuar pagimin e tantiemave bazuar në faktin se që nga viti 2000 deri më tani asnjëherë nuk ka paguar tantiema sepse bazuar në kontratën e komercializimit ajo është e liruar nga pagesa e tantiemave, Divizioni për

Qeverisje Korporative ka kërkuar mendimin ligjorë nga Departamenti Ligjor i Agjencisë.

Ndërmarrja ka obligime të trashëguara nga para-lufta të cilat tani paraqiten si akt vendime apo gjykime përfundimtare.

Deri më tani gjykimet përfundimtare, të paguara nga llogaria e të hyrave të qirasë janë rreth €2.5 milion. Ndërsa, ankesat në lëndët gjyqësore, arrijnë shumën prej më shumë se €8.5 milion.

Një tjetër çështje me rëndësi është verifikimi i përfundimit të kushteve të kontratës së komercializimit për auditimit të jashtëm. Ky proces tanimë ka filluar dhe mbulon periudhën kohore deri më 12 Qershor 2009.

Përmbledhje:

Ndërmarrja Sharr Cement është një prej ndërmarrjeve më të mëdha të komercializuara që do ti nënshtrohen privatizimit të ardhshëm. Megjithatë për shkak të obligimeve kontraktore që rezultojnë prej kontratës së komercializimit para privatizimit, së pari duhet të plotësohen kërkesat në vijim: vlerësimi i të gjitha asetëve që do t'i nënshtrohen vlerësuesit profesional të pavarur dhe auditimit të jashtëm të pavarur për tërë zotimet për investime dhe punësim. Pasi të bëhet procedura dhe të përfundohet propozimi do të dorëzohet për shqyrtim dhe miratim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së për të vendosur rreth metodës së privatizimit.

Emri i ndërmarrjes:	Betonjerka/2K Group
Vendi/Komuna:	Mitrovica / Rajoni i Mitrovicës
Data e nënshkrimit të kontratës:	25 Qershor 2001
Data e ndërprerjes së kontratës:	24 Qershor 2011
Zotimi i Investimit:	€680,018.20
Zotimi i punësimit:	30 punëmarrës për periudhën 2001-2010
Qiraja vjetore:	€6,135.50

Afarizmi / Sektori: Prodhimet nga çimento dhe çimento e përforcuar

Ndërmarrja dhe produktet:

Betonjerka ishte themeluar në vitin 1952 për prodhimin e të gjitha llojeve të prodhimeve dhe parafabrikateve nga çimento dhe çimentoja e përforcuar siç janë: ndërtimet e kombinuara inxhinierie, të gjitha llojet e elementeve të ndërtimit të rrugëve, gypave, tjegullave, pllakave, gypave të tokës, blloqeve, shtyllave dhe kushinetave, pusetave për furnizim me ujë dhe produkteve të ngjashme.

Investimet

Pjesa më e madhe e investimeve është bërë në rritjen dhe renovimin e objekteve, renovimin e sallës së prodhimit, ndërtimin e murit në kufijtë e ndërmarrjes, përmirësimin dhe renovimin e furnizimit me energji elektrike, rehabilitimin dhe blerjen e pajisjeve, blerjen e kompjuterëve dhe pajisjeve të nevojshme për zyrë, etj.

Bazuar në raportin e auditimit, ndërmarrja nga 01/06/2001 deri më 31/12/2005, ka realizuar €629,562.00 të shumës së investimeve të zotuar.

Punësimi:

Me kontratë të komercializimit parashihet se qiramarrësi punëson dhe mbanë 30 punëmarrës për dhjetë vite të komercializimit me një pagë mesatare prej €350. Bazuar në raportet e parashtruara nga qiramarrësi, ai ka punësuar 31 punëmarrës apo 103% të zotimit të punësimit, derisa obligimi për një pagë mesatare prej €350 nuk është përmbushur plotësisht. Bazuar në raportet e pranuar deri më Dhjetor 2007, €682,000 janë paguar për paga, të cilat janë subjekt i auditimit të jashtëm.

Në anën tjetër, Sindikata e Pavarur e ish organizatës punuese Betonjerka, është e pakënaqur dhe e revoltuar me komercializimin e NSH-së, punëmarrësit janë të brengosur sepse sipas tyre shpresat për të ardhmen për këtë fabrikë po përkeqësohen për çdo ditë, dhe vazhdimisht ata janë duke shprehur pakënaqësinë.

Çështjet:

Qiramarrësi nuk ka raportuar për vitin 2008. Divizioni i Qeverisjes Korporative ka kontaktuar menaxhmentin e ndërmarrjes dhe ka kërkuar që sa më shpejt që është e mundur të parashtrorjë raportet e nevojshme në përputhje me Kontratën e Komercializimit.

Po ashtu është në proces auditimi i kushteve të kontratës nga auditorë të jashtëm të pavarur.

Përmbledhje:

Pas pranimit të raportit të auditimit dhe varësisht nga mendimi i saj Agjencia do t'i ndërmarr hapat e ardhshëm të përcaktuar me kontratë.

Emri i Ndërmarrjes:	Fan Besiana/ CRK
Vendi/Komuna:	Podujeva / Rajoni i Podujevës
Data e Nënshkrimit të Kontratës:	01 Dhjetor 2002
Data e Përfundimit të Kontratës:	01 Dhjetor 2012
Zotimet e Investimit:	€1,200,000.00
Zotimet e punësimit:	33 - 81 punëmarrës
Qiraja Vjetore:	€12,000.00

Afarizmi/Divizioni: Mikpritja/Banimi, ushqimi dhe akomodimi

Ndërmarrja dhe produktet:

Fan Besiana është një ndërmarrje e komercializuar e cila gjendet në Podujevë, është në vitin e shtatë të komercializimit. Më 01 Dhjetor 2002, kontrata për komercializim është nënshkruar me CRK, në tekstin e mëtejme si "Qiramarrësi" e cila ka të drejtë të operoj, menaxhoj, përmirësoj dhe shfrytëzoj kompleksin për dhjetë vite. Ndërtesa ishte ndërtuar qëllimisht për arsye hoteliere. Është e dobishme për seminare, konferenca, trajnime dhe ngjarje tjera shoqërore.

Investimet:

Pjesa më e madhe e investimeve është bërë në ndërtimin e një Pishine Olimpikë, në përmirësimin dhe riparimin e ndërtesës, kopshtit për lojëra të fëmijëve, fushës së tenisit, klubit të fituesit si dhe investimeve tjera. Bazuar në raportin e auditorit ndërmarrja nga data e nënshkrimit deri më datë 31/12/2005, ka kryer €574,000 të investimit të zotuar të cilat janë subjekt i kontrollit dhe auditimit të jashtëm.

Punësimi:

Në kontratën e komercializimit është paraparë se qiramarrësi fillimisht punëson 33 punëmarrës dhe do ta rritë atë vit për vit deri në 81 me një pagë minimale prej €175 me mundësi të rritjes së pagës. Bazuar në raportin e parashtruar nga qiramarrësi, deri në fund të vitit 2007, ndërmarrja ka raportuar 35 punëmarrës dhe ka paguar €498,000 për paga.

Çështjet:

Aktivitetet e ndërmarrjes ishin ndaluar prej Shtatorit 2007 për shkak të borxheve ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) në shumën prej €68,000. Me ndërmjetësimin e AKP-së, është dakorduar të ri-programohet borxhi dhe më 01 Maj 2009 hoteli ka rifilluar punën.

Përveç obligimeve të papaguara ndaj ATK-së, ndërmarrja ka edhe obligime tjera të papaguara siç janë pagesat e koncesionit dhe mund të shihet qartë se ka probleme me qarkullimin e parasë. Qiramarrësi nuk ka parashtruar raportet për periudhën 2008-2009.

Përmbledhje:

Të dhënat e disponueshme nga raportet e parashtruara tregojnë se qiramarrësi nuk është në situatë të mirë si pasojë e problemeve me qarkullim të parasë dhe me përmbushjen e kushteve të Kontratës së Komercializimit. Për këtë arsye, Divizioni i Qeverisjes Korporative është në fazën e përzgjedhjes së një auditori të jashtëm të pavarur për t'i audituar kushtet e Kontratës së Komercializimit dhe bazuar në këtë raport, do të ndërmerren hapat e ardhshëm.

Emri i Ndërmarrjes:	Fapol/Konzorciumi për Rindërtimin e Kosovës "CRK"
Vendi/Komuna:	Podujevë / Rajoni i Prishtinës
Data e Nënshkrimit të Kontratës:	03 korrik 2001
Data e Përfundimit të Kontratës:	02 korrik 2011
Zotimet e Investimit:	€1,896,893
Zotimet e Punësimit:	40-180 punëmarrës
Qiraja Vjetore:	€9,203.25

Afarizmi / Sektori: Industria e ndriçimit, prodhimi i shtyllave nga poliesteri.

Ndërmarrja dhe prodhimet:

Ndërmarrja Fapol është një ndërmarrje e komercializuar e cilat gjendet në Podujevë, në vitin e tretë të komercializimit. Më 03 Korrik 2002, është nënshkruar kontrata e komercializimit me CRK, këtu e tutje si "Qiramarrësi", me mandat të operoj, menaxhoj, përmirësoj dhe shfrytëzoj kompleksin për dhjetë vite. Kjo ndërmarrje është duke u përballur me problem serioz në promovimin e prodhimit të saj siç është shtylla e poliesterit e cila ka forcë të madhe dhe është tejet e shtrenjtë.

Përveç pjesës së prodhimit, në zonën e ndërmarrjes është ndërtuar një Terminal Doganor, nga vijnë shumica e të hyrave të gjeneruar.

Investimet:

Pjesa më e madhe e investimit është bërë në rinovimin e ndërtesës ekzistuese administrative, terminalit doganorë dhe linjës për instalimin e elementeve të kuzhinës. Bazuar në të dhënat ekzistuese, qiramarrësi ka investuar €1,348,500 të cilat janë subjekt i kontrollit dhe auditimit të jashtëm.

Punësimi:

Në Kontratën e Komercializimit, në shtojcën e planit për punësim është paraparë se qiramarrësi do të punësoj 40-180 punëmarrës për dhjetë vite të komercializimit me një pagë minimale prej €175 si dhe pagesën ditore të ushqimit. Bazuar në raportet e parashtruara nga ndërmarrja deri në fund të vitit 2008, ndërmarrja ka raportuar 112 punëmarrës dhe gjithsej €2,048,000 janë paguar në emër të pagave.

Çështjet:

Divizioni i Qeverisjes Korporative është në proces të përzgjedhjes së auditorëve të jashtëm për auditimin e përfundimit të kushteve të Kontratës së Komercializimit.

Përmbledhje:

Varësisht nga raporti i auditimit, do të ndërmerren hapat e nevojshëm siç theksohen me Kontratën e Komercializimit.

Emri i Ndërmarrjes:	Remont Servis/Euro Food
Vendi/Komuna:	Prizren / Rajoni i Prizrenit
Data e nënshkrimit të kontratës:	22 dhjetor 2003
Data e përfundimit të kontratës:	21 dhjetor 2013
Zotimi për investim:	€653,335.00
Zotimi për punësim:	34-43 punëtorë
Qiraja vjetore:	€18,406.51

Afarizmi/Spektori: Servisim dhe kontroll teknik i automjeteve dhe prodhimi i produkteve ushqimore

Ndërmarrja/Prodhimi:

Ndërmarrja Shoqërore Remont - Servis ka ushtruar veprimtarinë e riparimit dhe rregullimit të automjeteve për transport dhe pasagjerë, duke ofruar servisim dhe kontroll teknik për të gjitha llojet e automjeteve dhe kryerjen e punës për regjistrimin e automjeteve.

Ndërmarrja gjithashtu merret me prodhimin e produkteve ushqimore, keçap, majonezë, lloje të ndryshme të reçelit dhe është shumë konkurruese, si në tregun e Kosovës, ashtu dhe në rajon.

Investimi:

Pjesa kryesore e investimit është bërë në ndërtesën e re, rimobilimi i ndërtesës dhe pajisjet, blerja e pajisjeve të reja, mirëmbajtja e ndërtesës, trajnimi i punëtorëve dhe menaxhmentit. Në bazë të shtojcës 3 mbi planin e investimeve të kontratës së komercializuar, ndërmarrja është zotuar të investojë shumën prej €653,000 ndërsa në bazë të raportit të auditorit të jashtëm deri në vitin 31.08.2006 ndërmarrja ka kryer investime në sasinë prej €954,800.

Punësimi:

Kontrata e komercializuar parashihte që qiramarrësi do të punësonte dhe mbante punëtorë më pagë neto €250 dhe me një pagesë për shujtë ditore. Në bazë të raporteve të pranuar deri në dhjetor 2008, janë raportuar 34 punëtorë dhe €430,800 janë paguar për rroga.

Çështjet:

Qiramarrësi ka aplikuar për licencë të kontrollit teknik që në 2004 dhe më në fund në 2008 Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit ka miratuar licencën për kontroll teknik. Një tjetër çështje është se Ndërmarrja ka një kontest lidhur me një dyqan i cili është pjesë e kontratës së komercializuar dhe që është rrënuar për shkak të ndërtimeve pranë dyqanit. Të gjitha institucionet relevante janë njoftuar me kohë lidhur me rastin dhe tani pritet vendimi i gjykatës.

Përmbledhje:

Qiramarrësi po bën një punë të mirë dhe në bazë të raporteve të siguruara, po i përmbahet kushteve të kontratës, me përjashtim të zotimit për punësim. Sa i përket punësimit, qiramarrësi ka deklaruar se për shkak të vështirësive në pajisjen me licencë për kontrollin teknik të automjeteve nuk ka qenë në gjendje të rrisë numrin e punëtorëve sikurse është paraparë në Kontratën e Komercializimit, edhe pse këtë vit do të përmbushin plotësisht zotimin për punësim.

Megjithatë, procesi i përzgjedhjes së auditorit të jashtëm është në vazhdim e sipër në mënyrë që të auditohet kryerja e kushteve të kontratës dhe hapat e mëtejshëm do të merren në varësi të raportit të auditorit.

Emri i ndërmarrjes:	Zdrukhëtaria / Egi-Bau
Vendi/Komuna:	Prizren / Rajoni i Prizrenit
Data e Fillimit të Kontratës:	16 shtator 2002
Data e Përfundimit të Kontratës:	15 shtator 2012
Zotimi për investim:	€1,444,300.00
Zotimi për punësim:	30-65 punëtorë
Qiraja vjetore:	€6,120.00

Afarizmi/Spektori: Prodhimi i materialit ndërtimor

Ndërmarrja/Produkti:

Ndërmarrja ka një sipërfaqe prej 1.5 hektarësh tokë, nga e cila 3,803 m² janë ndërtesa prodhimi, depo dhe dyqane. Veprimtari e Ndërmarrjes është prodhimi i materialit ndërtimor si tulla për tavan, mure dhe panele me trashësi dhe përbërje të ndryshme, ajo merret edhe me prodhimin e pjesëve nga druri, dyer, dritare dhe mobile. Produktet e kësaj ndërmarrjeje kanë disa prioritete si: fleksibilitet, kosto të ulur të ndërtimit dhe kohë të ulur të ndërtimit etj.

Investimet:

Pjesa kryesore e investimeve është bërë në rinovimin e çatisë, betonimin e dyshemesë, instalimet e brendshme, dyert, dritaret, lyerje dhe gledim. Gjithashtu kanë investuar edhe linjat e reja të prodhimit për "Polyesterol", presimi i tallashit, sallë pune për paketim, riparimin e pajisjeve ekzistuese, blerjen e automjeteve për nevojat e kompanisë, pastrimin e mbeturinave në oborrin e ndërtesës, shtrimin e zhavorrit dhe investime të tjera. Në bazë të shtojcës 3 mbi planin e investimeve në Kontratën e Komercializimit, Ndërmarrja është zotuar të investojë në shumën prej €1,444,300 ndërsa në bazë të raportit të auditorit të jashtëm deri në vitin 31.07.2005 ndërmarrja arriti investime në shumën prej €1,096,900.

Punësimi:

Në Kontratën e Komercializimit parashihej se qiramarrësi fillimisht do të punësonte 30 punëtorë dhe do të rriste numrin ndër vite deri në 65 punëtorë, me një pagë mesatare prej €215. Në bazë të raporteve të paraqitura deri në dhjetor 2008 numri i punëtorëve ka qenë 24 dhe në emër të rrogave janë paguar €439,900. Arsyetimi i qiramarrësit për mospërbushje të Zotimit për Punësim është se që nga fillimi i kontratës së komercializimit deri më tani të gjitha dyqanet që ishin pjesë e Kontratës së Komercializimit ishin të uzurpuara dhe nuk kishte asnjë mundësi për të rritur as të ardhurat, as numrin e punëtorëve.

Çështjet:

Në përgjithësi, Ndërmarrja ka funksionuar mirë, mirëpo që nga fillimi i komercializimit deri tani të gjitha dyqanet që ishin pjesë e Kontratës së Komercializimit kanë qenë të uzurpuara dhe kjo ka shkaktuar humbje financiare dhe ka rezultuar në mospërbushje të zotimit për punësim si dhe mospagesë të qirasë vjetore. Agjencia po merret me kontestin në mënyrë që kjo çështje të mbyllet sa më shpejt të jetë e mundur.

Përmbledhje: Ndërmarrja ka bërë kërkesë për privatizimin dhe Agjencia ka iniciuar azhurnimin e të dhënave kadastrale. Edhe procesi për përzgjedhjen e një auditori të jashtëm të pavarur është në vijim e sipër për të përmbushur kushtet e kontratës.

Emri i Ndërmarrjes:	IMN Kosova / N.P.T. Italkosova
Vendi/Komuna:	Prishtina / Rajoni i Prishtinës
Data e nënshkrimit të kontratës:	01 dhjetor 2001
Data e përfundimit të kontratës:	07 qershor 2007
Zotimet për investim:	€3,505,000
Zotimet për punësim:	78 punëtorë
Qiraja vjetore:	€10,225.83

Afarizmi/Spektori: Prodhimi i materialit ndërtimor, tulla nga argjila

Ndërmarrja dhe produktet:

Fabrika e Tullave IMN Kosova është themeluar në vitin 1947 për prodhimin e tullave, gjendet në periferi të Prishtinës. Në 1975 Fabrika i zgjeroi kapacitetet e saj dhe deri në 1990 ka punuar me pothuajse kapacitet të plotë. Sipërfaqja e fabrikës shtrihet në një zonë prej 9.07 ha.

ITALKOSOVA e ka komercializuar Ndërmarrjen IMN Kosova dhe ka vazhduar me prodhimin e këtyre produkteve që nga nënshkrimi i Kontratës së Komercializimit deri në nëntor 2006, kur kjo fabrikë u mbyll për shkak të borxheve për rrymë dhe shumë detyrimeve të tjera.

Investimet:

ITALKOSOVA nuk ka paraqitur asnjë raport mbi vlerën e investimit të bërë në këtë ndërmarrje. Në bazë të vizitave dhe investimeve të punëtorëve në vitet e mëparshme qiramarrësi ka përmbushur një pjesë të investimeve, mirëpo kurrë nuk ka dhënë raportim pavarësisht kërkesave të vazhdueshme nga Agjencia.

Punësimi:

Kontrata e Komercializimit parashihte që qiramarrësi të punësonte 78 punëtorë me orar të plotë dhe të siguronte pagesë minimale prej €204 dhe pagesë maksimale prej €1,022. Gjithashtu, në bazë të marrëveshjes qiramarrësi është i detyruar të sigurojë pagesë mujore prej €77 për 20 punëtorë në bazë të moshës së tyre (mbi 60) dhe problemeve shëndetësore. Qiramarrësi nuk ka raportuar asnjëherë mbi punëtorët dhe gjendjen e punësimit. Aktualisht ka vetëm disa punëtorë që sigurojnë ndërtesën (roje) ndërkohë që pritet të gjendet një zgjidhje për ndërmarrjen.

Çështjet:

Në mars është mbajtur një takim me përfaqësues të punëtorëve, ku janë ngritur disa çështje dhe ku është vendosur që AKP të gjejë urgjentisht një zgjidhje për sigurimin e ndërtesës dhe të fillojë privatizimin e ndërmarrjes sa më shpejt të jetë e mundur.

Përmbledhje:

Marrëveshja për koncesion u ndërpre me vendim të Bordit të AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 07 qershor 2007, kur u mor dhe vendimi për privatizimin e kësaj ndërmarrjeje. Që atëherë nuk është ndërmarrë asnjë hap tjetër për të bërë diçka për këtë situatë. Qiramarrësi u njoftua gjithashtu lidhur me këtë vendim. Në shkurt 2009 zyrtarë të AKP-së vizituan NSH dhe përfaqësues të punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje paraqitën rekomandime dhe kërkesa për fillimin e procedurës së privatizimit. Ky rast po trajtohet nga Departamenti Ligjor i AKP-së në mënyrë që të sqarohet situata dhe të përcaktohen përgjegjësitë potenciale të qiramarrësit lidhur me mospërmbushjen e kontratës. Bordi i ardhshëm i AKP-së do të vendosë mbi procedurat që do të ndiqen.

Emri i Ndërmarrjes:	Termovent /SHPK Dajti
Vendi/Komuna:	Lipjan / Rajoni i Prishtinës
Data e fillimit të kontratës:	29 nëntor 2001
Data e përfundimit të kontratës:	28 nëntor 2011
Zotimet për investim:	€ 619,695.76
Zotimet për punësim:	60- 85 punëtorë
Qiraja vjetore:	€20,451.67

Afarizmi/Spektori: Prodhimi i ventilatorëve, dyerve, dritareve dhe fasadave me profil alumini dhe rafiniturë xhami.

Ndërmarrja / Produkti:

Ndërmarrja Termovent është themeluar në 1986 për prodhimin e ventilatorëve freskues dhe ajrosjes si dhe akse për çati. Ka një sipërfaqe prej 3.43 ha dhe me ndërtesa të tilla si Drejtoria, salla e punës dhe Ndërtesa e Bojlerit me sipërfaqe prej 60.21 ari në Komunën e Lipjanit. Gjatë vitit 1999, Ndërmarrja nisin punën me 30 punëtorë dhe në 29 nëntor 2001 u nënshkrua Kontrata e Komercializimit me SHPK Dajti.

SHPK Dajti filloi prodhimin në vitin 2002 duke prodhuar në të njëjtën kohë dyer dhe dritare alumini dhe pjesë dekorative nga druri të cilat janë eksportuar për pak kohë në tregun italian.

Investimet:

Sipas raportit të auditorit të jashtëm, për periudhën 2001-2007 ndërmarrja ka investuar për blerjen e aseteve, riparimin e makinerive dhe pajisjeve ekzistuese. Në bazë të kontratës së komercializimit dhe planit të investimit ndërmarrja është zotuar të investojë shumën prej €620,000 ndërsa sipas raportit të auditorit të jashtëm ndërmarrja ka investuar në shumën prej €534,000 deri në 28 shkurt 2007.

Punësimi:

Me Kontratën e Komercializimit parashihet se ndërmarrja ka punësuar 60 punëtorë në dy vitet e para të komercializimit, ndërsa 80 punëtorë për vitet pasuese me një pagë neto minimale prej €150 dhe shujtë ditore. Në bazë të raporteve të siguruara nga AKP, SHPK Dajti ka paguar €1,281,000 për paga deri në dhjetor 2007 dhe ka raportuar për 52 punëtorë gjatë kësaj periudhe kohore. Gjatë vizitës monitoruese është vërejtur se me përjashtim të rojeve për ndërtesën, të gjithë punëtorët e tjerë ishin në pushim pa pagesë me justifikimin se nuk kishte prodhim.

Çështjet:

Të gjitha linjat e prodhimit janë jashtë funksionimit që nga shtatori 2008 për shkak të mungesës së fondeve dhe ndërprerjes së bashkëpunimit me partnerët jashtë vendit. Përkatësisht, me përjashtim të rojeve të ndërtesës, të gjithë punëtorët janë në pushim pa pagesë.

Gjendja e keqe me rrjedhën e parasë së gatshme ka ardhur si rezultat i investimit të qiramarrësit për të blerë pronë pranë ndërmarrjes dhe për të ngritur mbi të një ndërtesë ku është instaluar linja e prodhimit të detergjentit. Ky investim nuk ka të bëjë me Kontratën e Komercializimit; megjithatë ka pasur ndikim mbi gjendjen financiare të qiramarrësit.

Përmbledhje:

Pas vizitës monitoruese, është vërejtur se qiramarrësi ka probleme financiare dhe kjo ka shkaktuar ndërprerjen e prodhimit dhe gjendjen ku punëtorët është dashur të dërgohen në pushim pa pagesë. Megjithatë, përzgjedhja e një auditori të jashtëm të pavarur është në proces e sipër dhe pas marrjes së raportit do të ndërmerren hapat e tjerë të paraparë nga kontrata.

Emri i ndërmarrjes:	Shpezëtaria/ADI
Vendi/Komuna:	Lipjan/ Rajoni i Prishtinës
Data e fillimit të kontratës:	02 korrik 2001
Data e përfundimit të kontratës:	01 korrik 2011
Zotimet për investim:	€2,190,885.70
Zotimet për punësim:	60-112 për vitet pasuese
Qiraja vjetore:	€3,579.04

Afarizmi/Spektori: Fermë pulash dhe peshku

Ndërmarrja / Produkti:

Ndërmarrja ADI ka komercializuar ish-ndërmarrjen Shpezëtaria në Lipjan në 2001. Ferma e pulave dhe peshkut ADI merret me prodhimin e vezëve dhe rritjen e pulave. ADI ka ndërtuar gjithashtu kapacitete për rritjen e peshkut si dhe ka filluar shitjen e peshkut të freskët në treg. Vezët, pula dhe peshku shiten kryesisht në tregun kosovar.

Investimet:

Në bazë të planit të investimeve, ndërmarrjes i është dashur të investojë €1,997,000 deri në 31 dhjetor 2005, ndërsa investimet totale të zotuar për periudhën e koncesionit janë €2,191,000. Sipas raportit të auditorit të jashtëm deri në 31 dhjetor 2005, investimet arrinin në shumën €877,000.

Punësimi:

Kontrata e Komercializimit parasheh që qiramarrësi të punësojë 60 punëtorë me orar të plotë në vitin e parë të punës, ndërsa deri në fund të kontratës numri i punëtorëve nuk duhet të jetë më pak se 112. Qiramarrësi është gjithashtu i detyruar të sigurojë një vakt pa pagesë në ditë për punëtorët. Deri në fund të 2007 kompania ka raportuar për numrin e punëtorëve që është i ndryshëm nga viti në vit, megjithatë numri i përafërt i punëtorëve për këtë periudhë është 55.

Çështjet:

Gjatë vitit 2006, qiramarrësi ka paraqitur kërkesë për t'u liruar nga qiraja vjetor për periudhën kohore 2005-2006, si rezultat i gripit të shpezëve që ka ndikuar drejtpërsëdrejti mbi gjendjen financiare të ndërmarrjes duke shkaktuar humbje të mëdha financiare. Kjo kërkesë u miratua nga Bordi i Drejtorëve për një periudhë një vjetore. Megjithatë, në emër të këtyre humbjeve, që atëherë qiramarrësi nuk ka paguar detyrimet e qirasë dhe vazhdimisht ka raportuar humbje. Në mënyrë që të verifikohet informacioni i raportuar si dhe përmbushja e kushteve të Kontratës së Komercializimit, përzgjedhja e auditorit të jashtëm është në proces të auditimit për përmbushjen e kushteve nga kontrata.

Përmbledhje:

Raporti i auditorit të jashtëm për periudhën 2001-2005 paraqet mosrealizim të investimeve të parapara. Ndërmarrja nuk ka përmbushur zotimet e paraqitura në marrëveshje lidhur me numrin e punëtorëve që duhej të kishte punësuar dhe që nga viti 2006 ka raportuar humbje dhe nuk ka paguar detyrimet për qira. Pas pranimit të raportit të auditorit AKP do të ndërmarrë hapat e nevojshëm të paraparë në kontratë.

6.3 Administrimi i Drejtpërdrejtë

Njësia e Administrimit të Drejtpërdrejtë vepron brenda Departamentit të Qeverisjes së Korporatave të Agjencisë së privatizimit të Kosovës dhe ushtron veprimtarinë dhe kompetencat e saj në bazë të Ligjit mbi Agjencinë e Privatizimit të Kosovës 03/L-067, përkatësisht në bazë të neneve 5 dhe 6 të këtij Ligji.

Grupi prej (5) vetash përbëhet nga personeli i kësaj Njësie, që përbëhet nga: Drejtuesi i Njesisë, tre (3) Zyrtarë të Njesisë dhe një zyrtar ligjor i Njesisë, i cili shërben edhe si zyrtar ligjor për të gjithë Departamentin e Qeverisjes së Korporatave.

Kjo Njësi është plotësuar me staf në 18 shkurt 2009 dhe në atë kohë nën Administrim të Drejtpërdrejtë ishin 12 (dymbëdhjetë) NSH.

Gjatë kësaj periudhe dy ndërmarrje janë nxjerrë jashtë Administrimit të Drejtpërdrejtë e këto janë: NSH “18 Nëntori” në Hoqë të Madhe, Rahovec dhe NSH “Thertorja Eksportuese” Prizren. Kështu, në këtë kohë 10 ndërmarrje janë nën Administrim të Drejtpërdrejtë.

Perse një ndërmarrje vendoset nën Administrim të Drejtpërdrejtë?

Arsyet përse ndërmarrjet vendosen nën Administrim të Drejtpërdrejtë janë të shumta, por kryesoret janë më poshtë:

1. Keqpërdorim financiar,
2. Keqmenaxhim,
3. Konteste ligjore,
4. Si dhe keqpërdorime apo konteste të formave të ndryshme.

Është e nevojshme të përmendet se vendimet për ndërmarrjet që do të vendosen dhe vendimi për t’u nxjerrë jashtë Administrimit të Drejtpërdrejtë merren nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së, ndërsa propozimet për t’u vendosur nën Administrim të Drejtpërdrejtë bëhen nga Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes dhe Zyrat Rajonale të AKP-së. Njësia e Administrimit të Drejtpërdrejtë bën propozimin për ndërmarrjen të nxirret nga Administrimi i Drejtpërdrejtë nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme.

Procedurat për Administrim të Drejtpërdrejtë

1. Identifikimi i ndërmarrjeve me problemet e lartpërmendura nga Zyrat Rajonale
2. Planifikimi i Administrimit të Drejtpërdrejtë,
3. Masat e Administrimit të Drejtpërdrejtë,
4. Implementimi i Administrimit të Drejtpërdrejtë, dhe
5. Kthimi i ndërmarrjeve nën kompetencat e Zyrave Rajonale.

Detyrimet e Administrimit të Drejtpërdrejtë

1. Mbrojtja e aseteve të ndërmarrjeve,
2. Eliminimi i problemeve të ndërmarrjeve që e kanë sjellë ndërmarrjen nën Administrim të Drejtpërdrejtë,
3. Rritja e të ardhurave të ndërmarrjes,
4. Kufizimi i shpenzimeve të tepërta,
5. Rritja e vlerës së aseteve të ndërmarrjes,
6. Aranzhimi për privatizimin e cilitdo aset të ndërmarrjes që nuk ka probleme.

Raporti i hollësishëm për secilën ndërmarrje aktualisht nën administrim të drejtpërdrejtë është më poshtë:

Emri i ndërmarrjes:

Emin Duraku

Vendi/Komuna:

Gjakovë/Komuna e Gjakovës

Historiku

Ndërmarrja Shoqërore "Emin Duraku" gjendet/shtrihet në një zonë prej 16.048 ha. Ndërtesa e ndërmarrjes përfshin pjesën e prodhimit dhe hapësirën administrative, hapësirën e avulluesve, mensën e punëtorëve si dhe një pjesë oborr dhe ara rrethuese.

Kombinati është themeluar në 1957/58 fillimisht me dy departamenteve dhe më pas procesi i themelimit të departamenteve ka vijuar me krijimin e departamenteve të tjera (departamenti i tjerres, zgjerimit, rregullimin e motorëve dhe modernizimin e departamenteve të para, hapësirat e fabrikës për procesin e tharjes së materialit dhe hapësirat e qendrës mjekësore për punëtorë).

Veprimtaritë e Ndërmarrjes

Kombinati është angazhuar me prodhimin e tjerres duke përdorur pambuk si lëndë të parë, me prodhimin e të gjitha llojeve të materialeve prej pambuku që më pas finalizoheshin përmes procesit të zbardhjes, ngjyrosjes dhe përpunimit me mjetet e duhura si dhe prodhimin e lëkurave artificiale dhe produkteve që përdoren në industrinë e këpucëve, zdrukthëtari, etj.

Pas luftës, ndërmarrja nuk ka mundur të fillojë punën në aktivitetin e mëparshëm, sepse nuk ka pasur investime të duhura.

Arsyeja për ta vendosur ndërmarrjen në Administrim të Drejtpërdrejtë

Ndërmarrja u vendos nën Administrim të Drejtpërdrejtë me propozim të Bordit të Drejtorëve të AKP në 9 prill 2008.

Arsyet për ta vendosur ndërmarrjen nën Administrim të Drejtpërdrejtë kanë qenë: keqpërdorimi i menaxhimit të ndërmarrjes, shitja e makinerive për përpunimin e pambukut si hekurishte. Të gjitha departamentet/njësitë e NSH-së janë shitur si hekurishte.

Arritjet gjatë Menaxhimit e Administrimit të Drejtpërdrejtë

Që nga hyrja e masave të Administrimit të Drejtpërdrejtë gjendja është stabilizuar dhe shitja e mjeteve të ndërmarrjes është ndërprerë.

Menaxhmenti i vjetër është ndërruar dhe është zgjedhur menaxhmenti i ri. Bashkëpunimi i menaxhmentit të ndërmarrjes me Administrimin e Drejtpërdrejtë është i kënaqshëm. Është e nevojshme të përmendet se ndërmarrja nuk ka shans për revitalizim dhe për të rifilluar prodhimin për shkak të gjendjes së keqe të pajisjeve.

Gjithashtu në këtë rast, njëjtë si në shumë ndërmarrje në Gjakovë, pretendohet se kjo ndërmarrje është kompani aksionare, por nuk ka asnjë dokumentacion për një pretendim të tillë.

Pas pak kohë AKP filloi në këtë ndërmarrje procesin e mbledhjes së qirasë nga qiramarrësit ku aktualisht paguhen punëtorët dhe menaxhmenti aktual.

Punëtorët

Gjatë punës me orar të plotë të ndërmarrjes një mijë punëtorë u angazhuan. Për momentin janë të angazhuar në ndërmarrje vetëm bordi menaxhues aktual ndërsa 40 punëtorë janë nën asistencë teknike.

Çështje ligjore

Ndërmarrja "Emin Duraku" nuk ka konteste pronësore dhe pritet vetëm përcaktimi i statutit të saj. Ka disa qira të papaguara për qiradhënësit të kësaj ndërmarrjeje dhe disa paga të papaguara për ish-punëtorët.

Emri i ndërmarrjes:
Vendi/Komuna:

KBI Progres-Lavërtaria-Blegtoria-Drejtoria
Prizren / Komuna e Prizrenit

Historiku

Fillimisht, kjo ndërmarrje ka qenë pjesë e Kombinatit Bujqësor-Industrial KBI "Progres" që u themelua në vitin 1962, pikërisht NSH Lavërtaria Blegtoria, ishte themeluese e Kombinatit, për shkak të rezultatit të aktiviteteve të saj (bujqësi, fermë) në tokën e vet, brenda kombinatit janë zhvilluar ndërmarrje të tjera.

Deri në vitin 1974, ka qenë pjesë e Kombinatit, gjatë atij viti në këtë Kominat u krijua një marrëveshje e re e Organizatës së Punës së Bashkuar, ndërsa në vitin 1975 në Kombinatin e lartpërmendur ndodhi një riorganizim dhe erdhën në fuqi urdhëresë administrative të tjera, ndërsa Komuna mori përsipër kompetenca sipas vendimit të këshillit të punëtorëve, sipas vullnetit dhe marrëveshjes së punëtorëve.

Në këtë rast, nga ky Kombinat u ndanë dhe u krijuan Ndërmarrje të reja, që më vonë filluan veprimtarinë dhe punën në mënyrë të pavarur, pa ndonjë të drejtë apo detyrim ndaj Kombinatit Progres. Kjo Ndërmarrje vazhdoi të funksionojë në të njëjtën mënyrë deri në vitin 1991, kur hynë në fuqi masat e përkohshme dhe si rezultat i kësaj drejtorët u zëvendësuan dhe u sollën drejtorë të rinj, që i përkisnin kombësisë serbe. Pas luftës, kjo Ndërmarrje u riorganizua dhe filloi zhvillimin e veprimtarive të saj me shumë sukses.

Aktiviteti i Ndërmarrjes

Kjo ndërmarrje posedon në total një sipërfaqe toke prej afërsisht 600 ha që evidencohet nën emrin e ndërmarrjes. Kjo sipërfaqe toke përfshin tokë bujqësore, mjedise të ndryshme për zhvillimin e veprimtarive bujqësore dhe fermerë, Parkun e Makinerisë si dhe dy ndërtesa hoteli, "Hotel Tirana" dhe Restorant "Pojata".

Kjo sipërfaqe tokësore ka ndryshuar vazhdimisht dhe do të ndryshojë në të ardhmen për shkak të kontesteve pronësore, saktësisht kthimin e pronës tek ish-pronarët prej të cilëve toka është marrë nga Kombinati Bujqësor Industrial IAB "Progres".

Kultivimi dhe produktiviteti bujqësor dhe fermer është veprimtaria kryesore e kësaj ndërmarrjeje. Kjo ndërmarrje çdo stinë procedon 200 deri në 300 ha të tokës bujqësore. Ajo ka arritur ta mbrojë Parkun e Makinerisë, si dh të mirëmbajë makineri që shërbejnë për të zhvilluar veprimtaritë e kësaj ndërmarrjeje. Ka gjithashtu në dispozicion dy ferma për gjë të gjallë që janë në proces prodhimi, saktësisht janë të dhëna me qira.

Këto dy ferma kanë 100 deri në 150 krerë gjedhë. Edhe hapësira të tjera (stallat) janë ruajtur. Ia vlen të përmendet se një nga këto dy ferma ka shërbyer si qendër trajnimit për fermerët e rajonit të Prizrenit, projekt ky i financuar nga KFOR-i gjerman dhe që funksionon me sukses prej më shumë se 8 vjetësh.

Arsyet për ta vendosur Ndërmarrjen nën Administrim të Drejtpërdrejtë

NSH KBI "Progres" Lavërtaria-Blegtoria-Drejtoria Prizren është vendosur në Administrim të Drejtpërdrejtë me vendim të Bordit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të datës 20.07.2009.

Vendosja nën Administrim të Drejtpërdrejtë nga Agjencia ishte rezultat i elementëve të mëposhtëm:

- Shpenzimet në kesh të Ndërmarrjes nga ana e Menaxhmentit ishin ekonomikisht në mënyrë të papërshtatshme apo në bazë të standardeve të kërkuara nga banka.
- Shpenzime totale të pajustificuara, si pagat apo shpenzime të tjera.
- Konteste të shumta pronësore – ligjore.
- Probleme të shumta ndërlidhur me mbledhjen e qirasë.
- Mbrojtja dhe rritja e vlerave të Ndërmarrjes.
- Plotësimi i dokumentacionit të mjaftueshëm për përgatitjen e Ndërmarrjes për procesin e privatizimit.
- Për të shmangur keqpërdorimin e parasë së gatshme.

Arritjet gjatë Menaxhimit të Administrimit të Drejtpërdrejtë

Që nga ushtrimi i masave të Administrimit të Drejtpërdrejtë gjendja është përmirësuar dhe Ndërmarrja ka filluar të funksionojë normalisht.

Gjatë asaj kohe të gjitha shërbimet financiare janë bërë përmes bankave komerciale dhe qasja në këto llogari ka qenë kolektive, që tregon se secili transaksion apo pagesë është bërë me miratim dhe nënshkrim të personave përgjegjës nga Ndërmarrja dhe nga Zyrtari i Administrimit të Drejtpërdrejtë. Bordi dhe Menaxhmenti i Ndërmarrjes raportojnë për gjithçka dhe bashkëpunimi me Njësinë e Administrimit të Drejtpërdrejtë është në nivelin e duhur. Gjithashtu, pavarësisht shumë problemeve, mbledhja e qirasë për mjediset e përdorura të kësaj Ndërmarrjeje është rritur dukshëm si pasojë e angazhimit të Njesisë së Administrimit të Drejtpërdrejtë.

Për momentin, shumë persona që përdorin mjediset të cilat janë pronësi e Ndërmarrjes i paguajnë rregullisht detyrimet e tyre.

Për shkak të këtij bashkëpunimi dhe qasjeje pozitive nga të dyja palët, është arritur të rriten të ardhurat dhe në të njëjtën kohë të zvogëlohen dukshëm shpenzimet.

Administrimi i Drejtpërdrejtë në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të AKP në Prizren dhe menaxhmenti i ndërmarrjes kanë arritur për përgatisin disa nga asetet e kësaj ndërmarrjeje për procesin e privatizimit.

Punëtorët

Kjo ndërmarrje ka një total prej 57 punëtorësh, prej të cilëve 50 punojnë si punëtorë me orar të plotë, ndërsa të tjerët janë me asistencë dhe herë pas here thirren të punojnë.

Çështje ligjore

Rreth 80% e tokës nën pronësi të KBI "Progres" Lavërtaria-Blegtorja – Drejtorja, Prizren është krijuar nga prona private. Është me rëndësi të përmendet se e gjithë prona e NSH Lavërtaria-Blegtorja - Drejtorja ende prezantohet në emër të Kombinatit Bujqësor KBI "Progres". Ky 80% i pronës private është marrë nga persona privatë nga viti 1962 deri në vitin 1965, nga Komiteti Komunal i asaj kohë, me dhunë dhe presion të ushtruar ndaj tyre në mënyrë që ata t'ia shinin tokën Kombinatit, për një çmim të përcaktuar në mënyrë diskriminuese nga autoritetet.

Pra, pa asnjë vullnet palët janë detyruar të nënshkruajnë kontrata për transaksione pronësore. (Ky fakt është i ditur për të gjithë banorët e Prizrenit). Pothuajse të gjithë ish-pronarët kanë ngritur padi pranë Gjykatës Komunale në Prizren, e për rrjedhojë Gjykata Komunale ka nxjerrë vendime përfundimtare gjyqësore që shpallin joefektive të gjitha kontratat mes KBI "Progres", pjesë e së cilës është kjo Ndërmarrje dhe ish-pronarëve të pronës private.

Për shkak të volumit të këtyre lëndëve, Gjykata Komunale nuk ka arritur të anulojë të gjitha kontratat e transaksionit të bëra gjatë viteve 1990 dhe për këtë arsye pas luftës ish-pronarët kanë filluar të ngrenë padi për kthimin e patundshmërisë.

Për momentin ka shumë konteste pronësore-ligjore në procedurë e sipër, kryesisht padi për kthimin e patundshmërisë, si dhe konteste të iniciuara nga Ndërmarrja ndaj përdoruesve të hapësirave të ndërmarrjes, lidhur me borxhet e papaguara për qira muajore.

Emri i ndërmarrjes:

Nerezina

Vendi/Komuna:

Mushtishtë / Komuna e Suharekës

Historiku

Ndërmarrja është themeluar në vitin 1992 si fabrikë e konfeksionit dhe ka qenë fabrika e tekstilit më moderne dhe produktive në Kosovë, e pajisur me makineri moderne. NSH "Nerezina" Mushtishtë ka një sipërfaqe toke prej 3,851 m² dhe 2.12. ha që e rrethojnë fabrikën.

Më 8 shkurt 2006, Kryetari i Bordit të AKM-së miratoi kërkesën e Menaxhmentit të AKM-së/Zyrës Rajonale – Prizren për ta vendosur NSH "Nerezina" nën procedura të Administrimit të Drejtpërdrejtë nga AKM.

Arsyeja për ta vendosur Ndërmarrjen nën Administrim të Drejtpërdrejtë

NSH "Nerezina" u vendos nën masa të Administrimit të Drejtpërdrejtë nga AKM më 08.02.2006, për shkak të arsyeve të mëposhtme:

Pronësia e Ndërmarrjes është e papërkufizuar për shkak të faktit se ka tre pronarë potencialë të Ndërmarrjes.

- a) Ballkan Suharekë,
- b) Komuna e Suharekës,
- c) Zelengora Umka,

Në mënyrë që të mbrohen asetet e Ndërmarrjes deri në përcaktimin e statutit përfundimtar, Menaxhmenti i ZR/ AKM Prizren ka propozuar që NSH "Nerezina" Mushtishtë të vendoset nën masa të Administrimit të Drejtpërdrejtë.

Arritjet gjatë Menaxhimit të Administrimit të Drejtpërdrejtë

NSH "Nerezina" sigurisht është kompania e tekstilit më moderne dhe produktive në Kosovë, e pajisur me makineri moderne që në vitin 1992.

NSH i është lëshuar me qira ArtaTex dhe të ardhurat mujore janë €80. Qiramarrësi paguan rroga mujore për 20 punëtorë the NSH (€150 për secilin punëtor) në total €3,000. Marrëveshja për qira përfundon më 31 dhjetor 2009.

Pavarësisht faktit se NSH është dhënë me qira, hapësirat e ndërmarrjes sigurohen nga punëtorë të NSH-së që paguhën nga Njësia e Administrimit të Drejtpërdrejtë, shuma totale e pagesës për punëtorë është €740 në muaj.

Të ardhurat nga qiraja vendosen në llogari të veçantë deri në kohën kur Gjykata Komunale të marrë vendim.

Çështje ligjore

Ekziston një vendim gjyqësor që ka të bëjë me pronësinë e Ndërmarrjes i cili thotë se pronar i ndërmarrjes është Komuna e Suharekës.

Edhe OP "Zelengora" Umka ka dy kërkesa që kanë të bëjnë me pronësinë e NSH "Nerezina" Mushtishtë.

Njësia e Administrimit të Drejtpërdrejtë i ka bërë kërkesë Departamentit Ligjor të AKP-së lidhur me përkufizimin e statutit të kësaj ndërmarrjeje. Kërkesa është proceduar nga Departamenti Ligjor tek Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme dhe tani jemi në pritje të vendimit.

Emri i ndërmarrjes:

Qendra Kulturore Sportive Ekonomike – Pallati i Rinisë

Vendi/Komuna:

Prishtinë / Komuna e Prishtinës

Historiku

Ndërmarrja është themeluar në vitin 1976 si Organizatë Pune – Qendra Sportive dhe Shoqërore “Boro e Ramizi”. Në vitin 1999 është regjistruar si NSH “Qendra-Kulturore-Sportive-Ekonomike- Pallati i Rinisë” me numër të regjistrimit të biznesit 80096585.

Të ardhurat e Ndërmarrjes vijnë kryesisht nga qiraja, aktivitete kulturore, aktivitete ekonomike (reklama), parking dhe panaire.

NSH “Pallati i Rinisë Kulturës dhe Sporteve” ka një sipërfaqe prej 48,000 m² që përfshijnë sa më poshtë:

- Salla e Vogël
- Salla e Mundjes
- Salla e Boksit
- Salla e Pingpongut
- Salla e Gjimnastikës
- Salla e Kuqe
- Atelieja
- 117 lokale afariste
- 8 Zyra
- 8 Depo

Më 24 maj 2006, Kryetari i Bordit të AKM-së ka miratuar kërkesën nga Menaxhmenti i AKM-së / Zyra Rajonale Prishtinë për ta vendosur NSH “Qendra për Kulture, Rini dhe Sport” nën procedura të Administrimit të Drejtpërdrejtë të AKM.

Arsyeja për ta vendosur Ndërmarrjen në Administrim të Drejtpërdrejtë

Më 22 maj 2006, Drejtori Menaxhues i Ndërmarrjes i ka dorëzuar kërkesë me shkrim për ndihmë Shefit të Shtyllës IV, ku ka deklaruar se ndërhyrja nga jashtë në veprimtaritë e Ndërmarrjes ndikon në kapacitetin e saj për të menaxhuar Ndërmarrjen në bazë të udhëzimeve operationale të dhëna nga AKM dhe qeverisja e mirë që është implementuar në ndërmarrje gjatë viteve të kaluara. Fillimisht, ai i ka raportuar Zyrës Rajonale të AKM-së se po përballlet me probleme për mbledhjen e qirasë, që është përgjegjësi e anëtarëve specifikë të ekipit të tij menaxhues.

Kjo ka çuar drejt zvogëlimit të dukshëm të të ardhurave, rreth €200,000 në fillim të majit 2006. Ai ka raportuar se pritet që situatë me mbledhjen e qirasë do të përkeqësohet sepse disa nga anëtarët e Bordit Menaxhues nuk janë aq përkrahës sa kanë qenë.

Më 23 maj 2006, ZR e AKM-së ka marrë pjesë në mbledhjen e Bordit Menaxhues në mënyrë që të hulumtojnë dhe merren me vështirësitë aktuale dhe më pas kanë mësuar se 5 menaxherë e kishin bojkotuar mbledhjen dhe kishin organizuar mbledhjen e tyre. Gjatë takimit të ZR të AKM-së me Drejtorin Menaxhues dhe 4 menaxher, drejtuesit e Kuvendit të Punëtorëve shpallën se kanë aranzhuar një takim të Kuvendit të Punëtorëve për 24 maj 2006, me një pikë në rendin e ditës, e cila ishte shkarkimi i Drejtorit Menaxhues. U përgatit një shpallje me shkrim përfshirë rendin e ditës të përshkruar me hollësi dhe ku citohej se Drejtori Menaxhues akuzohej për gabime, shkelje të ligjit etj. Për më tepër, kjo shpallje bënte të ditur se Kryetari i Komunës së Prishtinës duhej të merrte pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Punëtorëve.

Kryetari i Komunës kishte kërkuar më herët që Ndërmarrja të kthehej nën kontrollin e Komunës dhe se pjesëmarrja e tij në mbledhjen e Kuvendit të Punëtorëve, ku propozohej shkarkimi i Drejtorit Menaxhues aktual, duhej të shihej si mbështetje e këtij propozimi.

Arritjet gjatë Menaxhimit të Administrimit të Drejtpërdrejtë

Njësia e Administrimit të Drejtpërdrejtë të AKP-së ushtron menaxhim të drejtpërdrejtë në Ndërmarrje në mënyrë që të mbrojë dhe rrisë vlerën, aftësinë dhe qeverisjen e korporatës së Ndërmarrjes.

Departamenti i Administratës Qendrore – Të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me burime njerëzore menaxhoheshin nga departamenti ligjor i Ndërmarrjes. Për momentin, ndërmarrja ka 125 punëtorë të regjistruar, prej të cilëve pesë janë me pushim me pagesë dhe marrin 50% të pagës së tyre.

Aktivitetet e Burimeve Njerëzore që kryhen nga Administrimi i Drejtpërdrejtë kanë përfshirë skemën organizative të procesit të ristrukturimit, amendamentimin e kontratave të të gjithë punëtorëve në përputhje me Ligjin e zbatueshëm mbi Punën në Kosovë, rishikimin e detyrave të personelit dhe freskimin e përshkrimit të vendeve të punës. Ekziston një projekt që përfshin përmirësimin në lëmin e teknologjisë informative si rezultat i të cilit të gjitha pajisjet e teknologjisë informative janë zëvendësuar me versione më të reja dhe brenda atij programi janë në vijim e sipër kurse për kompjuter dhe gjuhë angleze të organizuara për punëtorët. Struktura administrative përkatëse është modifikuar ngadalë në mënyrë që të pasqyrojë gjendjen aktuale dhe sfidat në të ardhmen për Qendrën e Rinisë dhe Sportit.

Gjendja financiare e ndërmarrjes – Duhet të theksohet se 90% e të ardhurave të NSH vijnë nga mbledhja e qirasë. Lista me çmimet e reja të qirave është rritur për 20% dhe kjo listë është paraqitur në shkurt 2009 kur u bë rinovimi i kontratave për qira. Qëllimi i rritjes së çmimit ishte rregullimi i qirasë drejt tregut aktual dhe krijimi i fondeve që do të përdoren për investime për përmirësimin e cilësisë së shërbimit si dhe për investime të mëtejshme në planifikim, kryesisht në fushën e mirëmbajtjes.

Janë bërë shumë përpjekje sa i përket rritjes së të ardhurave nga aktivitete të tjera reklamuese, si për shembull përmes panairove tregtare.

Njësia Kulturore – Bashkë me përqindjen e programeve të përfunduara, përkatësisht aktiviteteve të realizuara për vitin 2009 janë si vijon:

1) Programe Kulturore	65%
2) Programe Ekonomike	10%
3) Programe promovuese, humanitare dhe akademike	25%

Njësia e aktiviteteve sportive – Aktivitetet sportive që kanë ndodhur gjatë asaj periudhe kohore janë si vijon:

1) Trajnime në sallën e vogël	2,600 treningë
2) Lojëra në Sallën e Vogël	400 lojë
3) Trajnime në sallat e ushtrimeve	3,070 ushtrime

Gjatë kësaj periudhe kohore janë organizuar shumë kampionate kombëtare dhe ndërkombëtare në hendboll, boks, ping-pong, karate, basketboll, volejboll, mundje, xhudo etj.

Të gjitha këto aktivitete kulturore, sportive, rinore dhe edukative zhvillohen në Qendër pa kompensim për hir të bashkëpunimit me institucione komunale dhe qeveritare, si dhe për arsye të të qenit përkrahës për rininë në përgjithësi.

Aktivitetet të Departamentit Teknik (Mirëmbajtja) - Pjesa më e madhe e mirëmbajtjes dhe punës riparuese tani bëhet nga personeli i brendshëm. Kjo gjë ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi zvogëlimin e shpenzimeve të panevojshme përmes kontratave me palë të treta. Gjithashtu, shërbimi i cilësisë ndaj qiramarrësve është përmirësuar dhe është krijuar një formular për kërkesa të shërbimeve.

Mbrojtja dhe Aktivitetet të Sigurimit – Mbrojtja dhe gjendja e sigurisë është përmirësuar dukshëm. Qendra monitoruese video-digjitale, përfshirë edhe pajisje të tjera të sigurisë (sisteme të ndryshme alarmi) janë në funksion dhe mirëmbahen e kontrollohen me shumë saktësi.

Çështje ligjore

Konteste gjyqësore mes përdoruesve të depove dhe NSH "Qendra e Rinisë, Sportit dhe Kulturore", lënda kur pjesë e objektit të Ndërmarrjes është djegur në vitin 2000, nga qiramarrësit. Kontesti gjyqësor mes 16 depoistëve (paditësit) dhe NSH "Qendra e Rinisë, Sportit dhe Kulturore" (të paditurit) arrin vlerën prej €5,300.000 dhe kjo lëndë i është deleguar Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme.

Emri i ndërmarrjes:

Unimont

Vendi/Komuna:

Prizren / Komuna e Prizrenit

Historiku

Ndërmarrja është themeluar në vitin 1978 si Organizatë Pune për Montim dhe Ndërtim "Unimont" Prizren. Në vitin 1989 transformimet e Ndërmarrjes nga Organizatë Pune në Ndërmarrje Shoqërore të Montimit dhe Ndërtimit "Unimont" Prizren.

Aktivitetet e ndërmarrjes kryesisht kanë të bëjnë me prodhimin e llojeve të ndryshme të elementeve prej betoni, parafabrikate nga betoni për salla, ferma dhe objekte të tjera të parafabikuara (me objekte ndërtimore të larta), prodhimin dhe shfrytëzimin e zhavorrit, prodhimin e materialeve prej bitumenit, përgatitjen e ngastrave për ndërtim, ndërtimin e objekteve për ndërtim të rrugëve, projekte të tjera nga aktivitetet e saj si, transportimin e mallrave përmes mjeteve të transportit rrugor, ndërtimin e objekteve të hidro-konstruksioneve si dhe aktivitete të tjera inxhinierie.

Për shkak të gjendjes së vështirë financiare dhe përgjegjësi të mëdha ndaj furnizuesve, NSH "Unimont" e ka ndërprerë aktivitetin prodhues deri në privatizimin e kësaj NSH.

NSH Unimont ka asetet vijuese:

Njësi punuese në Krusha e Vogël (njësi për asfalt, dy njësi për beton, separacion, fabrikë për prodhimin e gypave dhe elementeve prej betoni); Park Makineri me 2.67 ha dhe objekt administrativ me 560 m².

Më 21 shtator 2006, Kryetari i Bordit të AKM-së miratoi kërkesën nga Menaxhmenti i AKM / Zyra Rajonale Prizren për ta vendosur NSH "Unimont" nën Administrim të Drejtpërdrejtë të AKM.

Arsyet për ta vendosur ndërmarrjen nën Administrim të Drejtpërdrejtë

Në qershor 2006 menaxheri i përgjithshëm ndërroi jetë. Që atëherë ka pasur mungesë të menaxhmentit të duhur të NSH-së. Ish-menaxheri i përgjithshëm mori me vete shumë sekrete që kishin të bënin me marrëveshje mes furnizuesve dhe klientëve. Për më tepër, NSH mbeti me një hipotekë ndaj ABU dhe shuma e papaguar është €1.1 milion. Hipoteka është e zbatueshme ndaj të gjitha aseteve të NSH, përfshirë dhe patundshmërisë që është aset kryesor i NSH.

Një delegacion i punëtorëve të NSH ka diskutuar çështjen me ZR të AKM në Prizren ku kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me realizimin e aseteve të NSH dhe gojarisht u kërkua që NSH të vendoset nën Administrim të Drejtpërdrejtë.

Kjo kërkesë u konfirmua përmes kërkesës me shkrim më 8 gusht 2006. Gjithashtu, ka edhe palë të treta që po përdorin pajisje të lëvizshme (tundshme) të NSH.

Arritjet gjatë Menaxhimit nën Administrim të Drejtpërdrejtë

Ndërmarrja është e specializuar për punë ndërtimore që përbëhen nga disa produkte/linja prodhuese si: ndarja e zhavorrit në dy njësi, njësia për presimin e gurëve për prodhim të asfaltit, prodhimi i betonit në dy njësi, prodhimi i shtyllave të betonit Fi100-150mm, prodhimi i konstruksioneve të betonit për ndërtesa industriale dhe ferma, si dhe prodhimi i asfaltit me bazë "Gradis".

UNIMONT ka një kontratë qiraje, marrëveshja skadon në fund të vitit 2009. Marrëveshja me NSH dhe qiramarrësit për bazën e asfaltit, për dy baza të betonit, për fabrikën e prodhimit të gypave, elementeve të betonit si dhe hapësirës administrative. Nga të ardhurat nga qiraja, NSH paguan 130 punëtorë të Ndërmarrjes.

Për shkak të disa vështirësive të gjitha aktivitetet kryesore të NSH janë ndërprerë dhe 80 punëtorë janë me asistencë teknike dhe janë informuar me kohë për këtë.

Administrimi i Drejtpërdrejtë i AKM-së ka caktuar dy persona kontaktues të cilët raportojnë dhe bashkëpunojnë me Zyrat e përgjegjës çdo ditë.

Çështje ligjore

Ka dy konteste që kanë të bëjnë me këtë Ndërmarrje. Për momentin ekziston një Detyrim nga një organizatë mikrofinanciare e quajtur ABU, e cila ka bërë marrëveshje për të financuar Ndërmarrjen de ata kanë marrë Makineri të Ndërmarrjes si kolateral. Gjithashtu ka edhe dy detyrime të tjera që janë paraqitur nga Furnizuesit. Pavarësisht faktit se disa nga kontestet janë në fazën fillestare të procedurës shpresojmë se këto konteste do të zgjidhen. Zyrat e Ligjor i Njësisë së Administrimit të Drejtpërdrejtë është angazhuar në këto raste që kanë të bëjnë me detyrimin kreditor të Ndërmarrjes drejt ABU.

Emri i ndërmarrjes:
Vendi/Komuna:

Vreshtaria
 Landovicë / Komuna e Prizrenit

Historiku

Në fillim kjo Ndërmarrje ishte pjesë e Kombinatit Bujqësor – Industrial KBI - “Progres” që është themeluar në vitin 1962.

Në vitin 1962 Kombinati përbëhej kryesisht nga 10 (dhjetë) ndërmarrje që ishin pjesë e Kombinatit “Progres” dhe një prej tyre është NSH “Vreshtaria” Landovica.

Si rezultat i kësaj strukture rreth 80% e tokës që posedon KBI “progres” është krijuar nga prona private. 80% e pronave private janë marrë nga viti 1962 deri 1965.

Në vitin 1992, NSH “Vreshtaria” u bashkua me NSH “Kosovavera” dhe ata kanë vazhduar të funksionojnë në atë mënyrë deri në qershor të vitit 2002.

Në qershor 2002, NSH “Vreshtaria” është regjistruar si njësi ligjore e ndarë nga NSH “Kosovavera” dhe ata kanë hapur një llogari bankare me emrin e Ndërmarrjes.

Ndërmarrja Shoqërore – NSH “Vreshtaria” ka 4 (katër) vreshta, me një sipërfaqe totale prej 1,000.00 ha. Vreshtat gjenden në katër zona të ndryshme si Landovica, Arbanasi i Epërm, Uji i Bardhë, Pirana dhe Tarazhda e Mamushës.

Për shkak të gjendjes së vështirë financiare, NSH “Vreshtaria” ka ndërprerë aktivitetin prodhues deri në momentin e privatizimit të Ndërmarrjes.

Më 14 qershor 2004, Kryetari i Bordit të AKM-së ka miratuar vendimin kërkesë të menaxhmentit të AKM / Zyrës Rajonale Prizren për ta vënë NSH - “Vreshtaria” nën procedura të Administrimit të Drejtpërdrejtë të AKM-së.

Arsyet për ta vendosur ndërmarrjen nën Administrim të Drejtpërdrejtë

Problemet e ndërlidhura me çështjen ligjore me Kosovavera dhe shumë konteste të tjera ligjore. Për shkak të mungesës së burimeve financiare, vreshtat me sipërfaqe rreth 1000 hektarë nuk mirëmbahen.

Arritjet gjatë menaxhimit të Administrimit të Drejtpërdrejtë

NSH “Vreshtaria” ka një marrëveshje qiraje për tokën bujqësore e cila është në Prizren në vendin e quajtur “parcela Belloshe” me sipërfaqe 50 hektarësh dhe marrëveshje qiraje për stallën e lopëve që gjendet në hapësirën e NSH “Vreshtaria” Landovica KK Prizren.

Në mënyrë që të mbrohen asetet nga dëmtimi dhe për të ofruar mbrojtje të përhershme për vreshtat nga çfarëdo pale dëmtuese, Administrimi i Drejtpërdrejtë i AKP-së ka marrë në punë 19 roje të NSH dhe koordinatorin e ndërmarrjes i cili në të njëjtën kohë përgatit listën e asetëve që kërkohen nga Njësia e Administrimit të Drejtpërdrejtë të AKP. Njëzetë punëtorë të kësaj ndërmarrjeje paguhën nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Njësia e Administrimit të Drejtpërdrejtë në koordinim me ZR në Prizren po punojnë për të sqaruar situatën me kontestet ligjore ndërsa asetet e ndërmarrjes për të cilat nuk ka konteste mund të privatizohen.

Çështjet ligjore

Shumë konteste kanë të bëjnë me verifikimin e pronësisë sepse kjo ndërmarrje në të kaluarën ka qenë pjesë e KBI “Progres”. Aktualisht, në procedurë e sipër janë shumë konteste pronësore – ligjore, shumica padi për kthimin e patundshmërisë.

Emri i ndërmarrjes:

Artizanati-Kosovarja

Vendi/Komuna:

Prishtinë / Komuna e Prishtinës

Historiku

Ndërmarrja është themeluar në vitin 1980 si organizate pune "Artizanati Shtëpiak- Kosovarja". Deri në vitin 1988 kur u ndërtua qendra e re tregtare në Fushe Kosovë, të gjitha aktivitetet e kësaj ndërmarrjeje janë zhvilluar në Prishtinë.

Me kohë, NSH Artizanati-Kosovarja u transformua disa herë dhe mori emra të ndryshëm.

Brenda pronës së "pohuar", kjo Ndërmarrje përfshin mjedise në zonën e Larishtës. Rr. Tirana nn, me sipërfaqe 500 m² dhe qendrën tregtare në Zonën Industriale në Fushe Kosovë me sipërfaqe 0.26.00 hektar.

Arsyet për ta vendosur ndërmarrjen nën Administrim të Drejtpërdrejtë NSH "Artizanati-Kosovarja" me një rezolutë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit – AKM u vu nën Administrim të Drejtpërdrejtë më 20.06.2006 duke theksuar arsyet vijuese:

- Ruajtja e vlerës së objekteve
- Mundësia e gjetjes së dokumentacionit në bazë të të cilit do të vërtetonim pronësinë dhe
- Konsiderimin së paku të ndihmës sociale për punëtorët.

Arritjet gjatë Menaxhimit të Administrimit të Drejtpërdrejtë

Që nga vendosja e masave të Administrimit të Drejtpërdrejtë është arritur të shmanget shkatërrimi dhe dëmtimi i mëtejshëm i kësaj ndërmarrjeje.

Kjo i ka paraprirë kontratës së nënshkruar mes NSH Kosovarja-Artizanati dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për të marrë me qira ndërtesën e ndërmarrjes që gjendet në lagjen Lakërishte, Rruga Tirana, p/n me sipërfaqe 500 m² në shumën €3.000 në muaj nga 01.07.2006 deri në 01.07.08 që është shtyrë për më shumë se një vit deri në 01.07.2009, kur pritet që të zgjatet kontrata edhe për këtë vit, meqë nuk ka njoftim paraprak për ndërprerje të kontratës.

Punëtorët

Ndërmarrja Shoqërore NSH Artizanati-Kosovarja aktualisht ka 16 punëtorë që paguhen çdo muaj dhe pagat e tyre sigurohen nga Marrëveshja për Qira që ndërmarrja ka me Ministrinë e Punëve të Brendshme sikurse përmendet më lart.

Çështje ligjore

Lidhur me çështjet ligjore në bazë të dokumentacionit të paplotë që kemi dhe pamundësisë për të përcaktuar statusin e ndërmarrjes, ne i kemi drejtuar një kërkesë Zyrës Ligjore për rishikim dhe sqarim të përcaktimit të statusit, përkatësisht të ardhmes së ndërmarrjes.

Presim përgjigje nga Zyra Ligjore dhe pastaj do të ndërmarrim hapat e mëtejshëm në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në bazë të të cilave punon Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Emri i ndërmarrjes:
Vendi/Komuna:

Rekreaturs
Prishtinë / Komuna e Prishtinës

Historiku

NSH "Rekreaturs" si Ndërmarrje Shoqërore në 1957, bleu një sipërfaqe prej 3.3 ha tokë në vendin e quajtur Kamenovo. Kjo Ndërmarrje ishte bashkëpronare e asaj toke së bashku me dy ndërmarrje të tjera nga Kosova.

Asetet e Ndërmarrjes kryesisht shërbejnë si vendpushim për punëtorët kosovarë.

- Prishtina – lokale biznesi (zyra) me sipërfaqe 100 m²
- Vendpushim në Kamenovo, Republika e Malit të Zi me sipërfaqe prej 3.31,00 ha pronë në pjesën më elitare të Rivierës së Shën Stefanit – vend turizëm dhe ndërtesë biznesi me kapacitet 2000 m² dhe infrastrukturën e saj.
- Në Ulqin, një vendpushim që është rrënuar në vitin 1982, kapaciteti i të cilit ka qenë 700 apartamente – hotel i kategorisë B me 2,000 shtretër.

Arsyet për vendosjen e ndërmarrjes nën Administrim të Drejtpërdrejtë

Më 20/03/2008 kjo Ndërmarrje u vu nën Administrim të Drejtpërdrejtë sepse Drejtori i Ndërmarrjes e shpërdoroi detyrën e tij zyrtare, konkretisht paraqiti dokumentacion të falsifikuar mbi pronësinë e Ndërmarrjes.

Gjithashtu, arsyeja për ta vendosur nën Administrim ishte shitja e përqindjes së aksioneve të kësaj Ndërmarrjeje nga drejtori, pa miratimin paraprak nga AKM.

Arritjet gjatë Menaxhimit nën Administrim të Drejtpërdrejtë

Gjatë Administrimit të kësaj Ndërmarrjeje, AKP arriti të krijojë një ekip të zyrtarëve ligjorë që të përfaqësonin së paku interesat më të mira të kësaj ndërmarrjeje para Gjykatës Supreme të Malit të Zi. Është hartuar një ankesë ndaj vendimit të Gjykatës së Malit të Zi; vendim që është marrë me paragjykim ndaj Ndërmarrjes Shoqërore.

Punëtorët

Sipas letrës së Drejtorit të NSH "Rekreaturs" drejtuar AKM-së, më 11.09.2003 të punësuar pranë kësaj Ndërmarrjeje ishin 4 punëtorë (3 në Prishtinë dhe 1 në Kamenovo).

Çështjet ligjore

Lidhur me problemet ligjore, Ndërmarrja kryesisht po përballet me statusin e saj ligjor dhe pronën që ndodhet jashtë territorit të Kosovës, përkatësisht në Mal të Zi. Edhe pse nga dokumentacioni shihet qartë se baza ligjore e kësaj pronësie është e dukshme, si gjithnjë ka ekzistuar në emër të NSH "Rekreaturs", Gjykata e Malit të Zi është vënë në lajthim nga veprimet e strukturave paralele të Ndërmarrjes në Mal të Zi. Në 1999 menaxhmenti i asaj kohe i Ndërmarrjes siguroi leje nga gjykata Paralele e Prishtinës me vendndodhje në Krlevë për ta regjistruar Ndërmarrjen në Mal të Zi.

Për shkak të këtij veprimi, Ndërmarrja është privatizuar në Mal të Zi dhe është regjistruar nën emrin e blerësit të quajtur "Atlas Group". Pas këtij veprimi përfaqësues të Ndërmarrjes në Prishtinë reagues dhe iniciuan procedurë ligjore në Mal të Zi për të anuluar regjistrimin e Ndërmarrjes në Mal të Zi. Lidhur me këtë iniciim të procedurës nga Ndërmarrja në Prishtinë, Gjykata e Malit të Zi ka filluar të rishikojë rastin.

Lidhur me këtë lëndë kontestuese, AKM ka mbledhur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në bazë të kërkesave të Gjykatës.

Për momentin pranë Gjykatës Supreme të Malit të Zi po zhvillohet lëndë kontestuese. Problemi kryesor i këtij kontesti është mosnjohja e legjitimitetit të AKP-së; Zyrtarët Ligjorë të AKP-së po përgatisin një strategji për përfaqësim më të mirë dhe mbrojtje të pronës së Ndërmarrjes.

Emri i ndërmarrjes:

Sharr-Sallonit

Vendi/Komuna:

Hani i Elezit / Komuna e Hanit të Elezit

Historiku

Lidhur me statusin e Ndërmarrjes Shoqërore të 28/11/1989 dhe nga regjistrimi në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë dt. 21/12/2009 ky entitet Fi. 605/89, dt. 21.12.1989 SOEPCM "Sharr" ka qenë Ndërmarrje Shoqërore në 1989 (në mars 1989 ky entitet ende ishte Organizatë Vepruese).

Neni 1 i statusit të Ndërmarrjes Shoqërore të 28/11/1989 thotë se Organizata Vepruese për prodhimin e materialit ndërtimor "Sharr" nga Hani i Elezit është transformuar në Ndërmarrje Shoqërore. Numri total i punëtorëve në NSH Sharr-Sallonit në 1989 ishte 309.

Sot, entiteti vepron në katër njësi, përkatësisht katër Ndërmarrje Shoqërore të ndara nga njëra-tjetra (që nga 1999):

1. "Sharr Cement" - GJI042
2. "NP "Silcapori" - GJI040
3. KAP "Sharr-Salloniti" - GJI039 dhe
4. FGG "Lepenci" – GJI038

Vendndodhja e Ndërmarrjes përbëhet nga 9.70 HA tokë, si dhe ndërtesa të tjera shtesë ku gjenden zyrat e administratës, depoja dhe ndërtesa ku ndodhet Dogana e Kosovës – Terminali Hani i Elezit.

Që nga viti 1999 në NSH Sharr-Salloniti gjendet Terminali i Doganave për portin Kosovë/Maqedoni dhe të gjitha shërbimet shoqërore të terminalit kryhen këtu si hyrjet, daljet, si dhe aspektet e tjera teknike.

Mbikëqyrja dhe aktivitetet teknike lidhur me mirëmbajtjen e terminalit bëhen nga Menaxhmenti dhe punëtorët e NSH Sharr-Salloniti që paguhen gjithashtu nga të ardhurat e terminalit dhe nga ndërtesat e marra me qira për shërbime të ndryshme, si zyrat e shpeditonit, bankat, etj.

Arsyet për vendosjen e Ndërmarrjes nën Administrim të Drejtpërdrejtë Me vendim të Bordit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dt. 20.06.2006, NSH Sharr-Salloniti shkoi nën Administrim të Drejtpërdrejtë.

Kjo masë erdhi si rezultat i elementëve vijues të shpallur:

- Shpenzimi i papërshtatshëm i parave të NSH nga Menaxhmenti mbi baza ekonomike dhe mbi baza të standardeve të kërkuara bankare.
- Shpenzimet detyimore të pajustificuara, si për paga dhe shpenzime.
- Çështja e ndotjes nga Azbest Çimentoja prej ku Ndërmarrja largonte materiale të rrezikshme (që është bërë tashmë).
- Për të ruajtur dhe forcuar vlerën e ndërmarrjes.
- Për të mbledhur dokumentacionin e nevojshëm për ta përgatitur Ndërmarrjen për privatizim.
- Për të shmangur keqpërdorimin e parasë së gatshme.

Arritjet gjatë Menaxhimit të Administrimit të Drejtpërdrejtë

Që nga aplikimi i masave të Administrimit të Drejtpërdrejtë gjendja është qetësuar dhe Ndërmarrja ka filluar të funksionojë normalisht dhe kjo ka treguar përmirësime nga viti në vit. Që atëherë të gjitha shërbimet financiare janë bërë përmes bankave të biznesit dhe qasja në këto llogari ka qenë kolektive, që do të thotë se secili transaksion apo pagesë është bërë me miratim dhe nënshkrim të personit përgjegjës në Ndërmarrje dhe Zyrtarit të Mbikëqyrjes së Drejtpërdrejtë.

Bordi dhe Menaxhmenti i NSH raporton për gjithçka dhe bashkëpunon me Njësinë e Administrimit të Drejtpërdrejtë në nivelin e duhur.

Për shkak të këtij bashkëpunimi dhe qasjes pozitive nga të dyja palët, është realizuar rritje e të ardhurave dhe në të njëjtën kohë ka zbritje të dukshme të shpenzimeve.

Duke parë stabilizimin e Ndërmarrjes në çdo aspekt dhe rritjen e të ardhurave nga aktivitete të ndryshme, në 2009 kanë filluar projekte të ndryshme me rëndësi të madhe për terminalin doganor dhe për vetë Ndërmarrjen.

Punëtorët

Në ndërmarrjen shoqërore NSH Sharr-Salloniti vërehet një numër i punëtorëve të rregullt, i atyre me asistencë sociale dhe ndihmë që iu jepet familjeve të heronjve të luftës dhe martirëve të luftës.

Më poshtë paraqesim situatën aktuale për të gjitha kategoritë:

- Punëtorët e rregullt janë 152
- Me asistencë sociale 83
- Ndërsa 23 janë në listën e personave të zhdukur, vrarë ose që kanë vdekur pas lufte.

Çështje ligjore

Në ndërmarrjen shoqërore NSH Sharr-Salloniti, çështjet ligjore me të cilat merren juristët e ndërmarrjes në bashkëpunim me këshilltarin ligjor nga njësia për Administrimit të Drejtpërdrejtë kanë kryesisht të bëjnë me padi nga punëtorë ose ish-punëtorë për kompensim me mjete financiare për kinse shkelje të të drejtave të tyre nga ana e ndërmarrjes.

Emri i ndërmarrjes:

Virxhinia

Vendi/Komuna:

Gjakovë/Komuna e Gjakovës

Historiku

Ndërmarrja Shoqërore NSH "Virxhinia" deri në 1989 ka qenë pjesë e KBI "Ereniku.

Më vonë ndërmarrja u quajt Ndërmarrja Shoqërore për Mbledhjen dhe Përpunimin e Tobacco Virxhinia, Gjakovë.

Sipas dokumentit të Fl. 5347/91 (regjistrimi i transformimit) ata pretendojnë se ata e transformuan në Shoqëri Aksionare "Virxhinia."

Kjo situatë e paqartë ka vazhduar deri në vitin 1999 dhe është rihapur kur kompania po përgatitej për privatizim në vitin 2007.

Kompania ka një sipërfaqe prej 13,015 hektarësh, përfshirë tokë ndërtimore dhe ndërtesa administrative si dhe infrastrukturë industriale.

Arsyeja për ta vënë ndërmarrjen në Administrim të Drejtpërdrejtë

NSH "Virxhinia" është miratuar për privatizim nga Bordi i AKM-së në valën e 27-të më 07 qershor 2007. më të gjitha përgatitjet për privatizim të kësaj ndërmarrjeje, kjo nuk ndodhi sepse menaxhmenti i kompanisë u ankua se "Virxhinia" ishte transformuar në kompani aksionare në 1991 dhe privatizimi i kësaj ndërmarrjeje nuk ishte i vlefshëm.

Pas kësaj menaxhmenti është ftuar të sigurojë dokumentacion për transformim të pohuar, por menaxhmenti nuk ka siguruar dokumentacionin e nevojshëm.

për shkak të refuzimit të bashkëpunimit me AKM, ndërmarrja është vënë nën Administrim të Drejtpërdrejtë që më 14.01.2008.

Arritjet gjatë Menaxhimit të Administrimit të Drejtpërdrejtë

Që nga vendosja e Ndërmarrjes nën Administrim të Drejtpërdrejtë, ka pasur hezitim nga ana e Menaxhmentit për bashkëpunim me Administrimin e Drejtpërdrejtë me qëllim të bllokimit të punës. Me kohë, është arritur relaksimi i këtyre marrëdhënieve dhe bashkëpunimi është krijuar për të gjetur një zgjidhje për problemet aktuale dhe si të arrihet dhe tejkalohet situatë dhe të sqarohet e ardhmja e Ndërmarrjes.

Bashkëpunimi është krijuar mes AD dhe Ndërmarrjes me anë të të cilit është arritur qasje në llogaritë bankare të ndërmarrjes, kontroll të financave dhe regjistrimi i aseteve të ndërmarrjes po vijon.

Punëtorët

Në ndërmarrjen shoqërore "Virxhinia" ka 35 punëtorë aktivë, 50 janë me asistencë sociale. Menaxhmenti pretendon se ka 192 aksionarë.

Çështje ligjore

Ndaj qiramarrësit është ngritur vetëm një padi dhe lënda është e hapur.

6.4 Minierat e Trepçës

Trepça është konglomerat në rajonin e Mitrovicës me asete dhe degë tjera të shpërndara në rajone të ndryshme të Republikës së Kosovës dhe ish-Jugosllavisë. Në të kaluarën ka qenë një prej ndërmarrjeve më të mëdha të ish-Jugosllavisë që në një periudhë ka pasur mbi 20,000 punëtorë.

Konglomerati Trepça ka tri elemente kryesore: minierat, parkun industrial të Mitrovicës dhe kompleksin e shkrirjes së metaleve në të cilin është themeluar konglomerati. Gjithashtu ka aktivitete të shumta përcjellëse për të cilat në proces përdoren plumbi, zinku, kadmiumi ose argjendi. Si tërësi, përfshihen rreth 41 vendndodhje duke përfshirë një numër të tyre që gjenden jashtë Republikës së Kosovës. Në aspektin politik, ekonomik dhe shoqëror ndërmarrja ka rëndësi të madhe për Kosovën dhe të gjitha komunitetet; megjithatë si partnerë kryesor mund të konsideron palët në vijim:

- Kreditorët dhe pronarët,
- Menaxhmenti dhe punëtorët e Trepçës,
- Qeveria e Republikës së Kosovës,
- Donatorët.

Historik i shkurtër dhe zhvillimet e fundit në Trepçë

Aktivitetet e minierës së Trepçës kanë funksionuar që nga kohërat e lashta (kanë qenë të njohura edhe në kohën e Romakëve). Të dhënat e fundit të historisë tregojnë se kompania britanike Seltrust ka themeluar një industri moderne gjatë viteve 1930 në afërsi në Mitrovicës dhe bateritë e Trepçës kanë qenë një burim i rëndësishëm gjatë Luftës së Dytë Botërore. Që nga atëherë Trepça ka pasur një periudhë të rritjes masive gjatë viteve 60'-të dhe 70'-të kur janë themeluar industritë përcjellëse dhe mbi 20,000 njerëz janë punësuar. Gjatë viteve 1990, Trepça ka kaluar në një numër transformimesh të dyshimta. Me 1989, Kombinati Trepça ka qenë konglomerat i ndërmarrjeve të pavarura që si trup kryesor kanë pasur njësinë Trepça Plumb & Zink. Para vitit 1989, Kombinati i Trepçës ka centralizuar disa funksione (sikurse financat, blerjet, shitjet dhe kontrollin e kualitetit) dhe entitetet që kanë qenë pjesë e konglomeratit kanë mbajtur personalitetin e tyre ligjor të pavarur. Prej 27 ndërmarrjeve që kanë qenë pjesë e konglomeratit të Trepçës, 26 kanë qenë të regjistruara në Gjykatën Ekonomike dhe /ose statuse që tregojnë se ato kanë qenë NSH në vitin 1989 ose kanë qenë organizata të punës në proces të transformimit në NSH. Përfshirja e vetëm është Banka e Trepçës (Institucion Financiar).

Gjatë dhjetorit 1989 një Marrëveshje për Integrim është nënshkruar nga 26 NSH-të dhe 1 Organizatë Financiare. Me 10 janar 1990 Gjykata Ekonomike ka regjistruar marrëveshjen e 26 NSH-ve dhe 1 organizate financiare. Sipas kësaj marrëveshjeje të re ndërmarrjet kanë mbajtur personalitetin ligjor dhe një seri e funksioneve thelbësore janë centralizuar në Kombinatin e Trepçës, sikurse janë: financat, kërkimet, blerjet dhe shitjet. Përkundër centralizimit funksioneve thelbësore, mund të merret parasysh se në 1989 kombinati i Trepçës ka qenë një grup i NSH-ve të pavarura me biznesin thelbësor Trepça Plumb & Zink, megjithatë Marrëveshja për Integrim nuk ka ndryshuar statusin e ndërmarrjeve.

Me 1990 Qeveria e Serbisë ka paraqitur masat e dhunshme në 14 prej 19 kompanive që i përkisnin grupit Trepça në atë kohë. Masat e dhunshme ka rezultuar me largimin dhe zëvendësimin e menaxherëve Shqiptar me ata Serb dhe me anulim të funksionit të Këshillave të Punëtorëve të kompanive, këshille që kanë qenë organ mbikëqyrëse të Ndërmarrjes. Kjo ka dërguar tek protestat me shtrirje të gjerë dhe greva të punëtorëve që si pasojë kanë pasur humbjen e vendit të punës në periudhën 1990-1992.

Me 22 nëntor 1991, 19 ndërmarrje që i takonin grupit Trepça (18 NSH dhe 1 organizatë financiare) janë bashkuar në NSH Kombinati Trepça. Ndërmarrjet që kanë mbetur, 8 prej tyre, kanë mbajtur pavarësinë e tyre.

Në përputhje me shqyrtimin ligjor dhe analizat e dokumentacionit të disponueshëm për agjencinë paraprake – Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) , NSH Kombinati i Trepçës është transformuar nga NSH-ja në SH.A. me 11 nëntor 1992 dhe çështja rreth ligjshmërisë së këtij transformimi është dërguar tek Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës. Sipas Rregullores së AKM-së (me ndryshime), kur një ndërmarrje i nënshtrohet transformimit, një transformim i tillë nuk do të ndikojë në të drejtat dhe kompetencat e AKM-së nën paragrafët 6,8 dhe 9 të Rregullores, që është poashtu rast identik sipas Ligjit për themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) si pasardhëse ligjore e AKM-së.

Ndërmarrjet që kanë marrë pjesë në bashkimin “Ndërmarrjet e Bashkuara” janë:

- Fabrika e Baterive, Pejë
- Fabrika e Rimorkiove, Mitrovicë
- Metalurgjia e Zinkut, Mitrovicë
- Industria kimike, Mitrovicë
- Fabrika e Baterive, Mitrovicë
- Trepça Commerce, Zveçan
- Trepça Standard, Zveçan
- Metalurgjia e Zinkut, Zveçan
- Trepça Trans, Zveçan
- Qendra elektronike llogaritare, Zveçan
- Laboratori Trepça, Zveçan
- Sigurimi i pronës, Zveçan
- Miniera dhe flotacioni Stan Tërg dhe Tuneli i Parë, Mitrovicë
- Miniera dhe flotacioni Kizhnicë dhe Novo Bërdë, Prishtinë
- Instituti Trepça, Zveçan
- Instituti Shëndetësor, Zveçan
- Banka e Trepça, Zveçan
- Minierat dhe flotacioni, Leposaviq
- Energjetika, Zveçan

Asetet e të gjitha ndërmarrjeve të lartpërmendura janë plotësisht ose në masë të madhe të vendosura brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Ndërsa ndërmarrjet që nuk kanë marrë pjesë në këtë bashkim janë:

- Famipa Metal dhe Fabrika e produkteve të plastikës në Prizren, Kosovë
- Fabrika e municionit për gjueti, Skenderaj, Kosovë
- Metaliku Industria e Metaleve, Gjakovë Kosovë
- Llamkos, prodhimi i metalit të galvanizuar, Vushtrri, Kosovë
- Fabrika e Baterive, Nikel, Kadmium, Gjilan, Kosovë
- Fabrika e Ngjyrave, Vushtrri, Kosovë etj.

Është e qartë se me asetet e Trepçës jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe jurisdikcionet tjera jashtë Republikës së Kosovës, çdo veprim do të varet në masë të madhe nga bashkëpunimi i qeverisë në fjalë.

Në shkurt të vitit 1995, Novak Bjelic është emëruar si Drejtor Gjeneral i Trepçës dhe më pas Bjelic ka ri-vendosur mirëbesimin dhe ka ri-integruar degët e Trepçës. Për shkak të largimit të madh të punëtorëve Shqiptarë të minierave, punëtorë të rinj janë sjellë nga Çekia, Polonia, Bullgaria, Bosnja dhe Serbia. Prej 1995 – 2000, Bjelic ka zhvilluar një seri të manovrave financiare që kanë rezultuar me rritje të borxheve përkundër aseteve të kufizuara të Trepçës. Menaxhmenti i vendosur nga Serbia në Trepçë jo vetëm që ka shkaktuar stagnim teknik dhe teknologjik mirëpo gjithashtu ka bërë edhe aranzhime të dyshimta dhe të dëmshme për Trepçën.

Me 1999, pasi që forcat NATO kanë hyrë në Kosovë, në pjesën veriore të Trepçës ka vazhduar funksionimi i biznesit, përderisa në pjesën jugore punëtorët Shqiptarë nuk kanë mundur të hyjnë në vendet e tyre të punës deri në dhjetor 1999 kur është nënshkruar një marrëveshje ndërmjet UNMIK-ut dhe Sindikatës së Trepçës që lejonte 214 punëtorë të hynin në Stantërg për të bërë gati minierën për prodhim. Në Gusht 2000, KFOR-i dhe UNMIK-u janë detyruar të mbyllin kapacitetet metalurgjike në Zveçan për shkak të ndotjes së ambientit, në këtë kohë afër 1000 punëtorë Serb janë punësuar drejtpërdrejtë dhe të gjithë punëtorët tjerë Serbë në total prej 2316 kanë filluar të marrin ndihmë sociale si përkrahje prej BKK (Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës). Gjatë shtatorit 2001, afër 1000 punëtorë Shqiptarë janë punësuar në pjesën jugore përderisa rreth 5000 punëtorë Shqiptarë kanë mbetur me status të pazgjdhur dhe ndihmë sociale. Kjo situatë e ka detyruar IPVQ (Institucionet e përkohshme të vetë-qeverisjes së Kosovës) që në qershor të vitit 2003 të miratojë Udhëzimin Administrativ për pensionim të hershëm për të gjithë punëtorët e Trepçës që ishin më të vjetër se 50 vjeç. Një numër i konsiderueshëm i punëtorëve tjerë të mbetur (që kanë dështuar në teste mjekësore) kanë fituar pensionin e hershëm, si shtesë ata kanë pranuar edhe një shumë tjetër prej €30 prej fondeve të Trepçës. Prapë në vitin 2005, për shkak të grevave të punëtorëve të Trepçës, IPVQ është detyruar të rrisë shumën për pension të hershëm prej €40 në €50 për muaj.

Duke marrë parasysh madhësinë e konglomeratit dhe faktin se gjatë viteve 1990, 27 NSH janë bashkuar në

RMHK Trepça (që aktualisht ka një numër të madh të padive kundër), në rastin e Trepçës ka qenë e pamundur të trajtohet njëjtë sikurse ndërmarrjet tjera që ishin nën administrimin e AKM-së në atë kohë. Duket se ky ka qenë drejtuesi kryesor për nxjerrje të rregullores së UNMIK-ut 2005/48 (të nxjerrë në nëntor 1005 si Rregullore e re e UNMIK-ut 2005/48- ngjashëm me Kapitullin 11 US) që në thelb lejon emërimin e administratorit i cili mund të bëjë ri-organizimin e ndërmarrjes. Në dhjetor 2005, Bordi i AKM-së ka autorizuar Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës (OVGJS) për administrimin e Trepçës dhe më pas në mars 2006, Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme ka lëshuar “ Vendimin për Moratorium” për riorganizimin e “ Trepçës nën Administrimin e AKM-së” .

Kjo nënkupton që deri në atë kohë administratori është emëruar, OVGJS është pajtuar për moratoriumin e përkohshëm që të ngrij veprimet në gjykatat e Kosovës dhe të parandaloj pagesën/ekzekutimin e ankesave të kërkuara nga gjykatat jashtë Kosovës kundër ndërmarrjes. Rregullorja për Riorganizim gjithashtu përcakton orarin për të cilën AKM-ja është obliguar të organizoj tenderin për shërbimet e një administratori. AKM-ja në atë kohë kërkon për zgjatjen e këtij orari për të siguruar që rregullat e prokurimit të BE-së janë përmbajtur dhe për të siguruar që janë paraqitur shume shprehje të interesi që do të pranohen për këtë pozitë. Më pas AKM-ja, me mbështetje të IPVQ-së kryen tenderin për shërbimet e një administratori dhe disa shprehje të interesit të përshtatshme është raportuar të jenë pranuar. Rregullorja për Riorganizim, siç është konfirmuar në Vendimin e Moratoriumit, të kërkuar nga AKM-ja për të parashtruar në OVGJS shprehjen e interesit dhe të përfundoj ofertat e pranura nga ofertuesit e mundshëm, së bashku me një raport të vlerësimit me rekomandimet për ofertuesin më të përshtatshëm për pozitën e administratorit. Emërimi i Administratorit së fundi ka qenë emërim nga OVGJS dhe jo nga AKM-ja. Raporti me rekomandim për emërimin e Administratorit ka qenë të parashtrohet më 9 Nëntor 2006. Sidoqoftë, AKM-ja nuk ka qenë në gjendje të paraqes raportin me rekomandimet e saja në OVGJS për ofertuesin më të përshtatshëm për administrator dhe procesi i riorganizimit ka ngecur që nga atëherë. Nga raportet e plotësuar duket që IPVQ-ja në kohën kur shprehet mbështetja për riorganizimin e Trepçës ka shprehur shqetësime serioze ndaj administratorit, se administratori nuk do të vlerësoj tërësisht rëndësinë e Trepçës ndaj popullit të Kosovës dhe që administratori nuk do të jetë në gjendje të merret me të gjitha çështjet dhe detyrimet të cilat e dëmtojnë Trepçën. Në këtë rast IPVQ-ja shprehu shqetësimet lidhur me kontributin nga BKK-ja (në kohën kur kapin shumën më shumë se €60 milion, siç janë stipendit dhe subvencionet në Trepçë), çështja e 20% për punëtorët e Trepçës (në rast të privatizimit të aseteve të saja), dhe çështja e detyrimeve të mëdha ambientale (ndotja gjatë viteve të funksionimit të Trepçës).

Megjithatë, mos emërimi i Administratorit, përfshinë rrezik për Trepçën (nëse nuk është ndërmarrë ndonjë veprim), është që Trepça mund të vendoset për likuidim. Kjo do të thotë që Vendimi për Moratorium në vend është një qëndrim për të gjitha ankesat ndaj Trepçës, sidoqoftë, OVGJS në atë kohë ka deklaruar qartë në Vendimin për Moratorium që veprimet e suspenduara si rezultat i moratoriumit “*mund të vazhdojnë me lejen e Odës së Veçantë dhe që “nëse ka vonesë të paarsyeshme, pala e dëmtuar mund paraqes ankesën në Odën e Veçantë për heqjen e moratoriumit.”* Në rast të dështimit të qartë në emërimin e Administratorit (për zbatimin nga ana e AKM-së ose nga vendimi i OVGJS) legjislatura në vend (akoma në fuqi) qartë ofron shndërrimin në likuidim, i cili në rastin e Trepçës do të prodhonte gjendje të paparashikuar dhe jashtëzakonisht e tensionuar politikisht dhe në aspektin social. Prandaj, OVGJS në atë kohë i drejtohet PSSP-së (ZL) ku kërkon sqarime shtesë në lidhje me zbatimin e legjislaturës në këtë rast.

Pavarësisht nga të gjitha këto, janë bërë përpjeke në gjetjen e një zgjidhje lidhur me Trepça. Në gusht 2007, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Minierë, Transport dhe Telekomunikacion (KETIMTT) i Kuvendit të Kosovës (KiK) përgatit një draft rezolute në të cilën KK do të deklaronte Trepçën si Ndërmarrje e Interesit të Veçantë Publik për Kosovë dhe si Ndërmarrje Publike (NP). Po ashtu ai vendim ka kërkuar që procedurat për riorganizimin e Trepçës dhe emërimin e Administratorit të anulohet. Sipas KETIMTT-it, shqetësimi kryesor ka qenë fakti që as Qeveria e Kosovës e as KK nuk kanë kompetencë lidhur me Trepçën. Në këtë kohë është evidente që emërimi i administratorit ka dalë të jetë jashtëzakonisht kompleks, të mos themi i pamundur. Më pas, janë mbajtur disa takime ndërmjet përfaqësuesve të KETIMTT, UNMIK-ut dhe AKM-së dhe janë pajtuar që të kërkohet një këshillë të pavarur nga gjykatësi i falimentimit, më pas ky këshillues i financuar nga USAID-i do të përgatis propozimin për diskutime të mëtejme. Analiza e cila del nga kjo punë ka nxitur partnerët të kërkojnë koncesus duke e përdorur legjislaturën ekzistuese sa më gjatë që është e mundur. Në tetor 2007 një dokument i emëruar Qasja për Rivitalizimin e Trepçës është lëshuar për konsultim.

Në esencë, plani i ri përvijon formimin e Ekipit Riorganizues i cili do të përbëhej prej ekspertëve ndërkombëtar të minierës dhe falimentimit të mbështetur nga një ekip e ngjashme e ekspertëve vendor. Ky ekip i financuar do të inicioj më pas, procesin formal të identifikimit të të gjitha ankesave që i takojnë konglomerati i Trepçës ndërsa, planifikimi i planit për riorganizim për dorëzim në OVGJS. Planit përvijon riorganizimin e Trepçës në një biznes

operues me sukses dhe rregullimi i borxheve të saja, nën mbikëqyrjen e OVGJS-së, që i nënshtrohet të drejtave të kreditorëve dhe konsultimeve me partnerët relevant.

Më pas, zgjedhjet u mbajtën në fund të vitit 2007, dhe fillimi i vitit 2008 e gjeti Kosovën në rresht me prioritetë më të mëdha se sa Trepça. Për më tepër, Agjencia e paraardhëse (AKM) pushoj të gjitha operimet nga 30 Qershori 2008, dhe gjithashtu riorganizimi i OVGJS-së në atë kohë (transferi prej UNMIK-ut në EULEX). Prandaj situatë lidhur me Trepçën mbetet e pazgjedhur.

Situata aktuale:

Si qëndron tani, duket që vendimi për moratorium akoma është në vend. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) rishtas e themeluar, fillimisht janë përballur me vështirësi të jashtëzakonshme kanë arritur të riorganizojnë dhe ristrukturojnë veten, veç kësaj ka arritur të asistoj dhe kontrolloj gjendjen e Trepçës deri më tani në masë të mundur. Trepça edhe më tej pranon fonde të rëndësishme nga Buxheti i Kosovës dhe trendëve pozitive aktuale në tregun global (pas krizës së fundit) me një rast të mire ka ndikim pozitiv në tërë gjendjen financiare të Trepçës, megjithëse nuk ka dyshim që kjo status-quo fare nuk është zgjedhje afatgjatë e qëndrueshme. Duhet të kuptohet qartë se Trepça nuk mund të vazhdoj funksionimin pa mbështetje financiare që e pranon dhe mbrojtjen ligjore. Vendimi i moratoriumit parandalon AKP-në dhe NSH-të për ndonjë veprim lidhur me asetet e Trepçës (thelbësore dhe jo-thelbësore/sekondare). Asetet që i përkasin Ndërmarrjes së Bashkuar i lejon ata që gjerësisht të ndahen në kategori dhe kjo mund të ndihmoj në përcaktimin e strategjisë për ristrukturim të kompanisë, siç është vënë në listë më poshtë:

Miniera dhe Koncentratet (mineralet kryesore dhe asetet për përpunimin e mineraleve)

- Miniera dhe Flotacioni Stan Tërg dhe Tuneli i Parë, Mitrovicë
- Miniera dhe Flotacioni Kizhnicë dhe Novo Bërdë, Prishtinë
- Minierat dhe Flotacioni, Leposaviq

Objektet Industriale

- Fabrika e Baterisë, Mitrovicë
- Industria Kimike, Mitrovicë
- Metalurgjia e Zinkut, Mitrovicë
- Metalurgjia e Plumbit, Zveçan
- Fabrika e Baterisë, Pejë
- Fabrika e Rimorkios, Mitrovicë

Prona komerciale

- Trepça Commerce, Mitrovica
- Trepça Standard, Mitrovica
- Trepça Trans, Zveçan
- Qendra Elektronike Llogaritare, Mitrovica
- Laboratori i Trepçës, Zveçan
- Sigurimi i Pronës, Zveçan
- Banka Trepça, Zveçan
- Energjetika, Zveçan

Kompanitë e regjistruara si NSH pas 1999

- Fabrika e Baterisë, Peja
- Ni- Cd Fabrika e Baterisë, Gjilan
- Fabrika e Municionit për Gjueti, Skenderaj
- Llamkos, Vushtrri
- Famipa Prizren
- Metaliku, Gjakovë

Asetet tjera

- Instituti Trepça, Zveçan
- Instituti i Shëndetit, Zveçan, etj.

Zgjidhja përpara:

Status–kuoja (status-quo) e tanishme nuk është një opsion. Është thelbësore që të gjitha palët relevante së shpejti do të jenë në gjendje të përgatisin, pajtohen dhe miratojnë një qasje të “re” që më në fund do të mundësoj dhe krijoj kushte të cilat do ta largojnë Trepçën nga statusi i një shpenzuesi të Buxhetit të Kosovës në një Kontribuues të Buxhetit të Kosovës.

Në këtë aspekt, unë dëshiroj t’ju vë në dijeni lidhur me faktet dhe hapat në vazhdim të cilët besoj se janë thelbësor për zgjidhjen e mundshme të rastit të Trepçës:

1. Statusi politik i Kosovës ka ndryshuar në thelb nga periudha kohore kur janë marrë vendimet të cilat e kanë bllokuar Trepçën.
2. Tani është koha me urgjencë të madhe për të bërë ndërhyrjet e nevojshme në legjislacionin e tanishëm që e mbulon këtë çështje. Gjegjësisht shumë nga rregulloret e UNMIK-ut dhe disa nga UA (siç janë Rregullorja e UNMIK-ut 2005/48 etj) duhet të ndryshohen/shpallen si Ligje të Republikës së Kosovës, përfshirë ndryshimin e dispozitave përkatëse gjithmonë në pajtim me Planin Gjithëpërfshirës (Plani i Ahtisarit).
3. Riorganizimi i Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme në Kosovë në përputhje me Shtojcën VII – PGJS – neni 3.2 – nën v.) – Shpallja e Ligjit të Republikës së Kosovës mbi DHVGJS të Kosovës.

Qëndrimi i tanishëm i AKP-së është i qartë dhe mbetet i pandryshueshëm, pasi që kjo diktohet nga legjislacioni në fuqi; kjo për shkak se çdo propozim tjetër, përveç atij të riorganizimit përmes Gjykatës së caktuar si administrator për rigjallërimin e Trepçës, është ligjërishit i pamundur dhe për këtë arsye i prirur për të krijuar më shumë dëme në ndërmarrje. Implikimet për sundimin e ligjit në lidhje me pronën dhe të drejtat e kreditorit dhe rrjedhimisht për reputacionin e Republikës së Kosovës si një destinacion investimi mund të jenë gjithashtu të dëmtuara seriozisht. Për më tepër, të drejtat e njeriut siç janë përcaktuar sipas KEDNj mund të jenë shkelur për shkak se procesi lidhur me trajtimin e pronës dhe të drejtat e kreditorit nuk mund të jetë i sigurt jashtë procesit të riorganizimit siç është përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/48 siç qëndron aktualisht ajo.

Qasja e re (ndonjë) dhe rrjedhimisht çfarëdo plani për rigjallërimin e Trepçës DUHET të plotësoj të gjitha standardet e njohura ndërkombëtarisht lidhur me riorganizimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve strategjike si dhe të gjithë aksionarëve tjerë.

Kjo nënkupton dhe kërkon që fondet e mjaftueshme dhe ekspertiza të jenë në dispozicion për të filluar, vazhduar dhe përfunduar procesin e ristrukturimit dhe riorganizimit nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të gjykatës përkatëse (DHVGJS) dhe angazhimin serioz nga institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Në thelb, rruga e propozuar përpara që është si rezultat i mësimave të mësuara nga dështimet në të kaluarën, është si vijon:

1. Një gjykatës i veçantë ndërkombëtar i cili është ekspert në trajnime dhe riorganizim të falimentimit të caktohet në DHVGJS të merret ekskluzivisht me Trepçën dhe mbikëqyr riorganizimin e Trepçës.
2. Menaxhmenti i Trepçës të operoj ndërmarrjen gjatë procesit të riorganizimit me anë të këshillave dhe udhëzimeve të Ekipit të Riorganizimit të përbërë nga ekspert vendor dhe ndërkombëtar.
3. Trepça fiton kapital pune për financimin e rigjallërimit të saj duke shitur asetet e saj jo- thelbësore pas marrjes së autorizimit nga Gjykatësi Special (dhe DHVGJS e Kosovës).
4. Ekipi i riorganizimit i ofrohet Trepçës për të ndihmuar Trepçën me (i) rigjallërimin e operimeve të Trepçës (ii) rishikimin dhe, ku të jetë e nevojshme, dorëzimin në DHVGJS të kundërshtimeve ligjore të ankesave të kreditorëve të cila mund të parashtrohen, dhe (iii) zhvillimin e planit të Trepçës mbi riorganizimin dhe komentimin e ndonjë plani tjetër mbi riorganizim i cili mund të dorëzohet nga ndonjë palë tjetër.

5. Rekomandohet që Republika e Qeverisë së Kosovës të angazhoj një ekip ligjor special të përfaqësoj qeverinë lidhur me plotësimin dhe mbrojtjen e ankesave të kreditorëve të saj, rishqyrtimin dhe ku të jetë e nevojshme dorëzimin në DHVGJS të Kosovës kundërshtimet e padive tjera të kreditorëve dhe gjithashtu mund të ketë mundësinë për të zhvilluar planin e vet qeverisë për riorganizimin e Trepçës dhe të komentoj mbi ndonjë plan të riorganizimit që mund të dorëzohet nga ndonjë palë tjetër. Për më tepër kjo mund të siguroj çdo plan riorganizimi të ketë të bëjë me çështje shoqërore, ambientale dhe pronësore.

Avantazhet kryesore të kësaj qasje janë kryesisht të bazuara në dështimet dhe mospajtimet në të kaluarën, përderisa ato përmbajnë pajtueshmëri me standarde ligjore ndërkombëtare dhe ruajnë reputacionin e Republikës së Kosovës:

1. Kjo qasje do të lejoj procesin e riorganizimit të shkoj tutje pa e vendosur Trepçën nën Administrator (pasi që do të veprojnë nën udhëzimin e ekipit profesional të riorganizimit dhe të monitorohet nga DHVGJS).
2. I siguron Qeverisë së Republikës së Kosovës mundësinë të angazhoj ekspertizë të përkushtuar substanciale mbrojtjes së interesave të saj në përmbajtjen e planit të riorganizimit. Kjo siguron mënyrën ligjore për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe përfaqësimin të komitetit të kreditorëve, prandaj Qeveria siguron rolin e aksionarit përkatës mbi zhvillimin e riorganizimit të planit të Trepçës.
3. I siguron menaxhmentit të Trepçës ekspertizë profesionale të përkushtuar ndaj mbrojtjes së interesit të Trepçës përgjatë procesit të riorganizimit dhe përpjekjeve për rigjallërim.
4. Ruan mbrojtjen shumë të vlefshme nga kreditorët të cilën aktualisht e gëzon Trepça nën Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/48.
5. Do të siguroj që Trepça të jetë në gjendje të merret me kreditorët e saj vetëm në një gjyq juridik, dhe një proces të konsoliduar, brenda Republikës së Kosovës në pajtueshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare.

Ristrukturimi/Riorganizimi/Rigjallërimi i Suksesshëm i Trepçës

Është e qartë se në mënyrë që të zbatohen ndonjë nga të lart-përmendurat, nevojiten përpjekje të mëdha, duke filluar që nga ndryshimi i legjislacionit aktual, sigurimi i aseteve financiare për implementimin dhe zbatimin e projektit etj. Rigjallërimi i suksesshëm i Trepçës në thelb nënkupton që Trepça të jetë e lirë nga detyrimet ligjore për shkak të trashëgimisë së kaluar të saj sa i përket detyrimeve dhe padive. Ky është hapi i parë i cili do të mundësoj (ose gjatë procesit) përgatitjen dhe lirin në treg të burimeve të rëndësishme të aseteve të Trepçës, qoftë përmes privatizimit apo koncesionit apo likuidimit të tyre (në rast të aseteve të vogla jo-thelbësore të Trepçës).

Në çdo rast (pa paragjykuar rezultatin e procesit të riorganizimit dhe rristurimit) shitja eventuale e minierave (apo aseteve thelbësore të Trepçës) është çështje komplekse e cila nuk mund të bëhet shpejtë pasi që investitorët e rinj do të duhet të ndërmarrin hulumtim paraprak gjithëpërfshirës. Investitorët e minierave janë të detyruar të investojnë ku është depozita dhe prandaj duhet të pranojnë rreziqet që janë të pandara nga lokacioni, sidoqoftë t'i bëjnë investimet në Trepçë sa më atraktive të jetë e mundur në mënyrë që të minimizohen apo largohen rreziqet tjera.

7. STRATEGJITË

Qëllimi i këtij dokumenti është të japë një vështrim të përmbledhur të veprimeve të planifikuara për strategjinë e biznesit për periudhën 2009 deri 2011.

Ndërkohë që çdo përpjekje do të bëhet për të qëndruar brenda udhëzuesve të strategjisë së përgjithshme të AKP të hartuar për të kryer mandatin e saj brenda një periudhe 3 vjeçare nën shqyrtim, implikimet më të gjera të krizës së vazhdueshme ekonomike botërore mund të shkaktojnë devijimi të pashmangshme nga plani.

Duhet të pranohet se AKP nuk mund të kontrollojë ritmin e procesimit ligjor pranë Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe as nuk mund të ndikojë mbi nismat domethënëse politike apo ndryshimet e politikave qeveritare që ndikojnë mbi Privatizimin dhe Likuidimin. AKP gjithashtu nuk pret asnjë privatizim apo likuidim të 28 NSH-ve që bien nën Moratoriumin e Trepçës. Aktiviteti i likuidimit është parashikim në lidhje me 30 NSH bujqësore që nuk kanë asete dhe privatizimi i 40 NSH-ve dot realizohet në të ardhmen e afërt dhe për këtë qëllim AKP-ja ka themeluar Zyrën ndihmëse në komunën e Shtërpçës dhe shumë shpejt do të hapë zyre të tilla në Graçanicë dhe Leposaviq.

Aktivitetet të Përgjithshme Administrative

Dega Ekzekutive e Departamentit të Financës dhe Buxhetit, Departamenti i Administratës, Departamenti i Burimeve Njerëzore do të vazhdojnë të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me Organogramin e AKP-së për të mbështetur veprimet e Agjencisë sipas mandatit të saj ekzistues nën ligjin e aplikueshëm.

Departamenti i Shitjes është përgjegjës për të siguruar vazhdimësinë e shitjeve spin off dhe të gjithë likuidimin e shitjeve të aseteve që propozohen nga Komitetet e Likuidimit të cilat udhëhiqen vetëm nga ZQ e AKP. Shitja e këtyre aseteve i ndihmon Agjencisë të ruajë profilin e saj në publik duke plotësuar zbrazëtitrat në valët e privatizimit spin off ndërkohë që numri i Ndërmarrjeve të Reja bëhet më i vogël.

Departamenti i Likuidimit do të vazhdojë të implementojë procedurat e likuidimit dhe dokumentet politike për të siguruar likuidim pa pengesa të NSH-ve si dhe të koordinojë aktivitetet me Komitetet e Likuidimit (KL) në zyrat rajonale.

Departamenti Ligjor do të ofrojë të dhëna të rëndësishme për të gjitha aktivitetet përfshirë privatizimin, likuidimin, prokurimin dhe raste specifike si Trepça .

Nismat Kryesore të 2009

Të gjitha praktikat dhe procedurat e punës të trashëguara të Komiteteve të Likuidimit të krijuara nga Agjencia paraardhëse do të rishikohen, ndryshohen dhe përmirësohen për të pasqyruar ndryshimet legjislative dhe për të krijuar standarde të praktikave më të mira, të cilat në pjesën më të madhe janë përmbyshur.

Baza e të Dhënave të Likuidimit do të konvertohet nga 'Access' në 'SQL' duke përdorur masa sigurie më të fundit të kombinuara me ndryshime të mëdha në kapacitet dhe gjenerimin e raporteve. Kjo do të lehtësojë shqyrtime më efektive nga KL të ankesave të kreditorëve dhe do të përshpejtojë procesin e likuidimit.

APK do të rrisë mbikëqyrjen mbi NSH për të shmangur caktimin e Administrimit të Drejtpërdrejtë si dhe për të përmirësuar administrimin dhe menaxhimin e atyre nën Administrim të Drejtpërdrejtë, që do të jetë i nevojshëm për t'i mundësuar Agjencisë të vazhdojë me Privatizimin dhe/ose Likuidimin.

Plani i biznesit tregon se nga fundi i 2009, një total i përgjithshëm prej 250 NSH do të jenë privatizuar plotësisht ose pjesërisht.

AKP ka trashëguar 166 kontrata privatizimi që duhet të plotësohen. Të gjitha këto 166 kontrata do të trajtohen në 2009, të cilat siç u përmenden më herët janë përmbyshur në pjesën më të madhe.

45 Likuidime të reja ishin planifikuar që t'i paraqiten për miratim Bordit të Drejtorëve (plus rifillimi i 120 lëndëve të trashëguara) dhe 55 lëndë Likuidimi të cilat fillimisht ishin paraparë që të mbyllen. Megjithatë, për shkak të

vonesave të konsiderueshme (më shumë se 12 muaj) lidhur me emërimin e përfaqësuesve të ZNC në Komisionet e Likuidimit, ky synim në mënyrë të qartë më nuk është realistik.

AKP do të botojë 53 lista fillestare që do të sigurohen nga pesë Zyrat Rajonale dhe 34 që janë tashmë pranë departamentit të Likuidimit, përkatësisht Njësia e Listave të Punëtorëve. Agjencia ka publikuar 41 lista të përkohshme dhe AKP do të synojë të shqyrtojë të gjitha ankesat që dalin nga listat fillestare në mënyrë që të publikojë lista finale, gjë e cila tani më është përmbushur.

Me ndihmën e Asistencës Teknikë të ZNKE theksi do të vihet tek trajnimi i stafit në mënyrë që ata të jenë plotësisht të trajnuar dhe të pajisur me njohuri teknike për të mbyllur raste të Likuidimit.

Puna përgatitore në lidhje me NSH 'Qendra Turistike në Brezovicë do të fillojë. Kjo do të kërkojë zhvillimin e një plani të tërësishëm të marketingut, ndihmë për të gjitha palët e interesuara dhe promovim të madh për të kapitalizuar një treg të gatshëm me mundësi për zhvillim.

Nismat Kryesore të 2010

Gjatë 2010, AKP potencialisht do të fillojë privatizimin e rreth 50 NSH-ve (duke pritur rezultatet e analizave financiare dhe ligjore në lidhje me supozimet e transformimeve të pretenduara), duke krijuar një numër të madh të Ndërmarrjeve të reja në komunën e Gjakovës, që pretendojnë të shndërrohen në Shoqëri Aksionare. Ky ushtrim do të thithë vëmendje të konsiderueshme të stafit për shkak të ndërlikueshmërisë së transformimit.

Mesi i 2010 do të jetë pika ndarëse e hapit të ndërrimeve të proceseve nga privatizimi në likuidim. Kjo për faktin se të gjitha NSH pa probleme pronësie apo të ashtuquajturat NSH të pastra janë privatizuar tashmë dhe AKP do ta kthejë vëmendjen nga NSH më çështje të vështira pronësie. Ky ndërrim nga privatizime në likuidime ilustron në mënyrë grafike në përmbledhjen e vështirimit më poshtë. 150 likuidime të reja do të fillojnë në vitin 2010 dhe 120 ekzistuese do të mbyllen, megjithatë kjo shifër fillestare do të duhet të ndryshohet si rezultat i vonesave të konsiderueshme lidhur me emërimet e ZNC.

Nismat Kryesore në 2011

NSH Dragash Sharrprodhimi, NSH Miniera e Boksitit dhe NSH Fabrika Sharr Cement janë ato që do të jenë kryesore në transaksionin e hapur lidhur me privatizimin. Një numër NSH që mund të paraqesin sfidë kryesore për privatizimin mund të rriten gjatë 2010 dhe 2011 si Trepça.


Në 2011, AKP do të bëjë të gjitha përpjekjet për të iniciuar dhe mbyllur grupin e fundit të rreth 140 likuidimeve dhe 170 lëndë do të mbyllen. Në varësi të statusit të moratoriumit, vëmendja mund t'i kushtohet çështjeve të Trepça s përmes privatizimit dhe/ose likuidimit. AKP ka gjasa të vazhdojë me privatizimin e cilësdo NSH që ka mbetur ende e pa privatizuar për shkak të ndërlikueshmërisë.

3 Vështrim i Përgjithshëm i Vitit të Privatizimit


Privatizimi për 3 vitet nën shqyrtim do të rezultojë në një total të vlerësuar prej 106 lëndësh për një periudhë prej 50 privatizimesh të planifikuara për 2010. AKP do të vazhdojë me shitjet përmes dy metodave: metoda me Spin Off dhe likuidim, gjersa Spin Off-et Speciale potenciale i nënshtrohen ndryshimeve të mundshme të legjislacionit aktual.

"Spin-Off" - "Likuidim"


Më poshtë është një vështrim i aktiviteteve të privatizimit:



Privatizimi parashihet të ngadalësohet ndërsa aktiviteti i likuidimit do të rritet si tregohet në grafikun më poshtë:

**3 Përmbledhje e Vitit të Likuidimeve**

Duke përjashtuar 120 lëndët ekzistuese që duhet të rifillojnë në 2009, është planifikuar një total prej 335 likuidimesh të reja. Totali i likuidimeve të reja të planifikuara dhe mbylljes së likuidimeve tregohen në grafikun vijues:

**Komercializimet (trashëguar nga UNMIK ose DTI "Ish Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë")**

Meqë shumica e kontratave të komercializimit skadojnë pas 2011, këto do të monitorohen gjatë 3 viteve nën shqyrtim. Në rast të gabimeve, do të iniciohen veprime ligjore sipas nevojës.

8. PENGESA DHE RRUGA PËRPARA

Historik i shkurtër i pushimit të mandatit të ish AKM-së

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (ish-AKM) është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut No. 2002/12 dhe e ka zhvilluar funksionin e saj brenda Shtyllës IV të UNMIK-ut. Kjo Agjenci e ka zhvilluar mandatin e saj deri në fund të qershorit 2008.

Më 04 qershor 2008, Drejtori Menaxhues i AKM-së Jasper Dick bëri të ditur përmes një qarkoreje (letre) tek të gjitha gjykatat në territorin e Kosovës, përfshirë dhe Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës rreth mundësisë së pushimit të mandatit të AKM-së dhe pamundësisë së kësaj Agjencie për t'u marrë me lëndë gjyqësore ndërlidhur me mandatin e saj.

Në atë letër thuhej si më poshtë, se ndërkohë që AKM e transferonte autoritetin e saj tek PSSP, Qeveria e Kosovës punon për të implementuar legjislacionin, që do të themelonte Agjencinë e re të Privatizimit të Kosovës, e cila do të kishte të njëjtin mandate si AKM.

Prandaj, Drejtori Menaxhues i AKM-së Jasper Dick kërkonte përmes letrës së lartpërmendur të pezulloheshin të gjitha procedurat gjyqësore ky AKM apo cilado NSH, nën administrim të AKM-së, ishte palë dhe ky pezullim fillonte të implementohej që më **1 qershor 2008 deri në 1 shtator 2008**, kur pritej që Agjencia e re – AKP – të bëhej funksionale.

Pezullimi i aktiviteteve procedurale të gjykatave në territorin e Kosovës përfshirë Odën e Veçantë

Duke iu referuar letrës së Z. Jasper Dick – Drejtorit Menaxhues të ish-AKM e datës 4 qershor 2008 dhe Vendimit Ekzekutiv No. 2008/34 për pezullimin e përkohshëm të aktivitetit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe të gjitha gjykata e tjera në nivel komunal dhe të qarkut ë Kosovë kanë pezulluar të gjitha procedurat gjyqësore që kanë të bëjnë me NSH dhe asetet e tyre, ku AKM ishte palë.

Edhe pse përmes kësaj letre kërkohej pezullimi i procedurave gjyqësore dhe aktiviteteve që më 01 qershor 2008 deri më 01 shtator 2008, ky pezullim ka vazhduar deri në fund të 2008, ndërsa për disa raste edhe pas janarit 2009. Kjo ka ndodhur për shkak të bartjes së kompetencave nga ish AKM tek AKP, si një organ publik i pavarur i themeluar me ligj, si dhe për shkak të faktit të fillimit të funksionalizimit të Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme, me staf të UNMIK-ut duke ia bartur përgjegjësitë stafit të EULEX.

Themelimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Në pajtim me Nenin 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Agjencia Kosovare e Privatizimit themelohet si organ publik i pavarur që zhvillon funksionet e saj dhe përgjegjësitë me autonomi të plotë, me Ligj të Kuvendit të Kosovës Nr. 03/L-067 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

AKP themelohet si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 "mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit", të ndryshuar. Të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e AKM-së do të jenë asete dhe përgjegjësi të AKP-së.

Agjencia merr përsipër të gjitha përgjegjësitë në pajtim me Rregulloren e UNMIK 2002/12, të ndryshuar, që Agjencia vetë apo pasuesja e saj ka shkaktuar. Bordi dhe menaxhmenti i Agjencisë përmbushin të gjitha përgjegjësitë e Bordit apo menaxhmentit pasues të emëruar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 të ndryshuar.

Agjencia, përkatësisht Bordi i AKP-së thirret për herë të parë në gusht 2008, për të vazhduar me procesin e privatizimit rast në të cilin u bë dhe miratimi i organogramit dhe politikave operacionale të AKP-së në pajtim me ligjin e zbatueshëm. Më tutje, nisja e Valës së 34 të privatizimit për shtatorin 2008 u miratua etj. Pa vonesë Agjencia dhe menaxhmenti i saj nisën punën për të organizuar stafin dhe për të ushtruar praktikisht mandatin. Që nga ajo datë deri tani Agjencia ka arritur të përmbushë rekrutimin e rreth 95% të stafit të paraparë nga organogrami i AKP.

Sfidat me të cilat përballët AKP si pasardhëse e AKM-së

Që nga fillimi, në punën e saj Agjencia është përballur me disa vështirësi të cilat kanë lënë gjurmë mbi procesin e privatizimit dhe punës së Agjencisë në përgjithësi.

- **Problem kyç i Agjencisë ka qenë dhe vazhdon të jetë mosnjohja e subjektivitetit të Agjencisë Kosovare**

të Privatizimit nga Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe nga ana tjetër Agjencia Kosovare e Mirëbesimit vazhdon të njihet si palë ndërgjyqëse dhe të ftohet Zyra Ligjore e UNMIK, që përfaqësohet nga AKM. Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës, duke mos njohur legjitimitetin e AKP-së si palë ndërgjyqëse krijon vështirësi shumë të mëdha në kryerjen e procedurave gjyqësore të iniciuara në këtë Odë dhe që janë të ndërlidhura drejtpërsëdrejti me AKP-në dhe procesin e privatizimit.

-Është shqetësuese si Zyra Ligjore e UNMIK përmes një shkrese të datës 22 qershor 2009 iu është drejtuar të gjitha gjykatave në territorin e Republikës së Kosovës duke kërkuar që:

“Duke pasur parasysh se UNMIK do të jetë përgjegjës për administrimin dhe mbikëqyrjen e Ndërmarrjeve Shoqërore dhe pronës së tyre nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, kjo zyrë ka nevojë për kopje të të gjithë urdhrave dhe vendimeve të nxjerra që nga qershori 2008 nga gjykata përkatëse e Kosovës, që kanë të bëjnë me Ndërmarrjet Shoqërore dhe Asetet e tyre.

Për shkak të kësaj, zyra do të ishte mirënjohëse nëse mund të urdhëroni sekretarin e gjykatës të hartojë një listë me lëndë në gjykatë të cilat kanë të bëjnë me çështje të ndërlidhura me NSH ku të përfshihen urdhrat dhe vendimet që nga qershori 2008.

Kjo zyrë gjithashtu do të ishte mirënjohëse nëse ju na siguron kopje të urdhrave dhe vendimeve dhe t’i lejoni qasjen në lëndë të gjykatës një përfaqësuesi të emëruar nga UNMIK-u në bazë të listës së siguruar nga shkrimorja e gjykatës dhe ta lejoni këtë përfaqësues të marrë ose bëjë kopje në gjykatë sipas nevojës.”

Kjo kërkesë krijon pasiguri dhe konfuzion që ndikon drejtpërsëdrejti mbi zvarritjen e procesit të privatizimit.

Përveç pengesave ligjore dhe praktikave të lartpërmendura ia vlen të përmendet fakti se që më 17. 2. 2008, në Kosovë, të gjitha autorizimet dhe kompetencat ligjore që PSSP dhe UNMIK-u kanë pasur për administrimin e pronës shoqërore dhe publike i janë bartur organeve legjitime të Republikës së Kosovës, ndërkohë që me Ligjin mbi AKP, kjo e drejtë i besohet ekskluzivisht Agjencisë Kosovare të Privatizimit duke përjashtuar UNMIK nga të qenit pasuesi ligjor i ish AKM-së, që ka pushuar së ekzistuari si dhe Zyrat e tij Ligjore.

- Gjithashtu, qëndrim i Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës krijon konfuzion edhe më të madh dhe dilema, pasi me anë të direktivës së saj SCA - 09 - 0024 të datës 02 korrik 2009 kërkon nga Agjencia Kosovare e Privatizimit të deklarojë nëse zyrtari i AKP është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës apo Serbisë. Kjo nënkupton se Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës nuk njeh aspak ekzistencën de jure dhe de facto të AKP, që është themeluar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Për rrjedhojë, një kërkesë e tillë e cila bëhet nga Oda e Veçantë është në kundërshtim me nenin 24.1 të Urdhërësës Administrative Nr. 2008/6, ku parashihet se Agjencia përjashtohet nga ky rregull në lidhje me palët e tjera në procedurë gjyqësore, sepse Agjencia, sipas Ligjit, mund të përfaqësohet nga avokatë të kualifikuar nga vetë stafi i tij. Një urdhërësë e tillë si kjo e Odës së Veçantë nuk është e kuptueshme dhe është e paligjshme. Një tjetër problem që shkakton paqartësi dhe funksionim jo të rregullt të AKP gjatë procesit të privatizimit në Republikën e Kosovës është edhe zbatimi i dispozitave të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit në mënyrë selektive, gjatë procedurës ankimore lidhur listën e punëtorëve që kanë të drejtë të marrin pjesën e 20% nga fitimi i privatizimit të NSH-ve. Mund të bëhet pyetja se cili Ligj është relevant për Odën e Veçantë për të rishikuar procesin e ankesave, a është Rregullorja Nr. 2008/4 si ligj i zbatueshëm për rastin konkret, apo është Ligji mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 03/L-067 i datës 21 maj 2008. Kjo gjykatë, për shkak të arsyeve zyrtare, që nuk kanë pasur ndikim mbi marrjen e vendimit të duhur për të hartuar listën përfundimtare të punëtorëve, anulon listën dhe kështu pengon dhe vështirëson procesin e shpërndarjes së fitimeve nga fondi 20% i NSH-ve.

Vendimet e Odës së Veçantë në shumë raste mbështeten mbi të tjera baza, mbi atë të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nuk njeh subjektivitetin e AKP. Për rrjedhojë, Oda e Veçantë nuk ka një qëndrim ligjor të qartë se cili është ligji i zbatueshëm në Kosovë. Nxjerrja e ligjit për OVGJS sipas planit të Ahtisarit është thelbësore për punën e AKP-së.

Duke pasur parasysh këto rrethana, Agjencia konsideron se është më se e nevojshme të harmonizohen çështjet që kanë të bëjnë me kornizën legjislative mbi të cilën është mbështetur procesi i privatizimit në Republikën e Kosovës duke përfshirë edhe qëndrimet e Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjithashtu, është më se e nevojshme të hartohet ligji mbi Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, i cili ligj do të zëvendësonte Rregulloren e UNMIK-ut.

Asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore jashtë vendit

Një tjetër çështje me rëndësi me të cilën përballlet AKP ka të bëjë me pronat / asetet e NSH-ve që gjenden jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe shndërrimin e këtyre pronave nga persona të paautorizuar, sidomos prona / asete në Mal të Zi dhe Serbi.

Agjencia e Privatizimit të Serbisë aktualisht po shet asete të NSH-ve që gjenden në territorin e Republikës së Serbisë si rasti i disa dyqaneve të NSH Jatex, për të cilën të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës janë njoftuar me rregull. Duhet të theksohet se 55 NSH kanë më tepër se 155 asete në republika të ndryshme të ish-Jugosllavisë.

Në gjykatat e këtij shteti po zhvillohen konteste ligjore që në vitin 2001 lidhur me NSH Rekreaturs-Prishtina e cila ka asete në Kamenova-Budva (3.3 hektarë) si dhe Industria e Mishit me ngrirje – Fushë Kosovë (asetet e kësaj ndërmarrjeje gjenden në qytete të ndryshme të Malit të Zi).

Po bëhen hulumtime për identifikimin e të gjitha pronave të NSH jashtë dhe një prej tyre është kampi veror për fëmijë në Beçiq dhe Sutomore.

Por pavarësisht përpjekjeve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit autoritetet gjyqësore të Malit të Zi refuzojnë të njohin Agjencinë Kosovare të Privatizimit si palë në procedurën e ndërlidhur me këto NSH dhe në të njëjtën kohë refuzojnë subjektivitetin e kësaj Agjencie.

Kjo bën të pamundur implementimin e Nenit 5.2 të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Agjencia, në kapacitetin e saj ka vepruar shumë herë, duke ushtruar mandatin e saj ligjor dhe ka ndërmarrë veprimet e duhura lidhur me përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të NSH-ve dhe aseteve të tyre. Stafi i AKP ka shkuar në gjykatat e Malit të Zi dy herë për dy NSH, në lëndë të veçanta, por jemi përballur me pengesa të pakapërcyeshme nga gjykatat e këtij shteti duke mos njohur subjektivitetin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit si palë në procedurë që sipas ligjit është organ me kompetencë ekskluzive për administrimin, menaxhimin, shitjen dhe privatizimin e NSH-ve në Kosovë dhe jashtë.

Duke mos qenë në gjendje të marrin pjesë në procedura gjyqësore në cilësinë e palës, Agjencia ka punësuar një firmë ligjore nga Mali i Zi për të përfaqësuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit lidhur me mbrojtjen e interesave të NSH Rekreaturs Prishtina. E njëjta kompani merret edhe më lëndën e një tjetër NSH Industria e Mishit me ngrirje “Kosova” që ndodhet në Fushë Kosovë në kontestin ligjor për çështjen e pronësisë të aseteve të NSH (dyqane dhe mjedis administrative) në Mal të Zi.

Dy lëndët janë shumë komplekse dhe janë pothuajse të ngjashme lidhur me natyrën e problemeve sepse në këto lëndë kemi të bëjnë me transferim të pronës nga persona të paautorizuar dhe transferim të zyrës qendrore të NSH nga Kosova në Mal të Zi.

Duke pasur parasysh zhvillimet me të cilat përballlet Agjencia në fushëveprimin e punës së saj, mendojmë se duhet të ndërmerren hapa konkretë për të rritur vetëdijesimin e institucioneve relevante të Republikës së Kosovës dhe për të kërkuar prej tyre komunikim ndërshtetëror në sferën diplomatike duke ngritur dhe duke trajtuar çështjet e lartpërmendura me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje të përshtatshme.

Asetet e zëna nga UNMIK-u, KFOR-i, EULEX-i dhe Institucionet e Kosovës

Është shumë me rëndësi të theksohet që një numër i konsiderueshëm i aseteve të N.Sh-ve janë të zëna nga Institucione të ndryshme ndërkombëtare dhe të vendit siç janë: KFOR, UNMIK, EULEX, Qeveria dhe Komunitat dhe privatizimi i këtyre do të shtyhet gjersa këto të lirohen dhe t'i dorëzohen N.Sh-ve. AKP tashmë ka nënshkruar Marrëveshjen e Mirëkuptimit me Ministrinë e Administratës Publike lidhur me asetet e zanuna nga Institucionet e Republikës së Kosovës. AKP është duke vazhduar negociatat me Institucionet e tjera Ndërkombëtare në mënyrë që të formalizohen marrëveshjet mbi Qiradhëniet.

Propozim për Amendamentimin e Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të privatizimit Nr. 03/L-067

Rrethanat e reja në Republikën e Kosovës pas 17 shkurtit 2008, kanë pasur ndikim mbi rrjedhën e ushtrimit të mandatit të Agjencisë me vështirësi dhe zbrazëtira ligjore të natyrës procedurale që kanë rezultuar në nevojën për të freskuar dhe ndryshuar Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në këtë rast, Agjencia ka paraqitur disa propozime për të freskuar dhe ndryshuar Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit:

Propozimi 1

Në nenin 10.2, të futet paragrafi c)

“c) do të krijojë rrethanat nën të cilat Agjencia mund të kërkojë nga palët ofertuese për aksione në Korporata të paraqesin një plan biznesi të zbatueshëm për atë Korporatë, duke përfshirë aktivitetet e propozuara, investimet dhe nivelet e punësimit, dhe dëshmi të mjeteve financiare për të bërë investimet e parashikuara në planin e biznesit dhe të specifikojnë se si këto kritere do të merren parasysh nga Agjencia në vlerësimin e një oferte.”

Arsyet

Teksti i ri i propozuar është përkthim fjalë për fjalë i të njëjtës dispozitë që ka ekzistuar sipas Rregullores së UNMIK-ut nr 2005/18, e cila ka qeverisur operacionet e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit para se të trashëgohet nga Agjencia Kosovare të Privatizimit (AKP). Paragrafi c) është një dispozitë shumë e rëndësishme sa ajo jep autorizim ligjor në bazë të të cilave Bordi i Drejtorëve të AKP ka të drejtë të rregullojë procedurat për Spin Of-in Special me anë të politikave operative. Paragrafi c) nuk është përfshirë në Ligjin për AKP-në për arsye të panjohura për AKP-në. Megjithatë, duke ditur se AKP-ja ka ende shumë kontrata të Spin Of-it Special nën administrimin e saj, dhe se politikat operative të cilat AKP-ja i ka miratuar në mënyrë eksplicite merren me procedura të tillë është konsideruar e nevojshme për të rivendosur dispozitën që ka ekzistuar në fillim sipas legjislacionit të kaluar si një klauzolë të mundësuar për politikat ekzistuese operationale.

Propozimi 2

Ndryshimi i neneve 12.1 dhe 12.3 të cilat thonë si në vazhdim:

“12.1 Bordi do të përbëhet prej tetë Drejtorëve.

12.3 Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar do të caktoj tre ndërkombëtar si Drejtor të Bordit dhe një ndërkombëtar si Drejtor Ekzekutiv i Sekretariatit të Bordit. Bordi gjithashtu do të caktoj tre anëtarë të tij, përveç Kryesuesit për të shërbyer si Zëvendës Kryesues.”

Propozimi 3

Ndryshimi i nenit 16.3 i cili thotë si në vazhdim:

“Drejtori Menaxhues dhe dy Zëvendës Drejtorët Menaxhues do të caktohet nga Bordi me emërtim nga Kryesuesi. Procedurat për caktimin e kandidatëve për Drejtor Menaxhues dhe Zëvendës Drejtor të emërtuar nga Kryesuesi do të përcaktohen në rregullat e nxjerra nga Agjencia. Drejtori Menaxhues dhe Zëvendës Drejtorët mund të largohen në çdo kohë nga Bordi. Bordi do të vendos për pagesën si dhe kushtet tjera të shërbimit për Drejtorin Menaxhues dhe dy Zëvendës Drejtorët pa paragjykim të nenit 16.5 më poshtë. Drejtori Menaxhues apo ndonjë nga Zëvendës Drejtorët Menaxhues të caktuar nga Drejtori Menaxhues do të marrin pjesë në baza të rregullta në mbledhje të Bordit; ata mund të propozojnë dhe diskutojnë çdo pikë të rendit të ditës por nuk do të kenë të drejtë vote.”

Arsyet:

Neni aktual 12 i Ligjit për AKP-në parashikon se Bordi i Drejtorëve, e cili është organi vendim-marrës i AKP-së, ka Drejtorin Menaxhues ndërmjet anëtarëve të tij. Nga ana tjetër, Drejtori Menaxhues është përgjegjës për kryerjen e veprimtarisë së zakonshme të Agjencisë dhe për kryerjen e funksioneve të tjera ekzekutive, siç përcaktohet me ligj. Kjo e vë Drejtorin Menaxhues në një situatë ku ai / ajo ka në të njëjtën kohë autoritetin e vendim-marrjes dhe të pushtetit ekzekutiv, dmth ai / ajo mund të votojë për çështje që ai / ajo ka për të ekzekutuar. Kjo qartë mund të rezultojë në një konflikt të interesit, gjë që me konsiderate të qeverisjes së mirë duhet të shmanget. Për qëllim të evitimit të konfliktit të tillë të interesit, amendamentet e propozuara kanë për qëllim të krijojnë një ndarje të qartë midis Bordit dhe menaxhimit ekzekutiv, e cila është një strukturë organizative që aplikohet në mes organeve të tjera të pavarura në Kosovë.

Propozimi 4

Të futet neni i ri 31.4 i cili thotë si në vazhdim:

“31.4 Kurdo që vendimet ekzekutive të nxjerra nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me administrimin, privatizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore, si dhe kontrata për të cilat Agjencia Kosovare e Mirëbesimit është caktuar si palë, kërkojnë miratim, autorizim apo në ndonjë formë tjetër, një autorizim të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, miratimi i tillë, leje apo autorizimi do të jepet nga Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit.”

Arsyet:

Para hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, operacionet e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit – tani e trashëguar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit - ka qenë e qeverisur me ligje të UNMIK-ut, sipas kompetencave të ashtu-quajtura të rezervuara të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). Duke vepruar sipas këtyre kompetencave të rezervuara, PSSP-ja ka qenë i caktuar në kontratë si autoritet për të miratuar transaksione të caktuara, p.sh. të miratojë ushtrimin e opsionit për tërheqje të aksioneve në kuadër të marrëveshjes së zotimeve të nënshkruar ndërmjet Agjencisë dhe blerësit të një ndërmarrje në pronësi shoqërore sipas procedurave të spin of-it special. PSSP-ja ishte imponuar si autoritet autorizuar për të siguruar se UNMIK-u mban kontrollin e operacioneve që janë ndërmarrë nën kompetencat e rezervuara të PSSP-së dhe për të siguruar përputhje me rezolutën 1244. Kjo nuk është më e nevojshme sipas rendit të ri kushtetues të Kosovës.

Ndërsa Ligji për AKP-në është rregulluar për të zëvendësuar çdo referim ndaj UNMIK-ut dhe PSSP-së, kjo nuk ka ndodhur ende me ligjet e tjera që lidhen me veprimtarinë e Agjencisë. Më tej kësaj, ka një numër të kontratave në të cilat Agjencia është palë, gjë që gjithashtu duhet të rregullohen për të pasqyruar kuadrin e ri ligjor sipas Kushtetutës dhe Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Propozimi). Neni 31,4 i ri i propozuar ka për qëllim të jetë një klauzolë që ia mundëson Bordit të ketë sukses në autoritetin e PSSP-së për të miratuar transaksione të caktuara.

Bordi konsiderohet të jetë organi më i përshtatshëm që të trashëgojë kompetencat e përmendura të PSSP-së. Sipas propozimit, Agjencia është organi publik që ka autoritet ekskluziv për të administruar, privatizuar dhe likuiduar-ndërmarrjet në pronësi shoqërore dhe asetet e tyre. Agjencia është themeluar si një organ i pavarur, i cili i përgjigjet Kuvendit dhe e cila është e pavarur nga ekzekutivi. Për këto arsye, Kryeministri dhe Qeveria kanë qenë të përjashtuara, si pasues të mundshëm të autoritetit të lartpërmendur të PSSP-së, si ndryshe Agjencia, si një organ i pavarur, do të ishte vendosur nën një shkallë të caktuar të kontrollit nga dega ekzekutive, e cila është në kundërshtim me formulim dhe frymën e legjislacionit ekzistues dhe Propozimit.

Dhënia e autoritetit për miratimin e transaksioneve të caktuara në Kuvend do të rezultojë në politizimin e operimit teknik dhe menaxherial. Kushtet nën të cilat Agjencia mund të ushtrojë opsionin për tërheqjen e aksioneve janë përcaktuar në detaje në marrëveshjet përkatëse të zotimeve. Politizimi i një operimi të tillë do të bart shumë rreziqe, duke përfshirë edhe atë të veprimit të vonuar, i cili do të rezultojë në humbje financiare ndoshta me ndikim të madh social dhe ekonomik.

Vet Bordi është i përbërë nga anëtarë ndërkombëtarë dhe vendor. Ai gjithashtu ka garancitë e nevojshme ligjore dhe procedurale për të siguruar se çdo vendim i marrë nga Bordi është në përputhje me ligjin në fuqi dhe me standardet e njohura të të drejtave të njeriut. Në kuadrin e këtyre masave mbrojtëse dhe duke pasur parasysh faktin se Bordi është më se i njohur me çdo marrëveshje kontraktuale në të cilën ka hyrë, Bordi konsiderohet si më i përshtatshmi për të pasuar në autoritetin e PSSP-së siç është shpjeguar më lart.

Ndryshimet në lidhje me procesin e likuidimit

Departamenti Ligjor konsideron se nevojitet të bëhen ndryshime dhe freskohet Ligji mbi AKP. Si dhe lidhur me procedurën e likuidimit edhe pse përmes këtij ligji kjo procedurë është shumë e gjatë dhe e ngarkuar dhe si e tillë e pafavorshme për palët dhe agjencinë.

Sipas Ligjit mbi AKP procedura e likuidimit deri në realizimin final të kërkesave të kreditorëve përfshirë dhe procedurën e ankesës zgjat deri në 270 ditë për secilën kërkesë.

Agjencia, në planin e saj të veprimit për likuidim ka krijuar 120 Komitete Likuidimi për likuidimin e aseteve të ndërmarrjeve që janë privatizuar dhe për ato që janë shitur për herë të parë përmes likuidimit.

Konsiderojmë se gjatë procesit të likuidimit nevojitet të harmonizohet Ligji mbi AKP me Urdhëresën Administrative 2007/1 dhe të bëhen përpjekje për të shkurtuar afatet për shqyrtime apo ankesat e kreditorëve nga Komitetet

e Likuidimit dhe Komitetet e Shqyrtimit të Likuidimit si dhe të gjenden afate të arsyeshme për të përshpejtuar procedurën e shqyrtimit të kërkesës.

Të gjitha këto janë me qëllim të implementimit të suksesshëm dhe efektiv të mandatit të AKP.

Agjencia ka përgatitur një Doracak i cili do të miratohet nga Bordi i Drejtorëve të AKP dhe i cili rregullon procedurën e shpërndarjes së 20% nga fitimet e privatizimit të NSH-ve. Ky doracak rregullon të gjithë procedurën e shpërndarjes së 20% nga fitimi i privatizimit duke filluar me hartimin e listave të përkohshme deri në përfundimin e procedurës administrative brenda AKP dhe Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Draft ligji që lejon përdorimin dhe shkëmbimin e patundshmërisë mes NSH dhe komunës

AKP ka krijuar një grup punues që po merret me hartimin e ligjit për lejimin e përdorimit dhe shkëmbimit të patundshmërisë mes NSH dhe komunës.

Synimi i këtij drafti është të caktojë procedurën sipas së cilës komuna lejon përdorimin e patundshmërisë komunale dhe shkëmbimin e saj me patundshmëri shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për qëllime të interesit publik.

Ky draft ligj përcakton metodën e dhënies së përdorimit afatshkurtër deri në 10 vjet dhe afatgjatë mbi 10 vjet dhe jo më shumë se 99 vjet, shkëmbimin e patundshmërisë komunale me pronësi shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, monitorimin dhe regjistrimin e patundshmërisë komunale.

Konkludim

AKP-ja beson fuqimisht se është nevojë urgjente ndryshimi i legjislaturës aktuale lidhur me aktivitetet e AKP-së dhe Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe pajtueshmëria e tyre e plotë me dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Status nga Presidenti Ahtisaari.

Këto përmirësime të nevojshme në legjislaturën aktuale janë kërkuar në mënyrë që të mundësoj funksionimin e duhur të AKP-së dhe OVGJS-së së Kosovës e që padyshim se do të shpejtojë tërë procesin e privatizimit dhe në veçanti procesin e likuidimit dhe shpërndarjen e 20% për punëtorët e kualifikueshëm duke i lejuar AKP-së të përmbush mandatin e saj brenda kornizës kohore.

Megjithatë, derisa të bëhen ndryshimet e tilla, AKP-ja do t'i përmbahet tërësisht dhe do të vazhdojë operimin e saj në pajtim të plotë me legjislaturën aktuale. Duke pasur parasysh që legjislatura aktuale, në veçanti për likuidimin, parasheh që përfundimi i një procesi të vetëm të likuidimit për një NSH, pas privatizimit të aseteve të saja, merr për afërsisht 42 muaj. Duke patur parasysh faktin që portfolio e ndërmarrjeve nën administrimin e AKP-së numëron 599 NSH, pavarësisht nga dëshmia që një numër i rëndësishëm i likuidimeve mund të kryhet në të njëjtën kohë dhe që procesi i likuidimit të 120 NSH-ve ka rifilluar, akoma në praktikë, është e pamundur të përfundoj të gjitha ato brenda të paktën 5 vitet e ardhshme.

Veç kësaj, për shkak të pasigurisë së madhe në lidhje me asetet e NSH-ve jashtë territorit të Republikës së Kosovës, pamundësia e AKP-së të privatizoj NSH-të strategjike përmes metodës së Spin off-it Special, pritet që AKP-ja do të has në vonesa të mundshme në përfundimin e privatizimeve dhe likuidimeve përkatëse.

Gjithashtu dëshiroj të përsëris nevojën shumë të madhe të nxjerrjes së ligjit që do të mundësoj procedurën e shkëmbimit e tokës ndërmjet institucioneve të ndryshme të Republikës së Kosovës dhe NSH-ve për interes të përgjithshëm.

Në fund, dëshiroj të shpreh faleminderimin tim për Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian (ZNKE) në Kosovë për mbështetjen financiare.

Dino Asanaj,

Kryetar i Bordit të Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit